

**SULEJMAN
KRASNIQI**

Roman

**BETEJA
TE
NENDHESHME**

8JM-31
KPS

SULEJMAN KRASNIQI

~~Fadil~~ ~~Gorenaj~~ 9-24
Dt. 15-10-78

BETEJA TË NËNDHESHME

Roman



43776

2000
600
2600

1800
800
2600

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

BOSËTË DOLLARIT
Bankieri

KREU I

Ai u kthye nga puna i rraskapitur. Më tepër e dërrmomin mendimet e këqija sesa puna që bënte.

Derën ia hapi tezja e tij, zonja Serme. Ajo i hodhi një vështrim çapkën, pastaj bashkoi gishtin tregues me të madhin dhe i kërciti tri herë, siç bënte njëherë e një kohë kur thërriste kamarierin në mejhanen «Ballkan».

Miho Gjelasin e habiti ai ngazëllim i beftë, po iu kujtua se tezja u besonte ëndrrave, ndaj u ngrys.

— Nipçe, sihariq!

— Për kokën tënde, më ler në hallin tim, mos ma ngacmo plagën!

— Nipçe, Ortaku u kujtua për ty...

Mihoja ngeci në prag. Ktheu kryet prapa e, pasi përfshiu me sy të dyja anët e rrugicës, u fut së prapthi brenda. Mbylli shpejt portën me lloz, u mbështet me kurriz mbi të dhe u mbush me frymë sikur të kishte harruar të mernte frymë për një kohë të gjatë. Ndërkaq Sermja ngriti palën e çngjyrosur të robdeshambrit. Mihoja vuri re një paqetë cigaresh të jashtme. Vuri dy pëllëmbët mbi dorën e tezes, e shtyu atë brenda, mbylli edhe derën e dhomës, pastaj ia rrëmbeu paqetën nga dora dhe deshi ta hapte.

Në atë kohë trokiti dera e jashtme e oborrit. Nip e teze shikuan njëri-tjetrin me sy të zgurdulluar, pastaj nga porta.

— Ku ta fshehim?!, — belbëzoi Mihoja i shastisur.

Sermja ia rrëmbeu nga dora paqetën, deshi ta fshihte në trup, por u pendua. Mihoja i vuri kurrizin derës. Sermja u kërrus te pragu i aneksit që e përdorte si kuzhinë,

fshehu paqetën dhe u drejtua duke mbajtur frymën. Kur vuri re se si i ngriheshin dhe i uleshin hojëzit të nipit, u skërmit.

Dera e jashtme trokiti sërish.

— Ku të fshihem?, — pyeti Mihoja.

— Futu nën fustanin tim!, — shfryu ajo me mllef.

— Duhet të kuptosh, — foli Mihoja me zë të ulët, — duhet të jemi të kujdesshëm! Qemë shumë, të gjithë vanë...

— Ne që mbetëm, ç'bëjmë!

— Shëëëët!

Sermja hapi derën e dhomës e pyeti që nga pragu:

— Kush troket në derë?

— Hape, jam Diamanta, — foli me zë të ulët mysafirja.

«Eh, moj e uruar, ç'ma ngrive gjakun!», — bërbeliti

Sermja dhe vajti të hapte derën e oborrit. Mihoja doli në prag me gjunjët që i dridheshin dhe, ndërsa ato përqafoheshin përmallshëm, ai pështyu në drejtim të tyre. Hynë në dhomë duke u puthur.

— Shyqyr që u kujtove, moj zonjë, — ia pat Sermja mysafires dhe e puthi sërish. Mihoja, që tani ishte ulur në një kanape me mbështetëse të lartë, ia zgjati dorën Diamantës.

— Hallë, si je?, — e pyeti dhe me marifet vuri gishtin mbi buzë e i bëri shenjë teze Sermes të mos fliste për të fshehtë nën pragun e aneksit. Tezja u kollit, sikur deshi të thoshte: «Ato punë i di unë, fërko fytyrën, se të ka ikur gjaku, atë bëj ti!». Pastaj iu kthye Diamantës:

— Shyqyr që u kujtove, moj zonjë! Si me porosi të engjëllit na zbritë në furrikun që na kanë lënë.

— Jeni në Tiranë, mos u qani!, — tha Diamanta duke iu afruar pasqyrës së madhe.

— Oh, sa mirë bëre që erdhe!, — foli sërish Sermja.

— Lajme të mira ishalla!, — uroi Diamanta dhe zhbiroi hulumtueshëm nip e teze.

Mihoja brofi, mbylli kanatat e dritares e, për të ndërruar muhabet, pyeti Diamantën:

— Hallë, si është Giçi? Ekaterina si vete?

— Gjersa janë të reja, mund të presin ditë më të mira, mor nipçe. Të mos qe kjo kockë, ato do të harronin gjakun

e fismë dhe sojin. Tani që kanë nisur të turbullohen ujë-
rat, më japin hak.

— Për ç'ujëra e turbullira flitet?, — u interesua Mihoja.

— Ai dëgjon radion. Disa stacione të andejshme... flasin për grindje midis aleatësh.

— Kush të tha, zotëria?, — pyeti Sermja.

— Ai, — u përgjigj Diamanta dhe vodhi me sy Mihon.

Tjetri buzëqeshi e uli kokën. E dinte se zotëri i thoshin Llaqi Likos. Vërejtji vjedhurazi hallën në pasqyrë. «Vazhdon të mbahet mirë», — tha me vete dhe iu kujtua një bisedë e hershme midis babait dhe nënës së tij.

— «Ajo motra ime, Diamanta, ka gjetur shesh e bën përslesh, — i pat thënë i ndjeri Shahin së ndjerës Elmaze.

— Po i vë burrit brirë.

— Mirë ia bën, ç'iu desh zotit Durrmish ta shpinte atë tyryfyle në Venecia!

— Mor matuf, je gjashtëdhjetëvjeç, po jot shoqe, ime motër, është e re, e bukur. Ç'e lë të livadhisë qyteteve të botës?

— Ajo po e dredh me atë harramin e tregtarit të lëkurëve, Llaqi Likon. Edhe Talo Dylberi i bën elozhe.

— Diamanta kënaqet. Nuk kam hallin e saj, por bota thonë: *E motra e Shahin Gjelacit*. Myshterinjtë i kam xhahilë, kanë filluar të më tregojnë kurrizin...».

— Nuk do të vdesim buzëplatur e zemërpërvëluar. Do ta rigëzojmë jetën. Do të hakmerremi për të gjitha, — po i thoshte Diamanta tezes.

Mihoja ndërpreu kujtimet e vështroi me kureshtje dhe habi.

— Ç'më vështron ashtu, nipçe? Mos të është holluar gjaku që përpiqesh të harrosh ç'na kanë punuar?! Fundjaty ta kanë punuar, sa për mua, një copë bukë e ha rehat.

— Mos e lëndo, zonjë, — foli Sermja, — tërë jetën gojëkyçur ka qenë Mihoja ynë.

— Kush më shumë se Mihoja ka për të marrë hak, — shpërtheu Diamanta. — Nëse ky i ka futur veshët në lesh, është detyra jonë që ta kujtojmë. I gjori, vëllai im, Shahini, ishte ndryshe. Idhnak, i zoti. Trim ishte vëllai im, babai i këtij qyqari! E hodhi në erë depon bashkë me veten, sepse

nuk deshi t'ua mbushte zorrët partizanëve, nuk deshi që malli ynë të binte në duart e këtyre.

— Shëët, — vërejtji Mihoja, — të lutem, hallë, mos fol me zë të lartë. Mos e lejo gjuhën të lëvizë pa frenë! Të gjithë e dinë se depoja jonë u bombardua nga avionët e Ingliterës.

— Mos edhe ti mendon ashtu?! Ç'avionë, mor gjak-uthull, ç'avionë, mor teveqel!, — shpërtheu Diamanta. — Shërbyesi ynë që shpëtoi ma tha me gojën e vet: *Zotëria u çmend, minoi tërë depon dhe ndezi fitilat.*

— Po, ashtu që vërtet, — pohoi Mihoja dhe iu kujtua ç'kishte ndodhur kur kishte marrë vesh se ç'do të bëhej me mallin. Kishte dërguar shoferin. Ai që kthyer bosh e i kishte thënë se ç'kishte ngjarë. Atij sa s'i kishte rënë pika. Kishte përbiruar nëpër deriçka e rrugica. Flakët e depos lëpinin çatinë. Diamanta dhe shërbyesi çuçurinin dhe rrihnin kokën. E kishte thirrur shërbyesin e ai i kishte thënë se zotëria ishte çmendur, me dorën e vet i kishte vënë flakën depos, e kishte minuar. Diç kishte dashur të thoshte, po atë kohë një partizan dhe një partizane po aviteshin me vrap. E kishte tërhequr shërbyesin. Po ai, sikur të ishte mbërthyer nga xhindët, i ishte hakërryer. «Lëshomë, prej ditës së sotme s'kam punë me ju. E di përse e bëri Shahini atë punë. Do të...»

Mihoja e kishte mbërthyer për zverku. «Plak ishte i handakosuri, — tha me vete, — po i fortë. Mezi e futa në bodrumin e zotit Liko...». Dhe iu kujtua thika që i kishte ngulur prapa kurrizit shërbyesit të gjorë.

— Shyqyr që shërbyesi vdiq, ndryshe..., — tha Sermja.

— Ndryshe çfarë?, — pyeti Diamanta.

— Hallë, — ia pat Mihoja, — unë të gjitha i di, por zogu nuk fluturon pa iu rritur puplat që ia kanë prerë.

— Ashtu thuaj, ashtu të do halla, — u pajtua Diamanta.

— Si jeni ju, — foli Sermja, — pa u parë mirë, dorën në kobure.

— Nga zemra e plasur, zonjë, — tha Diamanta.

Sermja vuri xhezven mbi furnelë. Diamanta iu afrua Mihos.

— Nipçe, mjaft i heshtur e tinëzar je, kurrgjë në dritë nuk po na nxjerr!

Ai tundi kokën.

— Ke mbetur vetëm, ta qaj hallin, po besoj se Ekaterina do të dijë të rikthehet në Tiranë, — dhe mori një pamje më krenare.

— Ndonjë transferim?, — pyeti Sermja nga aneksi.

— Me punë, me shkollë, apo?... — pyeti Mihoja.

— Edhe kështu, edhe ashtu, — u përgjigj Diamanta, — ka zënë sevda me një student në gjeologji. Edhe student është, edhe komunist.

— Inxhinier gjeolog? Feja vetë!, — tha Mihoja.

— E dredh punën Diamanta, — tha Sermja. — Kjo, po të kishte qenë mashkull, edhe Çurçillit do t'ia kalonte në diplomaci.

— Nuk thua po të kisha banuar në Tiranë si ju. Mësoni pra, po arriti të martohet Ekaterina me gjeologun, të bëjë pasaportizimin në Tiranë, do të më tërheqë edhe mua. Atëherë do ta shikoni si di ta vërtisë situatën kjo Diamanta.

— Edhe pa këto që thua, unë kam besim te ti, — tha Sermja duke mbushur filxhanët.

— E merrni me mend kë kam parë sot, — tha Diamanta duke pirë kafe, — Talo Dylberin. Si ishte katandisur i gjori! M'u mbushën sytë me lot kur e pashë.

— Në ç'orë ke ardhur në Tiranë?, — pyeti Mihoja.

— Me trenin e mëngjesit.

— Uh, zonjë, në mëngjes paske ardhur, mezi mbrëmja të solli në furrikun që më lanë këta! Ku e kalove tërë këtë kohë?

— Gjezdisa. Sa herë vij në Tiranë, nuk më zihet pa kaluar në rrugën e shtëpisë që ma morën.

— Ku e pe Talo Dylberin?

— Mos ma kujto, zonja Serme! Më mirë të mos e kisha parë. Kur i shikojmë njerëzit tanë të katandisur ashtu, na veniten shpresat. Fytyra e Talos nuk do të më hiqet prej mendjes me muaj të tërë. Më kanë thënë se është marrosur, s'më besohej. Ishte ylli i Tiranës, zonjë! Kush ishte si biri i regtarit të konfeksioneve?!

— Të njohu?, — pyeti Mihoja.

— E pashë nga prapa. Belbëzonte: *Ikën magazinat! Fluturoi floriri. M'i morën të gjitha! Edhe dashnoren. Fjoren-*

tina Lambrozia iku! M'u mjegulluan sytë nga lotët. M'u fry zemra, sa s'më plasi! Ika.

— S'të vë faj, sidomos ty, — tha Sermja dhe psherëtiu.

— Cilitdo prej nesh do të na dhimbsej, është i sërës sonë.

— Unë dal rrallë nëpër rrugë, — tha Mihoja, — po është një plak që punon në serat e fermës. Vinte në shtëpinë tonë. E njihni edhe ju Aziz Lëndën, atë bahçevanin që i blinte babai kumbulla. Azizi më foli për Talo Dylberin.

— Hë, çfarë të tha?, — pyeti Diamanta.

— Pasi e ngarkuan me taksa të jashtëzakonshme, ai hoqi dorë nga malli. Shteti e futi shitës në një dyqan me plaçka luftime.

— Bubuja, Talo Dylberi shitës! Milioneri rrogëtar te ish-shërbyesit! Kësaj i thonë: *Kërko, zonjë, kos te jevgu!*, — tha Diamanta.

— Hallë, të lutem mos fol me zë të lartë!, — i tërhoqi vërejtjen Mihoja.

— Nipçe, e shikoj, të paska hyrë lepuri në bark. Mirë, mirë, do ta ul zërin, vazhdo, na trego ç'të tha tjetër Aziz bahçevani për Talon.

— E vendosën si shitës në dyqanin me plaçka luftime. Dikush solli atje një kostum grash, të cilin e kishte porositur dikur Talo Dylberi në Paris për Fjorentina Lambrozian që nuk arriti ta vishte asnjëherë...

— Miho, pusho, Miho!, — thanë dy zonjat me sy të për-lotur. Secilës prej tyre iu kujtua e kaluara e mugët...

«Sa i bukur ishte Talo Dylberi!, — mendoj zonja Serme dhe ofshani me dënësë. — Sevдали i madh femrash. Thuhej se edhe hanëmja plakë, bejleresha e madhe, ishte magjepsur pas tij». Iu kujtua se si një mbrëmje kishte kaluar nga Rruga e Postës. Në dyqan gjendeshin vetëm shërbyesit dhe plaku Dylber. Taloja jo. Ishte dëshpëruar pa masë.

Dy hanëme, ndoshta kishin vajtur atje për atë merak që kishte shkuar edhe ajo. «Të thashë se nuk e gjejmë këtu. Talo Dylberi ka kaparisur mejhane «Londrën». Bën xhymsh me dy zonja që i kanë ardhur nga jashtë,» — kishte dëgjuar t'i thoshte njëra tjetrës.

Shkruar nga...
Shkruar nga...
Shkruar nga...

Sermja, sa kishte dëgjuar se ku gjendej Talo Dylberi, ishte ngutur. E dinte se nuk mund ta takonte, por do ta shikonte tinëzisht. Kishte arritur te mejhania me një frymë. Kishte vënë syrin mbi xham. E kishte parë. Sazexhinjtë u binin veglave. Taloja ishte ngritur. Secilit prej sazexhinjve u kishte vënë nga një napolon në ballë. Dy zonjat e huaja kishin duartrokatur dhe kishin thirrur: «Kavalier! Kavalier! Viva!». Ç'zili i ishte nderur në gjoks! Gati i kishte rënë të fikët. Në qafë kishte një dukat. E kishte zgjidhur. Ishte gati t'ia falte kujtdo, vetëm t'ia prekte Talos dorën. Edhe e motra, Elmazja, ishte molisur pas Talos. Pyeste për të, fliste për të.

Çdo mbrëmje, Sermja ikte tinëzisht, kalonte përballë dyqaneve të firmës «Dylberi». Më në fund... Ishte i dehur. E kishte futur në zyrën e të atit... «O kohë e perënduar!...», — ofshani me vete e përhumbur në kujtime.

«... Talo Dylberi më bënte elozhe, — mendonte Diamanta në të njëjtën kohë. — Nami i bukurisë sime kishte marrë dhenë. Kishte kaluar edhe kufijtë e nënmbretërisë. Taloja më çoi një zonjë që e përdorte për të tilla punë. E dija kujt ia vinte syrin Taloja, nuk i shqitej pa e futur në dorë. Prandaj e ktheva zonjën pa shpresa. Isha e bindur se do të vinte vetë dhe erdhi... U takuam edhe në Romë. Tri netët në hotel «Kavaleria» s'kam për t'i harruar kurrë...».

— ... I gjori Talo, çdo ditë pret te Bashkia..., — vazhdonte të fliste Mihoja.

— Si, si? Taloja te Bashkia!, — u shpërgjumën e pyetën dy zonjat.

— Desha të thosha te ish-Bashkia, — e ndreqi Mihoja.

— Çfarë tek ish-Bashkia?, — pyeti Diamanta.

— Talo Dylberi pra, sapo zbardh dita, i afrohet ish-Bashkisë e pret

— Kë pret?

— Si puna e të marrit, pret prefekt Qazimin që t'i ankohet, kërkon dyqanet.

Dy zonjat sërish u mallëngjyen. Nxorën shamitë. Filloan të fshinin lotët.

— Në orën dy, — vazhdoi Mihoja, — kur dalin gjithë nëpunësit, Talo Dylberi thotë: *Zoti prefekt nuk paska dalë*

sot në punë, dhe kthehet duke bërbelitur për dyqanet dhe për Fjorentina Lambrozian...

— Nipçe, pusho, nipçe, të keqen pusho!, — iu lutën dy zonjat e përlotura.

Mihoja pa orën. Ishte vonuar. Përfitoi nga hutesa mallëngjyese e tezes dhe hallës, nxori paqetën e cigareve nga nënpragu i aneksit pa u rënë në sy zonjave dhe doli duke u lënë prapa një «natën e mirë» të zvarur.

*
* *

Mihoja hapte kanal në parcelat pranë minierës. Me atë punë merrej dhjetë ditë të tëra. Punonte i vetmuar. Vetëm kur dilnin minatorët, i afrohej xha Azizit që punonte në serat dhe e pyeste me marifet për emrat dhe përgjegjësitë e punëtorëve të minierës. Xha Azizi që i njihte mirë minatorët, pa vrarë mendjen përse i duheshin Mihos ato të dhëna, i tregonte gjerë e gjatë për secilin.

Ditën që zë fill tregimi ynë, Miho Gjelaci ishte futur nën degët e disa akacieve kapërthye nga kulprat. Me sytë gjysmë të mbyllur sodiste dallgëzat e dëgjonte llokoçitjet e ujit në përrua. Ktheu kokën me përtim nga kanali që kishite hapur. Ngriti pëllëmbët në lartësinë e syve, pa gërvishjet dhe pështyu. Ndjeu ca pickime përbrenda. Helmi i mbledhur me vite në një mulla të madh tani po i tajitte. Ai lëng i hidhur bënte t'i rrihte zemra gulçueshëm. Tutej mos nuk do të përmbahej. Mjaftonte të humbte vetëm një çast barzפשهن e sjelljeve dhe të veprimeve dhe...

«Vetëm një hap i pamenduar, — mendonte ai, — dhe ...katastrofa!». Fjala e fundit ishte bërë për të më e rëndomtë se fjalët «bukë» e «ujë».

Llokoçitjet e përroit llokajë¹⁾ me mbeturina nafte, që formonin gjole të rrumbullakëta në sipërfaqe, i kujtuan Mihos letrën e fshehur në këmbëzën e çorapeve prej leshi.

1) uji që vjen i përzier me baltë e ndyrësira.

Ngriti kokën. Vëzhgoi. Pasi u sigurua se nuk kishte njeri, bëri sikur kroj pulpën e nxori letrën. E vuri në astarin e ka-peles. Çdo shkronjëzë e vockël e asaj letërze që i kishte ardhur e mbështjellë në një cigare me filtër kishte tingël-llimin e vet.

Letrën ia dërgonte Ortaku që përtej kufirit. Mihoja preku shkronjat sikur ato të ishin ndërtuar prej koralesh. Edhe pse gishtat i rrëshqitën në sipërfaqen e lëmuar, për-veç përfytyrimit të njeriut që kishte shkruar atë letër, atij iu përftua edhe pandehma sikur prekte tastierën e një pia-noje të harruar. «Ka një ndryshim, — çërroi një mendim në kokën e Mihos, — tastierën e prek, kumbon, kurse këto, sado të dobëta, sikur këlthasin». Afroi letrën pranë syve. Iu bë sikur shkronjat lëvizën. U kthyen në cingëla. Filluan një valle çmendurie. U lidhën me njëra-tjetrën dhe, prej tyre, si ndonjë afsh përcëllues, dolën urdhrat që përcille-shin nga përtej kufirit:

Na duhen të dhëna mbi pikat ku nxirren minerale të çmuara. Të dhëna për të gjitha xehet! Ku nxirret nafta dhe pasuri të tjera të nëndheshme, atje duhet të gjendesh ti dhe kolegët e tu! Të veproni...

Mihoja tundi kokën. Shikimi i rrëshqiti në disa rresh-ta më poshtë: «... nga një i arratisur që gjendet këndeje... je-mi njoftuar se i biri i Soli Kimit, atij plakut që lëshoi dekla-ratën në praninë tënde dhe time, i quajtur Demir, punon në një dikaster që ka të bëjë me minierat... Duhet ta shfry-tëzosh!... Përdore si urë për t'u futur në damarët e pasurive të nëndheshme...

Mihoja bëri shuk kapelen. Vështrimin tymnajë e ho-dhi nga miniera.

«Mund të gjendet në minierën «1 Maji», — belbëzoi. — Po këtu paska katër Demirë! Cili nga këta është i bi-ri i Soliut?! Pastaj me një fjalë goje nuk e fut tjetrin në dorë. Ku ta gjej atë të shkretë deklaratë! Po ta kem atë, di unë si të veproj».

Pasi kishte hapur paqetën e cigareve që i kishte ar-dhur nga jashtë dhe kishte lexuar letrën, Mihoja i ishte drejtuar brigadieres:

— Jam burrë i moshuar, vuaj nga zemra. Zhurmat më

lëndojnë shëndetin. Më cakto të punoj në serat përtej përroit.

Brigadierja ia kishte plotësuar kërkesën, e kishte çuar jo në serat, po në kanal.

Mihoja rilexoi disa herë letrën. Në kohën kur po i ndizej fantazia dhe po çapitej në përfytyrimet e restauruara me vite, u dëgjuan hapa mbi kodrinë. Zbrisnin minatorët e turnit të parë.

Mihoja u fut edhe më thellë në tunelthin e kapërthyer prej kulprave dhe përgjoi bisedat e minatorëve:

— Se si përmbysen ata drej vagona!, — tha një minator.

— I fortë Demiri, — ia pat një tjetër, — vagoni i ngarkuar ia zuri këmbën dhe nuk nxori zë.

— Përherë na turbullojnë gjakun dhe na nxjerrin avaze këta vagona.

— Jo vagonat, po shinat.

— As shinat, presioni.

— Mirë thotë Demi, — foli një minator, — shtrydhet shkëmbi si nga dhembjet e lehonisë.

— Sikur kërkon të na zërë frymën. Nga lart s'ka ç'të na bëjë, as anash, se ia mbyllim gurmazin me shtylla pishe. Po nga poshtë... që fryhet si tharmë...

— Fryhet brenda një nate. Të nesërmen shinat, i gjej-më të shtrembëruara. Njëra më poshtë, tjetra më lart. Shinat prej çeliku bëhen hark!

— Ishte duke e këputur në mes...

— Nuk e lamë, u gjendëm shpejt atje.

— Djema, të ngutemi. Kemi kur bisedojmë për këtë punë.

— Mirë thotë shoku Kujtim, — tha një tjetër, — nuk e pritëm autobusin, i ramë fushave që të arrijmë sa më parë në spital.

— Mos kini gajle, e mora spitalin në telefon. Nuk ka rrezik, vetëm njërën këmbë e ka keq. — Ky ishte zë femre. Mihoja largoi një vilëz kulpre që ia pengonte shikimin. Ishte ajo. Topolakja e kolme. Minatorët e quanin sinjaliste, xha Azizi vetëm asaj nuk ia dinte emrin. Mihoja e kishte parë me vëmendje sa herë sinjalistja kishte kaluar andej. Madje kishte përgjuar edhe bisedat e saj me një mesoburrë

fytyrëbardhosh me lëkurë të lëmuar, sikur do t'i pëlciste nga gjaku. E quanin Ramë. Nga ato kuvendime nuk kishte marrë vesh ç'ishin midis tyre, se më të shumtën e herës bisedonin vetëm për punën, të paktën kur kishte përgjuar ai.

— Shpejtoni hapin, djema!, — u tha Kujtimi minatorëve që ecnin përpara tij monopazit.

Këto ishin fjalët e fundit që i kapën veshët Mihos. Ai fërkoj duart dhe qeshi. Ishte një qeshje e frikshme, e brendshme, dehëse. Por sakaq u ngrys. «... Demiri. Po, për Demirin flisnin. Një aksident. Unë për Demirin kam ardhur këtu dhe kam lëshuar grepat... Po sikur nga të katër Demirët të jetë ky ai që kërkoh?!... Në qoftë se vdes! Epo tërëllëqet s'po më lënë të bëj hap!».

Mihoja doli nga tunelthi i kulprave. Atë kohë minatori i fundit, një zdap i gjatë, zbriste zvarë-zvarë kodrinës. Ecte i shpenguar dhe këndonte:

«Ky, — mendoj Mihoja, — botë më vetë!».

Gjatë atyre dhjetë ditëve ai kishte përgjuar, pyetur e fiksuar në mendje copëza bisedash. Xha Azizi i serave ia kishte thënë edhe karakteristikat e çdonjërit prej minatorëve. Atë që zbriste i fundit, e quanin Zhagan Dhoga (se ishte nofkë, apo emri i tij i vërtetë, këtë Mihoja nuk e dinte. Dinte se atij farë Zhagani nuk i pushonte goja për asnjë çast. Ky sikur është i një vathe tjetër, — mendonte. — Vetëm ky ndryshon prej të tjerëve». Prandaj dhe kishte shënuar në një bllok që e mbante fshehur: «*Zhagan Dhoga, koqe e gëlltitshme për fytin tim. Siç i thonë fjalës: në mungesë të thëllëzës edhe një sorrë është diçka*». Po prapë iu kujtua Demiri. «Ai që më duhet mua është i biri i Soli Kimit. Nga të katër Demirët, ai që mban mbiemrin Kimi, më duhet mua. Po sikur pikërisht ai të jetë i dëmtuari nën vagon?!». E ndjeu se si po i boshati eja koka dhe u krodh në atë greminën e zakonshme të pikëllimit, ku, përveç trishtimit të ftohtë, asgjë s'pipërinte.

Atë ditë punoi më pak se çdo ditë tjetër. Dielli kaptoi Kodrat e Bareshës, kur ai la punën. Tek ecte mbi urën e telit dhe shikonte rrugicën që nxirrte krye në xhade, iu shpif një hije nga ana e majtë, iu bë sikur dikush u fsheh prapa akacjeve. Mornica të ftohta ia cimbisën trupin. Edhe

pse nga prapa akacjeve doli një këlysh, pandehma e sur-
vejimit që ishte bërë si qenie e dytë për të, e bëri Mihon
të kujtonte tërë rrugën nga kishte ecur në jetë dhe gjur-
mët që kishte lënë.

* * *

Atë buzëmbremje si edhe ndonjë natë tjetër, Mihos iu
kujtua rinia e hershme.

I ati që u mëkëmb dhe u pasurua shumë gjatë pushti-
mit fashist të vendit, e dërgoi tek Ortaku, një shoku i vet
në allishverishe tregtare. I huaji, të cilin Shahini e thërris-
te thjesht Ortaku, e njohu të riun me disa afaristë, të cilët
kishin një vilë në Romë, ku kishin hapur një shkollë pri-
vate «tregtare». Askush, ose pakkush dinte se biznes-
menët ishin zbuluesit e mineraleve të çmuara në Ballkan
dhe tregonin interes të veçantë për Shqipërinë. Ortaku i
Shahinit vdiq, duke ia lënë amanet Mihon profesorit të an-
glishtes, një burri energjik rreth të tridhjetepesave, i cili
më vonë do të ishte Ortaku.

Iu kujtua se si në fillim të atij viti brenda një dite e
thirrën dy herë. Në mëngjes drejtori i shkollës, kurse në
darkë profesori i anglishtes.

— Ke marrë letër nga Shqipëria?, — e pyeti drejtori.

— Marr në të rrallë, zoti drejtor.

— Ç'të shkruajnë? Zoti Gjelaci mirë?

Mihoja në fillim u frikësua mos i kishte ndodhur gjë
vëllait të madh, Salës, i cili shoqërohej me ca njerëz sher-
xhinj. I ati i kishte shkruar: «Nëse gjer tani ke mësuar mi-
rë, tani duhet të përpiqesh edhe më shumë. Babai yt po e
shton pasurinë. Asaj i lypsen mbrojtësit. Kujt më tepër se
ty i takon të jetë ai, ose njëri ndër ata që do të mbrojnë
firmën «Tre vëllezërit Gjelaci»? Iu kujtuan edhe frazat e
tjera që i kishte shkruar për vëllanë e madh: «Harxhon
më tepër sesa fiton. Më bren një dyshim i keq. Mos është
dhënë pas pijeve e kabareve. Së shpejti do të bëj një udhë-
tim. Gjurmaje, po qe se janë të vërteta...»

— Shqipërinë, — e nxori nga kujtimet zëri i drejtorit, — e pret një e ardhshme e ndritur. Disa e kanë kuptuar se ai vend i prapambetur vetëm nën hijen e një fuqie të madhe mund të ngjallet. Injoranca është e madhe. Po shumica që nuk e kuptojnë të mirën që u kemi bërë, çuquris. Ushtrinë imperatore e këqyrin me urrejtje. Nuk e shikojnë si pishtare të kulturës. E keqja është se shumë të rinj, bile edhe me shkollë, po e ndërsejnë popullin kundër imperatorisë.

— Zoti drejtor, — e pa me vend të ndërhynte, — ka kohë që nuk kam qenë andej. Gjendjen e tanishme nuk e njoh fare.

— Birit të zotit Gjelaci nuk i falet të qëndrojë indiferent. Jeni i ri, po politika ju takon juve.

Mihoja u mat të fliste, po drejtori ngriti dorën e vazhdoi:

— Vera që më dërgoi zoti Gjelaci, ishte diçka e rrallë, e lëvduar për tryezë perandori. Kam ca para të vdekura. Dje, kur të pashë duke shëtitur në oborr me profesorin e anglishtes, m'u kujtua vera...

— T'i dërgoj letër babait që t'ju nisë edhe disa damixhana?

— Faleminderit! Thashë se kam ca para të vdekura. Në Shqipëri kanë filluar të peshkojnë edhe peshq shumë të mëdhenj. Do të më vinte shumë keq sikur zotin Gjelaci ta dërrmonin dhëmbët e konkurrencës. Për zotërinë kam një respekt të veçantë. Jam altruist. Dua t'ju ndihmoj. Atje të ngrinin një fabrikë pijesh, pranë saj të mblidhnim edhe ca specialistë që dinë të zbulojnë ç'gjendet nën dhë. Të jesh rojtës i varreve, është një farë humanizmi, po të jesh pronar i parave të vdekura në kohën tonë, është krim.

Ndërsa drejtori fliste për fabrikën e pijeve dhe të një rrjeti dyqanesh, Mihos iu shfaq tabela e madhe dyfirmëshe «Fontano-Gjelaci» dhe një gëzim i çërriti në thellësi, pastaj iu ngjit gjoksit. Një rrymë gjaku i vërshoi faqeve. U mat të fliste, të pranonte në emër të të atit, po drejtori sërisht e ndaloi:

— Mos fol! Mendohu. Përgjigjet e ngutshme i ngjajnë hedhjes së një guri në humnerë. Duhet të bësedoj njëherë me zotin Gjelaci, pastaj...

Në mbrëmje Mihoja u takua me profesorin e anglishtes. Ai ndryshe nga herët e tjera, i foli me një gjuhë orakujsh, sa që ai nuk kuptoi asgjë tjetër përveç se lypsej të ishte i mbyllur, konspirativ, se i takonte një brezi që kishte për të bërë çudira, se do të specializohej edhe më tej, në një kurs më të lartë, ku u përgatitkëshin njerëz të veprimit dhe të perspektivës, të politikës me valë të gjata, të strategjisë poliformëshe. Duke përfunduar, tha:

— Asnjë fjalë me asnjëri. Asnjëherë nuk të kam konsideruar si nxënës të zakonshëm. Mos harro se Shqipëria është ndoshta i vetmi vend ku populli zbatohet ecën mbi koren e tokës, e cila fsheh në vetvete flori, madje edhe metale më të çmuara se ari. Shqipëria mund të jetë një bosht iksi ndeshjesh të interesave të Fuqive të Mëdha. Pretendoj të jem profesor vetëm i njerëzve të mëdhenj. Por, nëse këta njerëz flasin pa arritur momenti... — Tregoi me gisht kafkën e një njeriu mbi kasafortë. Pastaj hapi një hartë të Shqipërisë të mbushur me shenja e shigjeta e tha: — Në këto pika ka thesare. Ju mund të bëheni guvernator i pasurisë së nëndheshme atje. Ne nuk do ta kursejmë ndihmën. Qysh sot unë për ty jam Ortaku.

Miho Gjelaci atë natë shkoi në fjetore fare i trullosur. Gjumi nuk e zuri gjer vonë. Mëshonte lakmia. Ndizej egoja, me të cilën e kishte ushqyer e ëma, Elmazja. I përHITEJ firma «Fontano-Gjelaci», mbulohej nga mjegulla, mbi të shfaqej firma tjetër «Guvernatori i thesareve të nëndheut». Pastaj si në ndonjë tunel tymnaje tundej kafka e njeriut me gropa të thella në vend të syve, me dhëmbët e mëdhenj e kërcënues.

«Sigurisht, — mendonte Mihoja, — kafka ka llapur pa ardhur koha. «Pra njeriu, nëse nuk bëhet Cezar, — iu kujtua një frazë e profesorit të anglishtes, — duhet të bëhet Neron. Jo Neron që përflak Romën, por që shkakton epideminë e varfanjakëve që ngrihen kundër zotërisë e zotit, që mbytnin rrugët me gjak, që përmbysin frone me gjak, që mbajnë në duar flamurë të skuqur me gjak...».

Mihoja fjeti me ankthin e së pritmes. U krodh në botën e turbullt të ëndrrave. Pa veten të burrëruar, po përmes një shtëllunge tymi iu shfaq kafka. Makthi ia zuri

frymën. Me sy të shqyer dhe duar të shtrira përpara bërtiti: «Jo! Nuk kam folur! Kurrë! Kurrë! Pa u bërë guvernator, kurrë pa ardhur koha!...».

Ditët me ngjarje e turbullira kaluan rrufeshëm. Mihoja vajti në Londër i veshur si bir baroni amerikan.

Një mbrëmje me mjegull ai shëtiste me barkë me Ortakun (Tianin). Mendohej t'i shikonte fytyrën profesorit, po mjegulla ishte e dendur dhe ai dëgjonte vetëm fjalët:


— Do të nisesh për Shqipëri! Herr Hegeri, shef i gestapos në qytetin ZH, është miku im i ngushtë. Mund ta quajmë argat... Të gjitha pasuritë e nëndheshme janë tonat, të miat dhe të tuat. Mund të vij në Shqipëri si këshilltar «aleat» ushtarak. Nuk do të më japësh të njohur. Do të veprosch si të të them unë, sipas kushteve.

Pak nga mjegulla, më shumë nga misioni që përcillej përmes ca fjalëve si rebus, Mihos iu duk se përbironte përmes një labirinti. Personi i Tianit po rritej dhe po merrte rëndësi të madhe në mendjen e tij. Në nëntor të dyzetetreshit Mihoja u kthye në Shqipëri me bankënota e çeqe për të kaparisur e paguar njerëzit që do të gërmonin e zbulonin xehe.

Për Shahin Gjelacin, të atin e Mihos, kthimi i djalit të vogël qe një gëzim i madh.

«Në bark të shejtanit të venë dy të mëdhenjtë, — i kishte thënë ai së shoqes, Elmazes, — ky i mbulon jo dy të pahairit, por edhe dhjetë gjallnikë tregtarë ndër më të mirët. Me belbëzimet ia kam mësuar allishverishet. Rraha hekurin sa ishte i skuqur. Ai i madhi kullufiti depozitimet që i derdha në bankën e Romës për ditë halli. U martua andej dhe theu zverkun në tinglimajmun. Mirë ma bëri. Unë matufi ia depozitova firmën. Ai i dyti u zhduk pa lënë gjurmë. Miho, Miho», — i fliste ai të birit dhe e përqafonte.

Elmazja edhe kënaqej, edhe habitej me Shahinin, sepse për herë të parë e shikonte duke mikluar dhe përqaftuar pjellën e vet. «Ndoshta e ka nga bankënotat që i ka sjellë Mihoja», — mendonte ajo.



K R E U II

Ishte e diel. Minatorët e turnit «Sulmi» kishin pushim. Ata të grupit të Kujtim Kreshpës u gjendën në minierë pa vezulluar rrezet e diellit mbi pikat e vesës mëngjesore. Pa fjalë u futën në ashensor dhe zbritën nën dhé. Njëri pas tjetrit morën veglat e punës në depot e nëntokës.

Të ardhurit rishtazi në minierë habiteshin me atë marrëveshje të heshtur minatorësh. Më vonë, edhe për ata, kjo metodë pune kthehej në përvojë.

Dita e asaj pune vullnetare kishte filluar fare thjesht. Kur dolën nga spitali, ku kishin vizituar shokun e aksidentuar, Dem Qesati tha:

— Shokë, duhet të mbulojmë mungesën e Demirit. Të mos pranojmë minatorë zëvendësues!

— Mirë thotë Demi, — miratuan dy të rinj.

— Sonte m'i ka lënë puplat gjumi, — foli sërish Demi, — shinat mbetën me cen. Sikur të vemi qysh tani...

— Qoftëlargut duhet t'i shtypet kaptina, — tha shprehjen e ngahershme Rama.

Kujtimi lumturohej tek dëgjonte shokët e grupit që tregonin zell dhe gatishmëri për punë. Ai kishte mbledhur në grupin e tij ata punëtorë, për të cilët ishin ankuar brigadierët dhe përgjegjësit e turneve të tjera, njerëz me të cilët i ishte dashur të punonte me takt dhe kujdes të madh. Dhe ja, dalngadalë sikur po ia arrinte qëllimit.

— Të vemi të nivelojmë dyshemenë, të rivendosim shinat, — tha Lim Thana, ndihmësi i Kujtimit.

— Nisemi, burra, — tha Sherifi i gjatë dhe bëri nga stacioni i autobusave të minierës.

— Sonte s'kemi sesi. Atje punojnë shokët e turnit «Hovi», nesër në mëngjes, — tha Kujtimi.

— Sikur të vemi sonte, se nesër është e diel e..., — e la frazën përgjysmë Lim Thana. Ndoshta mund të takohej me Bukuriën, llampisten e turnit. Por buzëqeshjet qesëndisëse të shokëve i prenë hovin.

— Thashë, — tha Kujtimi, — sonte i pengojmë ata të turnit «Hovi». Nesër në mëngjes të gjithë atje.

Dhe ashtu u bë.

Kujtimi zhvidhoste dadot mbi shina e traversa. Agroni hiqte shinat. Të tjerët i mbartnin ato në galerinë kundrejt, përtej oxhakut të rrugëdaljes. Një pjesë e galerisë u lirua. Demi dhe Rama i hynë gërmimit me kazma. Më tutje punonte Zizi me dy ndihmës. Fare në ballë punonte Sherifi.

Kujtimi po zhvidhoste dadot e shinës së fundit, Agroni që priste ta ngrinte atë, i foli:

— Dy portozat e oxhakut të rrugëdaljes paskan shkarë. Mund të ndodhë ndonjë shembje.

Kujtimin, që e kishte mendjen gjetkë, e përmendi fjala e fundit.

— Shembje the?! Ku?

— Ja, — tha Agroni dhe drejtoi dritën nga oxhaku.

Kujtimi u afrua.

— Dreq, o punë, — tha ai, — si nuk e vura re, dashkan ndërruar portozat.

— Të ndihmoj unë.

— Jo. Po nuk përtove, ngjitu lart, lësho dy shtylla për portozat. Dale! Edhe kapelja e tavanit qenka thyer. Nisu, Agron!

Pas pak Agroni lëshoi tri shtylla me arganellë. Kujtimi, pasi shmangu shinën dhe traversat e fundit, filloi punën nga riparimi. Agroni deshi t'i ndihmonte:

— Bashkohu me shokët, këtë punë e bëj vetë.

Tjetri e shikoi me habi.

— Shko, Agron, ti e di se këto punë më vijnë ndoresh.

Tjetri u largua pesë-gjashtë hapa, kapi kazmën dhe filloi gërmihjen.

— Tunde kazmën e ta pasha hajrin, bre!, — thërriste Sherifi në ballë të frontit.

Kujtimi hapte gojën e portozit me sqepar. Të gjitha bisedat e shokëve, edhe pse flisnin me zë të ulët (përveç Sherifit që nuk dinte të fliste shtruar), i vinin në vesh si jehonë. Me ritmin e goditjes së sqeparit i rrihnin edhe mendimet:

«Pse e ngacmon Zizi Lim Thanën? Sot është e diel. Ndoshta vërtet Limi ka takim me Bukuriën. Ç'shaka të rënda bën edhe ky Zizi».

— Puno në galeri, — dëgjohej zëri i Zizit, — Zhagani si fort i vjen vërdallë asaj llampistes së bukur. Përfiton nga mungesa jote Zhagani, ia bën çorbë mendjen asaj fakires dhe Limit nuk i mbetet gjë tjetër veç të lëpijë gishtin e unazës.

— Delenxhi i madh je ti, Ziz, — ndërhyri Rama, — Zhagan Dhoga është i martuar.

— Rri, mor beqar i thinjur, — ia ktheu Zizi, — nuk merr vesh nga këto gjëra ti. Që të mësosh, më mirë dëgjo.

— Shëndoshë koka, pa për kapele..., — tha një ndihmësimator.

— Si the?!, — i foli atij Demi. — Të mos ta dëgjoj më atë fjalë!

— Mos, — thumboi dyfish Zizi, — për atë thënie kam ngrënë një dru unë që...

— Ajo është pjellë e mendjes së sulltanëve, — tha Demi.

Demi u kollit me pahir, Zizi i heshtur iu afrua oxhakut e u ngjit lart.

— Dem, kam dashur të të pyes, — u dëgjua zëri i Ramës.

— Mos të ka mbirë ndonjë çiban në gjuhë? Këto ditët e fundit sikur gjithë retë e Dajtit kanë zbritur në fytyrën tënde.

— Njerëz jemi, halle kemi, — u përgjigj Demi dhe shpeshoi gërmimin me kazmë.

Atë kohë Zizi lëshoi me kavo një karrocë dore.

— Të pjell mendja, Ziz, — i tha Kujtimi, — ku e gjete?

— Në sipërfaqe, — u përgjigj Zizi. — Tani që jemi pranë oxhakut mund të hidhet qymyri me lopata, po, kur të përparojmë...

— Të lumtë!

— Bini, burra!, — thërriste Sherifi në thellësi të galerisë.

Zizi iu afrua me karrocë dore e tha:

— E ç't'i biem, a derëbardhë? Sot riparojmë, pas një jave prapë ky avaz. Harruam të thërrisnim normistin të na maste punën, ndryshe do të na vejë djersa kot.

Agroni ngriti kokën, shikoi Zizin, pastaj Kujtimin. Ky i fundit i bëri shenjë të mos e ngacmonte. Po Sherifi që,

siç thoshte Rama, i kishte veshët pipëz, ndërhyri:

— Ziz, të plastë plënci që s't'u ngop një herë!
— Sherif, mos merr zjarr kot. Gjersa punojmë, përse të mos i qëndrojmë besnik parimit «sipas punës, paga»?
— Qoftëlargu!, — shfryu Rama dhe iu afrua në frymë Zizit. — Ziz, nuk do të mbledhësh mend gjer sa të të shpien në Shishtufinë.

— Ramë, mos m'i përmend varrezat, se s'i kam qejf!
— Nuk bëj shaka, — ia ktheu Rama. — Ishe në turnin «Vrulli», ike andej se të thërrisnin «Mirëmëngjes, interes». Je burrë, mblidhe kallaballëkun!

— Turp është të vjedhësh, të përvetësosh e të gënjesh, po, të kërkosh hakun tënd, nuk është ndonjë gjë.

— Ç'i them unë, e ç'thotë ky!, — tha Rama.
— Lëre zorraxhiun mikroborgjez!, — tha i nxehur Sherifi.

— Sherif!

— Sherif!, — e qortuan njëherësh Kujtimi dhe Agroni.

— S'un e duroj, bre, — tha Sherifi, — ndjell fukarallëk.

Tjetri dergjet në spital, ky...

Demi punonte kokulur. Djersa i pikonte pikë-pikë nga hunda.

Në thellësi të galerisë Sherifi nxori tabanin e ri të dyshemesë. Agroni filloi të mbartte traversat.

Kujtimit i kapi veshi një copëz fraze, thënë me zë të ulët:

— ... edhe shokut tënd nuk do t'i tregosh hallin që të mundon?

Pyeste Rama Demin.

— Ramë, mos u bëj rriqën, — ia ktheu Demi, — s'kam asnjë hall.

— Mos më thuaj mua që të njoh mirë. Ti ngjan me vjeshtën e dytë, më saktë me dhjetorin me kallkan e erëra.

«Vërtet, ç'të ketë Demi?, — pyeti Kujtimi me vete. — Punon në heshtje, s'i qesh buza. Se ç'përtyp ai!».

Agroni, sikur t'i kishte përgjuar mendimet e shokut, tha:

— Demi qysh fëmijë e ka provuar jetën e minatorit. Ka sedër, e mundon puna e të vëllait, Qenanit.

— Mos e mundon edhe gjëkafshë tjetër?

— Edhe dallaveret e Alushit, prapësitë e Zhagan Dho-gës. Por kryesor është Qenani.

— Alushi dhe Zhagani nuk janë njoftuar për sot?

— Si jo, — u përgjigj Agroni, — edhe Qenanin e njoftuam.

— Zhagani kushedi ku gjendet në këtë orë, — thumboi Zizi dhe ktheu dritën nga Lim Thana.

Sherifi që dëgjoji emrin e Zhaganit, tha pa ngritur kokën:

— Zhagani do dru, vetëm druri e bie në vete atë. Dy metra burrë, vetëm te fustanet e ka mendjen, delenxhiu!

— Jo me dru, shoku Sherif, njeriu ka vesh, ka mendje, — qortoi Agroni.

— Më thershin ku jam më hollë, nëse ka kryet e Zhaganit tru. Ta kisha vëlla, e therja si berrin, hiç pishman me u ba për atë punë! S'un e duroj, bre! Burri sa lisi, kilivili si rrospi!

Kujtimi uli kokën. Sa herë fliste Sherifi me atë dialektin e kulluar, atij i qeshej.

Sherifi nuk dinte të lodhur në punë. Ishte i singertë, hile nuk dinte, por ishte ca gjaknxehtë dhe të thyhej në dorë për higjë. «Tel i zhveshur dyqind e njëzet voltësh», — i thoshin shokët. Sherifi ishte edhe hakmarrës, fyhej shpejt, s'përtonte edhe të kacafytej. Kishin dashur ta largonin nga miniera për zënka. Kujtimi dhe Demi e kishin marrë në grup, kujdeseshin dhe punonin me takt.

Sherifi ndeshi në shtresën e fortë, ndaj rrëmbeu matrapikun. Ndërsa Agroni la traversat dhe u kthye të merrte të tjera.

Kërkëllimat e matrapikut u dëgjuan gjithandej.

— Jepi, mitraloz, he ta pasha hajrin!, — thërriste Sherifi.

Sa qenë në galeri qeshën. E dinin të gjithë se Sherifi veçan çdo mjeti, e donte dhe kishte dëshirë të punonte me matrapik, se krismat ritmike të tij i ngjanin me krismat e mitralozit. Zizi iu afrua, mori kazmën e Sherifit dhe, për ta nxehur, lëshoi ca fjalë:

— Të paktën të merrnim ndonjë lek sa për të larë djersën e sotme.

— Ik tutje, dryni i dreqit, se po ta ngjesh matrapikun në mullë.

Zizi iku duke qeshur. Sherifi e kuptoi shakanë e vazhdoi të gërmonte.

— Të dielën tjetër do të dalim për gjah?, — pyeti Agroni Demin që punonte aty afër. Kam blerë dy grepa me flutur. Do të vish?

— Të shohim, — tha Demi pa ngritur kokën.

— Demi është shok i keq, — ndërhyri Kujtimi, — çdo të diel vete për gjah, po mua kurrë s'më ka ftuar.

— Shko me Qenanin ti, — ia ktheu me ironi Demi.

— Pse edhe Qenani gjuan? E paskeni për rracë ju vëllazëria.

— Mos e ço muhabetin nga ta kënda, nuk po bëj shaka!

— Domethënë edhe yt vëlla, Qenani, gjuan?

— Qenani? Po, ndonjë qosh të rehatshëm ku bën fresk, ku s'ka djersë dhe merret leku, — thumboi Demi.

Rama ngriti supet e tundi kokën, si të thoshte: «Demi është në të rënda. S'i qesh buza! Se ç'ka ky Demi ynë!».

«S'më qesh buza, jo, — mendoj me vete Demi. — Sa nuk e kisha vëllanë këtu, kritika më zinte vend. Isha vetë në rregull, qortoja dembelët, hilexhinjtë. Kurse pardje, kur i tërhoqa vërejtjen Zhaganit, ai m'u hakërrye: «Mos na shit mend! Rregullo vëllanë tënd njëherë! Pastaj folu të tjerëve! Ah, ç'më bëre, more Kujtim! Vete e mbledh njerëz teknefes, burra me teka e vese, sikur të ishim pavijon që pastron koncepte! Miniera do dashuri për punë, babam! Për mua, vëllai im, Qenani, nuk puthte në minierë. Parazit!».

*
* *

Trembëdhjetëvjeç ishte Demi kur pat hyrë në punë në minierën e Selenicës. Atëherë vendi ishte pushtuar nga pushtuesit italianë.

Pasditeve vonë kthehej nga puna i dërrmuar, ndaj, sa mbështeste kokën, e mbërthente një gjumë i rëndë. Kishte

vënë re se shokët e dhomës përherë prisnin sa të flinte Demi, pastaj bisedonin gjëra të fshehta.

Një pasdite Demin nuk e zuri gjumi, ishin shumë çimkat dhe s'e lanë rehat. Bëri sikur u kot, edhe pse lëkura i përcëllonte.

— Fjeti, — tha një punëtor nga ata që bisedonin kokë më kokë.

— Lodhet i shkreti, — tha xha Salikoja, — dymbëdhjetë orë punë nën tokë. Pa asnjë kusht pune e jetese. I ka kockat të njoma i gjori.

— I ri, — ndërhyri një punëtor tjetër, — po zemërak. Është djalë i mirë, besnik, duhet afruar Demi.

— Do të vijë koha. Punën e Demit dhe të shokëve të tjerë e kemi biseduar. Të vazhdojmë për çështjen...

«Punën time!, — mendoi Demi që tashmë i kishte ikur gjumi. — Për bukë e për kripë paskam qenë viç. I kam vënë re që bisedojnë kaptinë për kaptinë, por asnjëherë s'më ka shkuar mendja se bisedojnë për...».

Ai përgjoi edhe biseda të tjera. Në një rast u mat të shprehte edhe ai mendimin e vet, por iu kujtua se përgjonte dhe mbylli gojën me dorë.

Një muaj pas kësaj Demit i ra mbi kokë ajo që e kishin shqetësuar ditë me radhë.

Tërë natën çimkat nuk e kishin lënë të mbyllte sy. Kishin filluar punën që pa gdhirë. Në galeritë uji u vinte gjer mbi gju. Si gjithë të tjerët edhe Demi punonte zbathur. Lëkura e çarë dhe dregëzat e irituara nga uji i pistë i digjnin. Demi shtynte vagonetën. Koka i varej mbi të. Në të dalë të galerisë ndjeu dobësi, këmbët po i dridheshin. U ndal të merrte frymë. Kujdestari, të cilin Demi nuk e kishte vënë re, iu afrua nga prapa dhe e qëlloi me sa mundi. Fija e kamxhikut iu mbështoll rreth qafës. Djaloshi i nxorën sytë xixa. Në fillim u hutua. Pastaj rrëmbeu drurin që i shërbente për të ngritur vagonin mbi shina. Sapo u gjend ballë për ballë me kujdestarin fashist, fishkëlleu kamxhiku. Veshët i shungulluan. Gjaku i plasi hundësh. Djaloshi ra përdhe. Kujdestari, që vuri re se po vinin minatorët e tjerë, iku. Erdhën vagonistë. E ngritën Demin. E nxorën në sipërfaqe. Vendi ku e kishte goditur kamxhiku i ishte ngritur një gisht. Tërë

ditën ai qëndroi shtrirë dhe nuk foli me njeri. As iu përgjigj pyetjeve të xha Salikos, as të tjerëve. Nga mesnata u përvodh nga baranga. Tinëzisht iu afrua vilës bojë blu. Dera ishte e mbyllur. U kacavar në dritare, tërhoqi trupin dhe ra matanë, në korridor. Edhe në ato çaste mjaft alarmuese, i erdhi ndër mend tradita malësore: «Lufto me hasmin ballë për ballë!».

— Çohu, derr!, — thirri ai duke e goditur kujdestarin me shqelm.

Kujdestari fërkoj sytë. Kur pa djaloshin me hu në duar, fytyra iu ngërdhesh. Fare papritur klithi:

— Milicia! Milicia! Milicia!

Demi e qëlloi me sa munda mbi kokë. Kujdestari ngri-ti batanijen për t'u mbrojtur. Demi qëlloi mbi këmbët e zbuluara. Kujdestari u mbloodh lëmsh. Demi qëllonte ku mundte. Pastaj u zbraps. Hipi mbi parvazin e dritares. Sapo kërceu në tokë, e mbërthyen milicët e minierës. Qysh atë natë Demi përfundoi në burg.

Familja e Qesatëve në malësi të Tiranës mbeti keq. Minatorët mbloodhën ndihma dhe ia dërguan babait të Demit.

Qenani, vëllai i madh i Demit, kishte lënë medresenë dhe ishte kthyer në fshat. Babanë e kishte gjetur sëmurë, po vetë nuk ia thoshte punës. Qysh në vogëli pati vuajtur prej etheve. Prindërit jo nga dashuria e veçantë për të, po nga dhembshuria i kishin kushtuar kujdes të veçantë. Kjo përkujdesje kishte vazhduar edhe mbasi Qenani kishte mposhtur lëngatën. Atij i përkiste ushqimi më i mirë dhe ishte përjashtuar nga çdo lloj pune. Ndryshe nga fëmijët e tjerë tek ai po krijoheshin ca tipare të huaja: përbuzje ndaj punës, përtaci e tepruar, vesi i simulantit. Gjithmonë shtirej si i sëmurë, më dhemb këtu e më dhemb aty. Po përsosej në dinakëri. Babait dhe nënës së Qenanit u pikonte në zemër për shëndetkeqin, birin e tyre.

Meqë myezini i fshatit ishte plak, Qenani filloi ta ndihmonte në shërbesat fetare. Myezini vazhdonte fallin, nuskat, fitonte sa nuk thuhej. Djaloshit i jepte vetëm një sasi të vogël të ardhurash. Por nuk zgjati shumë, Qenani e futi në kurth myezinin. Befasisht iu fut në xhami. Myezini atë kohë numëronte paratë që ia kishte zhvatur një hallexhiu.

— Mulla Fet, — i tha Qenani.

Tjetri u tremb sa s'bëhet.

— Mulla Fet, — vazhdoi ai, — do të bëhemi ortakë. Këto dhe paratë që do të fitojmë këtej e tutje do t'i ndajmë. Myezinit në fillim iu drodh dora, pastaj mjekra.

— Ty të paska lënë fiqiri, o evlat!

— E pive pra, ti mësove prej meje rreth familjes dhe rreth halleve të atij që i parathe nafakën. Sa të mblidhen besimtarët, do t'u tregoj.

— Po ti tregon veten, mor shejtan xhidi!, — tha myezini dhe u gëzua se e kapi djaloshin dhe nuk kishte nga t'ia mbante.

— Nuk tregoj veten, mulla, por plakën Life, nga e cila mëson rrethanat e hallexhinjve. Pra nxjerr plakën Life dhe ty. Nesër është e xhuma, nesër unë besimtarëve...

— Jo, jo!

— Atëherë jemi ortakë!, — tha Qenani dhe vuri dorën mbi xhyben ku i kishte fshehur myezini paratë.

— M'i lër këto, — iu lut myezini Feti, — të tjerat po. Të gjitha bashkë do t'i kemi. U plaka.

— Nesër është e xhuma, nesër...

— Mos, mos, — u lut myezini duke u munduar të fshih-te paratë. Po Qenani ia kapi dorën. Qysh atë ditë ata u bënë ortakë.

Pas ca kohe mulla Feti vdiq. Këmbën e tij e zuri Qenan Qesati, të cilin qysh më parë fshatarët e thërrisnin mulla Qenani.

Mullai i ri kishte trashëguar nga familja e tij e mirë vetëm dashurinë për vatanin. Bisedat e pareshtura për luftërat që kishin bërë gjyshërit e tij, Qenanit i kishin lënë mbresa qysh kur ishte foshnje. Në prehrin e të atit, nëpër oda, kishte thithur me ëndje bisedat e burrave. Nëse i kishin pëlqyer qerosët dinakë të përrallave, hiç nuk ia kishte pasur lakminë atyre që ishin damkosur me vulën e tradhtisë ndaj atdheut. Në mendjen e tij ishte bërë një farë ndarje midis dinakëve dhe tradhtarëve.

Në shpirtin e Qenanit gjallonin dy forma të vetëdijes, ai këto i quante të veçanta, që s'kishin të bënin me njëra-tjetrën.

Çështja e burgosjes së të vëllait e pat bërë që Lëvizjen Nacionalçlirimtare ta shikonte si diçka të afërt, se «po, të fitonin ata që luftonin maleve, edhe Demi mund të lirohej». Kështu i pat bërë hesapet mullai. Babai i tij pat strehuar edhe ilegalë komunistë. Qenanin e patën thirrur në kuesturë dhe e kishin kërcënuar, por ai nuk kishte treguar gjë. Me dhelpëri të hollë kishte shpëtuar andej.

Pas disa vjetve çlirim, xhamisë së Gurrës po i pakësoheshin besimtarët. Qenani, që kishte një nuhatje të hollë, zëvendësoi çallmën me qeleshe. Kur dëgjonte se atypari kishin ardhur të deleguar nga rrethi apo lokaliteti, e mbyllte xhaminë. Kur pa se me të ardhurat që po pakësoheshin nuk ia dilte të mbante familjen, vajti në komitetin ekzekutiv dhe kërkoi punë zyre. Meqë nuk i eci, vajti tek i vëllai në minierë dhe iu lut që të ndërhynte t'i gjente ndonjë punë të lehtë.

— Ti këtu?!, — i tha Demi. — Mulla Qenani të punojë në minierë?! M'i shtri duart!

Qenani ia shtriu si me sustë pa ditur pse i kërkoheshin ato.

— Kjo dorë e butë, me lëkurë të bardhë e të hollë të punojë në minierë?! Jo, Qenan! Kur të pata folur atëherë, më pate shpallur laik, bile faqe gjithë besimtarëve. Unë turpërohesha nga jeta jote me rrena. Tani paske ardhur të më turpërosh, edhe këtu?! Mos e kërko këtë prej meje.

— Dem, unë bisedova edhe me shokun Kujtim. Më porositi që ta bëja mend një herë me ty, si vëlla që të kam.

— Jo, — tha prerë Demi.

— Ç'thua ashtu, mor burrë, — ndërhyri e shoqja e Demit, — ti e di se ata kanë një qerre kalamanj.

— Moj Hanë, Qenani i ka dyert të hapura të punojë ku të dojë. Gjithandej ka nevojë për punëtorë.

Qenani u ngrit i skuqur, as dëgjoi Hanën që deshi ta ndalte për drekë. Vajti te Kujtimi. Ky i fundit bisedoi me shokët e tjerë të grupit e me ata që ishin të një mendimi, vajtën në kuadër dhe, pa përfillur Demin, e pranuan të fillonte punën në minierë.

— Dem, puna përfundoi, ora është njëmbëdhjetë, kemi kohë të vemi për gjah, — i foli Agroni duke iu afruar.

Demi ngriti kokën, rrotulloi dritën gjatë galerisë, deshi të shihte Kujtimin: «Sigurisht Kujtimi e ka shtyrë Agronin; s'ka si shpjegohet ky ngulmim, — mendoi. — Sa i mirë është Kujtimi, edhe një gjë e vogël, një mërzi apo një rrufë e shokut e shqetëson. Por e prishi dreqi me atë Qenanin. Nuk i ka hije një punëtori si Kujtimi, i cili u vë gjoksin punëve më të vështira, t'ia punojë me të pabesë një shoku të vet. Si për inatin tim e pranoi Qenanin në minierë. Bile edhe më qortoi: «Nuk e prisja prej teje, Dem, — më tha ai. — Ke filluar t'i bësh bisht punës, revolucionit». Unë i bëkam bisht revolucionit?! E pse? Se nuk desha që një parazit, për më tepër një qelepírxhi, të punonte këtu. Po të mos qe vëllai im dhe unë të ngulja këmbë, shokët do të kishin të drejtë të mendonin keq, por ky është vëllai im. S'kam si i flas atij faqe të tjerëve. U zemëruan, Kujtimi nuk ka të drejtë. Ai më njeh mirë. Të gjithë të pamësuarit, të rinjtë, nga dora e Kujtimit kanë dalë minatorë të mbaruar, po krah Kujtimit kam luftuar edhe unë».

Në galeri u vunë shinat e reja. U provua edhe vagoni.

— Rrëshqet si në akull, — tha Sherifi.

Të gëzuar mblodhën veglat dhe u ngjitën. Në ashensor Agroni prapë i pëshpëriti në vesh Demit:

— Do të vemi për gjah sot?

— Mos të ka ngarkuar Kujtimi të bësh punë edukative me mua?, — pyeti Demi.

— Të më kishte thënë ndokush se Demi merret me cikërrima dhe hamendje mikroborgjezësh, nuk do ta kisha besuar, — ia pat Agroni.

— Të pyeta, se nuk e shpjegoj dot këtë pasion të pafre për peshkim, dy-tri herë gjithsej ke ardhur me mua për gjah.

— Kam peshkuar me shokët e turnit tjetër.

— Unë do të shkoj, ti, po deshe, eja, — tha Demi.

Në sipërfaqe u lanë e u veshën. Kur u ndanë, Agroni dhe Demi vajtën të merrnin mjetet e gjuetisë.

Dielli i mesditës reflektohej në sipërfaqen e liqenit të kulluar. Dy pulëbardha ngriheshin thikthi në ajër, pastaj lëshoheshin si shigjeta, çiknin ujin, shpupurisnin pulpat bardhoshe e ngriheshin sërish me klithma. Grupe njerëzish shëtisnin rrugicave të asfaltuara midis drurëve. Fëmijët mblidhnin lule. Kurse katër gjahtarë të heshtur si njerëz që bluajnë mendime filozofike qëndronin varg në buzë të liqenit.

Njëri prej kallamave u drodh lehtë. Fildispanja u tendos me forcë.

— I ra, Dem, është i madh!, — thirri Agroni duke iu afruar shokut të tij.

Tjetri përmbajti gëzimin që ndiejnë gjahtarët në të tilla raste, megjithatë vetullat iu ngritën hark. Shkuli kallamin prej toke, ndërsa me dorën tjetër kapi fillin dhe e tërhoqi me kujdes.

— Krap trikilësh, — thirri Agroni.

Peshku që kishte gëlltitur grepin tkurrej e i jepte trupit me forcë që të shpëtonte. Pasi bëri një gjysmëhark në buzë të liqenit, u gjend në breg. Kërcente e tundej. Luspat e argjendta vezullonin nga rrezet e diellit. Ishte mjaft i madh. U afruan edhe dy gjahtarët që kishin ngritur grepat më tutje.

— Të lumtë, — i tha njëri prej tyre Demit, — gjithnjë ke shans.

— Rremë, akoma me shanse ti!, — ia pat Demi. — Të vjen zor të pohosh se është dora e mjeshtrit që di të gjuajë e të kapë.

— Është dorë minatori kjo, — e mburri Agroni.

— Edhe Rrema punon në fabrikën e tullave, — shpjegoi Demi, — por ç'e do, dora që nuk nxjerr tulla të mira, edhe për peshkim nuk bën.

— Këtë do ta pjekim shoqërisht, — tha punëtori i dytë i fabrikës së tullave, — si gjithnjë, gjahu më i mirë kolektivit të peshkatarëve.

— Të dielën e ardhshme, sot jemi vonë, — tha Demi, na presin fëmijët, gratë.

— Jo, jo, — nguli këmbë punëtori i tullave, — për gjysmë ore e bëjmë.

— Merru ti me të, — i tha Demi dhe i tregoi peshkun. Tjetri nxori thikën dhe filloi ta pastronte.

Agroni hodhi grepin me flutur. Priti ca, pastaj e tërhoqi, por asgjë.

Atë kohë Rrema, i përqëndruar, filloi të tërhiqte fildispanjën duke folur si zbutësit e kafshëve të egra:

— Hajde, hajde de! Avash, të keqen, Rrema të do shumë! Mos u zemëro, ja ku po të pres. — Sakaq tërhoqi fillin me forcë. Në breg filloi të shpurdhte një mustak i madh.

Agroni, i ndezur nga zilia, harroi të përgëzonte tjetrin, as t'i hidhte sytë peshkut, hodhi me të shpejtë grepin me flutur. Gjatë tërheqjes thirri:

— I ra, i ra!, — dhe e tërhoqi. Kur po e afronte, peshku u shkund me forcë, këputi fildispanjën e me grepin në grykë u zhduk në thellësitë e liqenit.

Demi vështroi fytyrën e dëshpëruar të shokut dhe e ngushëlloi:

— Mos u mërzit, rëndësi ka që i ra grepit, do të kapësh të tjerë.

— Eh, ç'ma punoi qeni!, — tha Agroni.

— Fajet i ke vetë, nuk duhej ta tërhiqje menjëherë. Kur i bie, lëshoje fillin, lodhe mirë, pastaj tërhiqje lehtë. Të vjen në dorë. Po më habit. Në minierë të gjithë të quajnë «i gjerë si deti», kurse në peshkim qenke më i rrëmbyer se Sherifi.

— Lëre dreqin! M'i la puplat në dorë.

— Nuk thua fillin pa grep.

— Kam të tjerë.

Pas dy orësh të gjithë ishin të kënaqur për gjahun e mbarë.

Mblodhën fijet, i mbështollën në kallama dhe po ecnin me shpresë se atje tej punëtori i tullave do ta kishte pjekur krapin, po vunë re se tjetri po gjuante pa e prishur terezinë.

— Petrika, — i thirri Rrema, — ku është peshku i pjekur?

— E kam pastruar, e kam kripur, do ta pjekim së bashku.

— Ç'na e punove!, — tha Demi.

— Do ta piqja, por lezeti më i madh është kur e shikon duke u pjekur.

Të katër punëtorët hapën një gropë, vendosën dy tulla anash, po, sapo vunë rrasën e gurit mbi to, njëra prej tullave u shkërmoq. Gjetën një gur tjetër dhe e rivendosën rrasën mbi të. Shkarpat morën shpejt. Vendosën peshkun e kripur mbi rrasë. Pas pak filluan të kërcisnin kokrrat e kripës. Peshku filloi të fryhej e të nxirrte filluska.

Agroni kapi dy copa të tullës së shkërmoqur, i goditi me njëra-tjetrën e ato u troshitën.

— Gjynah t'i thuash tullë kësaj, — tha ai, — thërmohet më keq se qerpiçi i njomur.

— Ka qëlluar e papjekur, — tha Demi.

— Jo, — tha Agroni, — në pallatin që ndërtojmë me kontribut vullnetar të tilla tulla morëm, jo pak, po dy makina. Thyhen sikur të jenë gatuar me rërë.

Të dy shokët e fabrikës së tullave e vështronin vëngër Agronin.

— Nuk është hiç e hijshme të nxjerrësh skarcitete nga dora, — tha Agroni.

Punëtorët e tullave ulën kokën.

— Shoku im, Agroni, di shumë gjëra, veçse të përkëdhelë dhe të falë nuk di, — tha Demi.

— Të isha unë furnitor, as me qerpiç nuk ju furnizoja ju minatorët, — tha Rrema.

— Përse?, — pyeti Demi.

— Sepse asnjë ndihmë nuk na jepni.

— Çfarë ndihme dashkeni prej nesh?

— Qymyr ju japim, bile të një cilësie të mirë, — tha Agroni.

— Ne nuk na duhet vetëm qymyri i cilësisë së mirë, po edhe nga ai 800-900-kalorish, bile edhe 100-200-kalorish.

— E ke me gjithë mend?, — pyeti Demi: — Përse ju dashka ai?

— E përziejmë me baltën, dalin tullat hem të lehta, hem shumë të forta. Ato tulla jo nga pika, por as nga shqo-ta s'duan t'ia dinë.

— Sikur t'i hedhësh në lumë, nuk treten, — tha punë-tori tjetër, Petrika.

— Vërtet?, — pyeti Agroni mjaft i interesuar.

— Po, — shpjegoi Rrema, — duke përzier dheun me pluhur qymyri, bëhet një djegie e brendshme, grimcat e qymyrit digjen pjesërisht, pjesa tjetër kalcifikohet. Tulla del e lehtë dhe çelik e fortë.

Agroni vështroi Demin me nënkuptim dhe heshti. Peshku u poq. Të tre punëtorët hanin, kurse Agroni micërronte. Atij iu kujtuan galeritë e Jugut. Shtresa e qymyrit përbëhej prej dy nënshtresash, njëra pjesë ishte qymyr i një cilësie të lartë, kurse pjesa tjetër në ngjyrë të murme nxirrej jashtë e hidhej atje ku hidhej argjili.

Të katër gjahtarët lanë liqenin. Dy minatorët u ndanë me punëtorët e tullave afër shkollës «11 Janari».

— Agron, — pyeti Demi, — ç'pate që u ngryse, ata as të fyen, as thanë ndonjë fjalë pa kripë.

— Kjo e diel më ka vlejtur shumë. U binda se ne jemi hiçgjë dhe e quajmë veten diçka.

— Mos gjyko rrëmbyeshëm!, tha Demi.

— Kush punonte në laborator më parë?, — pyeti Agroni

— Ai ish-bixhozçiu, Alushi, — u përgjigj Demi dhe i ra ballit. — Sa mirë ma kujtove, ai ka provuar fuqinë kalorifike të qymyrit, Alushi ka vërtetuar se gjysmështresa e qymyrit të Jugorit është dhe.

— E mora vesh. Unë e kam gjetur Alushin si pompist.

— Kërkoj vetë, se nën dhe paguhet më shumë.

— Po, e qartë, gjithçka e qartë. Nesër pas pune do të vete në fabrikën e tullave.

— T'i themi Kujtimit njëherë.

— Dem, ti e di se Kujtimi kërkon mendime të bazuara, të vete njëherë në fabrikën e tullave, pastaj e bisedojmë me Kujtimin.

— Eh, mor Agron, nuk është vetëm puna e Qenanit që më mundon, por ka edhe të tjera.

- Çfarë?
- Ja, puna e Alushit, jo vetëm për analizat e gënjeshtërta, se këto sot i mësuam ose do t'i mësojmë, por ai njeri nuk është në binarë. Më vjen plasje kur ia kreh bish-tin edhe ai specialisti i huaj.
- Atëherë u dashka biscduar me Kujtimin, — tha Agroni.
- Të thashë, — ia pat Demi, — bisedo ti, jo unë.
- Ç'është kjo mëri kanunore, Dem?!
- Bëj si të them.
- Ashtu duke folur dolën tek unaza.
- Hej, peshkatarë, — u thirri dikush nga prapa. Kur kthyen kokën, panë Kujtim Kreshpën.
- Fol për shiun, — tha Agroni, — bëj gati çadrën.
- Si ju shkoi gjahu?, — pyeti Kujtimi.
- Agroni futi dorën në trastë dhe kapi peshkun më të madh.
- Lëre, — i tha Kujtimi, — po shkoj në spital, te Demiri.
- Mirë, po ia shpie Zanës, — tha Agroni.
- Do të gëzohet shumë, sidomos sime bije, Dallëndyshes, i pëlqen shumë peshku, — tha Kujtimi dhe vështoi Demin, i cili qëndronte hundë e buzë. — Kohë e vrenjtur, — thumboi Kujtimi, — do të bjerë shi.
- Demi sërish buzëvarur.
- Hajt mirëupafshim, po vjen autobusi, — tha Kujtimi.
- Kemi për të biseduar një çështje me rëndësi.
- Të ndalem?, — pyeti Kujtimi.
- Shko, shko, — tha Agroni, — do ta bisedojmë njëherë tjetër, — dhe i shtrëngoi dorën.
- Demi i dha vetëm majat e gishtave.

K R E U III

Kujtim Kreshpa atë pasdite qëndroi deri vonë në spital. Edhe pse mjekët i thanë se Demiri gjendej jashtë çdo rreziku, ai u kthye në shtëpi me vetulla të shembura mbi sy dhe mjaft i zymtë. Hëngri kokulur.

Zana pa turrën e rrudhave midis dy vetullave, i foli për Agronin që kishte sjellë një qefull të madh, u përpoq të hapte biseda të tjera, por, sa flet guri, aq hapi gojë Kujtimi. «Prapë ky karrocata e qëmotit, — mendoj Zana, — brenda së cilës nuk mund të hulumtosh asgjë». Kur u bind se nuk mund të mësonte mbi zyrtësinë e bashkëshortit, gruaja u mor me punë shtëpie dhe e la Kujtimin të qetë.

Kujtimi nga ana tjetër gjendej në prag të një dukurie, ku njeriu edhe ka dëshirë ta pyesin për shqetësimet, edhe përton të përgjigjet, sepse shkakun e vërtetë të andrallave akoma nuk e ka gjetur. Shkoi në dhomën e gjumit. U mbështet, vuri pëllëmbën mbi sy, aq më keq. Përfytyrimi i sollarit përpara të gjallë aksidentin. Vagoneta e përmbysur, Demir Ullishtasi nën të, me fytyrë të murrëtyer prej dhembjeve. Trajektoret e dritave të minatorëve u kryqëzuan në oxhaqe, në galeri, pastaj u përqëndruan në një pikë. Duar të fuqishme ngritën vagonetën. Të tjera duar mbërthyen të aksidentuarin. Në çdo shkallë një dritë, një minator. I plagosuri u përçoll dorë më dorë. Ramë Dushku, i cili kishte arritur i pari në vendin e ngjarjes, sillej rreth vagonetës së ngritur mbi shina dhe belbëzonte:

— «Është dora e qoftëlargut që mbjell prapësira në këtë errësirë xhehenemi». Edhe pse askush nuk ia vinte veshin, Rama përsëriste të njëjtën frazë dhe sillej e shikonte rreth vetes i tmerruar.

«Po, Rama, — mendoj Kujtimi, — ishte supersticioz. Sa herë hynim në minierë, hidhte këmbën e djathtë dhe lëvizte buzët, sigurisht thoshte ndonjë lutje. Rama mbante edhe ramazan. Kemi punuar, por ja, disa zakone ia zhdukëm, të tjera ka. Puna me njeriun qenka punë e vështirë, tepër e vështirë».

«Qoftlargu». Kjo fjalë e thënë në galeri nga Rama e bëri Kujtimin të harronte të aksidentuarin. Iu fanit edhe fytyra e ngrysur me vetulla të kacadredhura e Demit. «Dita e vjeshtës së dytë», siç kishin filluar ta thërrisnin minatorët. Kishin hak, kohët e fundit Dem Qesati gëzimin e mbante në njërin xhep, hidhërimin në tjetrin.

I tingëlluan si të gjalla fjalët e Lim Thanës atë paradite: «Grupi ynë do të quhej luftarak, sikur të mos kishte tre dezertorë...».

«Cilët ishin këta?, — pyeti me vete Kujtimi. — Pooo! Zhagan Dhoga, Qenan Qesati dhe Alushi, pompisti i turnit tonë! Vërtet, përse Alushin shokët e quanin Alushenko?!... Nganjëherë ka të drejtë Demi kur thotë se nuk duhet t'u dalim për zot vetëm ne njerëzve me vese. Shumë vetë janë kthyer në punëtorë pararojë, në revolucionarë të vërtetë, por paska disa shumë të vështirë. Ç'duhet të bëjmë me këta?». Ai mori frymë thellë. Po habitej me ato veçori të larme të shokëve. Çuditej edhe me ato vrapime përfytyrimesh, të cilat atë mbrëmje ishin me ngjyra të ndezura, po fluturake.

«Përse këtë muaj nuk realizuam planin?, — pyeti ai veten. Dhe u bind se ky ishte shkaku i të gjitha shqetësimeve të tij. — Po planin e realizojnë njerëzit», — iu përgjigj vetes me të pëshpëritur. Iu kujtuan disa të rinj, të cilët, kur punonin në turnin e dytë dhe të tretë, tërë ditën bridhnin qytetit. Pak pa filluar punën, bënë një sy gjumë. Pastaj flinin në galeri të mbështetur mbi vagona ose mbi kasat e tuneleve. «Apo nuk është i ëmbël ai drejgjumi në galeri, — mendoi Kujtimi. — Me të mbyllur sytë, fillon ëndrra. Jo si çdo ëndërr, po diçka midis dehjes dhe fluturimit. Kjo ua kalon të gjitha të këqijave. — Këtë herë Kujtimi foli me zë të vogël. — Struken në galeritë qorre, po ato janë të paajrosura, ka gazra. Rrezikohet jeta e gjumashëve». Iu kujtua se si ishte bërë problem ajo shkelje. Kujtimi u ishte afruar të rinjve.

— «Mor shoku Kujtim, — i kishte thënë një djalosh që e thërrisnin Rrush (meqë i kishte sytë si kokrra e rrushit të zi), — me të drejtë shqetësohen shokët për disa nga ne. Vërtet bredhim tërë ditën. Thyejmë disiplinën duke fjetur në galeri. Pengojmë edhe realizimin e planit. Rrezikojmë shëndetin. Qortimet janë me vend. Ja të flas për vete. Më këndon zemra. Më gufon gjaku. Kur dal nga miniera, dëshiroj të dëfrehem. Këtu s'kemi ku të zbavitemi, ndaj shkojmë në qytet. Bredhim. Mbetemi pa gjumë. Nuk jemi

murgj, të shkretën! Më këndon zemra, mor shok! Para marr boll, po dua të dëgjoj një këngë, një program.

— Në sorrollatjet, — i kishte thënë Kujtimi, — nuk gjendet asnjë zbavitje». Por me mend i kishte dhënë të drejtë. Këtë çështje e ngriti në mbledhjen e organizatës. Meqë Kujtimi kishte një farë përvoje në aksionet e rinisë, organizata e ngarkoi të ngjinte grupin artistik dhe ai iu përvesh punës.

— Por ja, Demir Ullishtasin, minatorin më gazmor, i cili këndonte bukur, i binte edhe mandolinës, i jepej të luante edhe role, e kishte zënë vagoneta.

Aksidenti, qoftëlargu i Ramës, dita e vjeshtës së dytë, mosrealizimi i planit mujor u ngatërruan në mendjen e Kujtimit.

«Sot riparua shinat në galerinë e prodhimit, — mendoj. — Pas pesë-gjashtë ditësh prapë presioni do ta bëjë të vetën. I gjendet ilaçi kësaj, apo duhet t'u nënshtrohemi tekave të nëntokës? Ptuh, ç'fjalë e ndyrë «nënshttrimi»! Për ideal se ka fjalë më fyese. Pse zvaranikë jemi ne? Ç'të bëjmë pra? Të veprosh, nuk di». Pastaj iu kujtua aksioni i parë, fill pas çlirimit të vendit. Notonin patatet e vogla në kazanin me supë që ngjante me një lëng të murmë. Edhe të uritur punonin. Edhe veglat mungonin. Po ata punonin dhe thyenin norma. Tërë ditën shkumëzonin prej djerse, mbrëmjeve grumbulloheshin pranë llampave me vajguri, mësonin. Shkronjat në fillim ishin të shtrembra, disa trashaluqe, disa të stërgjata, të anuara prapa, përpara. Dalngadalë ato stabilizoheshin, u nënshtroheshin vizave të fletoreve.

Në aksionin e parë Kujtimi i ngrysur shpërthente kundër ndonjërit që, jo me dashje, por nga mosditja bënte veprime të pahijshme. Kur pat shtyrë një të ri, e patën thirrur në komitetin e Partisë. Përveç qortimeve, i thanë: «Të mungon ngritja arsimore dhe ideologjike. Duhet të vesh në shkollë, shok». Kujtimi u zemërua, por porosinë e kreu. Edhe punonte, edhe mësonte në barakën e shtruar me kashtë. Lexonte broshura, libra. Në fillim i bënte si detyrë që ia kishin ngarkuar: «Për mbarëvajtjen e

punës, — i kishin thënë shokët e Partisë, — për socializmin që është i përbashkët për të gjithë ne, për jetën tonë dhe lumturinë e brezave të ardhshëm duhet të dimë të punojmë dhe të mësojmë. Gjithçka është jona».

«Injoranca ngjan me një merimangë që thur pezhi-shka për të penguar dritën». Kjo frazë e lexuar diku i slli edhe një herë ndër mend fjalët e Ramës» ... është dora e qoftëlargut që mbjell prapësira».

«Pesëmbëdhjetë vjet çlirim, — tha me vete Kujtimi, — Rama analfabet! O burra, prodhimi! Po ja, ky prodhim nuk ecën si duhet. Përmbysen vagonat... Po sikur...».

Fantazia po i ndizej. Iu kujtua fusha e aeroplanëve. Teli. Një aeroplan në miniaturë që shërbente për konkretizimin e mësimëve teorike të aviatorëve. Vuri dorën mbi sy si të donte të pengonte të mos i ikte imazhi. Përfytyrimi mbi avionin stërvitor iu mjegullua. Përmes davaritjes së mjegullës u shfaqën konturet e maleve, pastaj disa shtylla të larta prej hekuri, mbi to teleferiku nga ngjiteshin dhe zbrisnin vagoneta.

«Pra, — tha Kujtimi, — vagoneta nuk ecën vetëm mbi shina, ajo mund të rrëshqasë edhe në një kavo. Po kavoja si do të qëndrojë në galeri?...» Zëri i Kujtimit u dëgjua deri në dhomën tjetër. Zana iu afrua portës. Në fillim pandehi mos i shoqi fliste përçart. Po fjalët e thëna açik e habitën. Kur hapi derën, Kujtimi po vishej me ngut sikur të ishte dhënë sinjali i alarmit.

— Ç'bën?, — pyeti ajo me një buzëqeshje të ngrirë. Kujtimi lëvizte buzët, po nuk u përgjigj.

— Ku do të shkosh? Ç'ke?

— Di të më shpjegosh gjë për teleferikun?, — pyeti Kujtimi.

«... Teleferiku». — belbëzoi Zana. Kjo fjalë iu duk se s'kishte asnjë lidhje me punën e Kujtimit. Shikoi të shoqin me shqetësim. Po përveç skuqjes së mollëzave të faqeve dhe ca shkëndijëzave në sytë e të shoqit, nuk dalloi asgjë tjetër. Megjithatë ajo u përgjigj:

— Ulu! Të flas unë për teleferikun.

— Vërtet?, — pyeti Kujtimi dhe u derdh drejt së sho-

qes me njërin krah të futur në xhaketë e me mëngën tjetër të varur. Edhe fëmijët bënë ballë në derën e dhomës së gjumit.

Burrë e grua biseduan gjatë rreth teleferikut, rreth vagonave. Kujtimi mori minierën në telefon. Centralistja i tha se inxhinierët gjendeshin brenda në minierë. Edhe inxhinier Vangjoja që ishte dezurn, kishte zbritur poshtë.

— Kur mund të dalë?, pyeti Kujtimi.

— Kur të mbarojë turni, — iu përgjigj centralistja.

Edhe pse ishte natë, Kujtimi u nis për minierë.

K R E U I V

Agoi mëngjesi i 29 Nëntorit. Miho Gjelaci për herë të parë kishte vendosur të shikonte parakalimin. U përzie me turmën. Zuri një vend tutje komitetit ekzekutiv përballë hotel «Pezës» ku mund të shihte dhe të mos binte në sy.

Kureshtja e madhe që e kishte brejtur tani iu kthye në një ndjenjë torture frymëmarrëse. Vështronte fytyrat e qeshura e të gëzuara të mijëra njerëzve që mbushnin bulevardet dhe monologonte: «Të gjithë këta që i gëzohen sot festës, nesër, sikur të pëlçasë lufta, janë të gatshëm të shtrëngojnë armët, të mbrojnë pushtetin e tyre. Po, po...». Fillin e mendimeve ia prenë brohoritjet që dëgjoheshin në bulevardin «Dëshmorët e kombit». Ata që kishte pranë filluan të duartrokisnin.

Radhët e para të parakaluesve u dukën.

«Mami, ja babi, babi, moj, në tetëshen e parë», — u dëgjua zëri i një vajze pranë Mihos. Ky vodhi me bisht të syrit ëmë e bijë, pastaj derdhi shikimin nga parakaluesit. «Më bëjnë sytë, apo janë ata. Po, minatorët të parët në parakalim.

Ja, Kujtimi, Demi, Rama, Agroni, qenkan në tetëshen e parë. Mirë më thoshte xha Azizi, janë njerëz të besueshëm... «Shiko, shiko siçirren». Mihoja u ngrit në majë të gishtave. Në atë kohë një dorë e përbiroi nën sjetull. E shtrëngoi sapak. Iu drodh trupi. Ktheu kokën avash. Ç'të

shikonte! Ishte i marri, Talo Dylberi. Ashtu i parruar, me sy të turbulluar. Ia shtrëngoi krahun dhe i foli:

— Oh, zotëri, sa ju kam kërkuar. Kur paskeni ardhur?

Mihos iu mpak shpirti. «Taloja është i marrë! Kushedi ç'mund të llapë!». Tërhoqi krahun nga dora e të marrit dhe kaloi më tutje. Talo Dylberi prapa tij. Mihoja shtyu dy të rinj që ndodheshin para tij dhe u largua me ngut. Talo Dylberi prapa:

— Zotëri, ku veni, zotëri: Unë ju kam kërkuar.

Ata që nuk e njihnin Talon, e shikuan me habi dhe urrejtje. Ç'ishte ajo fjalë «zotëri»? Dy të rinj thumbuan:

— Talo, iku, iku Fjorentina! Mbaroi floriri! Fluturuan dyqanet!

«O bubuja, i marri po më ndjek! Kushedi ç'mund të nxjerrë prej goje», — mendoi Mihoja dhe mallëkoi veten që kishte dalë në bulevard. U përbirua përmes njerëzve. Doli në trotuarët e bulevardit «Stalin» dhe shpejtoi hapin. Kur pandehte se shpëtoi, u mbush me frymë, nxori shaminë dhe fshiu qafën e djersitur. Por Taloja sërish e mbërtheu për bërryli.

— Zotëri, ju e dini se më iku Fjorentina! Mbaroi floriri! Fluturuan dyqanet e mia!...

Mihoja deshi të vraponte, por edhe andej trotuarët ishin plot me popull. Pa vetëdije i lëshoi shaminë në dorë Talos. Ndërsa i marri afroi shaminë te hundët që t'i merрте erë, Mihoja u fut në një rrugicë dhe ia mori me vrap. Kaloi në rrugën e «Barrikadave», ktheu kokën, kur, ç'të shihte, Talo Dylberi vraponte pas tij.

Ç'më polli!, — belbëzoi i elektrizuar nga frika dhe zemërimi. Mësyu një rrugicë tjetër. Me hapa të shpejtë u fsheh prapa një kthese, pastaj doli në rrugën «Isa Boletini». Ktheu kokën prapa. Asnjeri. «Gati më polli me budallanë. Si më njohu, xhanëm! Mos më pa njeri kur m'u drejtua Taloja? Nuk besoj. Ai s'ma di as emrin». Ndërsa bluante kështu dhe ecte, te bërryli në krye të rrugës u ndesh ballë për ballë me Talon. Ai e priste. Mihoja deshi t'i shmangej, por ai e mbërtheu për jake. Këtë herë nuk iu drejtua me «zotëri» por:

— Rrezil, — i tha ai, — kujtove se do të më shpëtosh!
Këlysh bushtre! Ti ma rrëmbeve Fjorentina Lambrozian!
— Dorën tjetër ia kishte vënë në gurmaz.

Mihoja shikoi kthesën e rrugës. Asnjëri. Deshi t'ia ngjishte me grusht dhe të shpëtonte, por një mendim i keq e bëri të duronte:

«Mos e kanë bërë për vete dhe ky shtiret si budalla?!
Mos kundërzbulimi shqiptar ka zbuluar lidhjet e mia, duan të më arrestojnë dhe zënkën time me këtë mund ta përdorin si pretekst për të më kredhur brenda?!».

— O do të ma kthesh Fjorentinën, o ta mora shpirtin!
Rezil, këlysh bushtre, — hakërrehej i marri dhe ia shtrëngonte gurmazin Mihos.

«Duhet të iki, të iki, të iki, të shpëtoj!» — mendonte Mihoja. Po si të shpëtonte. Shikoi përpara, asnjëri.

— Më lësho, mor shok, unë s'të njoh, më lësho të sqarohemi!, — tha. Taloja e liroi. Tjetri deshi të ecte. Por ai ia zuri prapë rrugën. Mihoja e goditi në zverk. Taloja u shemb përdhe. Mihoja vrapoi rrugicë më rrugicë. Më në fund arriti në banesën e vet i hallakatur.

«Të shkretët ne si jemi katandisur! Talo Dylberi, ajka e parisë, tani lolo. Këta na morën ç'patën, këta na çmendën. Ne nuk duhet të rrimë duarkryq!».

Ishin vitet kur kryetari i një shteti të madh kishte zhveshur shpatën e kultit të vet dhe çirrej e bërtiste kundër një kulti të paqenë.

«Ja, — mendoi Mihoja, — forca e tretë ka filluar të veprojë me fuqi. Mirë më thoshte zoti Tiani: «Ti ke një nuhatje të çuditshme, ndaj kam besim të madh te ti.» Erdhi koha të lëviz».

Vendosi të bisedonte me ish-myshterinë e babait të vet, me Aziz Lëndën, i cili kishte vuajtur pesë-gjashtë muaj burg.

Xha Azizi sa herë bisedonte me Mihon, përmendte të atin, Shahinin: «Gjynah që u bombarduan depot dhe e zunë Shahinin brenda. Ishte burrë i zgjuar ai. Mendja ma thotë se do të dinte t'i përshtatej kohës së re». Ndërsa për Mihon ai mendonte se do ta kishte kuptuar sa e gabuar

kishte qenë rruga që kishin ndjekur bejlerët dhe tregtarët e mëdhenj, të cilët ishin kthyer në tradhtarë të atdheut dhe në bashkëpunëtorë të pushtuesit. Shkurt fjala, xha Azizi, për ta studjuar tjetrin, përdorte metodën e autoobservacionit.

«Mihoja, bir i një njeriu të zgjuar, duhet të jetë njeri i mirë». Kështu pat menduar në fillim xha Azizi dhe i bëhej zemra mal kur shikonte se Mihos i zgjidhnin punë sipas aftësive qoftë brigadierja, qoftë skuadërkomandanti.

«Ja, — thoshte me vete bahçevani plak, — edhe pse ne kemi gabuar e duhej të na hidhnin farmak, shokët na afrojnë me qëllim që të mësohemi me punën.

Njëherë, pas dy muajsh, ndërsa xha Azizi ishte futur në serat, iu afrua Miho Gjelaci. Plaku e pa sipër syzeve dhe pyeti:

— Hë, Miho, përse nuk punon, je gjë sëmurë?

— Jo, zoti Aziz, — u përgjigj Mihoja, — ne, edhe kur nuk jemi sëmurë, vuajmë. Vuajmë se na i shajnë të afërmit.

— Kush të ka sharë?

— Mua askush, por ata që i dua dhe i respektoj.

— Kush janë këta?

— Të gjithë.

— Kush janë këta të gjithë, mor Miho?, — pyeti xha Azizi duke u ngritur në këmbë me një tufë fidanësh në dorë.

— Shtiren sikur na duan, — tha Mihoja, — po grenzat nuk bëhen miq me bletët.

— Bëke shaka të pakripura, mor Miho!

— Të duket se të provokoj? Ke të drejtë. Njeriu sot nuk duhet t'i besojë as këmishës së vet.

— Ç'të mundon, Miho?

— Pse nuk pyet çfarë s'më mundon?

— Fol më hapur, djalë!

— Gjoja na zgjedhin punë të mirë, gjoja na flasin me fjalë të ngrohta, kurse në anën tjetër...

— Çfarë bëhet në anën tjetër?

— Të rinjtë dhe të rejat thumbojnë me romuze.

— Cilët të kanë ngacmuar?

— Jo direkt, po tërthorazi.

— Nxirrja kryet, të shkretën!

— Zoti Aziz, nuk marr vesh si mund të durosh. Unë nuk mund t'i duroj. Ato të rejat atje kakarisin dhe flasin.

— Ç'të thanë?

— Mua s'kanë ç'të më thonë, të përflasin ty. Lodra bie për atë që ka vesh.

— Fol, mor, ç'të thanë, mos dërdëllit kot!

— Kanë improvizuar një këngë ku përmenden bejlerë dhe agallarë, tregtarë e çifligarë, mercenarë dhe tradhtarë.

— Ç'lidhje ka me ty kjo?!

— Unë kam qenë i ri atëherë, ata këndojnë për ty, zgërdhien, se e dinë që ti ke qenë miku më i ngushtë i babait tim.

— Ik vazhdo punën. Për mua mos u shqetëso. Nëse të djeg gjëkund, nëse lëngon, ik vizitohu! Mos bëj ish pa pasur pula.

Miho Gjelaci u kthye në punë, përbrenda përleshej dy-luftimi: «Ky plak është matufepsur, apo ka frikë të hapet? Patjetër që është ujk i vjetër. Kërkon të provojë sa jam i vendosur».

Edhe disa herë iu afrua xha Azizit. E nxiti të fliste, me qëllim që të kapej në fjalët e tjetrit, por ai gjithnjë e këshillonte.

Një pasdite, ndërsa mori rrogën e pesëmbëdhjetëditëshit, Miho Gjelaci bleu në klub një shishe raki, në tregun fshatar një pulë dhe vajti në shtëpinë e xha Azizit. Plakun e gjeti në kopsht përpara shtëpisë së re duke gëzuar nipçen e vogël.

Edhe pse kohët e fundit Mihoja i dukej i bezdishëm, tinëzar, që orvatej t'ia linte tjetrit në derë, xha Azizit iu duke e rëndë ta përzinte prej shtëpisë. U shtruan nën hurmën xhufrrake, rreth një tavoline.

— Shishen me raki dhe pulën, — i tha xha Azizi, — lëri mënjanë. Je në shtëpinë time, mua asgjë s'më mungon.

— S'ka gjë, — tha Mihoja si me shaka, — kam ardhur

me racionin tim, – po, kur pa se fytyra e plakut u murrë-tye, ato, që pati, i mbylli në çantë e filloi të hante ato që serviri e reja e xha Azizit.

Mihoja mund të mos ishte për asgjë i bindur për sa i përkiste xha Azizit, por, që nuk do ta denonconte, ishte i sigurtë. E njihte mirë mentalitetin e plakut, ndaj për të parën herë pas aq kohësh, atë mbrëmje vendosi të pinte raki. Pija e fortë, siç i thonë fjalës, vetëm në vozë rri urtë.

– Xha Aziz, gjithkush punon për vete, zoti për të gjithë, – filloi. – Ne na ka harruar zoti, po e keqja është se kemi harruar veten. Do të fishkemi, nëse qëndrojmë duar kryq. E dimë se ç'na vlon përbrenda. I kemi vënë një kapak prej guri zemrës. Ajo përpëlitet. Një ditë po kaloja pranë bahçes sate e mendoja se sa djersë e mund ke derdhur ti në të, ndërsa tani e gëzojnë bythëgrisurit, bile edhe jevgjit.

Xha Azizi me një dorë po rrotullonte gotën, me tjetrën kishte mbërthyer cepin e tavolinës. Ai zë i dukej i ngjashëm me zërin e djalit të prefektit.

– Mendimet për bahçen tënde më kujtuan edhe dyqanet, depot e të ndjerit, babait tim. Ç'kishte vënë me djersë, ia morën. Unë nuk di ç'do të thotë dashuri për pronën që e ke vënë me duart e tua, por e marr me mend se është e tmerrshme. Të digjesh për së gjalli duke parë tek e shqelmojnë mundin tënd, të drejtën tënde.

– Babait tënd dhe ty t'i kanë marrë, kurse unë bahçen e kam dhënë vetë. Ç'më duhej një bahçe në formë hajmalie ku edhe pulës i zihej fryma. Dhashë bahçen e vogël, fitova gjithë këtë fushë pa anë e fund. Jetoja në një shtëpi me një dhomë e një ahur, tani kam shtëpinë me katër dhoma, kuzhinë dhe oborrin me pemë.

– Po kjo nuk është jotja.

– Imja është.

– Ashtu duhet thënë. Ti bën mirë që nuk e lë gjuhën të harbojë nga t'i teket. Thua kështu, por, për të luftuar, luftove kundër këtyre.

– Unë nuk kam luftuar. Më mashtroi ai qeni... – Xha Azizi foli me nofulla të shtrënguara, se fjalët e veta

i kujtuan personin që i kishte shkaktuar atë fatkeqësi të madhe. Iu kujtua letra që i kishte shkruar i biri i prefektit. I thoshte se fqinji, me të cilin ishte në hasmëri Azizi, gjendej në çetën partizane, dhe se ai kishte informata të sakta se hasmi dashkësh t'ia digjte shtëpinë.

«*Ta dua të mirën, — i shkruante biri i prefektit, — eja të të fsheh gjëkund, gjer sa të kalojë rrebeshi.*»

— Dhe unë budallai i besova, — tha me zë xha Azizi, — djali i prefektit më shpuri te maskarenjtë e Ballit. Ma bënë mendjen çorbë. Megjithatë, kurrë nuk u kam besuar plotësisht. Jo vetëm se nuk më lidhte asgjë me delenxhinjtë, po i pashë me sytë e mi, i njoha se kush ishin dhe për kë luftonin. Nuk mbeta aq budalla sa të mos kuptoja se partizanët luftonin për atdheun, për popullin. Me këta më bashkonte gjithçka. Hendeku i vetëm që qëndronte midis meje dhe partizanëve, sipas rradakes sime naive, ishte fqinji im, për të cilin ballistët më thoshin një mijë të zeza. Shyqyr jetova dhe e vërtetova se fqinji im paskësh qenë me zemër dhe mendje të madhe. Kurse unë një çapaçul që merr ditën për natë, dhe dritën për terr.

— Aziz Lënda, — klithi Miho Gjelaci, — mua më flet me këtë gjuhë?! Unë t'i di zorrët ty. Më njeh, të njoh, s'ka nevojë të më hedhësh kodër pas bregut.

— Çfarë kërkon prej meje?

— Atë që kërkoj prej vetes. Ti vetë thua «u kalbëm...».

«Paske qenë qen i madh, kush tha «u kalbëm», mor shpifës!».

— Pra, — vazhdoi të shpifte Mihoja, — siç thua ti, «të mos qelbemi». Tani po ndryshojnë punët. Shteti i madh, që dje i mbante nën sjetull, nesër do t'i ketë në grykë të pushkës. Dora jonë, siç thua vetë, duhet të fillojë të tregojë me punë atë që i vlon në zemër dhe që ia kemi fshehur edhe vetvetes gjer më sot.

— Çfarë do të bëjë dora juaj, o hardhucë jeshile. Ti je një hije e keqe dhe asgjë tjetër. Shporru prej shtëpisë sime dhe të mos ta shoh bojën, se më të madhen copë ta bëj sa një thnegël!

— Mos m'u kërcëno mua, se t'i di...

— Unë ia kam hapur zemrën doktorit. Nuk kam drujtje se ma nget sëmundjen njeri. Por më vjen ndoht kur shikoj para vetes një kërmë.

— Fjala e fundit?

— Largomu sysh! Të mos më dalësh më përpara, se do ta pësosh. Nëse pështirosem të ndyej duart me një coftinë, këtej e tutje mos pandeh se nuk të shpie në shtëpinë pa qira. Zaten atje e ke vendin ti! Shporru!, — klithi xha Azizi duke nxjerrë sqeparin prej brezi.

Miho Gjelaci shikoi i lebetitur nga porta e shtëpisë. Kishte frikë mos dilnin djemtë e xha Azizit. U zmbrops duke belbëzuar:

— Ki mendjen, Aziz! Mos bëj shaka me zarrar! Ti je i dehur, llape shumë, unë desha të të vija pas midesë, se isha në sofrën tënde...

— Mor, po ç'fola unë?!

— Fole shumë, nuk po të denoncoj, trupi yt i telen-disur nuk mund t'i durojë më burgut. Je i dehur, vetë fole, vetë u zemërove. Sikur edhe të jem i poshtër, që s'jam, të të denoncoj, jemi një më një; sa peshon po-ja ime, aq peshon jo-ja jote. Qetësohu!

— Ah, qen qeni, — thirri xha Azizi, — sa i poshtër qenke, sy për sy do të ndërrosh fjalët! Nuk jam i dehur, mor qafir, u bëra budalla kur besova se një këlysh si ti mund të bëhej njeri!, — tha i tërbuar xha Azizi dhe u sul drejt tij.

Mihoja u fsheh prapa trungut të hurmës, pastaj ia mbathi.

«U nguta, u nguta unë gomari, — mendonte Mihoja atë natë duke u rrotulluar në krevat. Edhe zhurma më e vogël në rrugë e bënte të dridhej. — Nëse do të denoncojë, nuk do të pranoj. Po sikur të shkoj unë ta denoncoj? Ato që thashë t'ia vesh atij? Po kush më beson mua! Azizi nuk më denoncon. Ka frikë, ndaj më priti me këmbët e para. Të pres. Nëse ai denoncon, do të mohoj. Fundja kush më dëgjoi?».

Vetëm nga mëngjesi e zuri gjumi. Të nesërmen shkoi në ambulancën e fermës, nuk u shqit andej deri sa mori

tri ditë raport. Tërë ditën qëndroi në një kallamishte. Frikësohej mos e kërkonte njeri. Ato tri ditë nuk fjeti në dhomën e vet, i kaloi te tezja, Sermja. Pastaj vajti në punë. Nëse dy vetë bisedonin, atij i vente mendja për keq. Mornica të ftohta ia kaplonin trupin. Kaluan ditët. Koha e siguroi Miho Gjelacin se Azizi nuk kishte denoncuar.

Me të tërë forcën e vullnetit iu shtrua punës për t'u futur në minierë.

«Në minierë, — mendonte, — e rregulloj biografinë. Kategorinë e pestë të minatorit e kam. Nuk do të tregohem dritëshkurtër si atëherë kur punova në tunelet e hidrocentralit «Lenin»».

Qysh kur kishte ikur andej, Mihoja ishte përpjekur të futej në ndonjë pikë ku nxirrej nafta, por i kishin kërkuar fletë pune, ndaj kishte mbetur në fermë.

«Në minierën «1 Maji» gjenden minatorë që kanë punuar në të gjitha minierat e Shqipërisë. Po hyra atje, do të mësoj për ato që jam porositur dhe do t'ua minoj tokën nën këmbë!».

K R E U V

Kujtim Kreshpa kishte punuar në turnin e dytë, pastaj kishte vajtur në kovaçanë. Ishte kthyer në shtëpi pa aguar mirë, ndaj u ngrit vonë. U la, hëngri. Fëmijët ishin në shkollë, gruaja në punë. Hyri në dhomën e fëmijëve, meqë edhe etazherët me libra gjendeshin atje. E bija, Dallëndyshja, e kishte vënë fotografinë e zmadhuar të gjyshit në ballë të dhomës. Kujtimi e vështroi, pastaj e mori në dorë. Sytë e mëdhenj të babait, shikimi i thellë e i mençur i zgjuan kujtime. Iu bë sikur fotografia lëvizti buzët. Në veshët e Kujtimit u përftua zëri i babait, Sadik Kreshpës:

«Ti linde në një vjeshtë të keqe, bir, — i pat thënë kur Kujtimi arriti të kuptonte çfarë i thuhej. — Binte shi atë ditë. Lllamarinat, me të cilat kisha mbuluar çatinë, rraptuan. Era frynte si e tërbuar. Unë qëndroja mbi kryet e nënës sate. Mbylla mazgallat e kasolles me velenxë.

Jot ëmë mërdhinte. E mbulova me kapotën time të irnosur. «Sadik, — thirri ajo, — dorën, ma jep dorën!». Fytyrën ia kishte mbërthyer ngërçi. Ma shtrëngoi dorën fort sikur të gjente shpëtim nga ajo. U ngrita. Çova velenxën dhe pashtë rrugën. Degët e akacjeve përkuleshin nën forcën e erës. Kujt t'i kërkoja ndihmë?! Iu afrova gruas. Djersë të ftohta kullonin nga duart e shtatzënës. Shtriqej. Tkurrej. Rënkonte. E kafshoi buzën e poshtme. Gjak më pikoi shpirti. Një dritë verbuese ndriçoi skutat. Bubullima tundi kasollen nga themelet. Kashtëza dhe pluhur ranë mbi fytyrën e saj. U dëgjua një klithmë e mbytur. Linde ti, bir, në atë ditë të vjeshtës së keqe. Zhvesha këmishën që binte erë së të mbështolla. Të lidha edhe kërthizën. Kur u ktheva nga ime shoqe, ajo ishte zverdhur. Mbërtheva me të dyja duart kokën e nuses sime të bukur. E putha. Ishte e ftohtë si akulli. Një mulla m'u mblodh në gjoks. Shpërtheva në një ngashërim plot ethe. Ja, ti më shikon, pandeh se ky Sadiku i ngrysur nuk di të qajë, as të ngashërehet nuk di. Më vdiq gruaja, biro, nëna jote. Ti i porsalindur, ajo e vdekur. Mund të thuash: «A t'u dhimbs, baba?». Shpirti im kishte provuar shumë grushte, po ajo vdekje më dërrmoi. Ka qarë babai yt me pika të mëdha loti. Selvia e bukur, gojëmblla Selvi na la mua hallemadhin dhe ty të porsalindurin. As bujk nuk isha; se tokë nuk kisha, as zejtar, as fshatar, as qytetar. Vite m'u desh të punoja, të mblidhja paranë si plaga qelbin. Bleva karrocën dhe një gërdallë. Karrocën e bëra shtëpi, arë e dyqan. Ngjitur me vendin përpara karrocës, ku qëndroja unë, rregullova një si punë krevati të vogël. Ai u bë djepi yt. Punoja natë e ditë, ty të merrja pas vetes. Foshnje ishe, bir. Nuk kisha me kë t'i ndërroja dy fjalë. Kur ndonjë bujk kishte për të shpënë drithë në pazar, më drejtohej mua, Sadik Kreshpës. Kur bëhej ndonjë dasmë, nusja merrej me karrocën tonë. Unë karrocieri bëja edhe punën e nallbanit, të opingarit, edhe të argatit, unë. Kalonin ditët. Unë flisja edhe me ty, që s'kuptoje ç'të thuhej, edhe me karrocën, edhe me kalin. Nuk njohe përkëdhelitë e nënës, biro! Dora ime me kallo, më shumë të gërvishte sesa të lëmonte. Sapo lëshove shtat, të ngarkoja

me punë, se isha ngushtë. Ç'të bëja unë i ziu. Më ndihmoje për të ngritur thasët në karrocë, ruaje kalin. Kur nuk kishte punë për karrocën, unë pajtoheshja hamall ose argat gjëkund. Ditë të tëra nuk kthehesha në shtëpi. Ti kullosje kalin buzë rrugëve. Je rritur në skamje, biro, më fal!...».

Në kasollen e Sadik Kreshpës shpesh vinte për vizitë Shaban Gazhda dhe disa të rinj. I ati i Kujtimit, edhe pse kishte natyrë të ngrysur, me atë njeri që e thërriste thjesht «shoku Shaban», gëzohej, fliste. Ata bisedonin pa teklif në sy të Kujtimit, meqë Sadiku kishte thënë: «Kujtimi ka dhënë prova se ato që i dëgjon, nuk i përgojos, nuk i përflet gjëkund, i kam dhënë shkollën e hamallit tim biri».

Kujtimin, edhe pse i dërrmuar nga puna, e interesonin bisedat. Vonë e zinte gjumi, kuvendimet e burrave i shtiheshin në ëndërr. Shabani dhe Sadiku bisedonin pothuaj tërë natën. Kujtimi në gjumë e sipër kapte ndonjë copëz bisede kur burrat flisnin me zë të lartë. Ato copëza shkriheshin me ëndrrën. Kur ngrihej, ashtu siç bënte edhe babai i tij, thoshte: «Ëndërr e mirë, baba!».

Ishin formuar çetat e para partizane. Një mëngjes Sadiku hyri në të ndarën e kasolles ku mbanin kalin. E përkëdheli kafshën (ai gjithnjë bisedonte me Doriun, që dukej sikur e kuptonte gjendjen shpirtërore të të zotit, sigurisht sipas dridhjes ose shtrirjes së zërit).

— Dori, — i foli ai, — po ndahemi, o xhan.

Kali as currieloj veshët, as e shikoi me sytë e mëdhenj e të mallëngjyer, por hingëlliu dhembshur.

Edhe karrocierit iu njomën sytë, po, kur pa se i biri qëndronte prapa tij, ofshani:

— Kujtim!

— Fol, baba, ja ku më ke.

— Do të ndahem prej Doriut dhe prej teje.

— Ç'ka ngjarë, baba? — Në pyetjen e të birit karrocieri kapi një notë hidhërimi dhe lutjeje bashkë.

— Kujtim, — foli sërish Sadiku duke tretur shikimin mbi malin e Dajtit, — hamalli do të kapë pushkën. E pret çeta hamallin, do të vrasim armikun, bashkë me të edhe barën e rëndë që na e bëri palmuç kurrizin.

— Po mua, baba?!
— Do të të çoj bashkë me Doriun te një mik.
— Baba, — foli Kujtimi duke picërruar sytë, — edhe kur isha fëmijë, më merrje për burrë të rritur, kurse tani që u rrita, më merr për fëmijë.

— Ç'do të thuash?
— Unë mund ta mbaj pushkën mirë, di t'ia heq edhe gishtin. Edhe Doriu do t'u duhet shokëve të malit. Nuk më the atë natë kur pamë një karvan me mushka të ngarkuara që u çonin ushqime partizanëve?

Sadiku përshkoi dorën e madhe mbi kurrizin e kafshës dhe heshti.

— Baba, ti mendon se nuk më pranojnë në çetë. Unë kam biseduar me shokun Shaban. I kam kryer edhe disa porosi. Shoku Shaban më ka premtuar.

— Kur? Pa dijeninë time?
— Kur ti vuaje prej etheve. Atë që do ta bëje ti, e bëra unë.

— Kujtim, mos më shtyj të flas atë që nuk duhet thënë. Lufta është luftë. Ti je gëzimi dhe kujtimi i fundit që lë pas.

— Baba, kështu nuk më ke mësuar. Më mirë të mos i kisha dëgjuar këto fjalë nga goja jote. Nuk je ti Sadik Kreshpa që më ke mësuar se ai që ruhet prej vështirësive i ngjan lepurit dhe përfundon si lepuri?! Nuk më ke thënë se mua më ke më të shtrenjtin, po pas atdheut, se për vatanin mund të më bëje kurban edhe mua?!

Sadiku u step për një çast, po shpejt e mori veten.

— Shtrëngohu pra!, — i tha të birit.

Të tre pjesëtarët e familjes Kreshpa: Sadiku, Kujtimi e Doriu u ngjitën në mal.

Babë e bir ishin edhe shokë. Kujtimin e bënë korrier.

Më shtatëmbëdhjetë nëntor batalioni ku bënte pjesë Sadik Kreshpa me forcat e tjera të brigadës çliroi Prizrenin. Pastaj vazhduan marshimin. Përmes Grykës së Carralevës u hodhën në Shtimje. Me luftime të përgjakshme çlijuan edhe Ferizain. Me dhjetëra të rinj, madje edhe vajza kosovare, u bënë pjesëtarë të brigadës dhe të batalionit të

Sadik Kreshpës. Ata ndër luftime tregonin traditat e lashta luftarake dhe heroike. Kosova u çlirua. Pikërisht midis Rashkës dhe Tregut të Ri u plagos rëndë Sadik Kreshpa.

Kujtimi sapo kishte shpënë postën. Iu afhua, po ç'të shihte, balli i babait ishte bërë shuk me rrudha. Vuri buzët mbi to.

— Jo!, — i thirri Sadiku, se u tremb mos të birin e tradhëtonin lotët. — Ma thirr komisarin!, — i foli pas pak me ton lutës.

— Ja ku më ke, — foli komisar Shabani.

— Kujtim, më lër vetëm për vetëm me shokun Shaban.

Djali u largua në anën tjetër të shkëmbit.

— Shoku Shaban, — foli me mundim Sadiku... — Ka mundësi... në... nëse e meriton... im bir... bëjeni komunist në vendin tim. Jo pa e shtruar në diskutim këtë punë dhe pa marrë pëlqimin e shokëve. Ma ki kujdes sanitaren e vogël të kompanisë. Babë e nënë ia vranë katilat. Dy vëllezërit ranë si kreshnikë në sheshin e betejës...

— Cila është kjo?

— Ajo prizrenasja e vogël, sanitare Zana.

Ndërkohë iu afhua Kujtimi dhe e përqafoi. Sadiku e puthi në ballë e i tha:

— Ku të jetë beteja më e vështirë, atje duhet të jenë komunistët. Këtë mos e harro!

— Nuk e harroj, baba!

— Përsërite!, — tha Sadiku me zë të mefshët.

— Ku të jetë beteja më e vështirë, atje duhet të jenë komunistët! — përsëriti Kujtimi fjalët e të atit.

Partizania pesëmbëdhjetëvjeçare, Zana Përdriini, u afhua për t'ia lidhur plagët Sadikut. Por Sadiku...

Vajza e re klithi thekshëm.

Komisar Shabani, që nuk pandehi të vdiste kaq papritur shoku i tij i shtrenjtë i armëve, u pikëllua pa masë. Nga frika mos ia plaste edhe ai të qarit, qortoi Zanën:

— Shoqe, nuk ka hije të qahen komunistët. Ja, shiko këtë djalosh, është i biri. Këqyre si mbahet!

Vajza e ngashëryer iu hodh në qafë Kujtimit e, duke dënesur, i tha:

— Të rrosh vetë! Ai vdiq si partizan i vërtetë. Edhe në e pata si baba.

Kush e merrte me mend se ajo sanitare e mirë kosovare do të bëhej shoqe jete për Kujtim Kreshpën.

Ndërsa Kujtimi shtegtonte në flatrat e kujtimeve, ra silja. Ai vari fotografinë edhe nxitoi të hapte portën. Ishte lampistja e turnit, Bukuria.

— Urdhëro brenda!

— Nuk kam kohë, — u përgjigj vajza. — Më dërguan Rama dhe shokët e tjerë, nesër del prej spitalit Demir Ullishtasi. — Vajza e përsëndeti dhe iku. Kujtimi u kthye në dhomë i kënaqur për lajmin që mori.

«Vërtet u dëmtua lehtë një shok, — tha me vete, — o na bëri t'i vinin gishtin kokës njëherë e mirë».

Propozimi për heqjen e shinave tokësore dhe zëvendësimi i tyre me shina ajrore po shqyrtohej nga një komision i posaçëm. Brenda pak ditësh do të bëhej një mblehje e zgjeruar ku do të diskutohej mbi novacionin.

Në këto mendime e gjeti Zana.

— Përse kaq herët?, — pyeti Kujtimi.

— Jam caktuar në një ekip shëndetësor. Nesër do të emi në malësi. Erdha të përgatitem. Të qeshka fytyra. Patjetër lajme të mira për «teleferikun» tënd.

— Edhe për të. Më shumë u gëzova se nesër del Demiri.

Zana u ul në divan. Ia vuri duart në supe të shoqit dhe buzagaz e pyeti:

— Sot një javë ke ardhur shumë i zymtë pothuaj me erva të tendosura, bën të ma thuash ç'kishe?

Kujtimi ia mikloi duart së shoqes dhe u vrenjt përsëri.

— Ma turbulloi gjakun ai specialisti i huaj.

— I huaji?

— Po, Idanikovi. Shokët e minierës e thërresin Izdajnikov. Se si më duket ai?! Sikur ka zanat tjetër. Përpara një javë më ndaloi te një kthesë traverbangu, më thotë se ato pak fjalë shqipe që di:

— *Ti ndryshon prej të tjerëve. Ta dëgjojnë fjalën*

minatorët. Ç'thonë shokët punëtorë për ne sovjetikët? Po ata të drejtorisë?

— *Populli i atdheut të Leninit dhe Stalinit për ne është miku më i shtrenjtë, — ia ktheva unë.*

— *Jo i Stalinit, jo i Stalinit, — tha dhe u zhduk.*

— *Vetëm kaq?, — pyeti Zana.*

— *Jo. Për Alush Shikun të kam folur. Shqetëson tërë grupin tonë. Dy herë është dënuar për kumar e prapë nuk vë mend.*

— *Përsëri me kumar ai?*

— *Jo me kumar, po me dallavere të tjera. Demi dhe Agroni thonë se është i pandreqshëm. Por unë them se s'ka njeri të pandreqshëm. Duhet punuar me njerëzit.*

— *Shumë i shpërndarë qenke sot, me Izdajnikovin fillove, me Alushin vazhdon.*

— *Mos u ngut, ka lidhje biseda. Alushi kërkon qoshe të rehatshme, Alushi merret me thashetheme, Alushi dekurajon të porsaardhurit në minierë. E kanë këshilluar e qortuar shokët, e këshillova edhe unë:*

— *Alush, — i thashë, — kërkove nga drejtoria punë ku mund të marrësh më shumë lekë, se paguan pension ekonomik për fëmijët (se ka ndarë dy gra), të vunë pom-pist. Përse mbledh rreth vetes të porsaardhurit në minierë. Jo vetëm që i mban me llafe, por edhe sajon legjenda rreth galerive të nëndheshme. Se gazrat marrkan flakë, se u shembkan tunelet. Ç'aksident ka pësuar qoftë edhe një punëtor në minierën tonë? Pastaj ç'ke që i merr nëpër gojë punëtorët që janë pararojë të minierës?*

— *Kanë shpifur, shoku Kujtim, — ma ktheu Alushi. — E di, e di ku ju rreh çekani juve edhe disave si ju. Keni bërë shkarje politike me inxhinierin sovjetik dhe kërkonit të nxirrni dufin kundër meje që shoqërohëm me të. Jeni nacionalist, por ka për t'ju kushtuar!*

— *Këto nuk janë fjalët e tua, — i thashë Alushit, — shiko veten, shok, reflekto në gabime, se nuk e ke punën mirë. — Kaq i thashë dhe e lamë të takoheshim më vonë, meqë nuk kisha kohë. Ai vetë ankohet te Idanikovi. Kushedi ç'ka sajuar Alushi! Më kap Idanikovi dhe më thotë:*

— Ju, Kujtim Kreshpa, nuk bëni mirë që kapni lle pitni njerëzit se ç'bisedojnë me mua. Atë ditë folët me pasion për Stalinin. Unë nuk ia kam fënë askujt. Ju vazhdoni në tuajën. . .

— S'po ju kuptoj, — i thashë unë. . .

— Më mirë do të qe të merreshin njerëz kompetentë me këtë punë, — tha Idanikovi, — sesa të ngarkonin njerëz të rëndomtë. Të na foshin troç: ju specialistët miq të merrreni vetëm me problemet e teknikës në minierë, me njerëzit mos flisni!

— Shoku inxhinier, unë s'po ju kuptoj fare.

— Naturisht, ashtu jua do puna të shtireni. Por mua nuk më pëlqejnëurvejimet. Kjo praktikë pune më bën të mendoj. U nxeha, se s'po merrja vesh përse fliste.

— Inxhinier, — i thashë, — do të më sqaroni për ç'survejime e keni fjalën? Se shau, e mora vesh, por ç'sharje ishin ato, nuk e di. Puna vajti gjatë. Më thirrën në komitet.

— Përse je zënë me Idanikovin?, — më pyeti sekretari.

— Nuk jam zënë me njeri, — u përgjigja dhe i shpjegova shokut Isa për ndodhinë:

— Thirrëni përkthyesin, — urdhëroi ai. Erdhi edhe përkthyesi. Ai pohoi në sy të shokut Isa të gjitha ato që pak më parë i kishte thënë edhe Kujtimi.

Si mendon, Kujtim, — pyeti Zana, — mos ky farë Izdajnikovi është ndonjë element i keq?

— Se është i keq, s'do mend, por...

Kur vuri re se Kujtimi nuk kishte dëshirë të zgjatej më në atë bisedë, Zana ndërroi temë:

— Kujtim, që kur ke filluar të punosh në minierë, si domos këta dy vjetët e fundit, ke ndryshuar shumë. Më parë ishe aq i mbyllur, sa shpeshherë kam pyetur veten: «Si kalohet jeta kështu?».

— E ka fajin ajo karroca, jeta e vetmuar e fëmijërisë. Edhe në luftë si korrier çdo gjë e bluaja vetë. Nuk thua shyqyr që nuk kam mbetur memec. Miniera të ndryshoka, Zanë. Nën dhë pa punën e përbashkët shkëmbi kokëkrisur do të qe mospërfillës dhe i panënshtueshëm. Atje, në thellësi, njeriu duhet të këshillohet me shokun për bashkim for-

cash, për sulme të përqëndruara. Kjo natyrë pune thyen çdo guaskë zvetënimi, çdo adhurim të tepruar të mendimit personal. Gjithë jeta dhe puna atje janë beteja, beteja të nëndheshme. Çdo fjalë është pjellë e një nevoje. Më parë urreja njerëzit që flisnin shumë, sepse, të flasësh shumë, është njëllëoj sikur t'i biesh legenit. Të flasësh kohë e pa kohë, vend e pa vend, do të thotë të mos respektosh vetveten, mungesë personaliteti. Kurse atje thellë nuk të lejon koha të flasësh. Në minierë bisedat diktohen nga nevoja të brendshme. Njeriu në minierë e ndien në vetvete se si i rritet guximi. Ndien një farë krenarie, sepse përleshet me shkëmbinj gjigantë dhe del fitimtar. Nëse ndokush do që të bindet se njeriu është më i fortë se të gjitha forcat e natyrës, duhet të punojë në minierë, mendoj unë.

— Sipas teje vetëm minatori nuk njohka humbje, — e ngacmoi Zana.

— Minatori i vërtetë kurrë nuk njeh humbje.

— Keni anomali në minierë?

— Pjesa më e madhe e minatorëve tanë janë me origjinë fshatare. Pothuaj të gjithë të rinjtë kanë kryer tetëvjeçaren, por nuk vazhdojnë më tej. Ja, si puna ime që sivjet mbarova teknikumin e minierave, siç e shikon, me vonesë. Unë të paktën e mbarova, po disa të rinj nuk vazhdojnë. E keqja është se ata kanë një besim të tepruar në vetvete për sa i përket zanatit. Janë mbërthyer nga pandehma e gabuar, sikur, për të qenë minator, përveç tetëvjeçares, nuk kanë nevojë për tjetër shkollë. «Mjafton, — thonë ata, — të jesh guximtar, me vullnet të fortë, i dashur me shokët, i vëmendshëm në punë. S'ka ç'të duhet shkolla në minierë». Kështu thonë dhe mendojnë disa. Por unë mendoj se shkolla është e domosdoshme për minatorin. Kam lexuar libra dhe lexoj shumë. Kjo më ka bërë që t'u buzëqesh me qesëndi mendimeve të mëparshme mbi gjithçka. Më janë hapur sytë dhe e kam parë botën ndryshe. Shumë më të bukur, sepse, të shikosh dhe të shijosh bukuritë, duhet të kesh sy, tru. Në veprimet më të rëndomta lypset të njohësh shkencën. Bie fjala, ke për të bërë mina, nëse nuk di këndin e shtresës së mineralit, baromina do të dalë në argjil. Kur pëlcastin minat, blloqe të tëra argjili rrokaniten dhe dergjen

në galeri, mbulojnë qymyrin, pengojnë shfrytëzimin edhe të turneve të tjera. Angazhohen shumë vagonistë dhe elektrovozi për ta nxjerrë dheun në sipërfaqe. Ka një difekt perferatori, matrapiku, pistoleta e të tjera mjete teknike, duhet të thirret mekaniku ose elektrikisti. Por sa galeri ka miniera! Ikën tetorëshi duke kërkuar nëpër galeri ose duke pritur me duar në ije. Fundja ne ëndërrojmë dhe jo vetëm ëndërrojmë që së shpejti të modernizojmë më tej proceset e nxjerrjes së mineralit. Makineritë moderne nuk mund t'i komandojë një minator pa shkollë.

— Edhe ti përtoje në fillim, po ta mblodhën ata të Partisë. Përse nuk e hapni teknikumin e minierave pranë minierës?, — pyeti Zana. — Ti bëje udhë disa herë në vit deri në Prenjas për të dhënë provime.

— Do ta hapim se s'bën. Po nuk është puna te hapja e shkollës, atë e bëjmë më lehtë. Kryesore është që shokët ta kuptojnë dhe ta ndiejnë domosdoshmërinë e shkollimit.

Kujtimi i shpjegoi Zanës se si ai dhe minatorët e tjerë kishin biseduar në galeri gjatë pesëminutëshit, kur bëhej bilanci i punës së ditës, në autobus e gjetkë dhe puna e shkollës profesionale ishte bërë problem i organizatave dhe komitetit të Partisë për minierën. Vetëm Ramë Dushku kishte mbledhur buzët sikur të gjendej përpara ndonjë kafshate të madhe që nuk mund ta kapërdinte.

— Boll biseduam, u kënaqa, — tha Zana, — ngrehu, ha, erdhi ora për punë.

Kujtimi shikoi orën e murit e u habit:

— Ou, paska shkuar vonë!

— Do të ankohesh se ta hëngri kohën gruaja.

— Për biseda të tilla jo.

*

*

*

Nuk kishin kaluar dhjetë ditë. Kujtimi mblodhi veglat në çantë dhe bashkë me ndihmësin filluan ngjitjen të gëzuar për punën që kishin bërë gjatë tetorëshit.

Kur arritën te nënkat i pestë, ua tërhoqi vëmendjen një dritë në errësirën e thellë të galerisë. Te balli i frontit

të atij nënkati tufa e një drite rrotullohej rreth vetes. U dëgjua zëri i mefshtë i një kënge:

*Unë të prita, mi goce,
të prita te gardhi i bab's tat...*

«Është zëri i Dem Qesatit», — mendoi Kujtimi dhe një gulsh gëzimi i gufoi në gjoks. Kujtimi kishte qenë fëmijë i vetëm, por, po të mos ishte Demi, nuk do ta njihnte ndjenjën e dashurisë vëllazërore. Demi dhe shokët si Demi i ishin bërë krah në të gjitha punët e minierës. Mirëpo kohët e fundit Demi i mbante mëri. Edhe pse ai lloj zemërimi Kujtimin i ngjante me ato tekat e fëmijëve, prapë ndiente një boshllëk në shpirt kur tjetri ia kthente shpinën ose i fliste vetëm për çështje pune dhe zyrtarisht. Në fytyrën e Demit vrenjtja dhe zyrtësia lexoheshin aq. Sidomos kur ato vetullat si çadër lëshoheshin rëndë mbi sytë e kaltër e pak të dalë. Sa herë nevríkosej, ai kruante qafën.

Qysh kur kishte ardhur Qenani në minierë pa pëlqimin e Demit, ishin ftohur marrëdhëniet. Demi e kishte pyetur Kujtimin:

— Përse e pranuat? Për inatin tim?!

— Qenani do të futej në një punë, — i ishte përgjigjur Kujtimi, — meqë ia njohim edhe cenet, menduam se askund më mirë se te ne nuk mund të shërohet.

— Do ta shikosh si mund të përmirësohet Qenani! Të një barku jemi, po ndryshojmë. I pëlqen qyli. Do të më turpërojë. Jepini duart! Do të interesohem unë pa dijeninë e Qenanit të futet në ndonjë punë tjetër. Këtu nuk e ha ai. Do të fillojë nga shejtanllëqet.

— Nuk besoj ta kalojë gjatë asisoji te ne.

— Nuk e njeh, prandaj flet ashtu.

— Qenani do të qëndrojë te ne.

— Bëj ç'të duash! Ia ke mësyer shkëmbit, më ke pasur krah besnik; ke luftuar dembelët, servilët, hipokritët, shok dhe luftëtar më ke pasur. Tani që të kërkoj një gjë të vogël, nuk më dëgjon. Udhë e mbarë e pa mua!

Qysh atë ditë Demi i mbante mëri.

Këto shkoi nëpër mend Kujtimi ndërsa ecte në thellësi të galerisë nga dëgjohej kënga.

Dem Qesati, sa vuri re se po i afrohej një dritë, ndërpreu këngën. Kur pa se ishte Kujtimi, për të mos i folur, rifilloi të këndonte:

Unë të prita, mi goce...

Këngën e shoqëronte me lëvizje të këmbës së djathtë; e ngrinte në ajër dhe e përthyente në gju.

— Dem, — i foli Kujtimi.

— Mos fol! E di, do të thuash se kënga është e ndaluar në galeri. Nuk shikon se çfarë qymyri i ka siguruar ky koc turnit tjetër! Ia di damarët unë! Demi ia gjen palcën mineralit, — dhe aty për aty ndërpreu ligjërimin e filloi të këndonte dhe të hidhte valle rreth grumbullit të qymyrit.

— Dem, do të ngjitesh?

— Për nder se më shkohet në shtëpi. — Këtë herë iu drejtua ndihmësit të vet dhe të Kujtimit. — Shikoni ç'qymyr është! Njëzetekatërkaratësh. Kur më vete puna mbarë edhe Hanën e dua më shumë. Eh, ç'jetë të bukur kanë për të shkuar ata çunat e mi! Të madhin minator, të dytin shofer... i treti ka sy për agronom. Kurse atë çapkënen e vogël që i ngjet Hanës sime, do ta bëj mësuese. Bija e minatorit mësuese, e bukur sa s'ka, — dhe mblodhi veglat duke kënduar:

Mësuese e fshatit je...

Lumturia dhe gëzimi i shokut sikur të qenë ngjitëse, gjallëruan dy ndihmësit dhe Kujtimin. Këtij të fundit mendime të pafundme i kalaruan në kokë: «Secili ka ëndrrat e veta. Demi të tijat, unë të miat. Ndihmësi im, Limi, të vetat. Limi duhet me një vajzë. Askush s'e pengon këtë dashuri. Të gjitha këto ëndrra gjejnë siguri në pikën e djersës, në të mirat që prodhojmë me duart tona».

Ngjiteshin oxhakut përpjetë. Demi nuk pushonte së foluri për çapkënen që do të bëhej mësuese.

K R E U VI

Kujtimi po ngutej për në sallën e mbledhjeve dhe kaloi përmes lulishtes ku shumë të rinj ishin grumbulluar rreth Demir Ullishtasit, i cili këndonte me ta dhe shoqëronte këngën me mandolinë.

Rrushi, sapo e pa Kujtimin, ia luajti dorën, pastaj i doli përpara.

— A po të këndon zemra?, — e pyeti Kujtimi buzagaz.

— Të gjithëve na këndon zemra. Ja, kështu zgjidhen problemet. Keni venë re që nuk bredhim më rrugëve si pulat e detit në mjegull?

— Mirë ju venë punët?

— Shkëlqyeshëm. Demiri, unë, Aliu jemi regjistruar në kursin e muzikës. Shkojmë tri herë në javë.

Kujtimi u përshëndet edhe me të rinjtë e tjerë, pastaj u ndal te Demiri, i cili tashmë ishte shëruar dhe punonte në magazinën e eksplozivit, pasi mjekët ia kishin ndaluar punën nën dhe për një kohë të gjatë.

Në sallën e mbledhjeve Kujtimi gjeti shumë minatorë, inxhierë e teknikë.

Inxhinier Idanikovi kishte zënë vend në radhën e parë, ngjitur me murin. Pranë tij gjendej Alushi që diç i çuçu-riste në vesh.

Mbledhjen e hapi shefi i byrosë teknologjike, inxhinier Vangjushi. Pasi lëvdoi propozimin e Kujtimit, foli për rendimentin e lartë që do të jepte ajo metodë pune, për lehtësimin e kushteve të punës së minatorëve, për leverdinë ekonomike. Ende pa mbaruar mirë Vangjushi, u ngrit Alushi, që kishte ndërruar vend e ishte futur midis minatorëve.

— Shoku Vangjush, — tha ai, — ne do të donim të dëgjonim novatorin. Propozimi vërtet është për t'u lëvduar, por me të thënë e me të bërë, shkon përmes një lumë i tërë.

Kujtimi vuri re se Alushi pas çdo fjale vidhte me sy inxhinier Idanikovin edhe pse dukej haptas se ajo gjë e nevrrikoste tjetrin.

Kujtimi u ngrit ca i emocionuar. Foli për galeritë, për presionin që ushtronte nëntoka, për anomalitë në prodhim.

Pastaj shkoqiti idenë ashtu si e kishte menduar.

Ndërkohë Alushi sërish ndërroi vend. U afrohej tekni-
këve, minatorëve. U pëshpëriste.

— Diçka e mrekullueshme, — i tha zjarmëtari, — diçka
që s'hahet prej së mirit, sikur të bëhet ashtu siç flet ai. Po
s'ma ha mendja se mund të vendoset teleferiku në galeri.
Çudi, ky Kujtimi akoma s'ka mbushur dhjetë vjet në minie-
rë, ti që je babai i minierës si thua? Pyete njëherë: ku do të
qëndrojë kavoja, si do të lëvizë vagoneta mbi të.

Zjarmëtari në fillim vuri gishtin mbi buzë i bëri she-
një tjetrit që të heshte, pastaj, i nxitur nga pëshpëritjet
cytëse të Alushit, u ngrit e pyeti:

— Shoku Kujtim, ku do të qëndrojë kavoja? Si do të
rreshqasë vagoneta mbi të? Do të shtyhet, apo do të tërhi-
qet?

Kujtimit i vetëtiu zemërimi në sy. Shikoi zjarmëtarin,
pastaj Alushin, i cili sërish kishte ndërruar vend, e tha:

— Shokë, unë fola si më lindi ideja. Se do të rresh-
qasë në kavo, apo në ndonjë mjet tjetër, e di komisioni i
posaçëm që e ka studjuar këtë punë, do ta bisedojmë të
gjithë së bashku.

— I thuaj: «Ti e shpikë, ti na trego», — ngiste Alushi
një minator tjetër.

— Me lejë, — mori fjalën Demi dhe, pa pritur t'i jepnin
lejë, drejtoi gishtin nga Alushi. — Ti, mor delenxhi, nëse
dëshiron të pyesësh, ngrehu dhe pyet! Mos bridh karrige
më karrige si lavire! Mos kërko bedel për të kundërshtuar
ose turbulluar!

— Unë mendoj, — u ngrit një minator pararojë i turnit
«Hovi», — se kavoja nuk është e përdorshme në galeri. Ka
ditë që po rrahim mendime. Duhet një mjet tjetër...

— Vagoneta mund të rreshqasë përmes një shine ajrore,
— tha Agroni.

— Dispozitivin e kemi gati, — tha kovaç Kaleshi.

U ndez diskutimi. Pyetje. Përgjigje. Sërisht u ngrit
kovaçi.

— Shokë, — tha ai, — në fillim m'u duk se dikush i bin-
te gozhdës, dikush patkoit. Por tani sikur po e shikoj va-
gonetën duke rreshqitur jo mbi shina, po nën to. Ne shokët

e fonderisë do të punojmë tërë natën. Skemat që morëm prej byrosë teknologjike po i afrohen së mundshmes. Propozoj që nesër të zbresim në galeri, ta provojmë në praktikë.

Inxhinier Vangjushi iu afrua Idanikovit:

— Si mendoni, shoku Idanikov? Në revistën që më dhanë shokët tuaj kishte diçka të afërt me metodat që po propozojnë minatorët. Mund të bazohemi te këto revista, si thoni?

— E para e punës, — foli Idanikovi, — kjo lypset menduar mirë. Megjithëse nuk besoj që t'i arrihet. E dyta: propozimi që të eksperimentohet nesër është njësoj sikur të besosh se, çfarë fluturon, hahet. Por mos harroni se fluturon edhe aeroplani. Kjo punë do kohë. E treta: ky nuk është novacion. Do të bisedoj me kolegët e mi. Do t'i bëjmë një relacion Institutit të Kërkimeve në vendin tonë. Do t'ju sjellim të gatshme. Sallami nuk mbushet me gogla. Përse e quajnë novacion? Është një propozim i rëndomtë. Ose të shprehemi ndryshe: një përvetësim metode dhe tendenca për t'u dukur kont me frakun e vjedhur. Do t'ju ndihmojmë, shokë, do t'ju ndihmojmë. Ne nuk kursejmë asgjë. Do t'ju sjellim. Edhe sivjet punoni siç keni punuar. Të mirat vijnë ngadalë-ngadalë. Mos u djersini kot. Do t'ju sjellim të gatshme.

Kur inxhinier Vangjushi po rendiste shënimet për të bërë konkluzionet e diskutimeve, u ngrit Agron Lama. Ai përcolli vështrimin hijerëndë në tërë sallën:

— Kam për të diskutuar, — tha ai.

Kujtimi vështroi fytyrën e madhe të shokut të grupit dhe iu kujtuan fjalët e një gazetari që kishte ardhur për të shkruar për minierën: «Ç'nofulla epike ka ky Agroni, — kishte thënë ai, — prandaj i gdhend fjalët përpara se t'i nxjerrë nga goja». Iu kujtua ardhja e Agronit në minierë. Ishte gjë e rallë të vinte një maturant atëherë në minierë. Madje xhaxhai i Agronit kishte ndërhyrë që të mos e praninin. Po kush i dilte përpara atij. E kishin pyetur disa se përse nuk kishte zgjedhur ndonjë punë tjetër se ai ishte me gjimnaz, po Agroni u ishte përgjigjur se secili ka dëshirat e veta dhe se atij i pëlqente të bëhej minator. Men-

donte se aty mund të jepte më shumë, prandaj dhe kishte ardhur.

I ishte përveshur punës Agroni. Tani kryente edhe detyrën e sekretarit të komitetit të rinisë për minierën.

— Isha në fabrikën e tullave, shokë, — vazhdoi Agroni. — Pashë të gjitha proceset e punës. Në bisedat me punëtorët dhe specialistët mësova se tullat do të dilnin të përsosura sikur t'i përzienin me pluhur qymyri...

— More shok, — e ndërpreu një minator pa u ngritur nga vendi, — ne diskutojmë për shinat në galeri, ç'hyjnë tullat këtu?

— Ka hall Agroni, — tha një tjetër, — se është përgjegjës i pallatit që ndërtohet me kontribut vullnetar.

Agroni nuk e prishi terezinë, përkundrazi vazhdoi më me zell:

— Shokët e fabrikës së tullave më folën gjatë. Mua më vajti mendja te qymyri që hedhim bashkë me dheun...

— Ç'qymyr hedhkemi me dheun ne?!, — folën dy-tre minatorë njëherësh.

— Gjysmën e shtresës në galeritë e Jugorit, u përgjigj Agroni, pa kthyer kokën nga shokët që folën.

Demi vështronte me kujdes si reagonte Alushi.

— Gjysma e shtresës së galerive jugore është argjil, më saktë argjil me grimca qymyri, — tha një inxhinier.

— Unë them është qymyr, — ia preu Agroni.

— Ti mund të thuash është flori, por analizat laboratorike thonë se ti ia fut kot, — tha nëndrejtori.

— Pyes, — tha Agroni gjithnjë i qetë, — gjysmën e shtresës së Jugorit e hedhim ku hidhen mbeturinat, më saktë ku hedhim argjilin? E hedhim. Kam edhe një pyetje: kush ia ka bërë analizat qymyrit të asaj gjysmështrese dhe ç'kalori ka?

Alushi u bë sa një grusht. Demi nuk ia shqiste vështrimin.

— E shikoni, askush nuk di të përgjigjet. Domethënë nuk i është bërë asnjë analizë.

— I është bërë, — tha inxhinier Vangjushi dhe shfletoi shpejt një dosje, nga e cila nxori një kartelë: — pesëdhjetë

deri nëntëdhjetë kalori dhe kjo pasi të seleksionohet mirë nga dheu.

— Jeni i bindur, inxhinier?

Vangjushi shtriu duart përpara:

— Shoku Agron, unë lexoj kartelën, nuk jam laborant.

— Bën të dimë cili ishte laborant kur iu bë analiza asaj gjysmështrese?

— Nuk është firmuar kartela.

— Atëherë laboranti anonim është sabotator. Armik është ai. Na ka shkaktuar dëme të mëdha. Le të flasë laborantja. Shoqja Pëllumbeshë, tregoju shokëve fuqinë kalorike të gjysmështresës së varfër të Jugorit.

— Tetëqind deri një mijë e një qind, — u përgjigj laborantja.

Për një çast në sallë u dëgjuan zhurma të mbytura, thirrje. Inxhinier Vangjushi u skuq gjer te veshët.

— Pse nuk thua qenka për të zënë kokën me duar!, — tha. — Unë dhe disa prej nesh u dashkemi varur atje ku janë hedhur me mijëra tonelata...

— Jo ty, as shokët, po sabotatorin!, — tha Demi.

— Shokë, — tha Zizi, i cili përherë orvatej të qetësonte gjakrat, — kushedi ç'qymyri i është bërë analiza nga Pëllumbesha dhe Agroni. Përse na nxirrni avaze. U nisëm për luleshtrydhe, Agroni na qeras me kulumbri.

«Ah, mor Ziz, — mendoi Kujtimi me vete, s'hoqe që s'hoqe dorë nga mbrojtja e kujtdo. Pse u frikësohesh te lasheve dhe debateve, xhanëm?».

— Ta shikojmë njëherë tjetër çështjen që ngriti Agroni, — vazhdonte Zizi.

— Kurrsesi, — tha zjarrmëtar Xhafa dhe deshi të vazhdonte, por Zhagan Dhoga që ndodhej prapa tij e që ishte i prirur për gjullurdi, e preku nën sjetull. Xhafa kërceu, sikur ta kishte pickuar gjarpri, duke klithur: — Harbut! Harbut! Harbut! — Të qe ndonjë rast tjetër, të gjithë do t'ia pëlcisnin të qeshurit. Mirëpo fjala «sabotim» në minierë është gjë e madhe, të gjithë mendonin për gjysmështresën e Jugorit dhe nuk qeshën me shakanë pa kripë të Zhaganit.

— T'ia japim fabrikës së tullave atë qymyr, — vazhdoi Agroni. — Do të qe një ndihmë e madhe, e pallogarit-

shme për ndërtimin, për ne të gjithë. — Pastaj foli mbi teknologjinë e tullave me djegie të brendshme. Foli edhe për leverdinë e minierës.

Të gjithë sa ishin në sallë e dëgjonin gojëhapur. Fytyrat e minatorëve ishin skuqur nga urrejtja për sabotatorin dhe moskokëçarësit.

— Kjo çështje nuk është dosido, — tha Kujtimi, — duhet bërë problem Partie. Qysh tani duhet të marrim masa për hetimin dhe shqyrtimin e gjysmështresës së Jugorit.

Meqë minatorët filluan diskutimin nga e para, nëndrejtori ndërhyri me nerva të tendosura:

— Agroni më është dukur i matur, nuk kam pandehur se qenkësh i prirur për sensacione. E di se në natyrën e tij gjallon pasioni për të filozofuar, po nuk ma merrte mendja se do të rrebelonte kundër të gjithëve. Sipas tij paska munguar kontrolli shtetëror dhe shoqëror. Sipas teje, shoku Agron, ç'paskemi bërë ne? Kemi kullotur bar?! Edhe Pëllumbesha foli qesim...

— Nuk flas qesim, shoku nëndrejtor, — foli e nxehur Pëllumbesha dhe tundi letrën ku kishte shënuar të dhënat e analizave.

— Unë përgjigjem për prodhimin, — vazhdoi nëndrejtori, — përse nuk më keni njoftuar. Apo deshët të bënit komplot të befashëm? Shoqe, shoqe, je e re, pa eksperiencë, mos u bashko me kritizerët!

— Nëndrejtor, fol shqip, që të kuptojmë të gjithë, mor burrë, — foli Sherifi, — se e ke jangllësh, gjysmën e fjalëve s'jam kah i kuptoj. Tjetri të thotë «ja ujku», ti «o burra, pas gjurmëve».

— E para e punës mëso të flasësh dhe hiq dorë nga anarkizmi dhe gjaknxehtësia kanunore, e dyta: s'të ka faj njeri që nuk kupton se ti parapëlqen gjuhën e kohës së sulltan salepëve. E treta, më e rëndësishmja, këtu ka centralizëm, unë jam drejtuesi, ulu!

— Nuk ulem, — thirri Sherifi, — në të djeg, kruhu.

— Sherif, qetësohu, Sherif, — e këshilloi Rama që gjendej krah tij.

— S'po flas për interesin tim, bre burrë, — ia ktheu Sherifi dhe u ul.

— Të kthehemi te diskutimi i Agronit, — vazhdoi nëndrejtori, — megjithëse nuk ia vlen të humbasim kohë. Më kujtohet mirë, kam kërkuar të dhëna laboratorike të të gjitha shtresave në Jug e Veri. Dhe jo një herë, po disa herë. Gjysma e shtresës në galeritë e Jugut rezultonte se ishte argjil me grimca shumë të pakta qymyri. Sa për analizën e re, nëse është e bazuar, mund të shikojmë. Për çdo pëllëmbë ndryshon minerali. Ka mundësi që gjysmështresa e tanishme përmban më shumë qymyr. I kanë fajet epokat gjeologjike që diku kanë vepruar ndryshe, diku ndryshe. Kjo mundet dhe mirë u bë që u ngrit këtu. Sa për të kaluarën, ajo as diskutohet. Eh, sa prova janë bërë! Nuk mbeti të na jepte mend Agroni e ndonjë tjetër.

Me kaq sikur u mbyll diskutimi për gjysmështresën e Jugorit. Inxhinier Vangjushi bëri konkluzionet e diskutimeve mbi shinën ajrore.

Mbledhja mbaroi. Kovaçët, mekanikët, inxhinierët, shumë minatorë shkuan në oficinë dhe punuan tërë natën.

Të nesërmen, që pa gdhirë, po bëheshin provat nën dhe.

Alushi shumë i alarmuar trokiti në derën e dhomës së Idanikovit:

— Eksperimenti u doli me sukses.

— Ç'eksperiment?, — pyeti Idanikovi.

— Vagonetat me shinë ajrore që u diskutuan dje.

— Kur?! Kush ua solli?

— Të gjithë kanë punuar tërë natën, sot...

— Edhe inxhinier Vangjushi?

— Po.

— Mos kanë punuar edhe kolegët e mi?

— Jo.

— Dhe puna u shkon në rregull?

— Po.

— Kësaj i thonë mospërfillje! Sfidë! Tallje! Në deshën dhe e paskan përgatitur vetë, përse më pyeti inxhinier Vangjushi?! Provokim! Fyerje! Sfidë!, — shfryu në gjuhën e vet (ashtu fliste përherë me Alushin) Idanikovi.

— Të gjitha fajet i ka ai Kujtimi, për inatin e ne të dyve e ka bërë. Bile ai e ka ngucur këtë punë, — tha

Alushi. — E dëgjuat dje atë romantik Agronin? Nuk ishin fjalët e tij, po të Kujtim Kreshpës! Kujtimi ngatërron të gjitha punët në minierë. As drejtori nuk guxon t'i lëvizë atij.

— E di, e di, i merr vesh të gjitha, — i tha Idanikovi duke kruar nën mjekrrën dhe pyeti: — Po puna e diskutimit të Agronit mbi gjysmështresën e qymyrit në Jug u mbyll? Sa mirë ua mbylli gojën nëndrejtori!

— Hi, hi, — qeshi me djallëzi dhe ia shkeli syrin Alushi, — unë isha laborant kur iu bë analiza asaj gjysmështrese. Ç'është e drejta, më hyri frika kur e ngriti Agroni. Vetëm kur ia mbylli gojën nëndrejtori, m'u qetësua gjaku. Nëndrejtori e rregulloi mirë.

— Domethënë u mbyll ai problem?

— Ku lënë minatorët të mbyllet. Qysh mbrëmë kanë vajtur kanë marrë kampione. Kanë punuar në laborator tërë natën. Po unë e kalova, nuk kam firmuar kartelat. Ç'është e drejta, as që i kam bërë ndonjë analizë asaj gjysmështrese, ia kam futur kuturu, prandaj nuk kam firmuar. Po nëndrejtori tha: *Minerali ndryshon me pëllëmbë. I kanë fajet epokat gjeologjike që diku veprojnë ndryshe, diku ndryshe.*

— Alushenko, ki kujdes! Nëndrejtori tha, po punëtorët nuk e hëngrën, prandaj kanë gërmuar tërë natën, — tha Idanikovi.

— Domethënë?...

— Mendohu mirë, mos ke lëshuar firmën, të piu e zeza. Këta punëtorët tuaj janë të tmerrshëm. Prit se m'u kujtua diçka. Si duket ajo Pëllumbesha?

— Si gjithë të tjerët, nuk është brumë për ne ajo, — tha Alushi që e kuptoi se ku i rrihte çekani Idanikovit.

— Po munde, vidh kartelat e analizave që ke bërë kur ke qenë laborant. Le ta hajë kushdo, ti s'duhet të prekesh...

Pas dy ditësh minatorët shkuan në komitetin e Partisë për minierën, kërkuan të bëhej një mbledhje për të shqyrtuar të dhënat laboratorike të gjysmështresës së qymyrit të Jugorit.

Mbledhja u bë.

Nëndrejtor Bajaziti u kritikua rëndë.

atë
një
ëhej

K R E U VII

Qenanit, që ishte mësuar me jetë të rehatshme, miniera iu duk si ato skëterrat që u pat krijuar mendja paraardhësve të tij, madje edhe atij vetë, me të cilat frikësonin besimtarët.

«Do të duroj, — mendoj ai me vete kur u fut në minierë, — sa të më japin shtëpi në qytet, pastaj do të sajoj ndonjë gjë. Do të gjej ndonjë punë tjetër, apo nuk ka punë sa të të dojë e bardha zemër. Puna është të marr shtëpi, se minatorët i strehojnë fët e fët! Pastaj atë shtëpinë në fshat e shes, grumbulloj një dorë të mirë parash».

Mirëpo nuk e nënshtronte dot durimin. Nuk kishte mbushur njëzet ditë në minierë, dhe paraqiti raportin e parë mjekësor.

— Shoku Qenan, — i tha një minator, — raporti yt nuk është në rregull. Të tillë e gjeti edhe kontrolli. Duhet të sjellësh një raport tjetër.

— Posi, — tha Qenani dhe vajti në poliklinikë.

— Të bësh analizat, — i tha mjeku.

Qenani mori një shishe të vogël, zbriti poshtë e iu afërua banjës. Shikoi vjedhtas rreth e qark se mos kishte njeri. Nxori një gjilpërë nga jaka e xhaketës, shpoi gishtin, e shtrydhi në shishe, shpoi edhe tjetrin, e shtrydhi. Kur bëri të hynte në banjë, një dorë e mbërtheu për krahu:

— Të kesh turp, — i folën tre minatorë, — në minierë nuk të solli njeri me zor, erdhe vetë, u lute. Minierës nuk ia hedh dot, hajde me ne.

Në mbledhje i shkonin djersët çurg të ziut Qenan. Nuk ia kishte marrë mendja, as në ëndërr nuk mund t'i ishte shtënë një gjë e tillë. E qortonin dhjetëra gojë me nofulla të shtrënguara. Dhe cilët pa? Ata që i ishin dukur njerëzit më të urtë, ata njerëz me të cilët kishte punuar ato pak ditë në galeri.

Ai rast u dha shkas thumbave e talljeve jo vetëm nga të rinjtë, por edhe nga veteranët e minierës.

Të nesërmen, duke zbritur me ashensor, dy të rinj fidan nga thumbat.

— Ky është mullai me mullë që s'e bëri punën kabull?,
— qesëndisi i pari.

— Jo, more, të bëjnë sytë, — ia priti tjetri, — ky nuk
ka çallmë.

— Gjer dje e pat mbajtur mbi kokë, tani e fsheh nën
lëkurë.

— Nuk e ditka ky se ne minatorët i zbulojmë gjërat
nën lëkurë, — tha i dyti.

Ashensori arriti në fund. Sapo u hap porta, doli Qe-
nani. Sinjalisti i nëndheshëm ngriti dorën si strehë e thirri:

— Hajde, mulla! Mulla ishe. mulla mbete. Dikur ngji-
teshe vrimës së minaresë, shisje zërin tënd. Tani zbret
vrimës teposhtë, fshihesh prej jehonës së zërit tënd!

Qenani nuk ia vuri veshin. Eci drejt për në magazinën
e nëndheshme për të marrë veglat e punës. Dy të rinjtë
i shkonin prapa dhe këndonin:

*O mulla, o mulla,
mos u bëj budalla,
në minierë s'ka hallva,
puno bam dhe bam ha!*

Ditët kalonin. Për Qenanin thureshin vargje humori-
stike, improvizime të çastit. Qenani punonte një orë, djer-
sitej, i digjnin duart, i përcëllonin sytë nga djersa. Mezi
priste që ta tallnin. Nevrikosej (të shumtën e herës shtirej),
bëhej si i xhindosur dhe dilte në sipërfaqe. Kjo u bë rrugë.

Në një mbledhje u kritikua rëndë.

Qenani gati përvaishëm u ankua:

— Kam ardhur me sevda të madhe që të punoj. Nuk
erdha që të qesëndisen me mua disa sojsëzë. Të tallen me
mua si me ndonjë noksan!

— Qenani ka të drejtë, — tha Lim Thana, ndihmësmi-
natori i Kujtim Kreshpës. — Në vend që ta afrojmë, ne po
e tërbojmë. Jam i ri në moshë, edhe në minierë jam i ri,
por më duket e udhës që me Qenanin të sillemi mirë. Ta
ndihmojmë. Edhe Qenani do të mësojë të punojë.

Fjalën e Limit e mbështetën edhe të tjerë. Qysh atë
ditë askush nuk u tall me Qenanin. Por atë e pllakosi një
mërzi e madhe. Tashmë ishte mësuar me ato shaka. I bëhej

se i mungonte diçka. Pos të tjerash i lypsej të punonte shtatë orë rresht. Me prerjen e shakave, u pre edhe preteksti për t'u ngjitur në sipërfaqe sa herë ia donte qejfi. Duroi një javë, dy, pastaj ishte Qenani ai që i tallte dhe i thumbonte.

Minatorët buzëqeshnin që të mos qeshnin dhe i shmangeshin në heshtje.

Njëherë, ndërsa ishin strehuar gjatë plasjes së minave, Qenani iu hakërrye Lim Thanës:

— Ç't'u desh ty që të më mbroje në mbledhje? Mos të ka vënë njeri veqil! Ptu, kungull pa fara!

Limi e shikoi ngultas.

— Vërtet qenke njeri dyfytyrësh!, — i tha. — Nuk u ankove ti duke u përjargur? E quajta të drejtë të të mbroja. Nëse paske pasur qejf të të tallnin, përse braktisje punën dhe bridhje në sipërfaqe gjatë orarit të punës?

— Mos u bëj teveqel, shiko punën tënde, — ia ktheu Qenani. Ai herë qeshej, herë shtirej sikur nevríkosej. Kjo i bënte edhe më tërheqëse ngacmimet.

Kur pëlçisnin minat, minatorët e nënkateve të një oxhaku strukeshin nëpër strehime, kurse Qenani ia mbathte oxhakut përpjetë e dilte në galerinë kryesore. Edhe atje nuk e ndalte vrapin. Kjo i bënte minatorët të binin në kurriz duke qeshur. Mjaftonte të dilte një mi që Qenani të alarmonte galeritë duke klithur gjoja prej frike. Të rinjtë, të cilëve u pëlqente të qeshnin shumë dhe të zbaviteshin, mezi prisnin. Madje bënin si bënin, e rregullonin të punonin afër nënkatit ku punonte Qenani.

Minatorët më të moshuar kërkuan që Qenani të punonte në galerinë kryesore, meqë në nënkatet e prodhimit pengonte në punë.

— Si ju pengon?, — pyeti Shkëlqimi, përgjegjësi i turnit.

— U tregon të lara e të palara të rinjve dhe ata lëshojnë veglat e mbajnë ijët së qeshuri.

— Qenan, — i tha përgjegjës Shkëlqimi, — nuk mban më ujë pilafi. Do të mbushësh vagonat me dhe nën bunkerin e rënorit.

— Sa është norma?, — pyeti Qenani.

— Katërmbëdhjetë vagona.

Qenani në fillim thartoi surratin, pastaj pyeti:

— Kush i shtyn vagonat?

— I tërheq elektrovozi.

— Kush i numëron?

— Ti.

— Atje më çol!

Oxhaku i dheut ishte i shmangur prej fronteve të shfrytëzimit.

— Qenan, sa vagona bëre?, — e pyetën ditën e parë.

— Trembëdhjetë e gjysmë.

Ditën e dytë përsëri e pyetën dhe ai u përgjigj.

— Normën, bereqavers!

Ditën e tretë Qenani raportoi se kishte tejkaluar normën dy vagona. Askush nuk e besonte, po s'kishin si t'ia numëronin, meqë edhe prej fronteve të prodhimit nxirreshin vagona me dhe. Galeria ku punonte Qenani po mbushej, dheu kthehej në baltë.

Një ditë punëtorët e përgjuan. Qenani mbushi vagonin e parë dhe e shtyu mbi shina, shtyu edhe katërmbëdhjetë vagona bosh, i lidhi dhe pastaj mbushi të fundit. Si bëri këtë, u fut në traverbangun më të afërt, u mbështoll me peliçe, pastaj me mushama dhe ia shtroi gjumit mbi një vagon të ngarkuar me shtylla. Punëtorët mengadalë e tërhoqën vagonin ku flinte Qenani dhe e lidhën me të tjerët. Elektrovozi e tërhoqi. Qenani që kishte mbuluar edhe këmbën dhe bënte gjumë të rëndë përfundoi tek ashensori.

Minatorët atë mbledhje e bënë brenda në galeri. Aty u gjend edhe Idanikovi.

Kritikuesit ia përmendën Qenanit të gjitha bataqçillëqet jo vetëm gjatë kohës që punonte në minierë, por edhe për kohën kur kishte shërbyer si mulla i fshatit. Qenani u habit se shumë të palara, të cilat ia nxorën minatorët, ai i kishte harruar. Aty iu mbush mendja se nuk kishte tjetër rrugëdalje, përveç se t'i përvishej punës.

*

*

*

Nuk kishin kaluar dhjetë ditë nga mbledhja që u bë. Qenani po mbushte vagonin dhe balta i ngjitej në lopatë.

Papritur si ndonjë hije me gunga iu gjend pranë inxhinier Idanikovi.

— Shjoku Kjenan, shi je?, — pyeti ai me një zë mallëngjyes.

— Ka mbetur të themi mirë, o inxhinier, — u përgjigj Qenani.

— O, oh, i zjiu ti, kjenke mbutur në baltja. Epo kur kërkojnë njerëzit undura prej pljeshtit, siç e foni ju shkip-tarët...

Qenani ia drejtoi dritën mbi sy inxhinierit. Deshi të kuptonte nëse tallej, apo e kishte me gjithë mend.

— Mirë, kjeç, ti i ke sherbier një vendi të shenjtë. Të këtilla njerëza ti katandisjesh në ditë halli, do të fotë që në vend të truve të kesh argjil në koka.

— I pamësuar, o inxhinier. Vërtet po lodhem shumë, — tha Qenani.

— Do bisedojmë, do bisedojmë, elle punën tjende do e rrjegullojmë.

— Nga nxore fjalët, të daltë alltan, o inxhinier!, — uroi Qenani.

— Kam një pjetje, Kjenan, përsje të urjejnë të gjithë? Mjendoj se i nxit dikush. Duke të ljuftuar tije, kjerkon të duket. Po, po. Do mundjohem të rrjegolloj. Kam mësuar se ke shjumë fëmija. E di se kje nevojë, — tha Idanikovi, pastaj shikoi dy anët e galerisë, nxori një tufë lekësh dhe ia futi Qenanit në xhep. — E kemi për detjirë t'i ndihmojmë hallexhinjtë.

— Inxhinier, përse, inxhinier! Mos... Vërtet jam nevojtar, po s'kam të t'i kthej shpejt. Prandaj...

— As mos e bej fjala! Ç'janë ato! Ke shjumë kalamaja, — tha ai duke vënë gishtin tregues mbi buzë.

— Faleminderit, shumë faleminderit, shoku inxhinier! Idanikovi iku. Po nuk harroi ta vizitonte dhe herë të tjera.

Qenanin nuk e habiste ky afrim, sa e çudiste fakti se në sipërfaqe, kur kishte njerëz, Idanikovi bënte sikur nuk e njihte. Po ashtu edhe nën dhe, kur gjendej njeri pranë Qenanit, kalonte si pranë varreve të jeniçerëve.

Qenanin e mundonte edhe një gjë tjetër: Alushenko-

ja, i cili më parë ishte kthyer në ordinancë e shkuar ordinancës, që s'i shqitej as natë, as ditë Idanikovit, tani nuk e shihte as të hynte, as të dilte te specialisti i huaj. Habia arriti kulmin kur filloi t'i afrohej Alushi. Si bisedat e Idanikovit, ashtu edhe të Alushit nxirrnin krye në një qafë. Po Qenani lodhej aq shumë, sa nuk i bëhej të merrej me hamendje.

Ndodhi edhe ajo që Qenani nuk e priste.

Alushi bënte ç'bënte gjente rastin e i afrohej Qenanit. I huazoi edhe ca para.

Punonin në turnin e tretë. Alushi la pompat dhe matej t'i afrohej Qenanit. Herë i dilte në një anë, herë në tjetrën. Hidhej e përdridhej e s'pushonte së foluri.

— Dije se të gjitha të këqijat i ke prej njerit, — i thoshte. — E kam dëgjuar. Të gjithë thonë se ai njeri nuk la rast pa folur keq për ty. Madje ka thënë se njerëz si Qenani nuk e kanë vendin midis nesh, por në burg. Qenan vëllai, Kujtim Kreshpa ka për të ta bërë varrin! Njerëzit që ta duan të mirën, që u dhimbsesh, u munduan të të rregullojnë në një punë për të qenë, e di ku?

— Ku?

— Në sipërfaqe, seleksionues.

— Sa mirë!

— Mirë, po ku të lë Kujtimi. Ai e tha haptas: *Qenani nuk i mungon asgjë. Atij i duhet të kalitet me vështirësitë.*

— Ç'i kam bërë, mor jahu!

— Kujtimi të ka borxh më tepër se një jetë. Të isha në vendin tënd...

«Ku e ka hallin ky?, — mendoj Qenani dhe vuri re se diçka po i përzihet përbrenda. — Për kë më merr mua ky! Më provokon, apo mendon se unë...». I tingëlluan si të gjalla fjalët e Kujtimit: «Qenan, ai që kursen djersën, mund të pranojë edhe koren e bukës së tjetrit që ia shtrin me hile. Nëse do të jesh i nderuar dhe i lumtur, mos i bëj bisht punës. Puno siç punojnë shokët. Çdo rrugë tjetër për të siguruar jetën të shpie në greminë, edhe më keq... Dëgjomë mua, forca nuk të mungon, edhe arsyeja jo, prandaj jepi».

Alushi, që kujtoi se tjetri po luhatej, sulmoi:

— Dëgjo, Qenan, Kujtimi sa ta ka bërë borxh ty, aq ma ka bërë edhe mua. Na ka poshtëruar, ka shpifur për ne. Nuk mund as nuk duhet ta durojmë. Tani, në këtë minutë ai po meremeton oxhakun. Eja me mua. Ti nuk do të bësh asgjë. Do të qëndrosh te kthesa e traverbangut të përgjosh mës vjen njeri, lëvizjet, kurse unë...

— Cili je ti, mor qen bir qeni, — shpërtheu Qenani, — për kë më paskeni marrë mua! Unë jam dembel, e zeza e vetvetes jam unë, por jo i poshtër, hafije si ti! Në këtë tokë kam lindur, për këtë tokë edhe kaptinën..., — dhe i përplasi lopatën tërë baltë Alushit turinjve.

Alushi iku me vrap dhe u fsheh në një galeri qorre. Kurse Qenani me nerva të acaruar zbriti në nënkatën ku punonte Kujtimi.

— Shoku Kujtim...

— Kush të ka ngarë, ç'je mbushur kështu?, — pyeti Kujtimi i merakosur.

— Shoku Kujtim, nëse nuk do që t'i jap fund jetës, më huaj shtatëmijë lekë!

— Përse të duhen?

— Që të mos hidhem nga oxhaku kokëposhtë!

— Nuk po të kuptoj. Ke ndonjë hall familjar? Qetsohu, se do të të ndihmoj, sa të duash.

— Ah, vëlla, — qau me dënësë Qenani duke e përqa-fuar Kujtimin, — unë jam i poshtër, i dobët, njeri pa karakter...

— Pusho, Qenan, nuk bëjnë burrat kështu! Ç'hall ke?

— Vëlla, do të ta hap zemrën. Prej ditës së sotme unë... më duhen lekët patjetër!

— Nuk kam lekë me vete, prit sa të mbarojë turni.

— Jo, jo, tani më duhen. Në këtë minutë.

Kujtimi po e shikonte me habi. Nuk po i jepte hall gjendjes aq të alarmuar të Qenanit.

— Edhe katër orë punë na kanë mbetur, në galeri s'kanë ç'të duhen lekët.

— Në këtë deqikë më duhen. M'i ka dhënë ai qeni i pabesë, Izdajnikovi. Pesë mijë ai, dymijë Alushenkoja. Paskan dashur të më blejnë. Por... Ah, mor Izdajnikov, në mos ta... qen i zgjebosur të më thërresin.

Kujtimi lëshoi kazmën:

— Lim, — i thirri ndihmësit, — mbushe karelin, krife frontin, fillo e bëj potat për portozat. Unë do të vonohem ca. — Pastaj i foli Qenanit: — Ec pas meje.

Rrugës për tek ashensori Qenani ia tregoi ngjarjen fill e për pe.

*
* *

Ditën që ikën tre specialistët sovjetikë nga miniera «1 Maji», Alushi që kishte tentuar të arratisej u kap në kufi.

Mbledhja e organizuar nga komiteti i Partisë për minierën vazhonte.

Fjalët «Qeveria revizioniste sovjetike na ka prerë çdo ndihmë», «Jemi në kushtet e një bllokade...» zvareshin në kokat e njerëzve.

Nga gojët e shtrënguara të minatorëve që diskutonin, dilnin dy fjalë si gjëmim pushke që jep kushtimin «Me forcat tona».

... Unë mendoj, — diskutonte nëndrejtor Bajaziti, — të merren masa të ngutshme. Mjetet teknike janë të pakta. Të tjera s'kemi ku marrim. Këto që kemi do të konsumohen. Që t'i shpëtojmë mbylljes së minierës, duhet të anulojmë shfrytëzimin në disa fronte.

— Përse të pezullojmë shfrytëzimin në disa fronte?, — pyeti Kujtim Kreshpa. — Shoku Bajazit, mos flisni kuturu!

— Të lutem mos më ndërprit, kuturu nuk flas, — tha Bajaziti, — ai që është i urtë, mëson nga fjalët e të mençurit. E theksoj, të anulojmë shfrytëzimin në disa fronte që të shmangim mbylljen e tërë minierës...

— Disfatist! — thirrën katër pesë zëra nga salla.

Nëndrejtor Bajaziti bëri sikur nuk dëgjo, nxori shaminë, fshiu djersën dhe deshi të vazhonte:

— Të pyes, shoku Bajazit, — ndërhyri sërish Kujtimi, — pezulloke shfrytëzimin e shumë fronteve, po minatorët?...

— Minatorët i dërgojmë në bujqësi, — u përgjigj Bajaziti, — fundja shata e lopata do të kemi, se ato prodhohen në kovaçhanë. Kurse mjetet teknike për nxjerrjen e mineralit i kemi të numuruara.

Kujtimi iu afrua sekretarit të komitetit të Partisë, bisedoi goja-gojës diçka, pastaj gërmuqas iu avit derës e doli jashtë.

— Të paska hyrë lepuri në bark, shoku Bajazit, — ia pat drejtori i minierës, — ne, more shok, edhe kur e filluam luftën, të vetëm ishim, armë nuk kishim, po nuk pezulluam asnjë front...

— Në luftë sulmoje armikun, i merrje armët, vazhdoje luftën. Në minierë ndryshon puna...

— Po e tepron, shoku Bajazit, ka dy orë që flet vetëm për një gjë, shokët nuk janë mbledhur të dëgjojnë se si duhet të mbyllën fronte, por si të hapen të tjera, — foli sekretari i komitetit të Partisë.

— Para së gjithash jam inxhinier, si specialist nuk ngopem me fjalët «forcat e veta». Këta shokë që më dëgjojnë kanë forca kolosale, por le të nxjerrin qymyr me gishta, të shpojnë galeri me duar, makar edhe me kazma... E pamundur, shokë, flas nga e keqja. Dua ta ruaj prestigjin e minierës. Nëse nuk do të merren masa, ajo ka për tu mbyllur...

Atë kohë hyri Kujtim Kreshpa, prapa tij bënë ballë në sallë punëtorët e repartit mekanik. Fytyrat e tyre të nxira me vazhda djerse dukeshin si buste luftëtarësh triumfatorë të kthyer nga beteja.

— Shoku Bajazit ka dy orë që thotë se nuk mund t'i përballojmë vështirësitë në minierë me forcat tona, — i tha Kujtimi Kaleshit, brigadierit të tyre, — i thuaj pra cilin mjet nuk mund ta riparojnë shokët tanë!

— Jo ta riparojmë, por edhe ta prodhojmë, shokë!, — tha Kalesshi. — Që nga bullonat deri te barominat, thikat e matrapikut e të tjera mjete që janë të përditshme dhe të domosdoshme në minierë.

Një urra bubulluese shpërtheu në sallë. Bajaziti u ul. Dy pika loti lanë folenë dhe i rrëshqitën faqeve. Se qenë

lotë gëzimi, hidhërimi, frike, apo hije e sedrës së sëmurë të marrë nëpër këmbë, nuk mori vesh njeri.

— E shikoni këtë, — Kujtimi ngriti një thikë matrapiku, — është prodhuar nga duart e këtyre shokëve, — dhe tregoi me gisht punëtorët. — Brenda njëzet e katër orëve kanë prodhuar dhjetëra të tilla e të tjera pjesë këmbimi.

— Çfarë ju duhet, shokë, — thirri Kaleshi, — do të prodhojmë ne...

Ndërsa punëtorët diskutonin njëri pas tjetrit, merrnin zotime, jepnin mendime, sekretari i komitetit të Partisë vështronte grushtat e shtrënguar të minatorëve e tha me vete: «Me të tillë njerëz që ka rritur Partia s'ka furtunë të na dredhë qerpikun!».

KREU VIII

Atë mbrëmje Kujtim Kreshpa filloi hapjen e një oxhaku të ri.

Bashkë me Limin thelluan potat. Kur vendosën por-tozat, ndihmësi i tha minatorit:

— Do të ishte sukses sikur të arrinim të bënim edhe minat.

— Do t'i bëjmë, — ia ktheu Kujtimi.

Tjetrit i shndriti fytyra nga gëzimi. Atë kohë në galeritë fqinje u dëgjuan zëra:

— Alarm, një shok i porsaardhur në minierë ka humbur rrugën!

Ç'kishte ndodhur?

Një ndihmësminatori i dhembte koka. Minatori, për të mos u shmangur nga fronti i punës, meqë tamam atë ditë ishin zotuar se do të dyfishonin forcat, e përcolli ndihmësin në sipërfaqe me një pompist. Ndërsa udhëtonin galerisë, takuan dy vagonistë, të cilëve u kishte rrëshqitur vagoni prej shinave.

— Shok, — i tha ndihmësit të sëmurë pompisti, — ulu pak mbi ato shtylla, pritmë sa t'u ndihmoj shokëve.

Ndihmësminatori, të cilit nuk i pritej sa të ngjitej në sipërfaqe, vazhdoi rrugë. Në vend që të ndiqte rrugën

kryesore, ai ishte zhdukur në labirinte. Përmes galerive të manevrimit të elektrovozt kishte dalë në galeritë e Jugut, kishte zhgozhuar dërrasat e një galerie qorre, edhe pse atje ishte vendosur pllakati «NDALOHET KALIMI», dhe kishte humbur fare. I përfshirë nga makthi që shkaktonte vetmia dhe errësira të rinjtë në minierë, ishte futur thellë në galeritë e shfrytëzuara e të braktisura.

Pompisti që e shoqëronte e kërkoi dhe, kur nuk e gjeti, me vrap shkoi te telefoni për të pyetur sipërfaqen.

— Lart nuk është ngjitur njeri, — u përgjigj sinjaliste Dila.

Pompisti vrapoi tek ashensori, po as atje nuk dinin gjë.

Ai u sul të jepte alarmin.

Minatorët të nxirë në fytyrë, të djersitur, u shpërndanë në galerive në kërkim.

Lim Thana vrapoi në galerinë kryesore. Te kthesa e manevrimit të vagonave u ndal. Iu kujtuan ditët e para në minierë. Shpeshherë edhe ai kishte ngatërruar rrugën: «Po sikur t'ia ketë mbajtur djathtas?, — mendoi Limi dhe hovi andej. — Do të më qortojë Kujtimi. Ai i urren kokëkrisurit që të pashoqëruar bredhin galerive. Le të më qortojë! Shoku gjendet në rrezik». Mu nën pllakatin që ndalohej kalimi, hetoi një vrimë. «Ja ku qenka futur, — tha me vete. — Do të ketë kujtuar se kjo është rruga rezervë që të nxjerr tek ashensori. Ah, shok, shok, galeritë qorre janë të paajrosura! Andej ka gaz! Kundragazin! Ku ta gjej kundragazin? Të shkoj ta marr, s'pret koha! Shoku në rrezik. . .». Ndriçoi galerinë, po asnjë dritë tjetër nuk dukej. U fut në vrimën që kishte hapur tjetri dhe në hundë ndjeu t'i përplasej era e athët. Shpejtoi hapin. Eci i mbushur me frymë. Vraponte dhe kontrollonte sa në një degëzim galerish të braktisura në një tjetër. Frymëmarrja i rëndohej, ndaj zbrëtheu kopsën e jakës. Hundët i digjnin dhe një dehje trullosëse filloi t'ia mjegullonte pamjen. Ai e dinte se ç'ishte ajo. Gazi karbonik si ndonjë tinëzar të futet në hundë, të bën çakërçeqf. Fillon të të molisë me një ëmbëlsi të përzier me të hidhur. Iu kujtua edhe një herë se shoku ishte në rrezik. Vrapoi duke rrotulluar kokën sa në një anë, në

tjetrën. Hundët iu mpinë sikur t'i ishte bërë ndonjë mpi-rje e pjesshme për operacion. Këmbët po e humbnin peshën. Një dëshirë e madhe për t'u ulur. Një minutë, të paktën një sekondë.

— Ah, gaz dinak, gaz dinak, — thirri ai me zë të lartë, — nuk jam bythëpambuk, jam minator unë!

Filloi maramendthi. I dridheshin gjunjët. Kasat e galerisë i dukeshin të shumëfishuara. Galeria filloi t'i rrotullohej si dollapi i kafes. Limi nuk u kthye. Eci. Diçka si të zezë i zunë sytë më tej, mblodhi forcat e vrapoi. E gjeti. Ndhimësinatori kishte rënë përmbys. Streha e kapeles bashkë me llampën i ishte kredhur në llucë. E ktheu për së mbari. Ia vuri veshin në zemër. Asnjë zhurmë. Ia hapi gojën dhe filloi t'i shfrynte. Tjetri lëshoi një teshtimë fare të vockël. Limi e puthi. E hodhi mbi kurriz. Këmbët i dridheshin si purtekë. Qerpikët i rëndonin sikur mbi to të peshonin kuintalet. Vazhdoi të çapitej, po forcat po i shteronin. Çdo hap bëhej më i rëndë, më i ngathët se tjetri. Midis ballit i filloi një e therur me të prera. Mezi ngriti kryet për të hedhur shikimin përpara ku lëviznin dhjetëra drita si meteorë në një natë të errët. I shungulluan veshët. Iu bë sikur ishte në ëndërr. Sikur fluturonte. Pastaj sikur kridhej në ujë të vakët. Çudi, ai s'lëvizte as duar, as këmbë, po uji i trashë e i vakët e mbante sipër. Limin e kishte mbërthyer një gjumë i ëmbël e ledhatar. E tundi kokën që të shpërgjumej. Zëra. Shumë zëra. Zëra gudu-lisës, zëra të ëmbël që pëshpërisnin. Zëra që ngjanin me fëshfëritjen e gjetheve kur i lëkund era e majit. Ia hoqën atë që mbante mbi kurriz. Limi sërish fluturoi. Tani jo në ëndërr, por në krahët e shokëve.

Ëndrra joshëse vazhdonte. Diçka e freskët, diçka midis pickimit dhe gudu-lisjes i rrodhi brenda në hundë. Ia zgjeroi mushkëritë. Limi shfryu me një teshtimë të furishme. Teshtiu edhe një herë dhe me mundim hapi sytë. Të parën ndeshi fytyrën e Kujtimit. Ajo iu duk aq e madhe, sikur të kishte përpara një mal. Shokët i folën, po ata zëra atij iu dukën sikur i vinin nga largësitë si ndonjë jehonë.

Sërish ndjeu të therura të prera që lëviznin nga njëra

anë e ballit në tjetrën. Kafka sikur i ngrihej porsì barku-
she e ndonjë peshku të stërmadh. Pastaj e pickoi diçka në
kofshë, edhe një pickim tjetër:

— Si e ndien veten, shok?

Limi buzëqeshi. Kur hapi sytë, vuri re njerëz të veshur
në të bardha.

«Dreq, o punë, sa ëndërr e gjatë paska qenë!, — men-
doi Limi i shushatur dhe buzë një shpërgjumi të trullosur,
thirri:

— Si u bë ndihmësinatori, shpëtoi?

— Qetësohu, shokun Lim, qetësohu, gjithçka në rregull!
Të lumtë!

Zëri i dashur, zëri i njohur e bëri sërish t'i hapte sytë.

«Kujtimi! Po përse është veshur me të bardha? Kuj-
timi doktor!»

I sollën kos, shumë kos. Po kush t'ia hapte gojën!

— Lim, pi kos! Ti s'je çapaçul, je minator! — Kujtimi
tha shprehjen e preferuar të Limit. Tjetri i buzëqeshi dë-
shirës së madhe për të fituar titullin minator. Doktorët
përfittuan nga ajo hapje goje dhe nuk e lanë ta mbyllte.
Ai gëlltiste kosin e trashë. Pas pak u qetësua dhe e mbër-
theu një gjumë i thellë.

Të nesërmen mbrëma u gjend me pizhame në garde-
robën e turnit «Sulmi». Të gjithë shokët iu hodhën në qafë,
Ramë Dushku i preku majën e hundës, të tjerët e përqa-
fuan. Kujtim Kreshpa as ia shtriu dorën.

— Nuk i honeps kokëkrisurit, — tha ai nëpër dhëmbë,
— minatori para së gjithash duhet të jetë i disiplinuar. T'u
nënshtrohet rregullave.

Lim Thana uli kokën.

— Përse ike prej ambulancës?

— Doktorët kërkojnë të qëndroj shtrirë disa ditë. Po
unë s'jam lehonë. Doktorët qenkan njerëz që nuk besokan.
Ju betohem, shokë, nuk kam asgjë fare, fare.

— Doktorët dinë, pa të kanë thënë. Ke thyer rregu-
llat!, — i foli prapë ashpër Kujtimi.

— Shoku Kujtim, prej jush dhe prej këtyre shokëve
kam mësuar që të mos i nënshtrohesh së keqes, vështirësive.

— Lëri llafet! Shpejt në ambulancën e minierës!, — tha

Kujtimi pa guxuar ta shikonte në sy djaloshin energjik, ngaqë druhej mos ndryshonte mendje.

— T'ia shtrojmë kolektivit, — tha Limi me zë lutës.
— Ju betohem, shokë, e ndiej veten fare mirë. — Filloi të kërcente dhe të tundej nëpër garderobë për t'i bindur të tjerët se nuk kishte asgjë, me qëllim që ta pranonin të punonte.

— Ky është ariu i galerive, — tha Rama.

— Urra! Urra! Urra!, — brohoritën minatorët.

Limit i shkëlqyen sytë nga lotë gëzimi. Ai e dinte mirë se ç'do të thoshte emri i tij. E dinte se qysh atë çast e kishte merituar të quhej shok i denjë për ata që nuk i tremb asnjë vështirësi, që zhvillojnë beteja të pareshtura në nëntokën e thellë.

Disa iu lutën Kujtimin që të pranonte, me që Limi ishte ndihmësi i tij, po minatori kurrë nuk bënte lëshime.

— Ik në spital, — i tha ai Limit, — nesër, mbasi të marr mendimin e mjekëve, do të bisedojmë.

Deshi s'deshi, Limi iku buzëvarur.

Kujtimi tundi kokën e doli edhe ai nga garderoba. Kur iu afrua sportelit të llampave, vuri re se llampistja mungonte. Pas pak Bukuria u kthye, po, kur ndeshi Kujtimin në sportel, u bë prush e kuqe. Ia zgjati llampën dhe nuk iu zu pa thënë diçka:

— Limi tha se nesër do të bisedonit me mjekët, vërtet do ta bëni?

— Mos ki frikë, Buke, nesër do ta kesh këtu ariun e galerive.

Vajza s'dinte ç'të bënte nga gëzimi. Vuri dy pëllëmbët mbi faqet e skuqura. Kujtimi prapë tundi kokën dhe eci drejt kullës së ashensorit. «Duhet, — mendoi ai me vete, — çift i këndshëm: ajo bijë mekaniku, ai bir dëshmori».

Ka disa njerëz që, me t'i parë, të hyjnë në zemër. Edhe Kujtimin ashtu i ndodhi me Limin, ndaj e zgjodhi si ndihmës.

Tetë orë kishte punuar që ditën e parë edhe pse fillimet në minierë janë disi të vështira.

— Kam shërbyer në xhenio, — fliste me sinqeritetin e një fëmije. — Atje më hyri në zemër profesioni i minatorit.

Qysh atje zgjodha punën që do të bëja sa të lirohesha nga ushtria. Disa më thanë:

— *Lim, o tutkun, t'i ka ngrënë sorra trutë që kërkon të shkosh në minierë! Je bir dëshmori, mre lalë. Për ty janë të gjitha dyert hapur. Zër ndonjë zanat për të qenë!*

— *Më pëlqen zanati i minatorit, — thashë unë.*

— *Mos, mor çun, — më tha një tjetër, — s'të mbështillen kalamajtë nëpër këmbë, që t'i thuash shpirtit «dil»! Përse të shkosh në minierë? Nënë nuk ke, vëllezërit nuk ta kanë nevojën, jetojnë me gratë e fëmijët e tyre në bollëk. Bir dëshmori je, kërko, siguro ndonjë profesion që të ta kenë lakmi të gjithë! Po unë, në minierë thashë dhe ja, erdha.*

K R E U IX

Miho Gjelaci kishte filluar të thinjej. Edhe mendimet mbi çështje të ndryshme përpunoheshin, merrnin forma të ndryshme sipas kohës e situatave, por pa i kaluar caqet e bindjeve politike e ideologjike. Përkundrazi, mjetet për t'u shërbyer bindjeve të tij përsoseshin. Ai jo më kot kishte qëndruar me vite në pritje, në përgjim. Edhe ndonjë rast kur e pamundshmja i ishte shfaqur me tërë kokëfortësinë e saj, ai kishte krijuar me fantazi të mundshmen. Vullneti i tij jetonte në harmoni të plotë me pamjen e tij. Koka e tij të kujtonte bustet antike. Për t'u treguar sa më i moshuar e burrë zakoni, kishte lënë mustaqe jo të gjata, por rrafsh me buzën. Prej gojës i dilnin fjalë të sheqerosura. Sytë i mbante gjysmë të mbyllur, pak të picërruar nën vetullat e bashkuara. Këto tipare jo shumëkujt i pëlqenin. Bile te ndonjëri ndillnin edhe urrejtje përzier me një farë dyshimi të papërcaktuar.

Ishte burrë fare i zakonshëm, veshur me rroba doku. Ecte pak i kërrusur. Ishte ca i përvuajtur. Po brenda në dhomën e vet bënte gjimnastikë dhe stërvitje që do të ishin të stërmundimshme për një djalosh tetëmbëdhjetëvjeçar. Ajo ishte dhoma e ushtrimeve, «dhoma e ëndërrimeve të së ardhmes», siç e quante Mihoja me vete. Ca gazeta e libra, një radio dhe një sustë krevati, që ia kishte dhënë teza,

këto ishin pasuria e tij e dukshme, për të tjera pakkush mund të dinte gjë.

Kur ngrysej mirë, Mihoja ja shkonte te teze Sermja, burri i së cilës ish-sekser që mbytur në det me një anije të huaj gjatë një katastrofe. Tezja jetonte me ndihmën në të holla të kunatit të saj që ndodhej jashtë shtetit.

Mihoja nuk i hapej plotësisht as tezes, as hallës së tij, të cilat jo vetëm nuk druheshin prej tij por mundoheshin ta nxisnin. Tashmë ai kishte rivendosur lidhjet me Ortakun.

Një mbrëmje tezja i tha:

— Miho, prapë më ka shkruar im kunat. Ka dy-tre rreshta edhe prej Ortakut.

— Hë, ç'thotë?, — pyeti Mihoja.

Sermja heshti.

— Shkruaji tët kunati, — e porositi Mihoja, — që ta ndihmojë shegertin e tët shoqi, se është i varfër dhe ka dëshirë të punojë në mallin e zotërisë!

— Si kërkesë e tepruar kjo, Miho, — i tha tezja duke ia shkelur syrin dhe duke buzëqeshur me nënkuptim.

— Për ty mund të jetë e tillë, po për kunatin jo.

Tezja i shkroi kunatit dhe pas dy muajve mori katërfishin e parave që i vinin prej andej.

Po hynte pranvera. Një mërgimtar erdhi për t'u çmallur në atdhe. E kishin porositur shumë vetë, midis tyre edhe Ortaku:

«Kam një fisin tim, — i kishte thënë, — po nuk di a është gjallë. Shko te Serme Dika në... sa për ta kujtuar, çoi këtë pako cigare».

Mërgimtari i padjallëzuar, i cili të gjitha i maste me peshoren e vet, e kreu porosinë. Ai nuk e dinte se paqeta e cigareve ishte e mbështjellë me letër simpatike ku ishin shkruar porositë e hollësishme për Mihon.

Kur tezja i dha paqetën, Mihoja vajti me ngut në dhomën e vet në periferi të qytetit. Mbylli mirë derë e dritare, futi në një solucion letrën simpatike dhe pas pak lexoi:

Njerëzit që pëlqejnë mënyrën e jetesës sonë janë më të mundshmit për të qenë tanët. Ata që i gush e përbashkëta, janë objektiv i mirë për qitje... Të depërtojmë gjer

atje, e kemi të pamundur. Fytyrën tonë plot vezullime e shikojnë në televizion. Atyre që u pëlqen ky shkëlqim mahnitës, patjetër që do t'u pëlqesh edhe ti...

Shegerti kërkonte të punonte në mallin e zotërisë.

Malli gjendet në Tiranë te katër selvitë e Namazgjasë dhjetë-pesëmbëdhjetë hapa poshtë urës së Lanës. Në guvën e selvisë së dytë duke numëruar nga sipër, ka mbirë një fik. Tamam në atë guvë gjenden ato që kërkonte shegerti. Tre metra larg selvisë në drejtim të lumit është groposur një arkë metalike. Ai mall na intereson pa masë...

Kjo letër i ngjalli Mihos kënaqësi, po njëkohësisht dhe shqetësim.

* * *

Mesnatë. Hëna ndriçonte. Gjethet e plepave në të dy anët e Lanës fëshfërinin.

Një burrë me këmbëzat e pantallonave të përveshura ecte përmes lumit. Nën urën te bulevardi kryesor u ndal. Vuri dorën e djathtë në gjoks. Me zemrën e kishte punën keq. I përpëlitej e shkreta si e ndonjë zogu që çdo degëz i kthehet në çifte gjuetarësh dhe çdo zhurmë në krismë armë. Pasi nxori kryet sapak nga nënura dhe vuri re se në të dyja anët e sipërme të Lanës nuk kishte njeri, eci gërmuqas. Uji ishte i ftohtë, por atij i ishin mpirë këmbët me shumë nga ankthi sesa nga të ftohtit. Çapitej. Kur u duk ura te Rruga e Elbasanit, atij iu ngjeth mishtë. Kurrizin sikur ia mbërtheu një rrymë e fortë elektrike. U mbështet buzë përroit të mbushej me frymë. Pas pak mori nga brezi daltën e mprehtë që iu ngjit për dore. Ngriti kokën. Ja, katër selvitë e gjata të moshuara qëndronin të nemitura në rresht. Mihos iu dukën shumë të gjata, sidomos kur i shikoi nga poshtë. Ato sikur çanin qiellin. U ngjit në buzë të përroit e u fut shpejt në disa kaçube xhufrrake. Përgjoi. S'dukej njeri. Zvarimthi eci deri te këmbëza e urës, pastaj u ngrit pupthi, vështroi edhe një herë dy anët e rrugëve dhe lulishten sipër. Asgjë. Hëna ndriçonte. Ai vrapoi drejt selvive, u mbështet mbi selvinë e dytë, ngriti kryet dhe

sytë i zunë degët e fikut mbirë në guvën e drurit dyqind-
 vjeçar. Deshi të kacavirej, të fuste dorën në guvë, por...
 «Ah, moj hënë spiune, — mallëkoi me vete, — thyej zver-
 kun që të punoj në errësirë!». Por hëna ndriçonte pa çarë
 kokën për mallëkimet e Miho Gjelicit. Ai mati me hapa
 largësinë nga selvia. Filloi gërmihjen si urithi. Gërmoi shu-
 më, u djesit, zemra i rrahu me vërtik, iu shkumbëzua
 goja nga inati, nga frika e nga lodhja, por asgjë nuk gjeti.
 «I kanë marrë, — tha me vete, — s'kanë lënë vrimë pa gjur-
 muar!». Nuk i mbetej gjë tjetër veç të kacavirej në selvi.
 Vepronte gjithnjë nga ana e hijes së drurit të trashë. U
 kap me thonj, por, kur u gjend një metër mbi sipërfaqe,
 rrëshqiti. I ra kokës me grushte, po dorë nuk hoqi, prapë
 u kacavar. Gjunjët i digjnin nga gërvishjet. Djersa e mble-
 dhur mbi mustaqe i rridhte në gojë. Mihoja lëpihej. Më
 në fund, me dorë të dridhur, u kap në një degë. Por krahu
 i tendosur iu drodh. Mblodhi forcat dhe, me një kërcim, u
 kap në degë edhe me dorën tjetër. Ngriti këmbët dhe u fut
 në degët e fikut mbirë në guvën e selvisë. Futi të dyja duart
 në guvë. Mirëpo trangu i fikut ishte trashur dhe ai mezi
 përbiroi njëren dorë. Preku një gjë të butë, të qullët, mblodhi
 grushtin, por nuk e nxirrte dot. Shpejt u kujtua për dal-
 tën, e nxori nga xhepi dhe e futi në anën e brendshme të
 trungut. Pjesa e kalbur u shkërmoq lehtë. E zgjeroi. Në atë
 kohë u dëgjuan hapa në rrugë. Mihoja mbajti frymën. Gati
 i alivanosur priti mbi dhjetë minuta. Filloi sërish. Vrima
 ishte hapur. Tani dora hynte e dilte lirisht. Ai kapi pakon
 prej meshini dhe, pa e vërejtur, e futi në gjë. Futi edhe një
 herë dorën, kontrolloi, po asgjë tjetër nuk gjeti. Me marifet
 hapi degëzat e fikut e vështroi. Qetësi. Zbriti shpejt dhe u
 fut në përrua. Doli prej përroit atje poshtë ku Lana bën
 kthesën dhe del në fushë. Ndërkohë po zbardhte. Mihoja u
 ngjiti në kodër. Gjeti një vend të përshtatshëm thellë në
 zabel dhe, pasi pushoi mirë, nxori pakon nga gjiri. Me duar
 që i dridheshin e hapi. Shumë letra ishin çngjyrosur nga
 myku. Shfletoi. Nxori shkrepësen dhe dogji ato që nuk i
 hynin në punë. Të tjerat i kontrolloi mirë. Midis atyre që
 kishte ndarë, gjeti deklaratën e Soli Kimit që në rrethana
 tepër të vështira e kishte lëshuar në zyrën e gestapos. Mi-

hoja e ndau atë veç. E mbështolli me një copë lëkurë dhe e futi në xhepëzin e fshehur. Pastaj u shtri në kurriz e puliti sytë.

Miho Gjelaci nuk ishte takuar më me Tianin që prej asaj ndarjeje të ngutshme e të papritur më 14 nëntor të 1944-trës kur kapiten Hederi e Tiani, maskuar si këshilltarë ushtarakë aleatë, kishin mundur t'u shpëtonin partizanëve që asgjësuan karvanin e gestapos në Qafë Kërrabë.

«Ti je anëtar i forcës së tretë, — i kishte thënë Tiani në prag të ndarjes. — Sipas kohës, gëzofin! Do të vijë koha, do të të gjejme. — Shpresat tona do të varen kryesisht te ti dhe shokët e tu. Do të të ndihmojmë që t'i forcosh pozitën. Mos harro, forca e tretë është një rezervë që vepron me kurdisje të gjatë kundër komunizmit».

«Ja, — tha Mihoja me vete, — deklaratën e kërkuar e gjeta. Do ta sulmoj birin e gjynafqarit. Teze Sermja është vërtet siç e ka emrin. E zbuloi se nga të katër Demirët në minierën «1 Maji» Demir Ullishtasi na qenka i biri i Soliut. Që nuk ka denoncuar Demiri, kjo merret vesh... mbiemri i ndryshuar...

Eh, Demir, Demir, tani duhet të më ndihmosh!...».

K R E U X

Demir Ullishtasi, që drejtonte grupin artistik në minierë, atë të shtunë pasdite shfletonte një pjesë teatrale. Bardhoshi, i biri dymbëdhjetëvjeçar, që i qëndronte pranë, e pyeti:

- Babi, kur do ta japin shfaqjen minatorët?
- Të dielën.
- Domethënë nesër? Teto Dila ka ndonjë rol?
- Po, luan rolin e shoqes së asaj mësueses së mirë.
- Po xhaxhi Kujtimi, xhaxhi Demi, xhaxhi Rama,

Limi?

- Përveç Lim Thanës, të tjerët nuk kanë role.
- Po rolin e mësueses kush e luan?
- Bukuria.
- Po Limi ç'rol luan?

— Rolin e minatorit, me të cilin punon studenti.

— Cili është ky student?, — pyeti djali duke rrudhur ballin për ta kujtuar.

Në bisedë u përzie edhe motra e Bardhoshit. Fëmijët diskutonin me zjarr. Demiri dëgjonte dhe gëzohej që ata flisnin sikur të ishin të rritur.

E shoqja, e cila që prej dy vjetësh vuante nga zemra, u ul pranë Demirit në divan me bërrylat mbështetur mbi tryezë e mjekrën mbi pëllëmbë. Dëgjonte e buzëqeshte. Ajo sikur po e mposhtte lëngatën tek shihte Bardhoshin që shoqëronte fjalët me lëvizje duarsh dhe i lumturohej shpirti.

— Jo, — ngulte këmbë motra. — Po të kishte shkuar gjatë Tomi, drama nuk do të vlente dy para. Unë për vete nuk do ta shikoja. Unë e dua student Tomin vetëm se shkoi në minierë. Apo nuk kam të drejtë, babi?

— Tomi nuk shkoi në minierë që të shkruanin të tjerët dramë për të, — sqaroi babai, — të tjera gjëra e shtynë.

Në këtë kohë ra zilja e telefonit.

Afërdita që e kishte më pranë kapi receptorin.

— Alo, Demiri? Po është këtu. — Pastaj iu kthye të shoqit: — Demir, të kërkon një burrë, duket është nga ata të teatrit.

Demiri iu afrua telefonit:

— Alo, po, Demiri jam... Demir Ullishtasi..... Nga fshati Ullishtas pra!... E, e, i biri i Soliut... Po ju kush jeni?... Cili?... Te Zogu i Zi... Në orën njëzet? Po kush... — Dreq o punë, — iu kthye së shoqes, — të kërkon takim tjetri dhe emrin nuk ta thotë. — E mbylli telefonin. — Më vjen për të qeshur. Këta të teatrit edhe në jetë luajnë role...

— Do të shkosh?, — pyeti Afërdita.

— Si jo.

Në mbrëmje Demir Ullishtasi doli prej shtëpie bashkë me gruan dhe me fëmijët.

— Më prisni në «Flora», për mua porosisni një krem vanilje!, — tha Demiri dhe u nda.

Afërdita me të dy fëmijët zunë një tavolinë. Porositën. Porositë qëndronin mbi tavolinë. Demiri nuk po dukej. Bardhi me majën e lugës gërvishte kasatën, e afronte lu-

gën te goja, ajo i lëngëzonte. — Sa shikonte kolltukun bosh në krahun e djathtë të tij, e kthente lugën mbi kasatë. E dinte se motra do ta quante llupës, nëse nuk do të priste gjer sa të vinte i ati.

Afërdita herë pas here shikonte orën.

Më në fund u duk Demiri. Balli i ishte bërë shuk prej rrudhave. U lëshua mbi kolltuk. E shtyu tutje pjatën me krem vanilje.

— Shoqe, — thirri ai kamerieren, — një dopio konjak!

Tre palë sy e shikuan në mënyrë pyetëse.

Demiri lëvizi në kolltuk. Ktheu kokën nga ana tjetër e lokalit. Po shikimet e së shoqes dhe të fëmijëve sikur i nguleshin thellë. Ndezi një cigare.

— Ç'më shikoni si budallenj!, — shfryu ai tërë nerva. — Hani! Ç'prisni? — Pastaj u mundua të qeshte. Ajo mund të ngjante me gjithçka, vetëm me buzëqeshje jo.

Bardhoshi filloi të hante.

— Babi, — foli ai si lëpiu dy lugë kasatë, — na the të të porosisnim krem, kur të qenka tekur për... Ti konjakun nuk e pi!!

— Mos fol kur ha!

Kamerierja solli konjakun. Demiri e ngriti njëherësh.

Tri lugë të mbushura mbetën pezull. Vështrimet e fëmijëve u kryqëzuan jo mbi Demirin, po mbi Afërditën. Nervozizmi i papërmbajtur i të shoqit ishte i panjohur për gruan. Një ndjesi habie po ia trazonte tërë humorin e mirë të asaj të shtune.

Ende nuk kishin mbaruar së ngrëni kur Demiri tha të ngriheshin dhe doli nga lokali pa pritur njeri. Kur iu afruan Afërdita me fëmijët, foli me zë të lodhur:

— Dita, hipni autobusit dhe shkoni! Kam një punë.

— Në këtë orë?, — u habit e shoqja.

— S'ka ç'të duhet ty! Bëj si të thonë!

Afërdita rrudhi supet

— Babi, — i tha Bardhoshi, — ti s'e mbake alkoolin fare!

Demiri u nis drejt bulevardit. Si bëri ca hapa, u ndal e tundi kryet i penduar. Pastaj u kthye me vërtik. U bashkua me fëmijët dhe me gruan. Herë me të ngutur, herë ngadalë ecte sa para prapa fëmijëve.

Hipën në autobus.

— Babi, — foli Bardhoshi duke ia lëmuar dorën, — do të më marrësh në shfaqjen e minatorëve?

— Mirë, mirë, — ia ktheu Demiri.

Në shtëpi asnjëri nuk guxonte të hapte muhabet, as darkë nuk hëngri njeri, fëmijët vajtën drejt e në dhomën e tyre.

— Çfarë ke?, — e pyeti të shoqin Afërdita kur mbetën vetëm.

— Më dhemb koka. Sonte do të fle në kuzhinë. Merre Bardhoshin në krevat.

— S'po të marr vesh!

— Oj, kjo! Sikur u fejuam sot... Lërmë rehat! Mos bëj llafe!

Të nesërmen zilja e telefonit tingëlloi. Demiri me sy të buhavitur nga pagjumësia iu afrua. Kapi receptorin dhe, sa dëgjoji zërin matanë telit, e lëshoi mbi aparat. Zilja tingëlloi sërish.

— Alo... Po, Demiri. Si?, — dhe e përplasi sërish receptorin mbi aparat. Telefoni rënkonte pa pushuar. Afërdita kishte hapur derën për gjysmë dhe po shihte e habitur. Demiri e pa e iu hakërrye: — Si t'ia vëmë emrin këtij përgjimi?! Hajt, mbylle derën! Mbylle, të thonë!

Zilja tingëllonte bezdisshëm. Demiri mbërtheu receptorin me dorën që i dridhej nga nervozizmi:

— Ç'ke që mjaullit! Na lër rehat! — Pastaj uli zërin: — Çfarë?! Bëj ç'të duash! Thyej qafën... Jo, jo, prit. Sot? Jo sot. Kam punë në minierë. Jo, jo, atje mos eja! Çfarë? Mor, ti qenke një i bezdisshëm që... Të thashë po, veç në telefon mos më merr... — Pastaj mbylli telefonin e filloi të bariste nëpër dhomë si i çakërdisur. «Do të shkoj të denoncoj, — mendoi ai me vete. — Fundja babait i janë tretur eshtrat, — dhe iu kujtua se si vite më parë në çastet e fundit të jetës i ati i kishte folur për disa të fshehta, për një deklaratë dhe Demiri i kishte premtuar se do t'ia ruante sekretin. — S'kanë ç'më bëjnë. Po të më thonë: Ku ishe deri sot?», unë do t'i bie drejt, do t'u them se në fillim më gozhdoi fjala që i dhashë babait, më vonë pata frikë mos merreshin masa që nuk denoncova me kohë. Kur u mar-

tova dhe u bëra me fëmijë, frika m'u shumëfishua!... Tani le të më bëjnë ç'të duan! Pa prit!... — Këto dy fjalë i tha me zë dhe u ndal midis dhomës, si njeriu që matet të kapërcjë ndonjë hendek të lartë. — Si tha ai qeni. Jo, jo, do të shkoj, të bëhet ç'të bëhet!», — tha i vendosur Demiri dhe doli si hije prej dhomës.

Kur po zbriste shkallëve, dëgjoi ca klithma të llahtarshme. U kthye i hallakatur. Klithnin fëmijët e tij. E shoqja që shtrirë sa gjatë-gjerë në dysheme. Dy anët e hundës i ishin zverdhur. Bebet e syve i dukeshin pa jetë, të akullt.

— Zemra!, — tha vajza duke gëlltitur lotët.

Bardhoshi kishte zënë qoshen prapa derës e mundohej të mbyste dënesat.

— Taksirate!, — thirri Demiri dhe doli në dhomën ku ishte telefoni. Formoi një numër: — Alo, urgjenca! Gruaja po më vdes! E ka mbërthyer kriza e zemrës!... Jo, jo, nuk e lëviz njeri, po ngutuni! — Pastaj dha adresën. Nga dera e hapur dukeshin kokat e fëmijëve që shikonin të trishtuar. Demiri thirri sërish: — Ç'keni që më shikoni si budallenj!

— Baba, mos bërtit, — qortoi vajza. — Nëna ishte mirë, sjellja jote e ligështoi!...

— Mbylle gojën ti!, — klithi Demiri dhe aty për aty u pendua. Hapi derën e ballkonit dhe treti vështrimin jashtë. — «Ç'më duhet t'i nxjerr telashe vetes! Ai nuk më kërkoi asgjë. Do të punojë në minierë, meqë atje merren më shumë lekë! Eh, ç'budalla bëhem».

K R E U X I

Thuhet se në të njëjtin ujë të lumit nuk mund të lahesh dy herë. Në minierën «1 Maji» thonë: «Në galeri, me dy nuhatje, njeriu thith ajër të ndryshëm». Nuhatja e dytë përmban ajër më të pastër, më të freskët se e para. Në të gjitha galeritë ndodh e njëjta gjë, sepse ventilatori, që ngjan me mushkëri të mëdha elektrike, thith si i pangopur ajrin e papastër, kurse tubat shfryjnë brenda ajrin erëkëndshëm që thith në sipërfaqe. Miniera pra kryen një frymëmarrje të pandërprerë. Kështu ndodh me ajrin. Me ngjarjet ndodh

ndryshe. Ditari mbetet atje midis galerive. E shfletojnë, e kujtojnë minatorët sa herë futen në strehime gjatë shpërthimit të minave, sa herë zbrecin dhe ngjiten. Çdo nënkat, çdo galeri, traverbang, oxhak ka historinë e vet.

«Ja, e shikoni këtë vrimë si gojë e ndonjë ujku plak e të rënë dhëmbësh, — u tregonin të rinjve minatorët e vjetër. — Është projekti i atij qeni. Deshi të sabotonte përpara se të ikte. Çfarë bukëshkali! Tjetër gjë nuk mund të bënte. Po teknikët tanë qenë goxha të aftë. Të mos zbatojnë projektin e Idanikovit! Ky traverbang nuk nxjerr në shtresat e qymyrit, po në rënor, — thanë ata dhe mirë e kishin».

*
* *

Kujtimi bashkë me ndihmësin e tij Lim Thanën ecnin galerisë. Përballë traverbangut Nr. 3 u ndalën.

— Ja, këtu për herë të parë më foli Izdajnikovi, — tha Kujtimi.

— Domethënë përpara se t'i afrohej Qenanit.

— Shumë më parë. Kishte tentuar tek inxhinier Vangjushi, i kishte ndeshur sharra në gozhdë, tek inxhinier Ylli i ishin thyer ca dhëmbë, kurse tek unë iu thye sharra. Pasi nuk i eci, filloi të kapte njerëzit pa parti. Por e pësoi si ai tinëzari që hedh gurin e mundohet të fshehë dorën, po zbulon kokën.

Vazhduan rrugën për në frontin e punës. Nënkat i ende nuk ishte pastruar prej tymit të minave që kishin bërë ata të turnit të parë.

— Prit këtu në anë të oxhakat, — i tha Kujtimi Limit, — më duket se është mbyllur tubi i ajrit, e ndien si qelbet galeria dhe tymi sikur zvaritet me pishmanllëk.

— S'ka mundësi të jetë i mbyllur tubi i ajrit.

— Është i mbyllur, ndryshe do të dëgjohej fishkëllima dhe tymi do të merrte udhë, — tha Kujtimi duke vënë maskën dhe eci drejt ballit të frontit.

Limi hoqi kapelen ku kishte fiksuar llampën dhe rrotulloi dritën nga ajo anë që shkoi Kujtimi, por tymi i dendur

i përpiu rrezet e dritës. Pas pak dëgjoi një shkrim ajri. «Vërtet tubi paska qenë i mbyllur», — tha Limi me vete i habitur.

— Ai ndihmësinatori i turnit «Vrulli» që punon në këtë nënkat do varur me kokën poshtë, — tha Kujtimi kur u gjend pranë Limit. — E ka përthyer tubin dysh dhe e ka lidhur me tel. Tani lypset të presim gjysmë ore.

— Luani është djalë i mirë dhe punëtor i zellshëm, — tha Limi.

— Edhe i zellshëm, ë!, — foli Kujtimi si me vete. — E njeh mirë ti?

— Të mos e njihja, nuk do të flisja, — ia pat Limi. — Zaten gjithë minatorët e turnit «Vrulli» dhe «Hovi» janë të shkëlqyeshëm. Edhe të turnit «Sulmi» janë të mirë, përveç grupit tonë...

— Dhe nuk i vë faj atij ndihmësinatorit që ka mbyllur tubin?!, — pyeti Kujtimi i habitur.

— Nuk e ka bërë me qëllim. Ndoshta e ka loqur gjumi, i thonë turn i tretë. Ka harruar, — tha Limi.

— Ti flet sikur të ishe nxënës i Zizit, — tha Kujtimi.

— Pse, si është Zizi?

— Mundohet të pajtojë të kundërtat, — tha Kujtimi.

— Unë nuk e kisha fjalën aty, — foli Limi disi i fyer, pastaj vazhdoi: — Demi thotë se grupi ynë ka vetëm tre minatorë të vërtetë.

— Cilët na qenkan këta sipas Demit?, — pyeti Kujtimi.

— Ju, Agron Lama dhe vetë Demi. Gjithnjë kam dashur t'ju pyes, përse keni lejuar t'ju hedhin turnet dhe brigadat e tjera?

— Pse na e paşkan hedhur?

— Sepse na kanë fërfluar¹⁾ në grup fundërrinat!, — tha Limi.

Kjo fjalë i ra Kujtimit si bombë. Buza me majë iu përvesh, në ballë iu formua një xhungë rrudhash dhe vetullat iu ngritën hark.

— Ti, Lim, ngutësh edhe në veprime, edhe në mendime.

1) flakur, hedhur.

Nuk i përtyp ato që thua. Shpeshherë nxjerr bollgur, nganjëherë edhe helm, — tha duke tundur kokën. Kush na qenka fundërrinë sipas teje?!

Limi u pendua për fjalën e pamatur e deshi të justifikonte atë që nxori.

— Ja, për Zizin thatë vetë se përpiqet të pajtojë të kundërtat. Ashtu është Zizi, e kam dëgjuar në tërë ato diskutime, — tha. — Mbron edhe të gabuarit, edhe ata që kanë të drejtë. Ramë Dushku është analfabet dhe me paragjykime. Alushenkoja e gjeti vendin... Sherifi është gjaknxeh-të e hakmarrës. Zhagan Dhoga aventurier. Qenan Qesati hilexhi e dembel. Ata që i kanë hequr qafe dhe na i kanë përplasar neve si barrë nuk kanë vepruar drejt, edhe ju që i keni pranuar nuk keni bërë mirë.

— Të gjithë shokët që përmende i kam kërkuar unë. Atë fjalën fundërrinë, të mos ta dëgjoj më! Rama rrjedh nga një familje e varfër fshatare. Ka faj ai që është analfabet dhe me paragjykime? Kush duhet t'ia shtrijë dorën Ramës? Ne, shokët e tij. Edhe Zizi rrjedh nga një familje zejtare e varfër. Qysh fëmijë ka vuajtur për bukën e gojës. Skamja e ka bërë të druajtur, t'u frikësohet kokëçarjeve, të zgjedhë rrugën e pajtimit edhe atëherë kur duhet të ngrejë grushtin. Sherifi zbriti nga malësia. Bashkë me sinqeritetin dhe burrërinë e malësorit solli me vete edhe sedrën delikate, shpirtin e hakmarrjes. Nxehet shpejt, ftohet ngadalë. Për Qenanin s'kam ç'të flas, e di vetë. Pra këta nuk janë fundërrina, po njerëz të klasës. Mua më vinte shumë më rëndë kur fliste ndonjë brigadier ose përgjegjës turni me gjuhën tënde. Ndaj bashkë me Agronin kërkuam që të vinin tek ne. Unë kam besim te vetja e te njerëzit. Këtë besim ma forcon edhe përvoja. Disa nga punëtorët pararojë janë bërë të tillë këtu, në minierë. Krahas luftës për të nxjerrë qymyr, ne duhet të punojmë me veten dhe me njerëzit. Si thua ti? T'i hidhnim në rrugë të madhe?! Socializëm do të thotë dashuri për njerëzit, punë me njerëzit, luftë për njerëzit. Megjithatë nuk pajtohem me ty kur merr në mbrojtje një ndihmësinator, i cili në rastin tonë nuk tregon dashuri as për punën, as për veten, as për shokët. Ai nuk ka mbyllur vetëm sonte tubin e ajrit, këtë e ka bërë

edhe javën që kishte turnin e parë. Mbrojtja më e mirë për të është qëndrimi kritik ndaj huqeve, puna këmbëngulëse me të, jo shfajësimi sentimental!

— Ndoshta nuk e duron dot zhurmën që shkakton tubi i ajrit të komprimuar, — tha Limi.

— Të kalitë durimin. Për këtë delikatesë ai rrezikon veten dhe shokët. Mund ta ketë bërë pa qëllim të keq, po veprimi është aq i dëmshëm sa edhe një punë armiqësore! Minat hapin mazgalla në thellësi të dheut. Ai që është struktur me miliona vjet çlirohet. Nga të çarat e thella çlirohet gazi karbonik, dioksid karboni. E di ti, Lim, — foli Kujtimi si me vete, — ndoshta pse fëmijërinë e kam kaluar i vetmuar dhe mësova të flisja me objekte pa shpirt, më ka mbetur ky ves, apo zakon, edhe sendet i shikoj si të gjalla. Kur hyj në galerinë e errët, më bëhet sikur i dëgjoj gazrat që flasin me zërin e mefshtë e pregatisin komplete.

— Kujtim, — e ndërpreu Limi, — sa më ngjan me një mësuese të letërsisë që kisha në malësi! Ajo i bënte me gojë edhe sendet, bile edhe ato që nuk i shikojmë me sy. Kaq lehtë më futen në tru ato që m'i thua...

Kujtimi e ndërpreu, se e kishte shumë bezdi ta lëvdonin.

— Lim, të këqijat, nëse nuk flasin, veprojnë.

Fjollat e tymit të fundit po ngjiteshin oxhakut. Galeria ishte plot qymyr, ndaj ata filluan të mbushnin karelin.

Pas dy orësh u djersitën kaq shumë, sa që kominoshet u bënin shllap-shllup. Limi, të cilit i ziente koka nga vapa, hoqi kapelen bashkë me llampën e deshi ta varte në një kasë me dritën andej nga punonte. Kujtimi i shikoi qortueshëm, por nuk hapi gojë. Limi buzëqeshi: «Lëre të qëndrojnë kapelja mbi kokë, — mendoi ai me vete, — ndryshe do të fillojnë të flasin copat e qymyrit. Ky Kujtimi kurrë nuk të fyen. As të bërtet. I zbulon të metat te tjetri, pastaj larg, larg tregon një mesele. Qëllon samarin që të marrësh vesh kali».

Në këto mendime Limit iu kujtua një ngjarje:

«Punonin në turnin e parë. Sapo bënë potat, Limi zhvldhosi matrapikun nga tubi i ajrit dhe u zhdruk në errësirën e galerisë.

Rama, që punonte një kat më poshtë e që i kishte pësuar difekt matrapiku, u ngjit te Kujtimi e i kërkoi mjetin.

— Jepja, Lim, — i tha Kujtimi ndihmësit duke vënë këmbën në pot.

Limi iu kthye Ramës:

— Ku e ke matrapikun tënd?

— Nuk punon dreqi, qoftëlargu ia ka prishur zorrët.

— Sa keq, — ia pat Limi, — nuk ta jep. Ti nuk di të punosh, i keqpërdor veglat. Do të na e prishësh edhe tonin.

— Lim, jepja matrapikun!, — i tha përsëri Kujtimi.

— Ma morrën ata të galerive në oxhakun përtej.

Meqë ato galeri ishin larg, Rama u ngjit në katin sipër.

— Ishalla nuk ia japin!, — tha Limi.

— Përse?, — pyeti i habitur Kujtimi.

— Ky Rama mburret shumë, do të na e kalojë. Prandaj nuk ia dhashë matrapikun. E fsheha në katriazh. Fundja matrapiku është yni, ne e kemi në dorëzim.

— Jepja shpejt!

— Tani? Kam turp.

— Sa mirë ke bërë që ke ardhur në minierë!, — tha Kujtimi.

— Përse paskam bërë mirë? Ç'lidhje ka kjo me matrapikun?

— Sepse disa, kur hyjnë këtu, kanë shumë lakra në kokë. Lakrat groposen në këto thellësi. — Kaq foli Kujtimi.

Ndihmësi, që e dinte se minatori i tij nuk i duronte llafet gjatë kohës së punës, heshti.

Pas punës, kur po ngjiteshin, pyeti:

— Thatë se njerëzit, kur hyjnë për herë të parë në minierë, mund të kenë lakra në kokë, të cilat i varrosin në këto thellësi. Unë kam lakra?

— Ke, — iu përgjigj Kujtimi.

— Si ka mundësi që njeriu të ketë lakra në kokë?

Kujtimi, edhe pse e kuptoi se në pyetjen e tjetrit kish-te diçka tallëse, diçka provokuese, nxitje për shpjegim, nuk e bëri veten. E mori si pyetje të zakonshme dhe shpjegoi sipas mënyrës së vet.

— Disa që kanë ardhur prej fshati, — tha ai, — dikur

kishin një arë rrethuar me gardh. Arës i futën traktorin. Edhe pse kësaj arë iu shkulën hunjtë e gardhit, hija e tyre ka mbetur në mendjen e pronarëve. Gardhiqet u dogjën, kurse në mendje gjallojnë. Ara që jepte bukë jo gjithnjë, bile asnjëherë nuk ua siguronte bukën të zotërve. Tmerrri i urisë e bënte pronarin e arës që çdo mëngjes e mbrëmje, ndoshta edhe në mesnatë, të kontrollonte mos ndokush ia lëvizte gurin e sinorit. Dyshimi e brente. Nevoja e cyste t'ia zgjeronte kufijtë arës. Vetëm një pëllëmbë, vetëm një hap, sikur edhe në dëm të atij tjetrit. Edhe për një rrëke uji për vaditje ishin gati t'i hidheshin në grykë njëri-tjetrit. Të kacafyteshin si ujçit. «Imja siguron bukë për kalamanj. Imja siguron lecka për të veshur. Imja është peri ku varet jeta. Këto hije të zeza, si plevit në mushkëri, ruhen. Edhe pse të zbeta, ato lëvizin, gjejnë skuta të errëta. Këto hije kanë përshkuar muzgun e shekujve dhe si mallëkim u janë lënë breznive trashëgim. Ato nxjerrin krye herë në një formë, herë në një formë tjetër. Edhe pse janë të mefshta, janë hije të gjalla të së keqes. Ato zvariten në disa dhe shkaktojnë andralla të vockla dhe, po t'u favorizohen kushtet, bëhen burim shqetësimesh të mëdha.

Konkretisht, njëri në minierë fsheh thikën e matrapikut sepse e quan «imja» dhe nuk dëshiron t'ia japë atij tjetrit. Koha kalon, ai harron vendin e fshehjes. Në këtë rast jo vetëm që ka penguar shokun në prodhim, po edhe veten, sepse gjithë prodhimi shkon në hambarin e përbashkët. Sa më shumë të ketë ky hambar, aq më shumë do të kemi dhe më mirë do të jetojmë unë e ti. Thika e matrapikut mund të kushtojë lirë. Po mendo se punën që do të kishte bërë shoku me matrapik për gjysmë ore, me kazmë nuk mund ta bëjë as për katër-pesë orë. Brenda kësaj kohe ai mund të kishte nxjerrë aq vagona me qymyr, që do të ishin të barabarta me qindfishin e çmimit të thikës.

Pra imja është zhdukur si pronë, ka lënë unin si hije. Të gjitha këto hije që errësojnë sadopak dritën e arsyes së vërtetë, figurativisht mund t'i quajmë lakra, të cilat lypsen shporrur prej kokës së njeriut që të mos kthehet koka në një lakër të qelbur...».

Fjalët e Kujtimit në fillim i ngjanin Limit me saçme

që e bëjnë lëkurën shoshë, që djegin, përcëllojnë. Se përcëllonin, ndaj nuk harroheshin lehtë, linin mbresa të thella.

Dalngadalë, duke parë si fliste Kujtimi, si sillej, edhe Limit, si shumë minatorëve, iu ngall një dëshirë e madhe për t'i ngjarë atij.

Thuhej se Kujtim Kreshpa bashkë me Dem Qesatin merrnin në grupin e tyre gjithmonë punëtorë, për të cilët ankoheshin brigadat ose turnet dhe i kishin kthyer në minatorë të vërtetë. Rama thoshte me gojën e vet: «Isha një copë trung i palatuar», ndërsa Sherifi: «Nuk duhet të më quanin Sherif, por Kanun Malësia», edhe Zizi e ndiente se kishte ndryshuar, megjithëse ende kishte shumë për të luftuar te vetja. Kujtimi nuk ia kursente ndihmën.

K R E U XII

Qenan Qesati që nga ngjarja me Idanikovin, kishte bërë kthesë.

Tek ai kishin ndikuar edhe faktorë të tjerë. Kur ikën specialistët e huaj, Idanikovi që largohej i dëshpëruar se nuk arriti as të helmonte ndonjë mendje, të sabotonte punën në minierë, u tha inxhinier Vangjushit dhe Yllit:

«Më dhimbsemi ju të dy. T'ju komandojnë punëtorët, t'u japin mend ata universitarëve, është shumë e rëndë! Jua qaj hallin. Keni për të vuajtur shumë. Të gjithë keni për t'u katandisur në ditë të hallit».

Në përgjigje të kësaj ata së bashku me minatorët të elektrizuar nga ndjenjat patriotike, nga vetëmohimi revolucionar dolën me angazhime të reja për normat, për shfrytëzimin e mineralit. Shpërthyen shpikjet dhe racionalizimet, natën e bënin ditë për t'i dhënë shoqërisë sa më shumë.

Këto të gjitha e bënë Qenanin dhe ndonjë tjetër që t'i vinte gishtin kokës.

«Duhet vullnet, thonë shokët, por vullneti nuk blihet në pazar. Po ata ku e gjejnë vullnetin? Te vetvetja! Të gjithë janë të lumtur, të gëzuar. Janë të nderuar, se derdhin djersë. Unë zvarisem si krimbi, se më dhimbset djersa. Epo

nuk është gjak kjo e shkretë djersë! Edhe gjak sikur të ishte... Sepse më dhimbset djersa, m'u afrua ai urith Izdajnikovi. Deshi të më blinte. Tani shokët po më trajtojnë mirë. Veç sepse më shikojnë me gjynah. E përse të më shikojnë ashtu?! Ç'më mungon mua?». Kështu pat monologuar Qenani dhe pas kësaj kishte shtuar përpjekjet.

«Pistoleta e prishur» — thoshin shokët midis tyre, — ka filluar të bëjë rrotullimet e para».

I vëllai, Demi, duke biseduar me të tjerët, kishte thënë: — Shpeshherë midis njerëzve dëgjojen fjalët: «Ato janë punë personale të miat, ose të tija ku tjetrit nuk i lejohej të fusë hundët. Këto nuk kanë asnjë kuptim në minierë. Edhe unë kisha gjynahe, po shokët diku duke më lëmuar, diku duke më pickuar m'i tëharrën barërat e këqija. Si unë kanë ndryshuar edhe shumë të tjerë. Ndryshe do të na villte miniera. Megjithatë prapë bëjmë ndonjë gabim të vogël. Unë nuk desha që Qenani të punonte në minierë, sepse detyra vëllazërore më pengonte të flisja hapur mbi të kaluarën e vëllait tim. Ky është një gabim, sedër feudale, siç thotë Kujtimi. Desha s'desha unë, Qenani u fut në minierë. Biografinë e secilit prej nesh e zbërthen galeria, edhe të Qenanit e zbërtheu».

Pas një kohe askush nuk e thërriste më Pistoleta e Prishur, siç ia patën vënë ditët e para kur i bënte bisht punës, por Pistoleta e Riparuar. Te Qenani po lindnin disa cilësi, pa të cilat minatori nuk mund të quhet minator.

Po, nëse në punë, në sjelljet dhe qëndrimin me shokët po përsosej si minator, në familje, të mos themi ishte mulla Qenani, një gjysmë xhahili ishte.

E shoqja, Sabrija, edhe pse kishte bërë katër kalamanj si katër pëllumba, ishte e shëndetshme, ruante freskinë e malësorese së këndshme. Në fillim u rregullua në punë si banakiere në një bufe. Por nuk ishte plotësuar muaji kur Qenani e nxori andej.

«Sarhoshët të të shikojnë llërët e bardha!, — i tha ai. — Nuk duroj! Pa punë të qëndrosh, atje kurrë!».

Sabrija që ç'i shihte syri ia bënte dora u rregullua në trikotazh. Qenani u rehatua, sepse atje punonin vetëm femra.

Minatorët organizonin mbrëmje të shpeshta. Qenani ishte i pari në tavolinë, i pari në valle.

Tetë Marsi po afronte. Një pasdite në shtëpinë e Kujtimit u mblodhën Sosja, e shoqja e minator Sherifit, Shpresa e nja dy gra të tjera.

— Zanë, Qenanin kot e quajnë Pistoletë e Riparuar, — tha Sosja, — hala ka nevojë për riparim. E mbyll të shoqen në shtëpi, vetë nuk lë mbrëmje pa shkuar, hidhet në valle si ndonjë nëntëmbëdhjetëvjeçar.

— Bile na shtrëngon edhe dorën gjatë valles, — tha Shpresa, e shoqja e Zizit.

Zana qeshi.

— Mos qesh, Zanë, — vërejt i Sosja, — është për të qarë. Më dhimbset Sabrija, duhet të bëjmë diçka.

— T'ia rregullojmë samarin Qenanit, — tha Shpresa.

— Ashtu kemi vendosur, — shtoi Sosja.

*

*

*

— Kujtim, — i tha Zana të shoqit në mbrëmje, — shoqet kanë vendosur t'i punojnë një rreng Pistoletës së Riparuar.

— Çfarë rrengu?

— Ai sillet si xhahil me të shoqen. Edhe pazarin për të gjithë javën ia ngarkon djalit të madh, vetëm të mos ia shikojë bota Sabrijen. Ajo ka mangut vetëm ferexhenë.

— Vërtet ashtu sillet?

— Ka ardhur në mbrëmje ndonjëherë me Sabrijen? Jo.

— Më ka rënë në sy kjo gjë. Kam biseduar me të e më ka thënë se Sabrija i urren mbrëmjet. «Është matufepsur, — më tha, — u qorrua duke thurur triko».

— Mbulon të vërtetën, mos i beso.

— Ke të drejtë, jemi marrë me probleme të tjera, kurse këto gjëra i kemi lënë pas dore.

— Dëgjo!

— Fol!

— Në mbrëmjen e parë që do të organizojmë, Sosja do t'i shkojë Qenanit në shtëpi. Pak më vonë do të venë edhe

të tjerat. Shoqet do të marrin me vete magnetofonin. Unë do të shkoj të marr Sabrijen në punë dhe ta shpie në klubin «Minatori», ku do të organizojmë mbrëmjen.

— Jo ta nxjerrësh prej pune.

— Çdo gjë është rregulluar.

— Kur do ta bëni këtë?

— Me rastin e 8 Marsit, këto ditë.

Kujtimi qeshi.

Zana i shpjegoi Kujtimit me hollësi planin që kishin bërë gratë e minatorëve.

— Hajde ç'do të qeshim, — tha Kujtimi. — Mrekullia vetë. Sosja i organizon këto «programe» për burrat fatnatikë?

— Ajo dhe ne të gjitha, — u përgjigj Zana.

*

*

*

Atë të shtunë pasdite minatorët e turnit «Sulmi» pregatiteshin për mbrëmje. Sabrije Qesati punonte në turnin e dytë.

Bukuria kishte shpënë në kinema katër djemtë e Qenanit. Qenani po rruhej pranë pasqyrës së madhe duke fishkëlyer. Tingëlloi zilja. Ai hapi derën. Kur pa Sosen me dy çanta të mëdha në duar, hapi sytë duke kthyer nga mysafirja anën e rruar të faqes e duke u munduar të fshih-te anën tjetër të sapunosur.

— Urdh... Urdhëroni! Më falni, jemi rrëmujë, ajo është në punë, kurse unë..., — foli i hutuar Qenani.

— Cila është ajo që qenka në punë?, — pyeti Sosja.

— Gruaja ime, pra, është në punë.

— Nuk ka emër gruaja jote? Nejse. Më kanë ngarkuar të siguroj verë të zezë. Më ra rruga këtej. Ju e gjallëroni mbrëmjen. Por ç'e do, sonte është mbrëmje thjesht familjare. Mbrëmje çiftesh.

Qenani harroi se e kishte njëren faqe me shkumë sapuni.

— Erdha t'ju lutem të qëndroni sonte me fëmijët, — ndërroi bisedë Sosja. — Sabrija do të vijë në mbrëmje.

— Është matufepsur ajo, nuk i honeps mbrëmjet.

— Mirë, mirë, atë punë e rregulloj unë. Pa provoje njëherë këtë verë, kushedi a do të ma pëlqejnë gratë?

Qenani ngriti shishen:

— Kajmak qenka, — tha ai duke përshkuar, me dorë, buzët e cila iu zhllye me shkumbë sapuni. Iu afrua pasqyrës së madhe duke folur: — Verë e mrekullueshme. Të dyja çantat janë me verë të tillë? U kënaqkemi sonte.

— Rruhu më shpejt, çoje edhe ndonjë gllënjë, se sonte s'ka për të ta puthur buza këtë verë. Do të qëndrosh me fëmijët.

— Fëmijët s'kanë nevojë për kujdesin tim. Më i vogli është pesëvjeç, më i madhi është dhjetëvjeç. Pastaj Sabrija nuk vjen në mbrëmje sikur t'ia heqësh kokën, le që ajo punon në turnin e dytë.

— Punën e Sabrijes na e lër neve, ajo do të vijë sonte në mbrëmje!

Qenani u hutua. Hoqi briskun me rrëmbim, po preu një lyth të vockël poshtë veshit. U zemërua dhe, pa e kthyer kokën prapa, shtriu dorën e mbërtheu shishen e verës.

Tingëlloi zilja dhe hynë me zhurmë gratë e tjera.

— Uuu, edhe Sosja qenka këtu!, — tha e shoqja e Zizit gjoja e habitur.

— Ç'e keni atë sënduk të bukur?, — pyeti Sosja gratë.

— Magnetofonin, — iu përgjigj Shpresa, pastaj pyeti: — Kush e piu shishen e verës?

— Qenani, — u përgjigj Sosja, — racionin e vet.

— Nuk më ka shijuar ndonjë verë si kjo, — tha Qenani. Shpresa shtypi butonin, nga magnetofonin fluturuan tingujt gazmorë të një valleje tiranase.

Qenani fshiu fytyrën me peshqir. Këmbët i lëviznin sipas ritmit të muzikës.

Afërdita, e shoqja e Demirit, nxori edhe një shishe verë:

— Çoje edhe një herë, — i tha ajo Qenanit.

Qenani lëpiu buzët e gjithnjë duke mbajtur ritmin tha:

— Një shishe e mbarova, s'ka kuptim më...

Gratë mezi mbanin të qeshurin.

Qenani s'e mbante fort pijen. Vera po e bënte çakër-
qejf.

— Kunat, — i tha Hana, — tregona si të gjetën besimtarët duke pirë verë atje në livadhet e gjelbra.

— Shëëët! — Qenani mblodhi buzët dhe vuri gishtin mbi to.

Shpresa shikoi orën, pastaj ia bëri me shenjë Soses, e cila shpalosi shaminë:

— Pistoletë, ma jep dorën!, — i tha ajo.

Ai mezi priste. Filloi vallja. Gratë e minatorëve e futën në rreth. Vallëzonin të gjitha. Diles i dridheshin supet prej të qeshurit. U hap dera e apartamentit, hynë Zizi, Rama, Limi, Agroni dhe dy minatorë të tjerë.

Qenani shtangu në vend.

— Ne pregatitemi për mbrëmje, kurse këto e paskan filluar herët!, — tha Sherifi.

— Jepi, Pistoletë, — thirri Sosja, e shoqja e Sherifit. Qenani vari kokën, u mënjanua.

Minatorët qëndruan pak. Kur po dilnin, Qenani i pyeti:

— Nuk po më ftoni në mbrëmje?

— Ti e di se është mbrëmja e 8 Marsit, — u përgjigj Zizi. — Pyet shoqet!

— Vetëm gratë bashkë me burrat e tyre, — tha Hëna, — është mbrëmje çiftesh.

— Edhe ti, kunatë?!, — pyeti Qenani.

Askush nuk u përgjigj.

Qenani i përcolli gjer te shkallët. «S'kam ç'bëj, — tha ai me vete, — o duhet të shkoj të marr gruan e të vete me të bashkë, ose të mbyllem brenda katër mureve».

Qenani ende luhatej në mëdyshje, kur erdhën fëmijët. Ai u vesh me të shpejtë. I porositi të hanin darkë, të flinin dhe vetë doli me nxitim.

Kur i thanë në trikotazh se Sabrijen e kishte marrë dokoreshë Zana, Qenani u bë si i çartur. «Ma paskan punuar. Njeriu, sa rroka, mësoka. Për mua paskan mbetur t'i mësoj të gjitha në burrëri. Sabrijes nuk do t'ia fal. Njëqind herë u kam thënë shokëve se ajo nuk i honeps mbrëmjet. Po sikur të mos ketë shkuar në mbrëmje, — e cyti një mendim i lig. — Atëherë ç'deshi. Zana Kreshpa këtu?». Po-

thuaj duke bërbelitur vaji në pallatin ku rrinte i vëllai. Meqë nuk gjeti njeri, u nis për në klubin «Minatori». Iu turbullua gjaku. Sikur iu zu frymë kur pa Sabrijen e tij të bukur midis grave dhe minatorëve. U mat të kthehej. Po Sosja që iu gjend pranë papritur, ia futi krahun dhe e tërhoqi pranë tryezave. Ia mbushi një gotë:

- Për të mirë, Pistoletë! Gëzuar.
- Ah, djall me brirë, — rënkoi Qenani.
- Sonte je bërë tamam minator, — ia ktheu Sosja.
- Ah, djall me brirë, — foli dhe qeshi me pahir Qenani.

PJESA E DYTË

KREU I

Kishin kaluar pesë vjet.

Edhe pse Dem Qesati e shikonte me dyshim kthesën e «punëtorëve të vështirë», siç i quante ai Qenanin, Zizin dhe ndonjë shok tjetër të grupit, sekretari i organizatës së Partisë për turnin, Kujtim Kreshpa, dhe komunisti Agron Lama mendonin krejt ndryshe. Ata bashkë me shokët luftonin edhe për flamurin e minierës.

Qindra punëtorë shkulinin me rrënjë shqopat dhe bushin. Ndërtonin tarraca.

Ai mëngjes pranvere sikur ishte zgjuar nën sinjalin e një alarmi. Sythet e kumbullave dhe të manave po shpërthenin në një blerim të mbyllët dhe të vezullueshëm. Thannat rrëzë kodrave ishin veshur me të verdhë. Rrezet e para të diellit përthyeshin mbi sipërfaqen e rezervuarit.

Mbi digën e lartë të rezervuarit të fermës ecnin minatorët që kishin dorëzuar turnin. Hijet e tyre të gjata vallëzonin mbi sipërfaqen e rezervuarit.

Atë kohë Kujtim Kreshpa doli prej mbledhjes së komitetit të Partisë për minierën. Kaloi pranë hotelit të beqarëve. Nga një dritare gjysmë e hapur dëgjohej një zë. Ai u ndal e dëgjoi:

«Revolucionarizimi i mëtejshëm i tërë jetës së vendit nuk mund të kuptohet pa thellimin e revolucionit ideologjik e kulturor...».

Kujtimi buzëqeshi. E njohu zërin metalik të Ramë Dushkut. Lexonte ngadalë, sikur çdo rrokje, çdo shkronjë të ishte një llampë e fuqishme si ato që ndriçojnë galeritë, që zbulojnë damarët e mineralit.

Kujtimi në mëdyshje të kthehej apo të vazhdonte rru-

gën, tundi kokën e buzëqeshi. Ndoshta u buzëqeshi lumturisë dhe kënaqësisë, se edhe Rama, ai minator i mirë që koha e errët e kishte lënë edhe analfabet, edhe beqar, me forca të shumëfishuara, me ndihmën e shokëve i ishte futur shkollës. Në fillim çdo shkronjë i ishte dukur si ndonjë kreshtë e thepisur, ku s'ia kishte marrë mendja të ngjitej, po vetëdija për nevojën e domosdoshme, detyra që i kishte ngarkuar kolektivi u kthye në ligj. Rama e zbatoi dhe fitoi. Tani kishte bërë kërkesë për t'u futur në radhët e Partisë. Veçan të gjitha librave, i pëlqenin pa masë edhe librat për fëmijë. Shokët qeshnin, pat qeshur edhe Kujtimi. Po Rama, gjak i kuq në fytyrë, me vetulla të rrudhura, thoshte:

— Në veprat gjej të sotshmen dhe të ardhshmen. Në librat për fëmijë gjej ato që nuk i jetova. Mos harroni se unë nuk kam fëmijëri. Kam kaluar menjëherë në burri.

Megjë Rama vazhdonte të lexonte (ndoshta mësonte fraza të tëra përmendsh). Kujtimi u shkund nga mëdyshja e vazhdoi rrugën. Atë mëngjes të qeshur vendosi të mos e priste autobusin. Flladi mëngjesor i pëlqente. Edhe pse goja i ishte bërë pelin nga cigaret dhe pagjumësia, ai mori rrugën përmes fushave për në qytet. Zbriti bregules e, kur ra në perimore, i ranë në sy një i ri dhe një e re. Djaloshi fliste, kurse vajza gërvishte tokën me majën e këpucës. Djali e pa Kujtimin, kapi vajzën për dore dhe u zhduk në pemëtore. Ishin Lim Thana dhe Bukuria, vajza me sy të mëdhenj dhe ëndërrues.

«Jeta, jeta! — Kjo fjalë përfshiu tërë trurin e Kujtimit si ndonjë melodi joshëse. — Të jesh zot i jetës, ngjan me një kopshtar të talentuar, i cili mbjell, kultivon pemë e lule. Ato shpërthejnë në mijëra ngjyra, mijëra vezullime. Të dehin me aromën e këndshme, të kënaqin me shijen e mirë. Duhet të jesh shumë i kujdesshëm. T'u qëndrosh mbi kokë luleve, fidaneve, t'i tëharrësh, t'ua shkulësh barërat e këqija, ferrat. Limi dhe Bukuria janë lule në shpërthim. Të dy kanë punuar në turnin e tretë. As duan t'ia dinë lodhjes. Limin e mundon tjetër gjë. Bëhet xheloz kot së koti. Ndoshta s'ka faj. Ai dreq Zhagan Dhoga, edhe pse i martuar, i var-diset Bukuries, hedh thumba, thur thashetheme rreth saj. Ajo, e re, e padjallëzuar, e pandeh si çdo minator dhe nuk ia

merr për keq, pandeh se bën shaka Zhagani. Mirëpo Limi...».

Kujtimi me këto mendime kaloi urën e telit e, kur doli në rrugicën midis arash, atje tej pa Dilen. Sepse iu kujtua sërish Rama. Pastaj mbledhja. Bajaziti e kishte quajtur: *Individualist. I vrazhdë me të gjithë. Mendjemadh. Mund të thuash edhe konservator! Ja, shokë, — kishte thënë Bajaziti, — Kujtim Kreshpa kërkon me këmbëngulje të pranohet në Parti Ramë Dushku. Cili është Rama, ju lutem shumë? Një ish-analfabet që gjer dje falej dhe agjëronte ramazanin. Thotë se ka ndryshuar, është punëtor i dalluar. Ta zëmë se është ashtu. Por këto nuk plotësojnë kriteret për të pranuar një njeri në Parti. Ta lëmë çështjen e Ramës. Të vazhdojmë me Kujtimin. Është i ashpër ndaj njerëzve që gabojnë. Mendjemadh deri në mospërfillje ndaj personelit inxhiniero-teknik. As drejtori, as ndonjë tjetër nuk guxojnë t'i flasin Kujtimin gjatë kohës së punës. Dëshën ta ngrinin me përgjegjësi në dikaster, Kujtimi refuzoi. Përse e bëri këtë? Të tjerët dinë më mirë, kurse ky do të dalë më i ditur. Prandaj propozoj që të mos figurojë në listën e anëtarëve të komitetit të Partisë për minierën.*

Kështu e kishte bombarduar nëndrejtori. Kujtimin i ishte ndezur gjaku. Shikimi i tij i përflakur kishte ndeshur në sytë zhbirues të drejtorit. Ai i kishte buzëqeshur. Ndoshta i ishte kujtuar edhe qëndrimi i tij kur e kishin propozuar nga minator në përgjegjësinë e drejtorit. Ajo buzëqeshje Kujtimin i ishte dukur si ndonjë melhem çudibërës që zbut pezmatimet, që mëlcon iritimet.

Kujtimi kishte dashur të ngrihej, po një komunist pararojë i turnit «Hovi» ishte ngritur më parë: *Kujtimi duket i vrazhdë, po kjo nuk do të thotë se ai është i tillë, siç u shpreh nëndrejtori, — tha minatori, — Cilin duan minatorët më tepër se Kujtim Kreshpën?! Nuk duhet ngatërruar natyra e mbyllur me mendjemadhësinë. Askujt më tepër se Kujtimin nuk i janë mirënjohës të rinjtë. Një të metë ka Kujtimi që nuk u vu në dukje e që duhej të vihej: hidhet i vetëm edhe në punë të tilla që kërkojnë bashkim forcash. Ndoshta ky është shkaku që disa kanë pandehmën e gabuar sikur Kujtimi kërkon të duket, të jetë një yll i rrallë i minierës, por këto janë dokrra. Si unë, si të gjithë*

minatorët revolucionar, edhe Kujtimi e quan minierën të vetën, për të i rreh zemra, ndaj nuk kursen asgjë.

Një teknik i turnit «Vrulli» ishte ngritur e kishte thënë: *Diskutimi i shokut Bajazit për Kujtim Kreshpën është tendencioz, madje do të thosha edhe hakmarrës. Marrëdhëniet e Kujtimit me personelin inxhiniero-teknik janë të shkëlqyeshme. Kujtimi ka një përvojë të gjatë në minierë, kemi mësuar dhe mësojmë të gjithë prej tij. Jam dakord me shokun Spiro që tha se pasionin e tij për t'i dhënë shoqërisë sa më shumë nuk e bashkon me shokët, sulmon edhe i vetëm. Shoku Kujtim ka forca të mëdha, këto të meta janë hiçgjë përpara vrullit, me të cilin punon ai.*

Një minator tjetër i turnit «Vrulli» kishte thënë se në kritikën e Bajazitit kishte rutinë. *Është ca liberal shoku Bajazit, ndaj ata që hidhen kundër çdo të mete i quan mendjemëdhenj!*, — kishte përfunduar minatori.

«Kritika e shëndoshë, — mendoi Kujtimi ndërsa doli në bulevard, — të kthjellon. Vë dorë mbi plagën në kohën e duhur dhe e shëron atë. Punët në minierë po shkojnë mirë, po unë nuk jam i kënaqur. Ç'dreq karakter kam. Gjithmonë nuk jam i ngopur. Përherë më bëhet sikur kemi edhe shumë për të bërë. Sa zhdukim një sërë të metash e plotësojmë boshllëqet, dalin të tjera.

Ja, shokët më kanë kritikuar se u hyj punëve i vetëm. Kanë të drejtë. Po ç'të bëj unë, kur punët kulturore kanë filluar të çalojnë?! Tamam në kohën kur u vunë në vijë, ia ngarkuam Demir Ullishtasit. Po Demiri, përgjegjës i grupit artistik dhe magazinier i depove të eksplozivit, është ngathtësuar...

Vërtet, përse ky dembelizëm, kjo rënie morale te një ish-minator i nëndheut? Ku avulloi ajo natyra gazmore e Demirit? Cili është shkaku? Nuk më brengos vetëm çështja e punës, por diç duhet të ketë Demiri! Çfarë të ketë?

K R E U I I

Kishte kaluar një kohë që kur Miho Gjelaci ishte futur në minierë. Ishte i matur në çdo veprim. Merrej me

studimin e personave. Po të dëgjonte se një minator do të ngrihej në përgjegjësi, Mihoja do të bënte çmos t'i afrohej atij që të fitonte miqësinë. Mirëpo minatorët qenqeshin shumë të çuditshëm, njerëzit që nuk iu dihej biografia, nuk ishin shumë të këndshëm në kuvendimet e tyre.

Pas kaq kohe po shfaqej sërish drama «Ajo dashuroi minatorin». Atë shfaqje e pa edhe Mihoja.

Ai kishte parë plot trupa diletante, por, kur pa se si luanin role ata njerëz të thjeshtë, që punonin të heshtur nën dhé, mendoi: «Ç'njerëz janë këta minatorët! Atje thellë të duken sikur dinë vetëm disa fjalë, sa për t'u marrë vesh me njëri-tjetrin, kurse në skenë! . . .» Atij po i topitej shpresa për të bërë diçka. Iu rrëqeth edhe mishtë nga ndonjë rrezik i mundshëm. Ndoshta do të qe zhdukur si hije, po detyra që i kishte ngarkuar Ortaku kohët e fundit ishte e prerë.

«Duhet të punoj dhe të hesht. Me kohë do të më afrojnë edhe mua. Jam i veshur si të gjithë me kominoshet e minatorit. E quaj veten të tillë. Me kohë do t'i shmangem çdo dyshimi. Si i tillë edhe mund të veprojmë më vonë. Tani s'bëj gjë. Iu afrova atij Petritit që ka punuar në naftësje-llës, por, sa mund ta bësh gurin të të thotë një fjalë, aq atë njeri të ndrëshme u jam afruar, për këta sikur kanë njëqind dryne në gojë. Dinë të flasin për revolucionin, për punën, po ku kanë punuar, ç'kanë nxjerrë atje, me ç'përqindje. . . , s'të thonë as gjysmë fjale. Megjithatë shpresat nuk duhen humbur. Jemi apo nuk jemi forca e tretë!». Kështu e ngushëlloi veten gjatë tërë shfaqjes. Doli andej i dërrmuar shpirtërisht.

«Ah, sa mirë e ndien veten ai Aziz Lënda. Nuk ndihet i huaj si unë. Si do të më vejë halli mua të mjerit! Grenza mund të thumbojë dhe t'i shkaktojë dëme një doçke fëmije, po ç'mund të bëjë thumbi i saj mbi korracat e një tanku! Ç'po mendoj kështu unë i marri! E krahasoj veten me çapaçulin Aziz. E ç'ka humbur ai nga përmbysja? E thoshte vetë: «Isha i mashtruar, i thashë të gjitha. . .». Dhe e liruan. Kurse unë nuk jam i mashtruar. Po të shkoja e të hapja zemrën para hetuesit, do të mohoja vetveten. Do të

ishte fundi më tragjik për mua. Se bota që më përket mua nuk është përmbysur siç është përmbysur në Shqipëri. Këto dihen, po ç'të bëj, unë nuk di! Fundja do të bëj diçka sa të më pranojnë andej në botën time. Biri i botës nuk të beson: *Ishe, ishe yni, të thotë ai, por kaq vjet midis tyre atje, ç'ke bërë? Apo të kanë bërë për vete dhe tani, të kanë hedhur si ndonjë bombë peshqesh për të zotin! Çfarë bëre!* Po, duhet të bëj diçka për ata dhe për vete».

Qëllimi për të cilin Mihoja kishte hyrë në minierë po kthehej në diçka zhurmuese. Sikur edhe mendimet rrap-tonin brenda dhe ngjanin me dhinë harrakate, e cila është ndarë prej tufe, është fshehur në dendësinë e fidanishtes dhe, sa herë matet të këputë një llastar, zilja në qafë i tingëllon. Ato ditë punonin në nënkatin e parë. Ndhimësi i tij, një topolak (Mihos i ngjante si ari), punonte si i ndër-kryer. Ndërsa kishin bërë minat dhe po tërhiqeshin në strehim, ndihmësi zbriti në shtresor, te vagonistët. Pas pak u ngjit e u foli minatorëve në strehim:

— Shokë, gjer tani kanë dalë në sipërfaqe vetëm tri-dhjetë vagona qymyr. Mendoj që kati i katërt dhe i pestë duhet të bëjnë edhe një herë minat. T'i japin forca. Kur të hedhim qymyrin tonë nëpër bunkere, t'u ndihmojmë atyre. Jeni dakord?

— Ngjitemi t'u themi atyre të katit të katërt dhe të pestë, — thanë dy minatorë të tjerë.

— Jo, ua them unë, — tha ndihmësi i Mihos dhe u ngjit oxhakut përpjetë.

Mihos nuk iu durua pa thënë:

— Djalë energjik ky ndihmësi im! E meriton emrin komunist që mban...

— Rizai është vetëm anëtar i rinisë, — shpjegoi një minator.

— Domethënë nuk është komunist?, — foli Mihoja.

— Edhe ne që nuk kemi dokument, — tha minatori i nënkatin të dytë, me zemër të gjithë jemi komunistë.

Kjo përgjigje iu duk Mihos sa thumbuese, aq edhe provokuese. «Si shumë po e zgjas llapën unë!», — mendoi ai me vete.

Ato ditë oxhaku katër dhe pesë duheshin shfrytëzuar

sa më shpejt, meqë presioni ishte tepër i madh. Minatorët e të dy oxhaqeve punonin në tërheqje. Prodhimi ishte i bollshëm. Minatorët tepër të gëzuar. Ishin zotuar që gjysmorëshin e plasjes së minave të mos futeshin në strehime, por ta shfrytëzonin duke u ndihmuar shokëve të oxhakut fqinjë ku minat bëheshin një orë më vonë.

Mihos i vinte plasje, se në atë gjysmë ore kishte rast të njihte njerëzit e nëndheut; tani edhe ai rast po i fluturonte. Në sipërfaqe merreshin me sport. Shumica shkolin në shkollë. Grupi artistik ia shmangte mundësinë për t'i grumbulluar të rinjtë rreth vetes. Në hotelin e beqarëve kishte vënë re se disa të rinj hapnin ndonjë metodë të gjuhëve të huaja, shfletonin fjalore.

«Duhet të përfitoj, — mendoi Mihoja, — vetëm në këtë pikë mund të tregoj se vlej diçka dhe mund t'u hyj në punë. Sa t'i grumbulloj, e di vetë si të veproj». Këto mendime ia kishin ndriçuar një fije shpresën.

Së pari hulumtonte të gjente një njeri që sipas porosive të Ortakut mund të ishte njeri për të.

Njëri prej manevruesve të sipërfaqes fliste pareshtur. Ai, edhe sikur t'ia mbyllnin gojën, me veshë do të fliste. Mihoja e kishte pikasur, i qëndronte pranë me marifet dhe mendohej të mësonte ndonjë gjë për njerëzit që merrte nëpër gojë. Herë pas here i afrohej me maturi. Llafazanin nuk kishte nevojë ta pyeste, ai fliste vetë. Mihos i interesonte të dinte diçka për minierën e re që do të hapej, meqë thuhej se do të ishte miniera më moderne e kohës. Në fillim iu prish qejfi, se manevruesi llafazan ishte edhe ca i trashë, megjithatë e vazhdoi me manevruesin «hiq e mos e këput». Por u bë helm e vrer kur mori vesh se manevruesin e kishin dërguar në një ndërmarrje tjetër, meqë komisioni provues e kishte gjetur të papërshtatshëm dhe të paaftë për punë në minierë, meqë ishte me të meta mendore. Materiali që kishte vjelë prej tij iu duk qesharak sidomos tani që mori vesh se ai ishte ashtu si ishte.

Mihoja vendosi t'i afrohej Zhagan Dhogës. Për një kohë të gjatë kishte studjuar dhe kishte arritur në përfundimin se, po t'i afrohej Zhaganit, binte në sy për keq.

Prandaj i kishte buzëqeshur nga larg dhe ia kishte mere-
metuar bisedat duke ia tundur kokën me dashamirësi. Por,
meqë koha po ikte, ai vendosi të bënte një hap më tej.

*
*
*

Një pasdite, sapo hyri Zhagani në autobus, hyri edhe
ai. Zhagani fliste vetë dhe qeshte vetë. Edhe pse nuk ia
vinin veshin ata të cilëve u fliste, ai nuk pushonte:

— Tani e kam rregulluar me një zogëz të njomë. E
orydhët është, kërthi. Akoma era qumësht i vjen. Ua ka-
lon atyre pesë biondeve që kam pasur. Ua kalon edhe
atyre dy bruneve me cipën e lëkurës të lëmuar edhe të
vezullueshme. Por ka një të metë. Nuk di të lozë. Unë dua
që femra të jetë si ngjalë.

— Zhagani, mbylle të shkretën, se na pështirose! Si
nuk more vesh xhanëm! Njëqind herë të kanë bërë rezil
përpara kolektivit, ti prapë me tënden. Edhe kafsha do të
merrte vesh, kurse ti!... Pastaj ankohesh përse kaq vjet
punon si ndihmës dhe nuk të bëjnë minator! — I shfryu
një ndihmësminator i ri.

— Rri, mor katundar, — ia ktheu Zhagani, — ku e
njuh botën ti. Fundja për minator nuk ma do qejfi mua,
edhe pse merret më shumë para. Jam qejfli unë, s'jam
për përgjegjësi!

Dy ndihmësminatorët që gjendeshin pranë Zhaganit
u ngritën dhe zunë vend më tutje.

Miho Gjelaçi që kishte zënë vend përpara, ktheu ko-
kën, i shkeli syrin dhe i buzëqeshi.

Zhagani u gëzua që gjeti një njeri, të cilit mund t'i
pëlqenin dërdëllitjet, e preku në sup e i tha:

— Gomarë, gomarë janë këta, — po Mihoja ktheu fy-
tyrën nga xhami për të mos rënë në sy të tjerëve se i
jepte muhabet. — Ku di dhia ç'është tagjia!, — llototiste
Zhagani. — Nuk merr vesh narja ç'vlerë ka ari. Si thua ti?
Vërtet, përse nuk kemi biseduar? Ti më pëlqen, më du-
kesh njeri me mend. Duhet të jesh usta i vjetër ti.

— Të them se nuk më pëlqen, gënjej atë që më dë-

gjon, gënjej edhe veten, — tha Mihoja me gojën puq me xhamin, — pastaj ti je i ri, të vlon gjaku.

— Syri im nuk gabon, — vazhdoi Zhagani, — më qafsh, a ke bërë qejf?, — pyeti ai dhe pa i dhënë rast të përgjigjej vazhdoi: — Më qafsh, më thuaj cilat të pëlqejnë, ato të shëndoshat me kajmak, apo belhollat?

Mihoja iu përgjigj me një fjalë italisht, pastaj frengjisht, që të dyja i improvizoi aty për aty.

— Frengu thotë: «Belholla të deh në vallëzim, kurse topolakja në krevat».

— E bukur, e mrekullueshme, sa bukur tingëllon kjo amerikançja!, — ia këputi Zhagani i ngazëllyer.

— Jo amerikance, — ndreqi Mihoja, — po frengjisht.

— Mersi, mersi, madmuazel... — filloi Zhagani.

— Sa bukur e shqiptoke frengjishten, — lëvdoi Mihoja me djallëzi, — ku e ke mësuar?

— Jam shejtan unë, nga të gjitha nga një çikë.

— Nëse ke pasion të mësosh gjuhë të huaja, të ndihmoj unë, — tha Mihoja.

— Paskë humbur kot. Punon me vëllaqkon dhe nuk ia thua! Përse nuk thua, a derëbardhë! Dinë edhe të tjerët këtu, por si e dinë, ranga-dranga. Sa gjuhë të huaja di?

— Di ca.

— I ke mësuar këtu, apo andej?

— Andej, këndej.

— Do të kesh bërë qejf, ato femrat e jashtme ia dinë mashkullit. Kurse këto tonat, kam pasur nja dy, belami...

«Qenka një sharlatan i pashoq, — mendonte Mihoja, — po s'ke ç'bën, vetëm njerëz të tillë mund të futësh në dorë. Të tjerët i preokupon interesi i përgjithshëm. Ah, ky interesi i përgjithshëm, ma plasi shpirtin. Vetëm ndonjë si ky Zhagani ka mbetur për ne...».

— ... Sykaltra, që thua ti, — vazhdonte Zhagani duke u munduar të kujtonte një shprehje që e kishte dëgjuar diku, — sykaltra ka diçka të ftohtë, po është e këndshme si akullorë. Kurse ato që kanë push në buzën e sipërme, janë, si të them, historike.

— Histerike do të thuash.

— E de.
— Ku do të zbrisni?
— Në stacionin e fundit.
— Më pëlqeke, qenke djalë i hedhur, fatkeqësisht unë do të zbres këtu.

— Ku?
— Në stacionin e parafundit. Plak njeri, do të hedh një gotë. Po deshe...

— Zbresim, a derëbardhë, gota dhe . . . (tha një fjalë të ndyrë) janë shpirti im. Në refuzofsha, më hëngërshin pulat e asaj dashnores topolake që e kam lënë përpara një viti.

Ata zbritën në stacionin e parafundit. Hynë në bufe. Mihoja porositi për vete një teke, kurse për Zhaganin një dopio. Nuk iu desh ndonjë mund i madh të njihje përfundimisht personin që pinte me të. Zhagani filloi vetë. Bile çiltërsia, me të cilin i fliste, e bëri Mihon të ishte më i matur. Meqë gjer atë kohë nuk kishte takuar edhe një të dytë si Zhagani që të fliste në atë mënyrë, dyshoi mos shtirej si i tillë.

Siç i thonë fjalës: Kush e ka mizën, ngre kapelen.

— Që thua ti, Miho, të quajnë Miho apo vetëm në minierë njihesh me këtë emër?

— Miho më quajnë, përse?

— Që thua ti, Miho, unë jam njeri i qejfit. Të tjerët mund të më marrin si të duan.

Mihoja porositi edhe një dopio për Zhaganin, duke menduar: «Nëse nuk më provokon, do të mësoj diçka, por, edhe nëse është i tillë, prapë mësoj diçka».

— Njerëzit mund të më marrin si të duan, — vazhdoi me të vetën Zhagani. — Unë nuk jam si Lim Thana, se përnjëherë kemi ardhur në minierë, ai e rreh lart, or vëlla, thonë se do të ngrihet edhe në përgjegjësi. Nuk e njoh. Është ai që e do shumë ai Kujtim Kreshpa dhe Agroni, Demi e ku ta di unë. Limi është bir dëshmori, helbete!

— Lim Thana është bir dëshmori?

— Po, edhe të tjerët, të gjithë njësoj janë ata. Ti nuk e di, se rri i veçuar. Më pëlqen, se je njeri që shikon punën tënde, ndaj mund të të hap zemrën. Pra, që thua ti,

njerëzit mund të mendojnë keq për mua. Nuk më bëhet vonë. Ika prej fshatit, se nuk më pëlqen jeta e fshatit! Kautandar, mo. Kurse unë (këtë ma kanë thënë disa) edhe pamjen, edhe shpirtin e kam qytetar. — Zhagani ngriti edhe dopion tjetër. — Ku e lashë? Po, ika prej fshatit. Mos kujto se më plasi barku për minierën. Jo, jo, le të punojë atje kush të dojë. Unë jo. Ika prej fshatit, u futa në një ndërmarrje, po më përcollën. Dëshën të më kthenin në fshat. Në qytet isha pa shtëpi, pa pasaportizim. Po të tregoj si vëllait, por ti...

— Gur varri, — tha Mihoja, po u pendua e shtoi:

— Shikoj punën time. Ndoshta është veti e keqe, po kjo është natyra ime.

— Ashtu më pëlqen mua, — vazhdoi Zhagani. — Pra, kur e pashë punën pisk, «përse të mos shfrytëzoj pamjen time të bukur?», — i bëra pyetje vetes. Fillova gjuetinë. Gjeta një nga ato pecogrosot. E dija se familja nuk do të ma jepte. E bëra fakt të kryer. E lashë me barrë. U informova ndërkohë dhe mësova se kush punon në minierë, pasaportizimin dhe banesën e ka të siguruar. Këto ishin dy kartat që luajta. Në minierë nuk deshën të më pranonin, futa njerëzit e gruas (kartën e parë). E rregullova. Edhe nja gjashtë muaj, i them lamtumirë minierës. Zë ndonjë punë për të qenë, ku të ketë sa më pak djersë e më shumë para. Para plot, femra plot.

«Djalë i zgjuar, të kam zili, — u mat të lëvdonte Mihoja, por u pendua e tha tjetër për tjetër:

— Ato janë punët e tua, s'përzihem. — Kurse me vete tha: «Më i matur, më me kujdes, Miho». — Për këto gjashtë muaj që dashke të qëndrosh në minierë, a dëshiron të ta mësoj një gjuhë?

— Toke!, — i zgjati dorën Zhagani. — Jo vetëm që do të mësoj mirë, por edhe do të të ndihmoj. Do të të sjell djelmoshat që kanë shumë qejf për të mësuar gjuhë të huaja. Ata marrin para me grushte, kuptohet edhe ty nuk të bie keq. Edhe unë për vete nuk kam për të të lënë pa gjë.

— Ty falas do të të mësoj.

— Nuk pranoj kurrsesi të më mësosh falas. Vetëm ta bëjmë me fjalë, të mos jesh i rreptë kur të mungoj ndo-

njëherë. Se unë, a derëbardhë, nuk mund të heq dorë nga gjuetia e biondeve, bruneve, ah, ato zogëzat! Brum!

Atë pasdite i zuri mbrëmja në bufe. Kur dolën, Zhagani ecte sa në një rën anë të trotuarit në tjetrën.

Mihoja, duke i buzëqeshur suksesit të parë, iu afrua stacionit të autobusave dhe u kthye në hotelin e beqarëve.

Pas një jave Zhagani i solli Mihos në dhomë pesë të rinj. Atij iu dukën të zgjuar dhe më se të zellshëm për të mësuar gjuhë të huaja.

Kalonin ditët, amatorët e gjuhëve të huaja po shtoheshin. Mihoja dhjetë minuta u mësonte fjalë e shprehje, dhjetë minuta shqiptim-përkthim. Nga njëzet lekë të rinj, e ngriti çmimin në tridhjetë lekë. Por të gjitha dhe gjithmonë vetëm nëpërmjet Zhagan Dhogës.

Pas ca kohësh filloi nga zbatimi i planit. Gjithmonë fjala ose shprehja e fundit e copës së leximit do t'i kujtonte Mihos një barceletë, një ngjarje. Fillonte të tregonte dhe të komentonte: «Hiçasgjë mos arritsha, pa gjumë i lë, — mendonte. — Nesër flenë në punë. Edhe nëse nuk flenë, nuk kanë mundësi të punojnë sa duhet. Do t'i qortojnë, do t'i kritikojnë. Nëpërmjet Zhaganit do t'ua ushqej zemërimin. T'ua turbulloj ndjenjën e hakmarrjes. Kështu fillojnë këto punë, treshi bëhet pesë, dhjeta njëqind dhe...». Ai me sytë e mendjes shikonte njerëzit e vet që sulmonin rrugët, që rrethonin institucionet. Shikonte flakë mbi dikasteret dhe zemra i refkëtinte nga një ndjenjë që e dehte dhe e dridhte.

Mihoja, edhe pse me sy gjysmë të mbyllur, mendonte të studjonte të gjithë ata që i vinin në dhomë. Planin nistor e filloi me fotografi gjysmëpornografike. Ia tregoi Zhaganit disa nga këto e ai u mrekullua. Mihoja i linte gjoja i shkujdesur diku mbi tryezë a dritare që Zhagani t'i përlante, i bindur se llafazani s'do t'i mbante ato vetëm për vete. Dhe vërtet ashtu ndodhi.

Dy të rinj të padjallëzuar ato lloj fotografish i morën si diçka zbavitëse, mirëpo i treti, Rrushi, e kishte mbërthyer për gjoksi Zhaganin:

— Ku e more këtë shëmtirë!, — i kishte shfryrë. — Edhe kafshët kanë qime e mbulohen, kurse këto! Nga janë

marrë këto fëlliqësira, mund të jenë marrë edhe gjëra të tjera...

— Të betohem, — i kishte thënë Zhagani, — i kam gjetur në themelet e një shtëpie të shembur. Bile i gjetën ca fëmijë, unë gomari, për t'u englandisur, bile për të demaskuar diçka të ndyrë... Thjesht për t'u englandisur si antikite...

Po Rrushi nuk e kishte lënë t'i shpinte gjer në fund dërdëllitjet, ia kishte marrë prej dore dhe i kishte grisur, po nuk e kishte bërë të madhe, meqë kishte kujtuar se vërtet mund t'i ishin gjendur në duar fare rastësisht.

Mihoja të gjithë kundërshtarët i shikonte jo si njerëz, por si ato kafkat e vizatuara në portat e kabinave të tensionit të lartë, me ndryshimin se në vend të mbishkrimit «Rrezik vdekje» lexonte: «Po preke, të piu e zeza».

Kur binte të flinte, fillonin ëndrrat, ca ëndrra që ndërpriteshin prej një makthi. Kafkat ishin personazhet kryesore të ëndrrave. Kafka me gojë të çaraveshura, kafka me dhëmbë të mëdhenj e të dalë jashtë, kafka me sy të zhbiruar, me gropa në vend të hundës, kafka me shumë mazgalla të errëta. Këto e dehnin. Nga çdo mazgallë kafke buçiste një zë, buçisnin shumë zëra. Pastaj pëlçisnin kafkat, që andej shpërthente një flakë e madhe me tym të zi. Përmes asaj flake e atij tymi dilnin plot njerëz të armatosur; të gjitha tytat e armëve i drejtoheshin Mihos. Sipër kokës së tij ngrihej një pllakat i ngjashëm me atë që kishte parë në bulevardin «Stalin». Mihoja lexonte i tmerruar: «Në këtë vend u vra spiuni dhe tradhtari...». Atij i dilte gjumi. I zihej fryma. Hapte dritaren përgjysmë. «Kjo është ëndërr, — thoshte me vete pasi qetësohej, — punët qëndrojnë ndryshe. Mua po më prin mbrothësia. Do të bëj atë që nuk arritën të bënin njerëzit e sërës sime».

K R E U I I I

Lim Thanà kishte depozituar një shumë të mirë lekësh në arkën e kursimit. Kur u ndanë apartamentet në pallatet e minatorëve, Limit i dhanë një hyrje të mirë.

Ai bashkë me Agronin, Demin, Zizin, Sherifin vajti në mobiljeri e bleu dhomën e gjumit, dy divane, stufën dhe bufenë për kuzhinën. I ngarkuan në makinën e minierës e drejt e në pallat. Zana, Afërdita, Sosja, Hana, Dilja ia rregulluan dhe vendosën çdo gjë në vendin e vet.

Atë mbrëmje, meqë ishte e diel, ia shtruan shokët në banesën e re. Në atë gosti, përveç minatorëve dhe grave të minatorëve erdhi dhe llampiste Bukuria. Edhe pse minatorëve nuk u kishte thënë Limi asgjë, shoqërimi i dy të rinjve i kishte bërë të mendonin se Limi dhe Bukuria do të përfundonin së shpejti në martesë. Bile u gufonte zemra prej gëzimit e u kënaqej syri kur i shikonin pranë njëri-tjetrit. Secili atë mbrëmje pat menduar se ishin çifti i mrekullueshëm, sikur të kishin lindur për njëri-tjetrin.

Me gojë nuk e thanë, por, sa herë cakrroheshin gotat, kryqëzoheshin edhe shikimet. Sa herë i buzëqeshnin Limit, i buzëqeshnin edhe Bukuries. Ky mendim ua bënte edhe më të hareshëm gazmendin.

Fisarmonicisti, përgjegjësi i grupit artistik për minierën, Demir Ullishtasi, tha:

— Shokë, mua më ka marrë shëndeti së prapthi, lëngata po më gërren, por, kur është puna për Lim Thanën, ariu e galerive, duhet t'i them lëngatës «plaç!». — tha ai me sy të turbulluar, mbërtheu gotën dhe e ngriti me fund. — Shokë, mjaft dëgjuat dërdëllitjet e një të sëmuri, tani një valle për beqarët!, — dhe u shkeli syrin shokëve.

Rreth tryezës ishin edhe Dilja e Rama të pamartuar, por të gjithë shikuan Limin dhe Bukurien. Zizi ia shkeli syrin Limit.

Kënduan e vallëzuan.

Demir Ullishtasin po e zinte pija.

— Shoku Kujtim, — tha ai me gojën si të mbërthyer nga ngërçi, — lëngata është e poshtër. Është edhe e ndyrë. Shoku Kujtim, unë ty të kam vëlla. Të gjithë këta këtu i kam vëllezër. Jemi përleshur së bashku me shkëmbinjtë, kemi dalë fitimtarë, po lëngata më mposhti. Është plagë e vjetër kjo! Lëshon helm dhe ka për të më mbytur. Ruhuni prej lëngatës. I bini prapa, mos e lini të qelbëzojë! Ptu, çfarë qelbësire!... — Fjalën e fundit e tha në drejtim të

pacaktuar. Minatorët e tjerë nuk ia vunë veshin, se e pandehën vetëm si të dehur të zakonshëm, kurse Kujtimi e shikoi thellë në sy. Sëmundja e Demirit kishte filluar të kthehej në një farë misteri. Fjalët e tij ishin refleksi i një brenge të madhe që kalonte kufijtë e çdo sëmundjeje. Askush nuk dinte se ç'kishte.

Demiri filloi të lëshonte fjalë të shkëputura, kuturu:

— Demiri i poshtër... Po, ai, ai, ah, ç'qenka ai! Njeri më të ndyrë s'më kanë parë sytë. Lëngata, shokë, lëngata, Doktor! E ç'më duhet doktori kur njerëzit duhet të vijnë për kryeshëndoshë për ngushëllim... Më dhemb zemra! Aha, baba, baba! Limi le të trashëgohet, unë nuk këndoju më. E shkreta Afërditë!

E shoqja e Demirit uli kryet, pastaj shikoi Zanën për-vajshëm.

— Dua të pi! Dua të pi! Më jepni raki! Helmi le të mbytet me helm! Ah, sa i poshtër paske qenë mor ta... — Këto ishin fjalët e fundit të Demirit, pastaj filloi të villte. Limi e rregulloi në njërin prej divanëve.

Shokët ikën njëri pas tjetrit si të kishin bërë një marrëveshje të heshtur.

Bukuria mbeti pas, ngriti tavolinën e pastroi dhomën. Filloi të lante edhe enët. Limi që përcolli shokët gjer në qoshe të pallatit, u kthye. U kujdes bashkë me Afërditën për Demirin, të cilit i kërcisnin dhëmbët nga shtrëngimi me ngërç.

Nga porta gjysmë e hapur dukej trupi i bëshëm i Bukuries, e cila ishte përkulur mbi enë. Limi kroi zverkun. Femrat kanë intuitën e rrallë për të ndier edhe shikimet prapa kurrizit e nuk u shpëton asgjë, megjithëse nuk e bëjnë veten. Shikimet e djaloshit Bukuria i ndoqi edhe nga pasqyra. Hodhi fjollën e flokëve që i kishte rënë mbi fytyrë, i buzëqeshi Limit, pastaj mbylli të dy sytë çapkënçe. Ai veprim sa e gëzoi Limin, aq edhe iu duk si gjest jo i mirë: «Vajza duhet të jetë vajzë, — i çërriti një mendim i lig, — kjo as ruhet, bile mezi pret... Kështu nuk bëjnë vajzat e ndershme. Ku mjaullin, ka edhe maçok. Thumbat e Zizit për Bukurien dhe Zhaganin nuk janë shaka. Zhagani i vardiset. Përse e bën këtë? Sepse e di që te kjo mund

të... Lëshon erë këрма, pa shkon grenza». Pasioni filloi të binte. Zëri i mendimit të lig vazhdonte të gërvishte: «Vajza duhet të jetë ca e tërhequr, e mbledhur në vetvete. Jo, jo, Bukuria nuk është e tillë. Bukuria është e dashur, e sjellshme me të gjithë».

— Limi, — foli Bukuria duke larë duart, — enët i lava, lëri të kullojnë, pastaj i vër në bufë ashtu si i kishte renditur Zana. Hajde më përcill tani, — tha ajo duke u fshirë me peshqir.

«Kjo është e çuditshme, — mendoi me vete Limi, — nganjëherë të duket se është gati të të shtrohet në prehër. Pikërisht se është e tillë, unë nuk kam mundur t'ia them. Është aq e afërt, sa që çdo fjalë të duket e tepërt».

Ata zbritën shkallëve. Limi pa dashje u përplas me trupin e bëshëm e të lidhur të vajzës.

Bukuria nuk iu shmang: «T'i shmangesh tjetrit që e ke shok dhe e njeh mirë, — mendoi ajo, — është njëlloj sikur t'i thuash se ti je edepsëz, provokator, i pamoralshëm, domethënë e fyen. Tjetër është me ndonjë të pacipë, atij jam gati edhe t'ia përmbledh turinjve. Por Limi është shoku im më i ngushtë. Unë këtë e dua. Edhe ky mua».

Rrugës për në shtëpi Limi mendoi t'ia thoshte

— Buke, — ashtu e thërriste ai, — unë do të shkoj në plazh.

— Lum si ti!

— Kam menduar të shkojmë bashkë, po kushedi ç'thonë prindërit e tu.

— Ua themi, s'kanë për të më penguar.

— Vërtet ç'thotë syziu? Unë të përcjell nga puna në shtëpi, të vij të të kërkoj?

— Babai të do shumë. Ai thotë: *Jemi ne mekanikët, por të ishën të gjithë minatorët si Limi, ua kam zili.*

— Përse?

— «Kanë një shpirt dinamik, një vështrim të çiltër, — thotë babai, — të keqen dhe të mirën ta thonë ndër sy. Edhe ne nuk biem më poshtë kur e do puna, ia lllapangjeshim mu në fytyrë ndonjërit që i bën dredha punës, por ja, mundohemi të jemi më të matur, i zgjedhim fjalët. Limin e dua se është vullkan», — thotë ai.

— Buke, ne njihemi prej kohësh.
— Pastaj?
— I kam inat këto pastaj e pasandaj.
— Edhe unë i kam inat fjalët e tepërta.
— Ne duhet t'ia themi njëri-tjetrit ato që janë për t'u thënë.

— S'ka nevojë të flasim kur e dimë se ç'jemi. Zyrta-rizmat i urrej.

Limin prapë e breu ai mendimi i lig.

— Edhe unë e urrej mendjelehtësinë, — foli.

— Çfarë the, Lim, ç'lidhje ka ajo fjalë me bisedën tonë?

— Kot, kot. Më fal.

— Nuk kuptoj përse e the?

— Më fal, më erdhi kot, — tha Limi dhe iu afrua sa më pranë Bukuries.

Flakët e dy zjarreve sa më tepër lartësohen, aq më tepër i afrohen bashkimit.

Limi dhe Bukuria u hodhën në krahët e njëri-tjetrit. U puthën për herë të parë. Ato ishin çastet më të këndshme. Çaste të provuara për herë të parë.

*
* *

Në fund të atij muaji ngjau diçka që e turbulloi zemrën e Lim Thanës. Kishte dorëzuar veglat e punës, vajti te Bukuria të përshëndetej. Kur iu afrua llampisterisë, dëgjoi zëra brenda. U ndal e përgjoi:

— Përse e ke lënë punën, mor shok, — i thoshte dikujt Bukuria, — llampën e paske fare në rregull.

— Llampa është në rregull, po me zemrën e kam keq, — u dëgjua zëri i burrit. — Përse shtiresh sikur nuk merr vesh?!

— Ç'të marr vesh? Ti the se t'u fik llampa në galeri, erdhe për ta ndërruar, tani del se s'paska llampa gjë, por zemra. Mos e ke ngatërruar llampisterinë me klinikën?

— Ti e di, bën sikur je fare, ja, s'ka asnjëri, përse druhesh...

Limit iu turbullua zemërimi. Zgjati kokën sapak e, kur pa Zhaganin, deshi të hynte, por u rrëmbye dhe e mori me mend se do të bënte ndonjë skandal, ndaj iku pa dëgjuar se ç'u tha e ç'u bë më tej. Po të kishte qëndruar, do të shikonte se si Bukuria rrëmbeu kaçavidën dhe iu sul Zhagan Dhogës me tërbim. Do të kishte parë se si iku Zhagani nga sytë këmbët duke llomotitur me vete: «S'kam parë femër të tërbuar kësisoji!».

Limi të nesërmen u nis për në kamp.

*
* *
*

Zhagan Dhoga vajti në dhomën e Miho Gjelicit e i tha:
— Gati më gjeti belaja me atë Bukurien. I vajta në llamperi, ia solla rreth e rreth, u tërbua. Deshi të më godiste. Ishim vetëm për vetëm, do ta kisha kapur me pahir, po vura re Lim Thanën. Vetëm kurrizin i pashë nga sporteli, po mendova se mos dilte rreth e më zinte dorën, ndaj ika.

— Të pa Limi?

— Besoj se po.

— Dhe iku?

— Se më pa dhe më dëgjoi, prandaj iku. Ai e do Bukurien.

Mihoja fërkoj duart. Me vete: «Edhe kjo është një punë e mirë. Rastësisht, po sikur të bënim edhe diçka në këtë drejtim, nuk do të qe keq».

— Limi ku vajti, the se do të shkonte në plazh?, — pyeti pastaj.

— Po, në plazhin e Durrësit, — u përgjigj Zhagani.

Mihoja ra në mendime. Papritur u ngrit e u vesh.

— Ç'pate?, — pyeti Zhagani. — Të vjen edhe ty plasje se nuk e shtiva në dorë. Mos sot, nesër, a derëbardhë!

Mihoja nuk iu përgjigj, vetëm kur u bë gati, tha:

— Zhagan, do të më falësh, kam një punë, e paskësja harruar fare.

— Ah, skile e vjetër, — ia bëri Zhagani, — ke ndonjë takim?

- Edhe mundet.
- Sa thëngjill i mbuluar je! Mirë, mirë, bëj si të duash, vetëm më thua j'është bionde apo brune.
- Ezmerkë, — u përgjigj Mihoja dhe doli.

Teze Sermja u habit për atë vizitë të vonshme të nipit. Por Mihoja nuk i dha rast as të pyeste:

— Teze, shpejt një letër!, — i tha.

Sermja ia solli. Ai u ul pranë saj e shkroi:

E dashur hallë Diamante,

Prej prishjes së Ekaterinës me atë gjeologun ti ndoshta i ke prerë të gjitha shpresat se mund të gjesh ndonjë kandidat për të qenë, e di vetë ku e kam fjalën. . .

Në kampin e punëtorëve ka vajtur një minator, është ashtu si na duhet neve. E quajnë Lim Thana. Porsa ta marrësh këtë letër bashkë me harchimet që ju duhen të dyjave ose të triave nëse vjen edhe Giçi (është mirë të vijë edhe ajo), shkoni në plazhin e Durrësit, paguani Turizmin për pesëmbëdhjetë ditë dhe mundohuni ta rregulloni Ekaterinën me minatorin Lim Thana. Ta përsëris, është beqar, pa njeri, sapo i kanë dhënë hyrje të veçantë midis Tiranës. Rregullojeni me Limin, pa për të tjerat ka kohë, bisedojmë. Është i rrëmbyeshëm dhe shpeshherë u futet punëve me ngut. Sapo të sjellë te zja letrën dhe paratë, nisuni për në plazh. Mos e lëshoni rastin t'ju ikë kot, se rrallë na bie të peshkojmë të tillë njerëz!

Ju përqafo me mall

Nipi

Teze Sermja që i kishte qëndruar mbi kokë dhe e kishte lexuar letrën shkronjë për shkronjë, qeshi, pastaj i rrahu supet nipit:

— Shyqyr që fillove të lëvizësh, tani të dua më fort!, — i tha. — Më dukesh më i hijshëm, më simpatik!

— Mirë, mirë, nesër që pa gdhirë të nisesh për Zh.

— Shyqyr që nise të lëvizësh, të tjerat m'i lër mua!, — ia pat te zja dhe, si mbështolli letrën me një copë basmë, e futi në një vend të fshehtë.

KREU IV

Kishin kaluar tri ditë. Limi ishte shtrirë mbi rërën e ngrohtë. Transistorin e kishte vënë pranë kokës. Që andej përhapeshin tingujt e këngës «A do të vish sivjet në plazh». Limit iu kujtua Bukuria, e cila kishte pasur dëshirë të madhe të vente në plazh, por Ermira, llampistja e turnit «Hovi» kishin pasur një rast më të domosdoshëm. Bukuria ishte ngushëlluar me mendimin se pesëmbëdhjetëditshin tjetër do të merrte lejën dhe do të kënaqej duke shëtitur bashkë me Limin, meqë ai, si minator, kishte një muaj lejë. Madje ata kishin menduar, pa ia thënë njëri-tjetrit, të bënin edhe fejesën atë pesëmbëdhjetëditsh.

Midis këtyre mendimeve të bukura hyri si pykë Zhaگان Dhoga. Në mendjen e Limit rrahën fjalët e tij aq të dyshimta. U inatos, u ngrit ultas, mbushi grushtet me rërë dhe i shtrëngoi fort. Atë kohë pranë Limit kaluan dy femra me rroba banje. Mbanin syze dielli, Limi nuk ua pa sytë, por zëri i tyre e gudulisi edhe pse ishte i zemëruar në kulm. Ato u ulën disa hapa më tutje dhe po dëgjonin muzikë. Atij iu zgjua një ndjenjë e çuditshme. «Fundja deti është i të gjithëve, — mendoj minatori, — edhe rëra po ashtu». Pas pak Limit iu afrua edhe shoku i dhomës, një mekanik i ri që e quanin Genc.

— Lim, — i tha Genci, — unë po hyj në det, nëse vjen fotografisti, mos harro ia kërko ato.

— Pse, sot vjen?

— Pardje ia dhashë filmin, do ta ketë larë, sot vjen.

— Mirë.

Genci u fut në det. Ai nuk dinte të dilte. Harrohej duke notuar. Kërcente nga tramplini.

Dy vajzat, duke u rrotulluar në rërë, iu afruan Limit fare pranë. U pëlqente muzika dhe dëgjonin me vëmendje.

— Shok, — i tha njëra, — nëse nuk të bezdisim, të dëgjojmë emisionin muzikor?

Limi për mirësjellje u ngrit ultas.

Nga transistori po dilnin tingujt e fjalët e një kënge dashurie.

Njëra prej vajzave preku shoqen me bërryl, i afroi buzët te veshi e i pëshpëriti me aq zë sa të dëgjonte edhe Limi:

— Ndoshta pret atë që thotë kënga? — Pastaj e shikoi beqarin me bisht të syrit. Limi preku në gaz. Femrat iu afruan edhe më afër transistorit. Ajo flokëverdha kapërceu këmbën mbi këmbë. Beqari shikoi belin e këputur, i ngjau me ato shtatoret e mermerta.

— Ju jeni tiranas?, — pyeti me gjysmë zëri brunia.

Limi buzëqeshi, por nuk u përgjigj. Brunia mori ca kokrra rërë, i shtroi në pëllëmbë e tha me shaka.

— Ekaterina, siç e thotë falli, ky djaloshi është prej Tirane. Para pak ditësh ka pasur një gëzim shumë të madh. Falli thotë se gëzimi është festuar, dollitë nuk janë ngritur Kavalieri. . .

Ekaterina e ndërpreu:

— Giçi, mos ma vështiros me këta tituj demode!

— Falli është fall, — tha Giçi buzagaz, — ka edhe më. Falli thotë se ky trup gjiganti fsheh përbrenda një zemër të madhe. Kaq pata, më falni, — tha brunia dhe eci drejt kabineve, ku e priste një burrë i veshur me rroba doku.

Limi kishte rrudhur buzët, siç bëjnë njerëzit kur nuk dinë t'i përgjigjen ndonjë pyetjeje që u lind vetvetiu.

Ekaterina, që e pa, pyeti:

— U habitët?

— Jo, — u përgjigj Limi.

— Paskeni veti për t'u lakmuar.

Njeriut, cilido qoftë ai, kur të tjerët i flasin për ndonjë veti karakteri, i pëlqen. Edhe Limin sikur e tërhoqi lëvdata e Ekaterinës. Pyeti:

— Cila qenka kjo veti që i bëka të tjerët të lakmojnë?

— Dini t'i vini kyçin gojës që të mos ju vërshojnë margaritarët. Sanguin i kulluar.

— Çudi! — tha Limi si me tallje, por ajo që dëgjoi i pëlqeu. Ia turbullonte gjakun ngjyra çokollatë e trupit të derdhur, mbi kokën e së cilës kontrastonte ngjyra e shkëlqyeshme e flokëve të verdhë. Dy gjëra nuk i pëlqyen Li-

mit: ajo shoqja me të cilën erdhi Ekaterina dhe mënyra e prerjes së flokëve të Ekaterinës, të cilat i kujtuan minatorit qethjen e dhive shkallë-shkallë.

— U habitët se ajo shoqja përcaktoi nga jeni?, — pyeti Ekaterina.

— Ia futi kuturu, — tha Limi.

— Jo, mbrëmë, ndërsa pinit birra pranë tavolinës sonë, një i njohur na foli për ju.

— Për mua?

— Po.

— Kush qenka ky që më njohka?

— S'ka rëndësi, ai ju lëvdoi.

— Ju nga jeni, me se merreni?, — pyeti Limi.

— Jam arsimtare.

— Arsimtare?!

— Me fakultet jam, por prapa botës. Shërbej në një fshat shumë të largët. Qysh e re, pothuaj kërthi, shërbej në fshat.

— Arsimtarja të flasë me këtë përbuzje për fshatin?!

Ekaterinës i lëvizi një hije në bebet e syve, gropëza në buzën e sipërme iu mblodh e me shikimin mbërthyer mbi ballin e minatorit foli:

— Unë nuk shpreha asnjë përbuzje, pohova diçka, krenohem për punën që bëj, po njeriu nuk duhet të lëvdohet. Të gjithë diku kryejnë një detyrë. Keni të bëni me një bijë prindërisht që i kanë dhënë shumë arsimin, i kanë dhënë luftës edhe gjakun e të afërmeve të vet. Kam shkuar vullnetarisht në fshat. — Kështu tha Ekaterina, pastaj, fare papritur, ktheu kokën nga kabinat e thirri: — Ua, mami! Ika, mami nuk i pëlqen të qëndroj vetëm për vetëm me një të panjohur! Jeni shumë interesant, por... ika. — Ajo u ngrit dhe vrapoi drejt kabinave.

Limi buzëqeshi.

Pas dy ditësh një burrë i thinjur, me syze të trasha, i cili rrinte në një çadër tutje, në mes të plepave, iu afrua Limit dhe Gencit që po bënë banja dielli. Dy punëtorët u ngritën, se plaku kishte ardhur edhe disa herë nën çadrën e dy të rinjve për të luajtur domino. Ishte magazinë pa inventar për sa i përket barcaletave. Edhe anekdotat e dë-

gjuara me dhjetëra herë, kur dilnin nga goja e tij, mund t'i dëgjoje pa u mërzhitur.

Ndërsa plaku me syze të trasha zuri vend pranë Limit dhe Gencit, Ekaterina dhe Giçi dolën prej detit e zunë vend përballë tyre.

Plaku tregoi tri barceleta radhazi: njëren për Pushkinin, tjetrën për Napoleonin, të tretën për një mama, e cila ishte bërë shkaktare që e bija e saj kishte mbetur e pamartuar. Barceleta përfundonte se si një bandill i vardisej një vajze të bukur që shoqërohej gjithnjë nga e ëma. Kjo e fundit paskësh përfutur nga rasti dhe ishte martuar me atë që i vardisej së bijës.

— Xha barceletë, — i tha Genci (ashtu e thërriste ai plakun), — na thuaj ndonjë barceletë me Luigjërit, me Karlët, se ato i kam qejf.

— Shiko, shiko! — tha plaku duke fshirë xhamin e syzeve dhe tregoi me gisht nga dy femrat: — Ekaterina, eh, ç'kreatyrë!

— Fillove ndonjë barceletë me kreatyra!, — u tall Genci.

— Jo, mor zog thiu, — ia pat plaku Gencit, — ja, ato të dyja, njëren e quajnë Giçi, tjetrën Ekaterina. Kjo e fundit është vajza më e bukur që ka njohur bota. Duket se e ka skalitur perenia ndërsa gëzonte lejën e zakonshme. E krijoi gjatë lejës, sigurisht për vete e nisi, pastaj krijoi një tjetër edhe më të bukur, atë e mbajti për vete, kurse këtë e lëshoi në tokë. Çudi, të gjithë thonë se perenia kishte tendenca poligamike.

— Nëse do ta kishte krijuar për vete, — tha Genci, — nuk do ta linte të vinte në plazh, sepse kush më tepër se perëndia është fanatik e xheloz.

— Pusho, mor fem... Ajo është goxha vajzë, po pa fat.

— Pse?, — pyeti Genci. Limi dëgjonte.

— E kanë kërkuar dhe e kërkojnë djelmoshat më të mirë, njerëz profesionesh të ndryshme, por, ku vendos ajo, nuk do mamaja, ku do mamaja nuk do ajo. E ka mbyllur mamaja si zogun në kafaz. Por ajo që zgjedh, një ditë ka për të mbledhur.

— E ke me gjithë mend?, — pyeti Limi.

— Me gjithë mend e kam, — u përgjigj plaku rëndë-rëndë.

Dy kampionët e rinj u përshëndetën me plakun e u futën në det. Iu afruan tramplinit. Një kohë të gjatë bënë gara kërcimi. E nesërmja kaloi pa trazira.

Në mbrëmje Limi dhe Genci si zakonisht vajtën në pistë. Kamerierja solli birrat, shiset ishin veshur me avull, bërçollat çërronin.

— Lim, — foli Genci, — ja ato dy bukuroshet.

— Ku janë?

— Përballë, ato të dyja me atë burrin e shëndoshë.

— Ç'na duhen!

— Na shikojnë dhe buzëqeshin midis tyre.

— Nuk mund t'ua mbyllim sytë, — tha Limi.

— Lim, nuk e ha sapunin për djathë unë. Ti i njeh ato. Shiko si të qesh ajo biondja, sherbet i pikojnë buzët.

— Të merremi me birrat, se qenkan akull, bërçollat të shijshme.

Genci kapi gotën, e ngriti në drejtim të dy femrave dhe, duke qeshur çapkënçe, e cakroi me gotën e Limit.

— Ç'bën, mor Genc, na turpërove!

— Ti the se nuk i njeh. Domethënë se më kanë buzëqeshur mua. E drejta ime është t'ua kthej.

— Eh, ç'na bëre, mor Genc!

— Ke frikë prej femrave?

— Ç'llafos!

— Shiko si janë, a derëzi, si pëllumbesha që njohin mirë fluturimin.

— Bëj ç'të duash, mua mos më ngatërro!

— Je i zënë?

— As jo, as jo.

— Atëherë mbaj vendin. Unë jam beqar njëzetekatërkaratësh. Plazhi më bën mirë.

Filloi orkestra. Bashkë me tingujt e ëmbël vallëzonin dritat në pluskimet e detit. Vallëzonin plazhistët, këndon-te shpirti i dy punëtorëve. Giçi danconte me atë burrin e trashë. Bisedonte dhe herë pas here vidhte me sy dy të rinjtë. Ekaterina qëndronte e vetme me shikimin mbërthyer në syprinën e tavolinës. Burri i trashë dhe Giçi u rro-

tulluan. Kur erdhën pranë tavolinës së dy punëtorëve, burri i buzëqeshi Gencit.

Muzika pushoi.

Burri i trashë e shpuri gruan në tavolinë, pastaj iu afërua dy të rinjve. Ia shtriu dorën e madhe Gencit, i buzëqeshi jo vetëm me buzë. Dukej sikur i qeshte tërë fytyra buçko:

— Shoku mekanik, — i tha Gencit ai, — më njeh?

Genci e këqyri me vërejtje ashtu qysh bëjnë njerëzit kur duan të kujtojnë atë që kanë harruar.

— Si, more Genc, e paske harruar harushën time?! — Ashtu e quante ai makinën me të cilën punonte. — E harrove Skodën me targë 33-88? — Pastaj iu drejtua Limit: — Kishte një difekt, Genci me shokët sa po dilnin prej pune, u kthyen e vunë në lëvizje gjithë gjenerikët, po mbi të gjithë punoi Genci. Sa u gëzua kur ia gjeti iletin.

— O, Bardhyli, — thirri Genci, — ti qenke trashur, po kujtesën ama hollë se hollë. I thonë tre vjet.

— Si ia çoni andej nga ofiçina? Djem të mirë, çfarë petritash, për gjysmë ore ma bëtë harushën gati për veprim.

Atë kohë Giçi përshkoi përmes tavolinave. Bardhyli e pa, iu formuan ca rrudha të imta në ballë, ndërpreu bisedën sikur të qe duke thënë ndonjë gjë të ndaluar.

— Njihuni, — u tha dy punëtorëve, — ime shoqe.

— Giçi, — u prezantua ajo.

Genci i liroi vendin e kërkoi një karrige. Bardhyli vazhdoi:

— Desha t'ua shpërbleja gjenerikëve dhe Gencit, por këta meazallah. Ja ku të kapa, Genc, tani do të pish një krikëll birrë prej të zotit të harushës. Kamerier!

— Të thërres Katin?, — pyeti Giçi.

— Për kokën tënde na lër ne, shko i bëj shoqëri sat motre, — ia ktheu Bardhyli.

Giçi ngërdheshi fytyrën si ndonjë ketër kur mundohet të çajë boçën e pishës për të nxjerrë thelpinjtë, por nuk u tund nga vendi.

— Shoqja kameriere, tri birra dhe tri meze!

— Pesë birra me meze, — shtoi Giçi.

— Ik, moj e uruar, na lër të bisedojmë!

— Èëë! Jo, jo, jo!, — tha Giçi duke tundur kokën dhe duke shqelmuar lehtë me këmbë si ata fëmijët e babëzitur. — Po shkoj ta marr edhe Katin, — tha ajo dhe iku. Pas pak u kthye me të motrën e ua paraqiti:

— Motra ime, Ekaterina, njihuni!

Muzika rifilloi, Giçi shikoi të shoqin me të lutur.

— Më lër të bëj muhabet, — i tha ai.

— Ka mundësi, — i tha ajo të shoqit duke ia bërë me kokë nga Lim Thana.

— Po deshi shoku.

— Ngrehu, Lim, — i tha Genci.

Limi u ngrit. Giçi ishte e lehtë. I mbështillej për trupi si ndonjë pëlhurë e mëndafshhtë. Herë puthitej, herë largohej. Mbi fytyrën çokollatë loznin dhjetëra reflekse të neonit. Dora e vogël dhe e butë kishte shteruar në dorën e madhe dhe me kallo. Limit ia guduliste hundët parfumi i këndshëm. Ai kurrë nuk kishte nuhatur erë të kuq buzësh. Pas ca u ngrit edhe Genci me Ekaterinën. Në vallëzim e sipër u afruan.

— Ju quajnë Lim Thana?, — pyeti Giçi.

— Po.

— A ndërrohemi. Ju danconi me time motër, unë me të njohurin e burrit tim.

— Si të doni, — tha Limi.

U këmbyen. Gjatë rrotullimeve, Limi disa herë e vodhi me sy fytyrën e Ekaterinës. Ishte e bukur. E bënin më tërheqëse disa shenja të vockëla nervozizmi, të cilat Limi i mori si diçka që ishin në natyrën e femrës. Një ndjenjë e çuditshme krenarie filloi t'i bulonte nga brenda kur këqyrte se shumë plazhistë i shikonin me lakmi. Edhe Ekaterina ishte e lehtë. Ca e frikshme, ca e turpshme. Ashtu iu duk Limit. Një dehje e vakët po i lëvizte në gjithë qenien.

— Ekaterina, — foli Limi, — e adhuroj profesionin e mësueses. Kam pasur një mësuese në tetëvjeçare, mësuese e shkëlqyeshme.

— Sikur të më shikonit në Tiranë, — pyeti Ekaterina, — do të më jepnit të njohur?

— Nuk më pengon asnjëri t'ju jap të njohur, — ia ktheu.

Limi, — pastaj nuk kam të bëj me ndonjë që nuk meriton respektin e minatorit.

— Ju thashë, jam mësuese, profesioni i thotë të gjitha.

Genci dhe Giçi kërcenin afër tyre, Giçi zgjati kokën e pyeti Limin.

— Lim, nuk ia keni vënë prangën gishtit dhe gurin portave të zembrës?

«Prangën gishtit, gurin portave të zembrës!» Këto fjalë rrahën çuditshëm në mendjen e Limit. Po parfumi, ah, parfumi që mbulon çdo erë tjetër, ia gudulisi hundët minatorit. Trupi i tjetrës që rrallë e çikte, po i fiksonte në shpirt çaste rrallëherë të provuara.

Muzika mbaroi. Dy femrat ecën përpara, kurse Genci ngadalësoi hapin, i futi krahun Limit e i pëshpëriti:

— Lim, ki mendjen, vëlla, ajo bukuroshja me flokë të verdhë ta ka vënë syrin!

— Nga e more vesh ti?, — pyeti Limi si me të tallur.

— Nga pyetjet që bëri për ty motra e saj.

— Po habitem.

— Përse?

— Një femër e bukur, me universitet, pa më njohur...

— E para e punës ty të mos të rritet mendja për çfarë do të them. Ti të merr në qafë nga pamja. Bukurisë sate burrërore i rrisin vlerën ata muskujt gunga-gunga, natyrisht kur je me rroba banje. E dyta, një person u ka folur shumë mirë për ty. E treta, nuk di çfarë të them, por, pa u njohur mirë, mos bëj asnjë hap drejt saj.

Ata u ulën, birrat dhe mezetë e porositura nga Bardhyli gjendeshin mbi tavolinë.

Ekaterina si e shqetësuar lëvizte dhe mudohej të shikonte përtej kabinave.

— Giçi, — i tha ajo së motrës, — më shoqëro, vajti ora, mamaja nuk ma fal vonesën.

Bardhyli ngriti supet, shikoi Giçin, mblodhi buzët siç bëjnë njerëzit kur futin ndonjë gjë të hidhur në gojë dhe nuk dinë ç'është ajo. Papritur ia plasi gazit në mënyrë të çuditshme.

— Edhe një minutë, — ia ktheu Giçi së motrës, kurse me majën e këpucës ia shkeli këmbën Bardhylit.

— Jo, Giçi, jam vonuar, ti e njeh mamanë.

— Ke të drejtë, moj motër, — ia ktheu Giçi duke ia shkelur edhe një herë këmbën të shoqit që të mos bënte ndonjë gjest të papëlqyer, — edhe mamaja ka të drejtë. Për gruan kujdeset burri, kurse për vajzat prindërit.

— Giçi, — e ndërpreu Ekaterina, — më shoqëro, të lutem!

Giçi u ngrit, të dyja ecën mes tavolinave dhe plazhistëve.

— Punë femrash, — tha Bardhyli, — të pimë!

Shoferi iu duk babaxhan Gencit, kurse Limit nuk i pëlqeu. Fjalët e fundit shqiptuar me një ton të shpëlarë, e zemëruan. Kujdesi i mamasë për të bijën dhe respekti i së bijës për të e ngritën figurën e Ekaterinës në mendjen e Limit.

Shofer Bardhyli deshi të fliste me Limin, po Giçi u kthye e ai heshti. Limi ndizte cigaret njëra pas tjetrës, ndërsa Genci dëgjonte Giçin që fliste me fjalë të zgjedhura për motrën e vet, vërente edhe burrin e saj që gogësinte dhe fërfëllonte me shikimin nga deti. Këqyrte shtëllungat e tymit që dilnin nga cigarja e Limit dhe shqetësohej.

Bardhyli, edhe pse babaxhan, i kapi ato përtypte të brendshme mendimi e i tha mekanikut:

— Genc, nuk do ta këmbëja me asgjë këtë mbrëmje, do të qëndroja të bisedoja me ju, por më pret makina me çimento, duhet të udhëtoj.

Kur u ngritën, Limi eci përpara midis tavolinave, Giçi iu qep prapa. Kurse Bardhyli ia futi krahun Gencit, ngadalësoi me qëllim hapat dhe e pyeti:

— Ç'njeri është ai shoku yt?

— Zor se i gjendet shoku, — u përgjigj Genci.

— Minator është?, — pyeti Bardhyli.

— Minator pararojë dhe komunist, — plotësoi Genci.

— Ia ka vënë syrin ajo..., — tha si me vete Bardhyli.

— Aq më mirë, — tha Genci me shaka, — do të fitosh një baxhanak, që do të ta kenë zili shumë njerëz!

— Dëgjo, Genc, dëgjo, vëlla, unë e hëngra kokrrën e ullirit... sepse u nguta dhe nuk dija ç'fshihej prapa lustrës. Ta dish ti ç'po heq... Janë të rrafinuara ato, sidomos e ëma. Edhe djallit i jep mend. Por unë shqyr fëmijë nuk kam

dhe... — Atë kohë Giçi u kthye, i futi krahun të shoqit dhe vështroi ngultas fytyrën e Gencit. Përpiqej të hetonte mos i shoqi kishte folur gjë.

— Hajde në dhomë, të pret mamaja!, — i tha Bardhyllit.

— Nuk kam kohë, — tha Bardhyli duke shikuar qiellin, — kam makinën të ngarkuar me çimento.

— Do të fyhet mami, — fërgëlloi Giçi. Ajo kishte ndër mend ta pyeste të shoqin ç'qe gjithë ajo shoqëri e bisedë me Gencin, por Bardhyli ia zgjati dorën e i tha:

— Natën e mirë!

Pastaj i shtrëngoi dorën Gencit, u takua edhe me Limin dhe iku. Giçi iu vu prapa.

Dy shokët, sa u ndanë, ecën një copë rrugë pa këmbyer fjalë. Kur po i afroreshin kampit të punëtorëve, Genci pyeti:

— Lim, nuk ke pirë cigare tri ditë bashkë, sa ke pirë këtë mbrëmje...

Limi nuk u përgjigj, po i vuri dorën krahaqafë.

— Po mendon për Ekaterinën?, — pyeti Genci.

— Edhe pyetja e parë qe për të, apo jo?, — foli Limi.

— Rrëmbimi është ves, ti këtë duhet ta dish, — tha Genci.

— Edhe opinionin i gabuar, po ashtu, — ia ktheu Limi. Genci e shikoi në sy e i buzëqeshi.

— Genc, unë vërtet jam i rrëmbyer, por, kur flitet për punë fejese e për të tjera çështje të rëndësishme, mendoj shumë, jam i matur, ndoshta-ndoshta më tepër se më i kujdesshmi...

Ata hynë në kamp duke biseduar.

Pas dy ditësh Diamanta, halla e Miho Gjelicit, u nis me trenin e parë për Tiranë. Gjatë udhëtimit i dridheshin hoxhëzit nga një nervozizëm i shfrenuar. Sa zbriti nga treni, shkoi drejt e në shtëpinë e Sermes.

Ende pa u përshëndetur si duhet, ajo shfryu:

— Zonja Serme, si mund të takohem me Mihon?

— Prit, moj e uruar, — ia ktheu Sermja, — më thuaj ç'hall ke. Përse të është prishur fytyra? Mos i ke gocat sëmurë?

— Më mirë të vdiste ndonjëra, sesa...
— Si t'i zë goja ato fjalë që nxjerr, zonjë?, — e ndërpreu Sermja.

— Lëre, lëre!, — tha Diamanta dhe, duke mbajtur tëmthat me pëllëmbë, u shemb mbi një poltron me mbulesë të çngjyrosur. — Paskam qenë e nëmur, — tha ajo.

— Mos fol marrëzira!

— Ke të drejtë ti, posi, ke të drejtë, edhe shumë bile, — shpërtheu Diamanta si e ndërkrjer. — Bëre si bëre, nuk u shkule nga Tirana. Si ti, ashtu edhe nipçja ynë... jetoni këtu... Kurse unë, eh, nganjëherë më vjen të dyshoj edhe... — Dënesat ia ndërprejnë ligjërimin. Shtrëngoi kokën me duar.

— Si mund të të ndihmoj?, — pyeti Sermja e hutuar.

— Të më sjellësh Mihon sa më parë, — tha Diamanta me zë të dridhur nga dënesat.

— Si jo, Mihoja ka punuar në turnin e tretë, tani duhet të jetë në dhomën e vet, — tha Sermja dhe u vesh me ngut. Pas pak ajo doli. Derën e oborrit e mbylli me dryn.

Diamanta u shtri në divan.

Pas një ore Sermja u kthye.

— Nuk e gjete?!, — pyeti me një frymë Diamanta.

— Nëse e lëshojmë veten siç bën ti, — ia ktheu Sermja, — na mori lumi. Mos ki siklet, tani vjen!

— Përse nuk erdhi me ty?

— Secili i di punët e veta. Ne shihemi një herë në javë dhe natën vonë. Mihoja nuk ka dëshirë të bjerë në sy. Ai di shumë dhe vepron me mend në kokë..., — tha Sermja.

Nuk kaloi shumë dhe Mihoja u fut si hije në oborrin e tezes së vet. Fare pa u ndier u gjend përpara Diamantës.

— Nuk na doli gjë ai minatori yt, — i tha Diamanta me përbuzje.

— Vërtet?, — tha Mihoja ftohtë, po, pasi shikoi flokët e kërlëshur dhe fytyrën e egërsuar të Diamantës, shfryu: — Më lehtë është të ecësh i zbathur mbi një fushë me ferra gjembaçe, sesa të bindësh budallanë të veprojë si duhet!

— Ç'dërdëllit kot!, — ia ktheu Diamanta me nerva. Po ndeshi në vështrimin e tij kërcënues, u zbut e tha: — Jo,

nipçe, jo! Nganjëherë më mbushet mendja se ora jonë ka vdekur përgjithmonë!...

— Mos ndill kob, trego si qëndron puna!, — e ndërpreu Mihoja.

— Sa menduam se u rregullua gjithçka, kur prisja të vinte ai Limi apo dreqi për të më kërkuar dorën e fatit, u prish tërë puna...

— Kush e prishi?, — e ndërpreu Mihoja me pyetje.

— Limi, — u përgjigj tjetra.

— Si?

— Sikur të dija si, nuk do të vija të qaja hall me ju, — tha Diamanta.

— Kësaj i thonë «jam sëmure, po nuk di ku më dhemb», — tha Sermja.

— Jo, moj zonjë, — ia ktheu Diamanta, — ata e dinë mirë ku na dhemb neve, ndaj nuk gjejmë shërim.

— Paskeni prirje për filozofime sot!, — tha Mihoja.

— Disa ditë sikur u nxeu Limi. Kur shikonte Katin, sytë i shkëlqenin me lakmi si të maçokut kur ka përpara mëlçinë e qingjit. Sakaq u ftoh njëherësh.

— Sa poshtë kemi rënë, — tha Sermja, — një copë maloku i jepet mundësia të martohet me një bijë prej gjaku të fismë, kurse ai hedh vickla!

— Kësaj i thonë: Tunde, mace, kokën e buallit!, — tha Diamanta.

— Do të jeni ngutur, — tha Mihoja. — Të kam thënë, vajzat e tua akoma nuk dinë në ç'botë jetojnë. Mendjelehti i bën keq vetes dhe të afërmve.

— Jo, nipçe, i kam mbajtur nën kontroll, kam vëzhguar çdo lëvizje, çdo fjalë e tyre ka qenë imja, megjithatë..., — tha Diamanta.

— Tri ditë janë pak, — tha Mihoja si me vete, pastaj shtoi: — Megjithëse ajo kala duhej të merrej me sulmin e parë, ndryshe është e papushtueshme. Njeriu i rrëmbyeshëm, po arriti të përtypë në vetvete mendimin e parë, të dytin e ka të peshuar. Prapë duhet të mos i humbisni shpresat. Orvatuni edhe një herë. Ta bisedojmë.

— Mirë thotë Mihoja, — ndërhyri Sermja, — kemi pa-

sur një shërbyes që thoshte: «Nuk pritet druri me një të qëlluar!».

— Atij minatorit tuaj nuk i mbushet mendja as me njëqind të qëlluara, — tha Diamanta. — Mbrëmë e kapi Giçi:

— *Je komunist, — i tha, — nuk të ka hije t'ua turbullosh mendjen vajzave të padjallëzuara!*

— *Jam i fejuar, — ia kishte kthyer ai.*

— *Ti na the se je i lirë, — i kishte thënë Giçi. — Komunistët nuk duhet dhe nuk veprojnë kështu si ti.*

Ai ia kishte kthyer:

— *Vërtet nuk veprojnë, sepse nuk martohen me kë t'u dalë përpara, e peshojnë mirë çdo gjë ata.*

— *Ashtu!, — klithi Sermja.*

— *Kjo qenka për të vënë kujën!, — tha Mihoja i shqetësuar. — Mos ka marrë vesh Lim Thana për origjinën tuaj?!*

— *Hë de, kjo më dërrmon, — tha Diamanta, — tërë natën nuk kam mbyllur sy. Si ciganët kemi bredhur për të humbur gjurmët. Më bëhet se e kemi të shkruar në ballë...*

— *Hallë, po të ishim ngutur, do të na ishin kalbur eshtrat si shumë zotërinjve të sërës sonë, — tha Mihoja. — Ti mos u mërzit, këtë punë ma lër mua. Do të gjej ndonjë tjetër. Duhet të mblidhemi të gjithë në Tiranë. Pastaj... Edhe punën e Limit nuk do ta lëmë ashtu. Teze Sermja dhe unë do ta bëjmë t'i vijë festja vërdallë!, — tha Mihoja dhe u ngrit. Sermja e përcolli në oborr; te dera biseduan me pëshpëritje:*

— *E di ku e blejnë qumështin gratë e minatorëve?, — pyeti Mihoja Sermen.*

— *E di, — u përgjigj tjetra.*

— *Nesër në mëngjes atje, vish ndonjë rrobe që nuk e mban përditë, — porositi Mihoja dhe e mësoi si të vepronte.*

K R E U V

Në galeritë e oxhakut të katërt bëhej shpërthimi i minave. Grupi i minatorëve që punonin në galeritë e atij oxhaku shpejtonin për në strehim. Rrezet e llampave lë-

viznin si meteorë dhe kryqëzoheshin tutje-tëhu. Atje te strehimi u grumbulluan shumë minatorë, ndihmësminatorë e shinashtrues. Po t'i shikoje nga gryka e oxhakut lart, ngjanin me një tufë yjesh të pasqyruara në sipërfaqen e një liqeni të parë nga ndonjë kreshtë sipër liqenit. Atë gjysmë ore të plasjes së minave dhe të pastrimit të gale- rive nga tymrat, minatorët kuvendonin:

— ...kur u fut në oxhak korrespondenti, — fliste Rrushi, — i shqeu sytë na!

— *Ka fund ky pus?*, — më pyeti.

— *Ec pas meje!*, — i thashë.

— *Hej, ku po më shpie?!*, — klithi ai. Duart i dridhe- shin, bulat e djersës i shkëlqenin në ballë.

— *Ec pas meje*, — i thashë, — *mos ki frikë. Mbahu mirë në shkallë!*

— Në duart e kujt paska rënë i shkreti!, — tha Zizi.

Rrushi nuk ia vuri veshin, vazhdoi të tregonte:

— *Jo, jo*, — tha korrespondenti dhe u kthye mbrapsht oxhakut përpjetë. U ngjita edhe unë. E pyeta:

— *Ke ardhur për të intervistuar minatorët? Hyr bre- nda! Në sipërfaqe nuk ka minatorë!*

— *Më fal, shok, ka vite që punoj si redaktor, s'kam dalë asnjëherë prej zyre, jo se nuk doja, po se kisha shumë punë. Nuk i merr vesh ti punët e redaksisë në radio. E kam për herë të parë. — Pastaj shtoi gjysmë me shaka: — Jam ca i dhjamur, oxhaku qenka i ngushtë, më zihet fryma. Vuaj edhe nga maramendthi.*

— *Përse nuk kanë dërguar ndonjë tjetër, shok?*, — e pyeta unë. Ai bëri sikur nuk dëgjoi e ndërroi bisedë.

— *Ka raste shembjeje?*, — pyeti. — *Shiko atë trarin atje si është shtrembëruar!*

— *Mor shok*, — ia ktheva unë, — *vuan prej maramend- thi, apo prej zonjës frikë?!*

— *Dëgjo, erdha që erdha, të mos kthehem bosh. Cila brigadë është e përparuar? Cilët janë minatorë të dalluar?*, — më pyeti dhe pregatiti magnetofonin.

— *Aaaa!*, — thirra unë, — *futu pas meje, po deshe të ma- rrësh përgjigje për pyetjet që bëre! Minatorët do t'i gjej-*

më treqind e pesëdhjetë metra thellë nga ky nivel që po të flas.

— *Treqind e pesëdhjetë the?! Bubuuuuujaaaa! Ti qenke djalë i mirë, a ke mundësi të nxjerrësh katër-pesë minatorë të dalluar në sipërfaqe? Atje bëjmë një intervistë, — tha korrespondenti.*

— *Dhe ti të thuash: «Udhëtojmë në galeritë e thella të nëndheut!» Këtë nuk e bën asnjëri, s'ke për ta bërë as ti! Korrespondenti u fye e tha:*

— *Si ka mundësi të gënjej! Do të them ashtu siç është, «Jemi në zyrat e minierës «1 Maji», bisedojmë me minatorët pararojë...». Unë i thashë se gjithë sa kanë ardhur deri më sot nga radioja dhe nga gazetat janë futur brenda. Bile mezi prisnin të zbrisnin poshtë, bile edhe kanë punuar me ne.*

— *«Vuake nga maramendthi», qenke edhe i dhjamur, nuk ta këshilloj të vish më në minierë!, — i thashë.*

Kështu e përfundoi rrëfimin Rrushi.

— *Përse nuk thua se na paske fëlliqur!, — tha rëndë-rëndë Agron Mala. — Tjetri ta paska qarë hallin. Për herë të parë vinte në minierë. Ndoshta e kanë dërguar nergut për t'u njohur me jetën.*

— *Sjellja jote nuk është sjellje punëtori, — tha Dem Qesati, — pse ashtu u punuaka me njerëzit!*

Rrushi shtangu në vend. Shikoi minatorët sikur të donte t'i pyeste: «Vërtet kam vepruar gabim?».

— *Kanë faj edhe ata të drejtorisë, — tha Sherifi, — përse të caktojnë shoqërues Rrushin, ky nuk merret vesh kur flet përnjimend e kur bën shaka!*

Rrushi shikoi nga Kujtim Kreshpa dhe mendonte: «Kujt do t'i japë të drejtë Kujtimi, mua, apo këtyre?».

Kujtimi, që kishte dëgjuar me kujdes, tha:

— *Rrush, shokët kanë të drejtë. Mendohu vetë: kujt i shërbeu ajo sjellja jote? Askujt, as korrespondentit të radios jo. Ta bindje të futej brenda. Kur të shikonte se qindra njerëz punojnë atje në ballë të frontit, do t'i hiqej frika. Cili nga ne nuk ka provuar dridhje të vockla kur ka hyrë për herë të parë në minierë?*

— *Ai nuk donte të hynte, — u shfajësua Rrushi.*

Përse nuk zbritët me ashensor, duket e ke shpënë qëllimisht nga dishenteria?, — ndërhyri Agroni, pastaj vazhdoi: — Shikoj një gjë, mani për t'i vënë intelektualët në lojë! Siç është koncept dhe qëndrimi borgjez, të përbuzurit e punës fizike nga ndonjë intelektual i rrallë, pjellë e një koncepti tjetër është edhe sjellja e Rrushit. Inteligjencia jonë është e re, ne jemi përgjegjës për të: ta ruajmë të pastër, ta kalisim me frymën e klasës, ta ndihmojmë shoqërisht, e jo ta vëmë në lojë. Të vënit në lojë nuk sjell asnjë të mirë. Nuk them të jemi zemërgjerë edhe përpara shkeljeve të parimeve. Në të tilla raste t'ia tregojmë vendin kujt-dotë.

Tymi i minave po davaritej. Fjollat e fundit të holla e të tejdukshme po ngjiteshin oxhakut.

Atë kohë zbriti një burrë. Ishte minatori veteran, xha Dini. Të gjithë vështruan me habi nga ajo anë. Ndonëse kishte dalë në pension, xha Dini nuk i ndahej minierës, po në turnin e tretë asnjëherë nuk kishte zbritur.

Kishte kaluar gjysma e natës. Ai, sapo iu afrua strehimit ku gjendeshin minatorët, përshëndeti si zakonisht me grushtin mbledhur, partizance:

— Si ju kam, trima?

Të gjithë u ngritën në këmbë. Këqyrën jo me pak habi se xha Dini ishte veshur me rrobat e minatorëve. Plaku bëri sikur nuk i vuri re ato vështrime pyetëse, u ul pranë Kujtimit e pyeti me radhë për galeritë, për presionin, për prodhimin, për shëndetin e minatorëve. Kur minatorët po shpërndareshin nëpër frontet e punës, xha Dini i pëshpëriti Kujtimit:

— Më dërgoi Zana, Demir Ullishtasi ka gruan shumë sëmure, po i ikën...

Kujtimi stepi në vend i menduar.

— Ik, nuk pret puna, — tha xha Dini. — Këto orë që mbetën do të punoj unë në vendin tënd.

Kujtimi iu afrua oxhakut për t'u ngjitur.

Plaku zbriti në galeri ku kishte zbritur pak më parë ndihmësi i Kujtimit. Plaku ecte me kokën lart. Sikur e përtëriu ajo fishkëllimë e tubit të ajrit të komprimuar. Një jetë të tërë kishte punuar në minierë.

— Ku shkoi Kujtimi?, — pyeti ndihmësi.
— Nuk ta mbush syrin unë?, — ia ktheu me pyetje plaku.

— Pyeta për Kujtimin, — ia ktheu ndihmësi, — nuk thashë asgjë për ty.

— Kujtimi ka një punë në sipërfaqe, këto orë që mbetën do t'i bëjmë bashkë, — tha plaku.

Shpërthimi i suksesshëm kishte mbushur galerinë me qymyr.

Plaku dhe i riu filluan të punonin.

Ishte ora dy pas mesit të natës. Kujtimi vajti në shtëpinë e Demirit.

Zana i qëndronte mbi kokë Afërditës, të cilën e kishin mbërthyer krizat e zemrës, fëmijët ishin zgjuar, qanin dhe gëlltisinin lotët në heshtje. Kurse Demiri gjendej në kuzhinë.

Zana, sa e pa, vuri gishtin tregues mbi buzë. Kujtimi e mori vesh se nuk duhej të dëgjonte Afërdita zërin e tij, mbasi ishte qetësuar pak. Ai përkëdheli fëmijët dhe u tha me zë të ulët:

— Mos u shqetësoni, nëna do të shërohet. Bini flini!

Fëmijët u futën në shtroja.

Zana i pëshpëriti Kujtimin:

— Është keq!, — dhe tregoi me kokë Afërditën.

— Përse nuk e thirrret urgjencën?, — pyeti Kujtimi.

— Ndihej e parë ia dhashë, ajo nuk duhet të lëvizë, — u përgjigj Zana. — Demiri sikur i ka vënë qëllim vetes ta vdesë sa më parë.

— Demiri?, — pyeti Kujtimi.

Zana pohoi me kokë.

— Ku është?

— Andej, në kuzhinë, — u përgjigj Zana.

— Ç'ka?

— Kjo vuan nga zemra, ai nga koka, e mendojnë ca fiksasione. Pak më parë ishin zënë. Thotë se Afërdita e përgjon, e survejon, — tha Zana.

— Është në vete ai apo flet ç'i vjen për mbarë?!, — tha Kujtimi si me vete.

Kujtimi doli në kuzhinë. U gjend përpara një rrëmuje skandaloze. Plaçka të hedhura përdhe, gota të thyera, shishe të përmbysura. Midis tërë rrangullinave ishte ulur këmbëkryq Demiri me sy të perënduar. Kishte shtrënguar një shishe në duar. Sa pa Kujtimin, megjithëse i dehur, fshehu shishen prapa kurrizit, deshi të ngrihej në këmbë, po këmbët nuk e mbajtën e u ul sërish. Iu shtrembërua goja duke gogësirë e tha:

— Më val... gush të zhqetësoi, — atij i ishte trashur edhe gjuha nga të pirët.

Kujtimin iu zgjua një zemërim i përnjëhershëm, i erdhi t'i hynte në shqelma, po e frenoi veten:

— Të lumtë! Ah, ç'burrë qenke!, — i tha.

— Më val, zhoku Gujdim, — bërbeliti Demiri kokulur.

— Ç'janë këto vandalizma! Je në vete ti?! Pa më thuaj ç'të mundon? Ka kohë që nuk të shikoj mirë. Mendoja, kisha besim se do të vije të këshilloheshe si shok, si minator, kurse ti...

— Nuk mund të jetoj më, — tha Demiri dhe vuri dorën në fyt, — deri gëdu më ga ardhur helmi.

— Mirë, mirë, do të bisedojmë nesër. Ma jep shishen. Ngrehu, duhet të flesh! Pusho, qetësohu, nesër bisedojmë shtruar!

Prania e disa njerëzve, që kanë takt, që gjithmonë sillen njerëzisht dhe tregojnë një kujdes të veçantë për shokët, bën çudira. Demiri, që pak më parë ishte sjellë keq si një i çmendur, sapo i foli Kujtimi, u zbut, iu afrua kreativitetit si ndonjë fëmijë i bindur, u zhvesh e sapo mbështeti kryet në jastëk, e mbërtheu një gjumë i rëndë. Kujtimi e mbuloi. Pastaj mblodhi plaçkat e shpërndara, i palosi, i vuri nëpër vende. Rregulloi dhe kuzhinën. Kur doli Zana nga dhoma e së sëmurës, gjithçka gjendej në vendin e vet. Ajo hapi duart si të thoshte: «Si ia arrite?».

Po Kujtimi ishte i zymtë. Ai mendohej të gjente me mend brengën që e mundonte Demirin. Se e mundonte diçka e madhe, e kishte të qartë, por cili ishte shkaku, nuk dinte, as kishte si ta merrte me mend.

Njeriu, kur i mungon burrëria dhe guximi të jetë i

singertë, patjetër që do të katandiset dhe do të zhytet në atë batac ku ishte kredhur Demir Ullishtasi.

Kujtimi bashkë me Zanën hynë në dhomën e Afërditës. Ajo kishte hapur sytë. Sa vuri re Kujtimin, deshi të ngrihej, po dora e butë e Zanës që iu gjend mbi ballë, zëri i saj i shtruar:

— Afërditë, nuk duhet të lëvizësh, — e bënë të mbështetej sërish në jastëk.

— Mos e mundo veten, — i tha Kujtimi, — çdo gjë do të rregullohet.

— S'e kuptoj ç'ka. Më tha spiune, sikur përgjokam çdo hap të tijin. Ç'kam për të përgjuar, e njoh më mirë se veten... Jo, jo, kështu mendoja dikur, — vazhdoi Afërdita me zë të shuar, — tani u binda se nuk e njohkam...

— Mos fol, qetësohu!, — i pëshpëriti Zana duke ia lëmuar ballin.

— Jo, Zana, e ndiej veten më mirë kur flas me Kujtimin. Ai ka qenë aq i mirë me ne, aq i mirë edhe me Demirin, po kush e dinte se Demir Ullishtasi do të çmendej kësajsoj...

— Ti duhet të shërohesh, — i tha Kujtimi. — Tani qetësohu, fli!

Gruas i rrëshqiti një kokërr loti nga syri, sikur me atë të zëvendësonte të gjitha fjalët që shprehnin mirënjohje. Mbylli qerpikët e gjatë dhe e zuri gjumi.

Edhe fëmijët e tronditur e të lodhur flinin.

Zana dhe Kujtimi u ulën në karrige pranë njëri-tjetrit.

Pas pak erdhën atje xha Dini, Agron Mala e Dem Qesati.

Atyre u kishin mbetur ende vazhdat e qymyrit mbi fytyrë. Xha Dini u kishte treguar sa kishin përfunduar punën. Ishin larë shpejt e shpejt, ishin veshur me ngut, nuk kishin pritur as autobusin, me një frymë ishin gjendur në shtëpinë e Demirit.

— Ku është i handakosuri?, — pyeti Demi.

— Shëëët, — ia bëri Zana, — fle.

— Të zgjohet!, — tha Agroni. — Duhet t'ia vëmë të dyja këmbët në një këpucë, — dhe vajti në kuzhinë. Pas

pak u kthye duke tundur kokën: — Të mos merrte frymë, do të mendoja se Demir Ullishtasi ia ka kthyer potkonjtë diellit. E tunda, e shkunda, nuk zgjohet!

— Lëre, — tha Kujtimi, — me të duhet të bisedojmë kur të jetë esëll!

— Do të bisedojmë ashtu, minatorçe!, — tha Demi. — Ç'janë këto broçkulla! Këtej dehet njëri e godit gruan, andej një grua si hije vete në radhën e qumështit, hap fjalë se Lim Thana na qenka martuar tri net në plazh, ia paska dhënë shqelmin asaj, paska zënë një tjetër. Këto të gjitha kanë një domethënie. Mirë tha Agroni: «Pas çdo rrebeshi, zgjohen disa krimba!».

«Po, pas çdo rrebeshi vërtet zgjohen disa krimba, — përsëriti me mend Kujtimi. Shumë mirë bëjnë shokët që çdo çështje sado intime, sado familjare që duket, e lidhin me situatën politike».

— Dem, kush i tha ato fjalë për Limin?, — pyeti pastaj.

— Ua tha grave tona një plakë te radha e qumështit, — u përgjigj Demi.

— Duhet të jenë shpifje, — tha Agroni. — Limin e njohim mirë. Nuk mund të jetë tjetër Lim në minierë, tjetër Lim në plazh.

— Edhe unë e njoh Limin, — tha Demi, — por vras mendjen, nuk e gjej, përse të thuren thashetheme. Pyeta cila ishte ajo plakë, askush nuk dinte të thoshte gjysmë fjale. *Si erë u duk, si gjiriz lëshoi fjalët, iku si furtunë, as fytyrën nuk ia pamë,* — thonë gratë.

— Kur bubullon, diku do të bjerë shi, — tha xha Dini.

— Sot është e diel, — tha Kujtimi, — nuk është keq të shkoni në Durrës, takohuni me Limin, nëse ka gjë, ai do t'jua thotë vetë.

— Kush të shkojë?, — pyeti xha Dini.

— Agroni dhe Demi, — u përgjigj Kujtimi. — Por kini kujdes, Limi është sedërli i madh. I thoni se keni shkuar për të kaluar një ditë në plazh.

— Të nisemi qysh tani, — tha Agroni.

— Prit, të merremi vesh, — tha Demi, — po nëse janë të vërteta fjalët e plakës, çfarë të bëjmë?

— Limi është shoku ynë, Limi është komunist, dihet

se është ca i rrëmbyer, nëse ka nevojë për ndihmën e shokëve, ia ofroni atë. Megjithëse nuk besoj në ato që janë thënë, së keqes i duhet zënë pusi. Nëse ka vetëm një grimcë të vërtetë, ia përplasni në fytyrë Limit, le t'i vijë pak hidhur, se edhe ilaçet janë të hidhura, po shërojnë sëmundjet.

— Po nisemi, — tha Agroni.

— Të lodhur jeni, pa gjumë jeni, — tha Kujtimi, — po s'kemi ç'të bëjmë. Edhe unë duhet të vija me ju, por, siç e shikoni..., — tregoi me kokë Afërditën, pastaj bëri me shenjë nga dhoma tjetër. — Unë më xha Dinin mjaftojmë këtu.

Dy minatorët u përshëndetën me Zanën e dolën.

— A mund ta shtrojmë në spital?, — pyeti Kujtimi Zanën.

— Tani nuk ka rrezik edhe nëse lëviz, — u përgjigj Zana. Ata thirrën urgjencën.

K R E U VI

Tek po i afrohej kullës së ashensorit, Kujtimin e ndali Bukuria. I foli me zë të vogël. Minatorët kujtuan se po i ankohej për Limin, por ajo as që e zuri në gojë atë punë, i foli për një ngacmim që i ishte bërë Diles.

Duke hyrë në kullën e ashensorit, këqyri Dilen, ajo ishte tepër e vrenjtur. Kujtimi i rrahu supet.

— Mos u shqetëso, — i tha, — nuk duhet të mërzhitesh!

— Nuk kam gajle për vete, — tha Dilja, — po më vjen keq për Ramën dhe Demin. Ata do të hanë kritikë për atë maskara.

Zhagan Dhoga që kishte qëndruar mbështetur pas kafazit të ashensorit, i doli nga prapa Diles dhe i tha:

— Ti je spiune! Ato janë përralla që i ke sajuar vetë. Nuk i ka plasur askujt barku për ty, aq më tepër mua. Ti je një qelbësirë!

Dilja mbërtheu levën e manevruesit dhe u mat ta qëllonte, po Kujtimi ia mbërtheu levën dhe e shtyu Dilen në kabinën e sinjaleve. Zhagani sërisht bëri ballë te dera.

— Ke për ta paguar shpifjen, nuk jam ndonjë horr që harron fyerjen! Vare vath në vesh.

— Ik, mor Zhagan, ik në punën tënde!, — i tha Kujtimi duke ia vënë dorën në bërryl.

— Hiqe putrën, — ia ktheu Zhagani, — kush ta ka dhënë atë të drejtë të më shtysh! Hajde, hajde, e quan veten edhe minator pararojë!

— Kujtimi shtrëngoi fort dorezën e kabinës së sinjaleve, sikur me atë shtrëngim të donte të mposhte në vetvete rrëmbimin.

— Ik, djalë i mbarë, ik!

— Nuk iki, ti konsideron dikë të njerkës, dikë të nënës!

— Cilët konsiderokam të njerkës dhe cilët të nënës, mor llafazan!

— Unë llafazan! Mbaje mend, për këtë do të përgjigjesh! Oi ky! Gjithmonë me kobure në brez! Ikën ato kohëra, a derëbardhë! Nuk zure mend ti!

— Pa më thuaj çfarë do?

— Dua t'ia thyej turinjtë asaj qelbësire!

— Zhagan, ik në punë, se për nder do ta pësosh!

— Jo, more! Mos, se na fute frikën!, — tha Zhagani dhe ua shkeli syrin disa minatorëve që po e shikonin si këqyret njeriu që u ka shpëtuar atyre të psikiatrisë.

Minatorët zbritën nën dhe, zbriti edhe Kujtimi. Punoi e u djersit tërë ditën, po mendja nuk iu hoq prej Zhagan Dhogës.

Mbaroi turni. Minatorët, pasi bënë banjë e pinë qu-mështin, u mblodhën në sallën e mblledhjeve (pesëminutëshi, siç i thonë minatorët) ku bëhej shoshitja e punës ditore.

— Shokë, — u foli minatorëve Kujtimi, — pasi u bë analiza, kemi vënë re se shumë shokë kanë pasion për të mësuar gjuhë të huaja. Kjo është një gjë shumë e mirë, sidomos për personelin inxhiniero-teknik, pasi literatura profesionale e domosdoshme nuk është përkthyer e tëra. Për t'ju ardhur në ndihmë juve dhe për t'i prerë rrugën tregtisë private, do të ndërmjetësojmë pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja e do të hapim këtu krahas shkollës profesio-

nale dhe teknikumit të minierave edhe kursin e gjuhëve të huaja. A jeni dakord?

Të gjithë e miratuan atë mendim.

— Ti më thoshe për shumë të tjerë se janë të rrezikshëm, — i pëshpëriti Zhagani Miho Gjelacit, — por dije se ky është më i rrezikshmi. I ka rënë në erë kursit tonë, nuk ka vend ku nuk i fut hundët Kujtim Kreshpa.

Miho Gjelaci psherëtiu.

— Është tepër i rrezikshëm, i tmerrshëm!, — pëshpëriti Zhagani Dhoga.

— Pusho, mor llafazan!, — ia pat Mihoja me një fije zëri.

Minatorët u shpërndanë, Mihoja nxori një pesëdhjetëlekësh të ri e ia lëshoi në dorë Zhaganit.

Sonte s'kemi përse të shkojmë në mensë, — i tha. — Bli një shishe raki dhe dy konserva mishi. Të pres në dhomën time!

Pas gjysmë ore ata mbyllën derën e ia shtruan me pije.

— Të them të drejtën, më vjen plasje, — filloi Mihoja, — jo se na e prenë një burim të ardhurash, por u mësova me dreqërit. Ishin djem të mirë. E kalonim kohën për bukuri. Sikur na e bënë për inat.

— Atij kam për t'ia rregulluar!, — tha Zhagani. — Ia kam bërë benë. E provokova me qëllim që të më qëllonte i pari. U mat, por prapë e frenoi veten. Jam i bindur se Rama dhe Demi të shtyrë prej tij më sulmuan. Fundja ç'do t'i dilnin në mbrojtje Diles. Ama ç'vithe ka ajo Dilja!

— Prapë me Dilen ti?! Gomarit ia hëngri vithet ujku, ai: «ëndërr ishalla!».

Zhagani qeshi, u shkoi pëllëmbën flokëve të gjatë që i ishin shkapërderdhur mbi fytyrë e foli:

— Ia shohim sherrin atij që e marrin për gomar. Unë di ç'bëj. Atij do t'ia punoj paq!

— Çfarë?

— Në minierë është lehtë...

— Si?

— Tjetri zbret në oxhak. Unë e përgjoj i afrohem oxhakut nga sipër, i lëshoj një bllok, trutë përshesh!

— Qenke i marrë, çuditëm si guxon të flasësh!, — provokoi Mihoja.

— Sikur flas me të tjerët. Të them ç'është për t'u thënë. Jam njeri i qejfit unë. Nuk i thonë shaka, për çdo javë fusnim tërë ata lekë në xhep. Atij Kujtimit s'ka për t'i dalë mirë. Ma ka bërë borxh edhe herë të tjera, por këtë herë...

— E kam vënë re. Vërtet po të bie në qafë. Po nuk e marr vesh ç'ka me ty, xhanëm! Fut hundët edhe në punët personale. Madje ka gojë e flet edhe për demokraci. Të pëlqen t'i mbash flokët të gjatë, mbaji gjer në brez, ç'i hyn në punë atij! Për t'i krehur nuk e bezdis, as para i kërkon për krehër. Po ti, Zhagan, mos bëj budallallëqe, se, po të diktuan...

— Nuk më diktojnë.

— Sikur të të diktojnë, njëzetepesëshin e ke pak.

— Di unë si t'ia rregulloj atij.

— Mor, po të diktuan?

— Ia mbath.

— Hë, ku?

— Në mal.

— Qenke i marrë. Në mal të kapin pa u mbushur ora. Bile edhe më parë, nëse nuk kalon malin.

— Të kaloj malin?!, — pyeti me hutim Zhagani duke shikuar bulat e rakisë që ngjiteshin nga poshtë lart. — Ç'më pandeh mua? Ndonjë qull?! Edhe e kaloj malin.

— Hi, hi, — qeshi Mihoja, — paske të dehur të lezeçëm.

— Ti kujton se jam i dehur.

— Gjersa më parë nuk më ke folur kësisoj, kam të drejtë të të marr si të dehur.

— Po të të kishte rënë njeri në qafë ty, — pyeti Zhagani, — ç'do të kishte bërë?

— Mua nuk më bie njeri në qafë.

— Po sikur?

— Unë për një copë fytyrë jetoj, Zhagan, nuk duroj. Dy duar për një kokë. Po nuk do të flisja më parë me askënd se çfarë do të bëja më vonë.

— Të kam thënë, ti je dhelpër e vjetër. Edhe unë nuk

do të flas më. Me vepra do ta tregoj. Sa mban prej këtej kufiri?

— S'më intereson mua kufiri, — u përgjigj flakë për flakë Mihoja.

— Pyes kot.

— Nja katër ditë e katër net.

— Miho, ti ke kujtime të pasura. Më trego ndonjë gjë, më zbavisin ato biseda.

Mihoja i foli për shtëpitë publike, për femrat, për paratë. Zhagani dëgjonte i mpakur nga kënaqësia.

— Andej bëhet jetë, — përfundoi Mihoja, — po neve... s'na takon ajo jetë. As duhet të merremi me biseda të tilla.

— Miho, ti je si ata që edhe ta tregojnë gjënë e bukur, edhe s'ta japin. S'ka rëndësi. Më ka rënë të bisedoj me shumë emigrantë që janë kthyer, ata e paraqesin skëtërrë jetën e andejshme. Thonë se ai që nuk ka, bën jetë qeni e shkuar qenit.

— Hi, hi, ndoshta janë të vërteta këto që thua.

— Ke të drejtë, edhe unë për gënjeshtër i kam marrë, po prapë pyes veten: përse janë riatdhesuar? Nuk janë një ose dy, po shumë. Të gjithë thonë se andej nëntëdhjetë e tetë për qind janë skamnarë. Thonë se andej jeta e skamnarit është më e keqe se e qenit të plakur.

— Hi, hi, — qeshi Mihoja, — ç'na duhen neve këto biseda. Ti pyet, unë nuk di si të përgjigjem, se nuk e kam provuar jetën e skamnarit.

— Po ç'dreqin u ktheve?

— Shkoi shyta të merrte brirët, i la edhe veshët. Më zuri lufta këtu.

— Cilin kishe këtu?

— S'ka rëndësi.

— Andej patjetër ke shumë mall?

— Kushërinjtë e mi kanë.

— Po ti qenke për tu përqaftuar, a derëbardhë! Përse nuk u shkruan. Kërkoju!... Ndonjëherë kur të bie ngushtë patjetër që do të ma zgjatësh dorën.

— Patjetër.

* * *

Diçka si e gjallë, diçka që përpëlitet përbrenda dhe i mëshon gjakut në vena me furi, diçka që grith, shpushpuri-
ritej me gulsh, llokoçitej në shpirtin e Zhagan Dhogës. Ish-
te ankthi i frikës që e pushtoi sapo rasti i afroi mundësinë
të zbatonte vendimin e marrë. Zhagani mendonte (dhe këtë
mendim ia ushqente edhe Mihoja) se, duke i bërë Kujtimit
një të keqe, do t'i qetësohej shpirti për të gjitha ato qortime
e kritika, për fyerjet përpara kolektivit. «Fundja, po ta
zhduk Kujtimin, unë për vete mund të livadhis si të dua kë-
tu», — mendonte Zhagani. — Kujtimi është më i rrezikshmi.
Nuk them se nuk ka edhe të tjerë, ka shumë. Po ky është
më i tmerrshmi. Këta të luftës janë më të tmerrshmit. Kuj-
tim Kreshpa ka krijuar një bërthamë të shëndoshë në mi-
nierë. Duhet minuar kjo bërthamë duke asgjësuar atë. Ja, e
detyrova atë Demir Ullishtasin të heqë dorë nga programet
kulturorë. T'i lërë djemtë të qetë me ato provat e përdit-
shme, po ku i lë Kujtimi. Atij i vjen doresh për gjithçka.
Duke goditur Kujtimin, godas të gjithë ata që m'i morën
ç'pata, që detyruan babanë tim të minojë depot e të digjet
i gjallë brenda. Duke përdorur Zhagan Dhogën, e fut për-
fundimisht në dorë këtë të fundit. Tyryfyl, tyryfyl, po ku
të gjesh tjetër, të bësh për vete një njeri në këtë sistem të
mallëkuar që i ka magjepsur të gjithë, është vërtet një fito-
re e madhe, një sukses. Dhe dihet, dihet suksesi...», — men-
donte Miho Gjelaci.

Atë ditë Zhagan Dhoga qysh kur kishte zbritur nën
dhé i kishte thënë minatorit të tij se i shkonte bark. Meqë
për nevoja të tilla në minierë duhet të ngjitesh lart, ai kish-
te përfituar e i ishte afruar oxhakut pesë. Buzë oxhakut
kishte avitur një bllok argjili për ta lëshuar në çastin ven-
dimtar. Mirëpo nëpër galeri kishte shumë lëvizje.

Ora njëzet e dy. Zhagani u përvodh për të katërtën
herë në traverbangun e sipërm. Duke ecur puq me murin e
galerisë, iu afrua buzës së oxhakut.

Fiku llampën mbi kapele. Dhëmbët i kërcisnin prej
frike. Brenda, në thellësi të oxhakut, midis katit të tretë

dhe të katërt dukej lëvizja e një drite. U dëgjuan krismat e mbytura të sçeparit.

Ishte ai, Kujtimi, që po përforconte shkallët e oxhakut. Zhagani e dinte këtë, e kishte parë pak më parë, ndaj dhe hapi dritën, e rrotulloi gjatë traverbangut, por s'pa njeri. Me duart që i dridheshin kapi bllokun e argjilit, e ngriti pezull, e leshoi tëposhtë oxhakut dhe ia mbathi në të katra. Traverbangu i ngushtohej. Ai u fsheh në kthinën e transformatorit. Fryma po i zihej. Vrapoi prapë. Te kthesa e traverbangut u përplas mbi kasat. Mori djathtas. Galeria i kthehej në vrimë gjilpëre. I dukej sikur zemra i ishte ngjitur te fyti, i zhurmonte bezdisshëm e ia pengonte frymëmarrjen.

«Do të më kapin! Ah, ç'më bëre, moj kokë budallaqe!».

Elektrovozi rrëshqiti për tek ashensori. Zhagani u mbështet midis dy kasave, pastaj eci shpejt. Doli në galerinë kryesore. Deshi të hynte në rrugëdaljen rezervë, te rënnori, po u frikësua mos takonte njeri dhe u fut nën pusin e dheut. Pikat e ujit i ranë mbi kokë e në qafë. Ai u mbloodh kutullaç. Copa balte i binin mbi gjunjë, mbi supe, ia ciklonin fytyrën. Deshi të ngjitej pusit përpjetë, por shkallët prej hekuri ishin të puthitura në kasa dhe të mbushura me baltë dhe s'kishte ku të kapej. Mbërtheu kovën e arganellës. Sa ndërroi dy-tri duar, rrëshqiti në llucë. Qëndroi pupthi. Dënesat ia tundën gjoksin. Frika po kthehej në një ankth frymëmarrës dhe mbytës.

— Hej, ç'bën në llucë atje? Cili je?, — u dëgjua një zë nga galeria kryesore.

Zhaganit i pushoi gjaku ndër damarë. Iu errësuan sytë e i ra të fikët.

Inxhinier Vangjushi dhe tekniku i turnit e ngritën, e nxorën prej balte, e ngjitën në sipërfaqe.

Zhagani erdhi në vete. Qante dhe nuk merrej vesh se ç'thoshte.

— Më shkante barku, — klithi ai.

S'kishte nevojë ta thoshte, se Vangjushi dhe tekniku, duke e zhveshur, zunë hundët me duar.

— Dile, — i thirri inxhinier Vangjushi sinjalistes, —

njofto Zeqon poshtë se ndihmësi i tij gjendet në sipërfaqe, i sëmure.

Zhagani bëri banjë e u vesh. Iu afrua kullës së ashen-sorit, u struk prapa saj i mbështetur mbi shtyllat dhe përgjonte në errësirë. Asnjë alarm.

«Domethënë nuk e paska gjetur gjë Kujtimin, — mendoj ai, — ndryshe do të bëhej alarm, do të bindej dreqi!». Priti shumë ashtu i strukur në errësirë.

Minatorët e turnit «Sulmi» po ngjiteshin në sipërfaqe. Zhagani me sy të zgurdulluar shikonte, përgjonte.

— ...I lumtë Ramës, — fliste një minator, — sapo dëgjoi zhurmë në oxhak, mbylli kapakun e nënkatit të katërt. Ndryshe Kujtimi...

— Rama vërtet vrau pak këmbën, po shpëtoi shokun, — tha një tjetër.

— Mirë që kishte mbyllur kapakun dhe po zbrapseej, se ndryshe s'do të mbetej vetëm me këmbën...

— Habitem, — foli një tjetër ndërsa po i afroreshin llampërisë, — nga u gjend ai bllok argjili sipër oxhakit të rrugëdaljes?! Opo ata të mirëmbajtjes duhen varur me kokeposhtë!

— Jo, mor vëlla, të mirëmbajtjes janë specialistë, nuk bëjnë punë shkel e shko ata.

Zhaganit i zunë sytë Ramën që iku andej duke çaluar. Pastaj u ngrit e, duke mbajtur barkun me dorë, shkoi në mensë. Edhe pse ishte i uritur, nuk hëngri gjë. Mori dy filxhana çaj dhe një pako biskota. Minatorët u futën në mensë grupe-grupe. Të gjithë diskutonin rreth bllokut të argjilit dhe shprehnin habinë sepse ishte e pashembullt të fluturonte një bllok i madh argjili përmes oxhakit të rru-gëdaljes.

Miho Gjelaci atë natë nuk u duk në mensë, po edhe Zhagani e pa të udhës të mos i shkonte në dhomë.

K R E U VII

Megjithëse mjeku kardiolog i pavjonit u shqetësua e u habit nga përparimi pa masë i sëmundjes, Afërdita sikur e mori veten dhe kërkoi me këmbëngulje të dilte nga spi-

tali. Rrugës për në shtëpi ajo mbante në pëlëmbët e veta dorën e të shoqit. Demirit iu mbushën sytë me lotë. Ai e ndiente fajin e madh, me sjelljen e vetë të hallakatur e kishte shpënë buzë varrit të shoqen.

Vetëm një njeri me karakter të dobët, një frikaman mund të barabitej me Demirin, i cili mori nëpër këmbë besimin e madh të shokëve, vetëm e vetëm t'i shpëtonte ndonjë kokëçarjeje që mund t'i shkaktonte denoncimi i atij njeriu që e kishte mbërthyer papritur aq fort me kthetra. Tek ia miklonte dorën e shoqja, atij iu mbush mendja se duhej të vente atje ku duhej. Disa herë kishte bërë orvatje të tilla, por ato kishin mbetur vetëm ethe mëdyshjeje midis mendimit e veprimit.

Gruaja e shikonte në sy, thua se lexonte mendimet e ngatërruara brenda karrocats që kavardiseshin me zjarrmi në kokën e Demirit. Ia shtrëngoi dorën. Atij iu kujtuan ditët e para të martesës dhe i erdhi mirë që u largua nga ngacmimet që e mundonin me muaj. I lindi një dëshirë e madhe që t'i rrëfente së shoqes diçka të gëzuar. Pasi u mendua, e gjeti me vend t'i kallëzonte se e kishte lënë pijen.

Faqet e Afërditës morën një ngjyrë rozë të nderur.

— Vërtet, Miri, nuk do të pish më? E thua për të më bërë qejfin?, — pyeti gruaja me një zë të ëmbël, të ngrohtë e të afërt dhe ia shtrëngoi dorën me ata gishtat e gjatë e të bardhë.

Demirit sërish iu kujtuan fjalët e mjekëve që ia kishin prerë shpresat së shoqes e iu drodh buza e poshtme. Vuri re sytë e mëdhenj të saj që prisnin përgjigje e foli:

— U kam dhënë fjalën shokëve!

— Cilëve shokë?, — pyeti Afërdita.

Demirin sikur e pickoi kjo pyetje, por e mbajti veten:

— Shokëve të mi minatorë, — u përgjigj ai, — kujt tjetër?

Afërditës, që e njihte mirë të shoqin, nuk i shpëtuan ato të dridhura zëri.

— Mos u zemëro me mua, — i tha ajo, — të pyes se ta dua të mirën, sa për mua...

— Çfarë sa për ty?..., — pyeti Demiri.

Gruaja qeshi në një mënyrë të çuditshme. Demiri e vështrroi gjatë. Rrallëherë kishte parë atë nur bukurie ku edhe buzëqeshja, edhe shikimi, edhe skuqja e faqeve, edhe ngritja hark e vetullave krijonin një harmoni magjepsëse.

— Përse më vështron ashtu! Bëhu burrë!... Sonte duhet t'i telegrafosh mamasë sime të vijë me ngut. Le t'i marrë fëmijët në qytetin e lindjes.

— Pse?!

— Vëllezërit punojnë larg shtëpisë, mamaja mërzhitet vetëm, pensionin e ka të mirë.

— Ç'do të thuash me këto, moj Diti?, — pyeti Demiri e sërish iu mbushën sytë me lotë.

E shoqja e shikoi thellë e tha:

— E njoh veten më mirë se askush tjetër. Ka kohë që ndihem shumë e këputur, po ditët e fundit... një pupël nga toka nuk mund të ngre. I kam të numëruara ditët. Oh, ç'po bëhem budallaqe, t'i lëmë këto, më thuaj diçka zbatëse.

— Çfarë të të them?, — ia ktheu Demiri.

— Të jesh më trim, të kesh më tepër besim te shokët dhe te vetvetja. Bëhu i këtillë për të mirën e fëmijëve...

«Mos ndokush di të fshehtë, — e gërryeu krimbi i dyshimit, — kjo më flet aq! Apo gratë kanë vetinë të heqjnë edhe mendimet dhe veprimet e pashprehura të burrave?!».

— Nëse e ke lënë pijen, — foli sërish Afërdita, — je burri më i mirë në botë!

Atë kohë shoferja e taksisë pyeti:

— Ky është pallati juaj?

Demiri përkuli kokën:

— Sa shpejt, — tha ai dhe zgjati dorën ta ndihmonte të shoqen për të zbritur.

— Jo, jo, dua të zbres vetë, — tha Afërdita. Dhe, porsa hodhi këmbën në tokë (duket ndjeu një goditje të beftë në zemër), fytyra iu ngërç, pastaj u zbardh fare. Demiri u lebetit.

Afërdita u përpoq të qeshte.

— Mos u frikëso, — i tha, — që një pickim i lehtë, — dhe u mbështet mbi supin e të shoqit.

Fëmijët dhe komshinjtë e pallatit u dolën përpara.
E ngjitën lart.

Në mbrëmje umbush hyrja ding. Gratë e minatorëve u erdhën për vizitë.

Demiri u shërbente vetë, edhe pse vajza mund ta bënte atë punë. Mundohej të qeshte, të fliste i shpenguar, për grave, që njohin mirë zymtësinë edhe nën maskën e çdo lustre, nuk u shpëtoi shqetësimi që fshihej prapa atyre fjalëve gjoja gazmore.

Zana Kreshpa që e dinte rrezikun që kërcënonte Afërditën, nuk e bëri veten, as u tha gjë shoqeve të veta.

«Do të vijë koha, — mendonte ajo me vete, — kur për çdo sëmundje, edhe për ato që janë kthyer në gogol, do të gjenden rrugë shërimi. Përpara nesh dalin detyra të mëdha. Duhet të punojmë natë e ditë».

Afërdita u ngrit, bëri dy hapa drejt derës e u tha shoqeve me shaka:

— Më falni, kam një fjalë sekrete me burrin, — dhe ua shkeli syrin. — Le të shërbejë vajza!, — i tha Demirit dhe i vuri dorën mbi bërryl. Kur doli në korridor, e pyeti: — E bërë telegramin? Nuk e ke bërë! Shko shpejt të lutem, mamaja duhet të vijë nesër!

Demiri hapi derën dhe iku, kurse Afërdita u kthye te gratë.

— Ama ia ke mbledhur Demirit!, — bëri shaka Shpresa. Afërdita duke buzëqeshur u ul në kolltuk.

— Edhe unë me Zizin tim merrem vesh, — vazhdoi Shpresa, — por, kur ka të bëjë me lekun, Zizi bëhet nopran. Më parë nuk e jepte tërë rrogën.

— *E more rrogën, Ziz?*, — e pyesja unë.

— *E ke në xhepin e brendshëm të xhaketës*, — fliste rëndë-rëndë Zizi. Unë i nxirrja, i numëroja e pyesja: — *Ziz, ku i ke lekët e tjerë?*

— *Ata janë pra! Ç'do më!*, — shtrej i nxehur Zizi. Përherë qepte nga një xhep të brendshëm nën astar. Kur ia gjeja, bëhej tym e më thoshte: — *Ti, Shpresë, ua kalon edhe atyre tagrambledhësve të Zog firaunit.*

Gratë qeshën, Sosja ndërhyri:

— Jo besa, Sherifi im tanë rrogën në shtëpi ma sjell.

Ama po i kërkove ndonjë hyzmet, skuqet si spec. Është zbutur tani. Disa vjet më parë Sherifit i vinte rëndë edhe kur e thërrisja në emër.

— Si kërkonte ta thërrisje?, — pyeti Afërdita që e zbavisnin ato biseda.

— Dihet, — u përgjigj Sosja, — unë atë «*hej, ti*», ai mua «*mori*».

Gratë qeshën, më shumë qeshi Afërdita.

— Shpresë, — tha Zana, — u trego shoqeve si ia gjete paratë e stivosura në dyshek.

— Ua kam treguar, — tha Shpresa.

— Neve jo, — foli Hana, e shoqja e Dem Qesatit.

— Zizi, — filloi tregimin Shpresa, — shpeshherë kycej në dhomën e gjumit. Një ditë djali i madh kërkonte të bënte detyrat, po e kishte lënë çantën mbi komodinë në dhomën tonë. Unë vura syrin në vrimën e çelësit. Ç'të shihja! Zizi ishte ulur këmbëkryq mbi krevat, numëronte para. Trokita në derë. Zizi mblodhi paratë. I vuri brenda në dyshek. Pastaj e qepi me ngut vendin e shqepur. Unë prapë trokita.

— Ç'ke, — thirri Zizi. Unë prapë syrin në vrimën e çelësit. Zizi filloi të zhvishej me ngut sikur ngrihej nga gjumi. — Ç'djall ke që ma prish gjumin?!, — thirri dhe mori çelësin mbi komodinë. Kur hapi derën, fërkonte sytë, shtriqej, gogësinte, shtirej sikur ishte zgjuar nga gjumi. Desha t'i thosha: «Ziz, ti qenke artist i mbaruar!», por më përgeu një mendim tjetër që më erdhi më i mençur se i pari.

— Më raftë pika që ta prisha gjumin, — i thashë dhe mora çantën. — Shtrihu prapë.

— Gjumi më iku, — tha Zizi dhe u vesh. Të nesërmen punonte në turnin e dytë. Sa erdha nga puna, shqepa dyshekun. Ishin një shumë e mirë. I derdha në arkën e kursimit dhe librezën e futa në vendin ku kishte fshehur Zizi paratë. Kur erdhi pesëmbëdhjetëditëshi tjetër, Zizi sërish mbylli derën nga brenda. Hapi dyshekun për të lënë lekët, po... nuk gjeti të parat e sa nuk luajti mendsh. E shqepi të tërin. E derdhi leshin në dysheme. Dísá herë e shkeli librezën me këmbë, po nuk i shkante nëpër mend ç'ishte ajo. Unë ndiqja nga vrima e çelësit, i ishin zgurdulluar sytë.

M'u dhimbs pa masë, në fillim u pendova... Ende qeshim kur e kujtojmë. Zizi thotë: *Drurin e kalb myshku, hekurin e bren ndryshku, kurse njeriun veset...*

— Nuk i fsheh më?, — pyeti Hana.

— Ç'ne, — u përgjigj Shpresa, — tani i derdh vetë në arkën e kursimit. Nuk fsheh paratë, po librezën.

Gratë qeshën e biseduan edhe ca, pastaj vajtën nëpër shtëpitë e tyre.

Të nesërmen, kur Demiri u kthye nga puna, në shtëpi gjeti vjehrrën. Po atë natë Afërdita u tha burrit dhe së ëmës:

— Kanë fjetur fëmijët?

— Po. Pse?, — ia ktheu me pyetje e ëma.

— Kam një amanet, — tha Afërdita.

— Ç'është ajo fjalë, moj Diti, — ia pat e ëma me zërin e trashë. Demiri shikonte herë vjehrrën me ato koska të mëdha, eshtake e energjike, e herë të shoqen të zbetë e të squllur.

— Mama, — foli Afërdita, — fëmijët merri me vete. Kujdesu për ta. Janë të vegjël, akoma kanë nevojë për kujdesin e gruas, Demirit nuk i vijnë ndoresh ato punë...

— Kujt i ngjave, çupë, — i foli rëndë-rëndë e ëma, — njeriu nuk e lëshon veten kaq shpejt!

— Si të them unë!, — ia pat Afërdita. — Demir, — thirri ajo, — ma jep dorën! Betohu se nuk do të pish më!

Demiri u betua.

— Të falem nderit, — tha Afërdita, — ke qenë burrë i mirë, të ishe pak më i guximshëm, do të ishe i mrekullueshëm!

Demiri thirri Zanën në telefon.

Pas pak ata erdhën të dy, Zana dhe Kujtimi.

Zana e vizitoi Afërditën dhe vështroi Kujtimin me nënkuptim.

— Zanë, — pëshpëriti Afërdita, — ma afro veshin!

Zana puthiti faqen me të sëmurën. Tjetra i pëshpëriti:

— Demiri nuk është plak, ai nuk duhet të mbajë zi për mua! Ka nevojë për kujdesin e një gruaje, sidomos të

shokëve. E mundon diçka. Të mos ngutej kjo sëmundje, do ta mësoja shkakun e brengës...

Zana deshi t'i kundërshtonte, t'i jepte kurajë.

— Mos fol, — pëshpëriti Afërdita, — Demiri është i dashur, i dhembshur, po nuk ka karakter të ngulur. E njoh mirë unë. Ai duhet të martohet. Nuk dua të dëgjoj asnjë fjalë!

Atë mesnatë Afërdita Ullishtasi vdiq.

Pas një jave, me gjithë kundërshtimet e Demirit, e ëma e Afërditës mori mbesën dhe nipin me vete.

— Amaneti i sime bije do shpënë në vend. Afërdita ishte e mençur, — tha ajo dhe iku.

Demirit nuk iu bë të ngulte këmbë, sepse e dinte që nuk mund t'ia dilte me fëmijë të vegjël.

* * *

Miho Gjelaci ishte tepër i gëzuar ato ditë. Edhe pse kishte aftësinë të fshihte çdo mendim, ndjenjë apo emocion prapa maskës së njeriut të përvuajtur, nuk e përmbante dot veten kur dëgjonte një emision të huaj pas mesnate që villte helm kundër vendit, Partisë dhe popullit tonë.

«Ka ardhur koha të lëvizim, — thoshte ai me vete. — Duhet tërhequr halla në Tiranë. Nëpërmjet saj do të mbaj lidhje me Llaqi Likon, me të tjerët! Duhet t'ua gërryejmë tokën nën këmbë këtyre».

Diãmanta vente shpesh në Tiranë. Takohej me Mihon, Sermen. Bisedonin gjerë e gjatë. Ajo u sillte lajme prej Llaqi Likos që e kishte kthyer mbiemrin në Fiku. Pra, Llaqi Fiku gjente mënyra origjinale për të mbledhur të dhëna që u kërkoheshin andej «forca e tretë», siç e quante Mihoja qendrën agenturale, për të cilën punonte.

Llaqi përherë udhëtonte me autobus. Përgjonte udhëtarët, sidomos ata të ndërmarrjeve ekonomike kur dilnin nga puna. Natyrisht përgjonte ndonjë llafazan dhe mendjelehtë, se cili është ai që përgojn problemet e punës në autobus. Llaqi Fiku fiksonte ato çfarë thuheshin dhe, sapo arrinte

në shtëpi, i shënonte në një bllok të veçantë e shumë konspirativ. Kishte mbledhur mjaft sish. Diamanta ia solli Mihos. Ky i fundit i çmoi dhe iu lut hallës ta përgëzonte Llaqin për punën e vyer.

«Të mos u ndahet punonjësve të naftës!», — ishte porosia e fundit për Llaqin.

Mihoja me Sermen e Diamantën e shoshitën mundësinë e ardhjes së kësaj të fundit bashkë me të dyja vajzat në Tiranë.

— Asgjë për punët tona vajzës, — këshilloi Mihoja, — Ekaterina është akoma e re, pak qejfleshë, ca mendjelehtë, nuk i dihet. Puna jonë kryesore është ta sjellim atë në Tiranë. Nëse nuk deshi ai maloku, do të gjejmë ndonjë sylesh, edhe sylesh, edhe me kredi. Kam plane në kokë, nuk dua të flas, pa i realizuar si duhet...

— Ti the se atij Demirit i vdiq gruaja, — tha Sermja, — përse të mos e rregullojmë me të?

— Është peshk i vogël Demiri, — tha Mihoja, — të mendojmë, ai nuk na ikën...

— Të martohet vajza ime me një të ve, — kundërshtoi Diamanta, nuk ju duket gjynah!

Mihoja deshi t'i thoshte: «Vajza jote ka ndarë dy burra!», por nuk e pa të arsyeshme të hapte avaze dhe foli tjetër për tjetër:

— Hallë, pa sakrifica, nuk fitohet asgjë. Vetë thua se nuk duhet të vdesim buzëplatur e zemërhelmuar.

— Ka të drejtë Mihoja, — tha Sermja.

— Se përmendëm Demirin, nuk e martuam Ekaterinën, puna është ta sjellim në Tiranë atë. Ndërkohë do të gjurmojmë ndonjë për të qenë. Cilido do të magjepsej nga Ekaterina. Këtë punë ia lër në dorë teze Sermes. Gjatë muajve të pushimit do ta nxjerr andej-këtej. Lëshojmë grepin. Midis peshqve që do t'i bien do të zgjedhim më të mirin.

Vendosën që Ekaterina qysh të nesërmen të vinte në shtëpinë e Sermes.

— Ekaterina duhet të zbatojë çdo këshillë timen, sa për mua, nuk duhet të mësojë asgjë, — porositi Mihoja dhe, pasi u tha natën e mirë, doli nga shtëpia e Sermes si hije.

Tek ecte rrugicave për në stacionin e autobusave, përpunoi copëza planesh për të ardhmen:

«Me Ekaterinën mund të ndjellim njerëz që na duhen... Ajo është e kolme, është magjepsëse, fatkeqësi që është ca mendjelehtë... Ç'theu zverkun ajo Afërdita! Kish-te filluar ta përgjonte Demirin në çdo hap. Ai e kuptonte këtë gjë. Po të jetonte edhe ca, do të ma zhvaste nga duart Demirin... Demiri ka shoqëri me nëndrejtor Bajazitin... Po arrita ta fus në dorë edhe atë, do të jetë sukses i lëvduar». Duke menduar asisoji, Mihoja u gjend në stacion e hipi në autobusin e minierës. Kur arriti në hotelin e beqarëve, ngjiti shkallët lehtë-lehtë, hyri në dhomë pa ndezur dritën, u zhvesh, u fut në krevat dhe mbuloi kokën me çarçaf.

* * *

Në kohën kur Mihoja po e përfytyronte veten guvernator të pasurive nëntokësore, madje dhe të të gjithë vendit, ndonëse po afronte mesi i natës, në dy pika të tjera të qytetit një i ri dhe një e re mendonin për ftohjen e marrëdhënieve midis tyre. Ishin Lim Thana dhe Bukurie Dema.

Vajza përpushej në krevat dhe vriste mendjen se Limi kishte ardhur prej kohësh nga leja dhe nuk e kishte takuar. Dy ditët e para kishte dërguar shokët e tij të merrnin llampën në llamperi. Tani vinte vetë, po kthente kokën prapa dhe zgjaste dorën. «Ato që u përhapën për të nuk paskan qenë thashetheme», — mendonte vajza. Ajo nuk kishte si ta dinte që Lim Thana dyshonte në dashurinë e saj qysh kur kishte përgjuar Zhaganin atë ditë në llamperi, ndaj i jepte vetes të drejtë ta gjykonte rëndë Limin.

Në të njëjtën kohë Lim Thana, shtrirë në kurriz, grindej me veten: «Nëqoftëse nuk është mendjelehtë Bukuria, do të kërkonte të sqarohej! Fajtori skuqet nga faji, nuk guxon ta shikojë në sy personin, të cilit ia ka punuar me të pabesë. Ajo më qëndron hundë e buzë. Thonë se da-

shuria i ngjan hijes, po e ndoqe, të ikën; nëse i kthen kurrrizin, të ndjek prapa. Nuk i ka bërë hesapet mirë. Si nuk më thonë shokët një fjalë!... Ajo biseda e Zhaganit në llamperi ishte fort e dyshimtë. Kaq poshtë të ketë rënë. Dhe me kë pa, me Zhagan Dhogën! Po pse më mbetet mendja tek ajo, xhanëm? Duhet të bisedoj me Bukurien. Nesër do të ngrihem herët, atje në llamperi do të shpjegohem për të gjitha». Me këto mendime agushitëse e zuri gjumi.

Të nesërmen udhëtoi në këmbë deri në minierë. Kur po i afrohej kullës së ashensorit, pa një vajzë dhe një djallë që bisedonin përpara llamperisë. Sa bëri edhe disa hapa në atë drejtim, i pa açik. Ishte Bukuria dhe Petriti, inxhinieri gjeolog i minierës. Petriti shoqëronte fjalët me lëvizje duarsh. Bukuria qeshte.

«Prandaj i është ngritur hunda Bukuries», — mendoi Limi dhe diçka si ndonjë gulsh përvëlues iu ngjit në fytyrë. U kthye mbrapsh e hyri në klubin e minierës.

Mihoja, që ishte ngritur herët, kishte dalë në dritare e priste të vinte nëndrejtori. Kishte vendosur ta qeraste me ndonjë fërnë. Ai vuri re Petritin me Bukurien që bisedonin dhe Limin që u kthye me nervozizëm.

«Qenka mirë të ngrihesh herët, — tha me vete. — Ja edhe një rast i volitshëm për të turbulluar ujërat. Lypset ngacmuar miza. Le të qelbëzojë mëria midis tyre si kutërbim gjirizi!», — dhe fërkoj gjoksin me një kënaqësi të madhe.

K R E U VIII

Atë ditë ata ndenjën gjer vonë në shtëpinë e Demirrit. Duke u kthyer, Kujtimi bisedonte me Dem Qesatin, Agron Lamën dhe me Lim Thanën.

— Demir Ullishtasit duhet t'i qëndrojmë afër. Ai ka një brengë.

— Të të vdesë gruaja, të të lërë me dy fëmijë, nuk është gjë e vogël, — tha Demi.

— Demiri ishte hallakatur edhe përpara se t'i vdiste gruaja, — tha Agron Mala.

— E kishte gruan sëmurrë, — tha Limi, — duket e parandiente humbjen e saj.

Kujtimi që i jepte vetes të drejtë të dyshonte, por jo ta shprehte dyshimin për shokun pa pasur ndonjë argument bindës, nuk u foli shokëve për ato që e mundonin. «Demiri ka diçka tjetër më të ndërlikuar. Jam i bindur për këtë. Por ec e gjej!», — mendonte ai.

— Demiri nuk pi më, i miri të afron me mirësitë, i ligu të largon me ligësitë. Të gjithë ne duhet t'i qëndrojmë afër, mund të na e hapë zemrën. Atëherë do ta kemi më të lehtë ta ndihmojmë, — tha më në fund Kujtimi.

*

*

*

Kaluan muaj. Demiri e kishte marrë disi veten. Një ditë i vajti në zyrë nëndrejtorit, po nuk e gjeti. Kur deshi të kthehej në depo, u ndodh ballë për ballë me Bajazitin tek po dilte nga kuzhina.

— Hë, Demir, — i foli Bajaziti.

— Kam një bisedë me ju, shoku nëndrejtor, — i tha ai.

— Unë po nisem për Tiranë, — ia ktheu Bajaziti.

— Mirë, bisedojmë herë tjetër, — tha Demiri dhe ndjeu një farë lehtësimi, sepse nuk dinte si tia fillonte.

— Hajde me mua, — i tha Bajaziti, — do të interesohem për një mikun tim në strehim. Apo do të furnizosh zjarrmëtarët?

— I kam furnizuar, për turnin tjetër do të vij, — tha Demiri.

— Epo shumë mirë, hajde, — tha Bajaziti. Hipën në makinë dhe u nisën.

Bajaziti mbaroi punë shpejt dhe e ftoi Demirin të pinin nga një krikëll birrë.

— Vemi, — ia ktheu Demiri, — ja këtu, në qendër.

— Bëra gabim që e përçolla shoferin, — tha Bajaziti, pastaj si me vete shtoi: — Na ka gjetur belaja me disa kokëkrisur si Kujtimi me shokë, të kërkojnë llogari edhe për harxhimin e karburantit. S'ka gjë, nisemi në këmbë.

— Ku?, — pyeti Demiri.

— Është një lokal, banakieri është një deli burrë, gatuan meze të shijshme, — tha Bajaziti.

Të dy ecën bulevardit, pastaj u kthyen në një rrugicë dhe sa s'u përplasën me Ekaterinë. Vajza u step një çast, pastaj përshëndeti Demirin me një buzëqeshje të përmbajtur dhe vazhdoi rrugën e vet, e bindur se dy palë sy mund ta përcillnin nga prapa.

Bajaziti u ndal i habitur. Pasi e ndoqi vajzën me një shikim tepër lakmues, pyeti Demirin:

— Demir, cila është ajo femër?

— Një e njohur, — ia ktheu Demiri.

— E kam ditur se je kavalier, njeri i mirë, por se je edhe..., — fjalët e pashprehura i plotësoi me një shkelje syri.

Demiri që e kishte hallin gjetkë, nuk u zgjat në atë bisedë. Bajazitin e breu kureshtja.

Hynë në një lokal të vogël, banakieri i priti me temerara. Demiri u habit, ai burrë i trashë e me pala dhjami nën gushë me sjelljet e tij i kujtoi dikë që s'po e sillte tamam ndër mend. Megjithatë nuk e bëri veten.

Bajaziti ngriti katër gishtat.

— Gati, — thirri banakieri me pala dhjami nën gushë dhe doli në aneksin e banakut.

Pas pesë minutave banakieri u gjend përpara Bajazitit dhe Demirit me një tepsi plot pjata ku çërronin ca mëlçi, zemra dhe shpretka të skuqura në zgarë. Edhe pse në atë lokal vetëshërbehej, banakieri solli edhe birrat e ftohta akull.

«Do t'i them përpara se të vë pije në gojë, — mendoj me vete Demiri, — se pastaj nëndrejtori mund të mendojë se isha i dehur», — dhe filloi:

— Shoku Bajazit, më mundon puna e atij të njohurit tonë.

— E cilit? — pyeti Bajaziti.

— E Miho Gjelicit, — u përgjigj Demiri.

— Ke të drejtë, Demir, — tha Bajaziti dhe, pa lënë tjetrin ta shpinte mendimin deri në fund, vazhdoi: — Mihoja është një ekzemplar i rrallë. I ditur, me horizont të

gjerë. Gjynah të punojë atje, kur atë punë mund ta bëjë edhe një njeri me më pak kulturë. Ne nuk ua dimë vlerën intelektualëve. Njerëz si Mihoja duhet ti mbajmë në pëllëmbë të dorës. Posi, t'i trajtojmë dhe të kërkojmë shumë nga ata. Edhe të ushtrojmë kontroll, posi!

— Shoku Bajaziti, unë desha...

— Atë punë e kam vetë parasysh, — e ndërpreu Bajaziti, — Mihoja duhet të rregullohet. Njeriu që di pesë-gjash-të gjuhë të huaja perfekt, nuk ka hije të punojë në galeri. Do ta rregullojmë. Hajde, ta ngremë, — përfundoi dhe trokiti krikllën me të shokut. Demiri piu pa e marrë vesh nëse nëndrejtori deshi t'i shmangej çdo bisede për Mihon, apo vërtet Mihoja ishte i padëmshëm dhe meritonte ndonjë trajtim tjetër. «Përse kërkon mina prej meje?!». — Kjo pyetje mbeti e ngulur si thumb në trurin e Demirit.

— Më trego si ke arritur të njihesh me atë bukuroshen?, — pyeti nëndrejtori, edhe pse ishte esëll.

Demiri nuk iu përgjigj. Kishte pesë muaj që nuk kish-te vënë alkool në gojë. Birra përnjëherësh ia gudulisi lakminë. Ai i thirri banakierit.

— Edhe dy dopio fërnët!

Bajaziti buzëqeshi në heshtje.

— Ia thënkë në të pirë! Nuk ka asgjë për t'u çuditur, njeriu që di të shijojë bukuritë e femrave siç qe ajo që pamë, merr erë nga të gjitha.

Demiri e ngriti me fund.

— Nuk më thua kush është ajo femër?, — pyeti Bajaziti. — Pyes, se nuk ma ka zënë syri në Tiranë.

— Atë, — tha Demiri, — mund ta marr për grua, po është mësuese... prapa diellit. Nuk mund ta rregulloj me punë në Tiranë.

— Kur ke miq, nuk duhet të shqetësohesh për një gjë kaq të vogël, — tha Bajaziti, edhe pse u habit pa masë që Demiri i ve, Demiri me dy fëmijë të merrte një vajzë, e cila, sipas Bajazitit, ishte në mos E bukura e Dheut, aty afër.

Ata pinë shumë. Demirin e zuri. Bajaziti u bë çakër-qejf. Meraku se mund të binte në sy duke pirë në orarin e punës nuk e shqetësonte, mbasi lokali ishte i veçuar dhe

nuk para kishte klientë. Tërë kuvendimi gjatë atyre orëve u bë rreth Ekaterinës. Nëndrejtori e nxiti Demirin të mos e humbiste rastin. Tjetrit iu hap hamësia. Harroi qëllimin për të cilin kishte kërkuar Bajazitin. Ndoshta e kishte zgjedhur atë njeri për t'ia hapur zemrën, jo vetëm se ishte nëndrejtor, por se ai gjithmonë i ishte afruar, asnjëherë nuk e kishte qortuar, siç bënin shokët e tij minatorë, as për pije, as për gabime të tjera në punë, sepse Demiri ishte nga ata njerëz të pakët që kritikën dashamirëse e ngatërronte me inate, me smirë, me dashakeqësi.

Ai i dha fjalën nëndrejtorit se qysh të nesërmen do të fliste për martesë me Ekaterinën.

— Nuk më the si u njohe?, — pyeti Bajaziti.

— Fare rastësisht, — u përgjigj Demiri duke gogësitur, —njëditëzaj, duke ecur përpara meje, i ra portofoli. Unë e pashë dhe i thirra. Ajo më falënderoi dhe me përzemërsi pranoi ta shoqëroja, meqë edhe rrugën e kishim bashkë. Rrugës më pyeti kush isha, ku punoja. Unë i fola për vete, midis të tjerave i tregova edhe se isha i ve. Ajo ofshani e pikëlluar dhe më foli për vete. Pak para se të ndaheshim takuam tezen e saj. Me të njihesha. Ja, kështu. Por mua nuk më mbushet mendja, shoku Bajazit, — tha Demiri, — kam pasur një grua që nuk i gjendej shoqja. Unë me sjelljet e mia e...

— Lëri ato, mor Demir, — e ndërpreu Bajaziti, — e kishe, por nuk e ke më. Ti nuk mund të kthehesh në murg për hir të kujtimit të saj. Je i ri, Demir. Jeta do jetuar, mor bablok!

Ai i foli gjatë Demirit, ky i fundit u bind se nuk duhej ta zgjaste më atë punë.

— Kur u ndanë, Bajaziti e porositi:

— Mos shko në minierë, nuk duhet të të shikojnë në këtë gjendje minatorët. Do të njoftoj me telefon, t'u them se je i sëmurë. Shko në shtëpi, fli. Punën e martesës mos e lër pas dore. Për ta vendosur në punë, interesohem unë.

Pas dy javësh Demir Ullishtasi u martua pa vujë e bujë. Muajin e mjalitit e kaluan në hotelin e ri të P.

Bajaziti e mbajti fjalën, u interesua për vendosjen e Ekaterinës në një shkollë të Tiranës.

Në katin e tretë të pallatit buzë bulevardit disa herë u ndez një dritë, disa herë u hap një dritare dhe nxori këmbën një burrë.

Qielli ishte i vrenjtur. Pas bubullimave të fuqishme rridhnin vija gjarpëruese të rrufeve verbuese. Pikat e mëdha të shiut formonin sixhima të pashkëputur dhe duke shin si stalaktite të argjendta rreth neoneve poshtë pallatit.

Kujtim Kreshpa u vesh, mbathi çizmet e u mbështoll me mushamanë e gjatë. Kur iu afrua derës, Zana ngriti kryet e foli:

— Kujtim, nuk dëgjon çfarë rrebeshi bën jashtë? Ende nuk ka aguar! Është e diel, automjete nuk do të gjesh.

— Tërë natën nuk më ka zënë gjumi. Ai drej oxhaku po na nxjerr telashe. Shokët më presin, po ti fli, se është herët, — tha Kujtimi duke dalë në sallon. Bëri të dilte, po u kthye, hapi derën e dhomës së fëmijëve dhe ndezi dritën. E bija, Dallëndyshja, rrudhi qepallat dhe vuri duart mbi sy. I biri që kishte lexuar gjer vonë, e kishte mbështetur librin mbi abazhur e flinte si qingj. Kujtimi i përkëdheli me shikimin e butë, fiku dritën, mbylli derën e zbri-ti shkallëve. Eci përmes bulevardit. Përpara këmbëve të tij vezullonin qindra pika shiu. Doli nga qyteti. Mbi asfalt rridhte një shtresë e hollë uji. Currilat shkapërderdheshin nën peshën e rëndë të hapave të minatorit. Mushamaja kërciste si llamarinë nga pikat e mëdha të shiut. Ai shpejtonte. Një erë e fortë që vinte nga gryka e lumit përplasej mbi degët e zhveshura të drunjve në të dyja anët e xhadesë. Pikat e ftohta ia rrihnin fytyrën. Po agonte. Kujtimi u kërrus, hapi mushamanë e futi kokën brenda. Ndezi një cigare. Kaloi në hekurudhë, eci sa mbi një traversë në tjetrën. Pastaj u ngjiti kodrës përprjetë. Kur arriti në majë të kodrës, pa se nga diga e rezervuarit në drejtim të tij vinte një burrë me fytyrën të mbështjellë me një shall të mëndafshtë me vija blu, të bardha e të kuqe. Kur e vuri re Kujtimin, burri u kthye me vërtik dhe eci gati me vrap drejt zabelit mbi rezervuar.

«Kush do të jetë ai njeri?! Ç'do këtu në këtë kohë?

Përse ndërroi rrugë sa më pa?», — mendonte me vete Kujtimi dhe iu vu prapa. Rezervuari ishte mbushur deri në buzë. Poshtë digës shllapavitej uji i turbullt në vorbulla. Nuk dukej nëse ishte mbyllur apo hapur kapaku i digës së rezervuarit. Sipër rezervuarit, nga zabeli rridhnin rrëkera. Burri që kishte mbështjellë fytyrën me shall u duk edhe një herë poshtë një trungu të trashë, pastaj u zhduk në zabel.

«Do të jetë ndonjë fshatar që ka ardhur për të bërë dru», — ndërroi mendje Kujtimi. Pastaj ndoqi rrugicën rrëzë bregut dhe zbriti në qytetin e minatorëve.

Turni i tretë e kishte lënë punën. Në qytezë mbretëronte qetësia. Vetëm nga hoteli shumëkatësh i minatorëve dëgjohej një këngë e shoqëruar me një kitarë. Meqë nuk gjeti asnjë prej shokëve të brigadës, Kujtimi kaloi prapa kullës së ashensorit, u fut në garderobë, veshi rrobat e minatorit dhe vuri kapelen mbrojtëse. Pasi provoi llampën, e fiksoi mirë atë mbi strehën e kapeles. Nuk u kthye tek ashensori si zakonisht, por te dishenteria numër 2. Hapi portën dykanatësh dhe filloi të zbriste.

Sapo iu përplas aroma karakteristike e galerisë, sytë i morën tjetër shkëlqim. Rrëzë trarëve, ku puthiten këmbët e kasave me kapelet, kishin mbirë dhe ishin rritur tufat e rrumbullakëta të myshqeve që ngjanin me lulebore. Një mi i murmë me qime vezulluese që ecte mbi tubon e ajrit, kur pa rrezet e llampës së minatorit, u ndal, currieloj veshët dhe lëpiu putrën me gjuhën e kuqe. U ul galiç mbi tub dhe s'ia ndau sytë minatorit gjer sa zbriti në galeri.

Kujtimi përkëdheli kërpuhat shumëngjyrëshe rrëzë një këmbë portozi dhe eci përmes shinave të katit të shtatë. Galeria merrte djathtas, pastaj zgjatej e thellohej tutje në zemrën e malit. Minatori rrotullonte kokën dhe hidhte dritën mbi çdo kasë, vëzhgonte armaturat. Mendimi që e kishte shqetësuar tërë natën edhe tani nuk i shqitej. Oxhaku numër 6 ua kishte prurë në majë të hundës. Ditë të tëra kishin punuar, po nuk kishin arritur as njëzet metro. Argjili tinëzar dhe i pabesë rrëshqiste si ndonjë nepërkë bojë hiri, prapa tij zvaritej uji i zi, i cili e gërmonte dheun rreth kasave, krijonte boshllëqe, pastaj shkëmbi kokëngje-

shur hidhte blloqe. Nuk i thonë shaka, treqind e pesëdhjetë metra thellësi. Presioni shtrydh si ndonjë përbindsh. Kujtimi me duart e veta kishte hapur shumë oxhaqe të tilla po oxhaku 6 e kishte lënë net të tëra pa gjumë.

Ky oxhak e kishte lënë pa gjumë edhe atë të shtunë mbrëma. Ishte përpjekur t'ia fshihte shqetësimin së shoqes, po ajo e kishte kuptuar. Kur iu afrua oxhakut të rrugëdaljes që të shpinte në katet e poshtme dhe u përgatit të zbriste, në ballë të katit të shtatë i zuri syri ca lëvizje dritash në mugëtirën e thellë. Ngriti dorën mbi kapele dhe fiku llampën e vet. «Atje është bërë katriazh këtu e ca vjet!, — mendoi me ankth Kujtimi. — Ç'janë ato drita?! Atje është i ndaluar shfrytëzimi i qymyrit! Sipër tij gjendet rezervuari! Ndoshta më bëjnë sytë! Ndoshta drunjtë e kalbëzuar, fosforitet». La oxhakun e rrugëdaljes dhe, duke u mbajtur mbi tubin e ajrit, eci me dritë të fikur.

Në galerinë qorre sërish lëvizën dy drita. Dëgjoheshin të çukitura të mbytura të një kazme.

«Kush punon atje?! Ndonjë i marrë që ka dëgjuar se kati i shtatë ka qymyr shumë dhe të një cilësie të lartë!». Lëvizja e dritave po dukej qartë. Kujtimi vrapoi i alarmuar. Ndezi llampën mbi kapele. Torba e baterisë i rrëshqiti përpara dhe ia pengonte ecjen. Mbërtheu torbën në dorë, po në vrapim e sipër ndeshi me kokë mbi guarnicionin e tubit të ajrit. Llampa iu shua, ai thirri me zë të lartë:

— Hej, kush punon atje!

Galeritë rikthyen jehonën. Në ballë të galerisë së shtatë një përzierje dritash. Sakaq pllakosi errësira e thellë e nëntokës. As u dëgjuan më kazmat, as u panë më dritat, as zhurma e preferatorit. Kujtimi e dinte se më tej gjendej edhe një traverbang i vjetër dhe një oxhak i braktisur ku mund të zbritej në katet e mëposhtme. Por si të shkonte deri atje përmes errësirës së trashë, ku njeriu pa drita është njëlloj si pa sy. Shqetësimi i ri sikur gëlltiti shqetësimin e vjetër për oxhakun numër 6. Meqë llampa i ishte thyer, u kthye nga kishte ardhur duke u mbajtur mbi tubin e ajrit. Me një mijë mundime arriti në sipërfaqe. I përbaltur dhe i vlarë në bërryle hyri në kullën e ashensos-

rit. Atë kohë u ngjii kafazi i ashensorit. Dyert u hapën me rropamë, që brenda doli inxhinier Vangjushi. Kur pa minatorin të zhyer me baltë, pyeti i habitur:

— Kujtim, ç'ne këtu? Mbrëmë ishte turni i dytë!

— Nuk më zuri gjumi, inxhinier. Në oxhakun numër gjashtë nuk vete puna mirë. U bë si puna e kalasë së Rozafës.

— Shko çlodhu, o i uruar. Sa po kthehem nga galeritë. Çdo gjë në rregull. Katriazhin që i ke bërë mbrëmë s'ka shkëmb që ta lëvizë.

— Punon njeri poshtë?

— Ku je bërë tërë baltë?

— Pyeta, punon njeri poshtë?

— Po.

— Kush?

— Anëtarët e brigadës sate.

— Cilët?

— Limi, Zizi, Rama dhe Qenani.

— Keni ngarkuar ndonjë njeri për ndonjë riparim në katin e shtatë?

— Jo.

— Ashtu!, — tha Kujtimi dhe u nis për në llamperi që të këmbente llampën.

— Prit, — i tha inxhinieri, — në katin e shtatë mund të ketë qenë Limi dhe Zizi. U duhej një dispozitiv, kanë bredhur të gjitha galeritë.

— Inxhinier, më jepni llampën tuaj, meqë erdha, të zbres të shikoj gjashtën kryeneçe.

Inxhinieri tundi kokën, qeshi me dashamirësi dhe i shtriu llampën bashkë me baterinë.

Kujtimi zbriti me ashensor. Mbasi pa dhe u sigurua se oxhakun numër 6 nuk e gjente gjë deri të nesërmen, kërkoi shokët e brigadës së vet. Asgjëkundi s'i pa. Gjetei vetëm dy lopata, një kazmë, një karel dhe një dispozitiv, të cilit nuk i punonin dy rondele.

«Janë shpërndarë për të gjetur një dispozitiv... Dome thënë s'më paskan bërë veshët, as sytë. Po pse nuk u ndalën kur u thirra?! Ndoshta nuk më kanë dëgjuar». — Kështu foli minatori dhe u ngjiti në sipërfaqe.

Demirit iu dukën të këndshme ditët e para të martësës. As mund ta barabiste Ekaterinën me gruan e parë. E dyta nuk fliste, pothuaj cicërinte. Demirit i pëlqenin ato fraza të zgjedhura plot tingëllime të ëmbla. Harroi edhe hallet e brenat që e mundonin. Me një fjalë i thoshte jetës: «Zgjatu pa telashe e kokëçarje!».

Erdhi shtatori. Ekaterina u vendos në një shkollë në Tiranë. Sa mori njoftim në seksionin e arsimit, u kthye në shtëpi me një frymë:

— Tirana, — i tha ajo të shoqit tepër e ngazëllyer, — Tirana! Ah, Demir, sa e lumtur jam! — E puthte, e përqafohte, hidhej nëpër dhomë. — Tani, Demir i dashur, do të më dëgjosh. Ti je i zgjuar, i pashëm sa mund të bëhem xheloze. I zgjuari është edhe i dëgjueshëm. (në çaste ekzaltimi ajo i harronte porositë e Sermes). Demir, e di se nuk dua njeri tjetër në botë më shumë se ty! As mamin, as Giçin, askënd, askënd. E more vesh? Dëgjo, pra, të presim shtatë-tetë muaj, nëntë është shumë. Ti vetë më the se në depo do të qëndrosh përkohësisht, prapë do të kthehesh atje në thellësi. Pra, pas shtatë-tetë muajve...

— Çfarë?, — pyeti Demiri.

— Do të ma bësh qejfin, i shtrenjti im!

— Fol, se po të dëgjoj.

— Do të largohesh prej miniere!

— Të largohem prej miniere?!

— Ah, ky romantizmi yt! Të dua pa masë, prandaj them të largohesh prej andej. Ti do të futesh në thellësi të dheut. Dridhem se mos të gjen ndonjë e keqe në barkun e zi të malit.

— Njeriu më i pasigurtë mund të jetë në çdo punë sesa në minierë, — tha Demiri.

— Po aksidenti që të ka ndodhur?

— Isha i pakujdesshëm, të tillë aksident mund të pësoja edhe midis bulevardit, — ia ktheu Demiri.

— Oh, ç'më thua, ti mendon se ke të bësh me ndonjë injorante, s'ke faj zaten, të tillë e ke pasur rastin... Sa kam lexuar unë për minierën, sa di unë për të, nuk di as ti!

— Ti nuk di asgjë për minierën.

— Çdo mbrëmje, sidomos kur mendoj se pas disa muajve do të futesh e të punosh ku ke punuar më parë, më shungullojnë veshët. Dëgjoj të gjallë hingëllimin e kuajve të verbër që tërheqin vagonat nëpër shpella.

— Të thashë se ti nuk e njeh minierën tonë.

— Pse, nuk është kështu si them unë? Nuk punoni dhe jetoni së bashku me kuajt e verbër e të shkretë që nuk e shikojnë kurrë dritën e diellit? Mos më thuaj jo, kam lexuar dhjetëra libra për minierat.

— Zherminalin, apo jo?

— Zherminalin dhe të tjerë, e di vetë.

— Do të të marr në minierë, të shikosh vetë se si punojmë. Eh, moj shoqja profesoreshë, — tha Demiri, — minierat tona janë moderne. Atje punojnë makineri nga më modernet, elektrovozi tërheq vagonat, jo kuajt e tu të verbër!

— Ashtu mund të jetë, po unë jetoj me frikë për ty. Më mirë të gjesh ndonjë punë për të qenë. Ti nuk je ndonjë minator i rëndomtë, je burrë me sqimë, me talent, e njeh artin, muzikën, do të gjesh ndonjë punë për të qenë brenda në Tiranë, — tha Ekaterina dhe filloi të kërcente e të këndonte.

Për çudinë e Demirit, Ekaterina herë grindej, herë i hidhej në kraharor me dhele. Nuk po mësohej me atë karakter që ndryshonte kryekëput nga ai i Afërditës. Megjithatë përpiqej të mos u jepte rëndësi grindjeve. «Fërkime të zakonshme, — mendonte ai, edhe pse një gjë e tillë nuk i kishte ngjarë me gruan e parë, — ndoshta i kalon çdo çift i martuar risht. Lumi në burim gjithmonë është i dallgëzuar, rebel. Po, kur bie në shtratin e vet, shtrohet, ndjek rrjedhën kokulur».

Demiri i gëlltiste të gjitha, po, kur Ekaterina i fliste me përçmim për minatorët ose kur përgojonte ndonjë kolegë e vet me fjalët: «E ç'mund të presësh nga një fshatare, e cila ndoshta akoma ruan në fund të sëndukut çitjanet...», i vinte plasje. Këso rastesh i fliste gjatë, ndonjëherë edhe rrëmbehej.

Shamata e madhe plasi në fund të atij nëntori. Kjo e

bëri Demirin të dyshonte se nuk ishin zënka të zakonshme çiftesh, po diçka më tepër.

Kishin ardhur fëmijët e Demirit. Ai nuk gjendej në shtëpi, Ekaterina i kishte shpënë në një ëmbëltore, u kishte blerë nga një pastë dhe i kishte përcjellë me trenin e mesditës. Edhe kur erdhi i shoqi, ajo nuk i tregoi gjë. Demiri mori vesh nga fqinjët. E qortoi, ndërsa ajo ia ktheu:

— Lëre që unë vajta të mora ty, burrë të ve, po dashke të të rrit edhe fëmijët. Mos pandeh se jam dado! Këto gjëra mos m'i thuaj më, se nuk do të duroj!

Zënka do të merrte përmasa, po Demiri bëri udhë, u mjaftua me një qëndrim të ftohtë që i mbajti disa ditë me radhë.

Si gjithnjë, edhe atë fund nëntori, turni, nga ishte larguar përkohësisht Demiri, do të festonte tejkalimin e planit.

Demiri e prishi mërinë me të shogën, e ftoi të shkonin në festim.

— Ua, ç'më mërzite me këta minatorët e tu! Si nuk zgjodhëm një shoqëri për të qenë, ku të ta ketë ënda të bisedosh e të dëfresh!

— Ç'të mungon në shoqërinë e minatorëve?, — e pyeti Demiri.

— Nuk thua: ç'mund të më zbavitë në shoqërinë e tyre! Le të të vijë keq, po më duken njerëz të trashë, pa poezi, ose më mirë të them me një poezi folklori. Të zinin ndonjë shoqëri të mirë, do të thyenim monotoninë. Më zbavisin njerëzit që karakterizohen nga një poezi e hollë, timide, moderne, që të mallëngjen.

— Unë nuk e di se si e qysh e ke kaluar në shoqëri të tjera, — i tha Demiri, — ne festat i gëzojmë bashkarisht.

— Më vjen keq, një njeri me talent si ti, është kthyer prapa, u je përshtatur njerëzve primitivë!, — tha Ekaterina.

— Se kush është primitiv, ne apo ata, këtë mund ta shikosh vetëm pasi t'i kesh njohur mirë minatorët!

— Po unë nuk kam fustan për minatorët, ata janë aq prapa botës, sa që nuk dinë fare ç'është moda. I ngushtë është intelekti i tyre, ndaj nuk dinë të ecin me kohën. I

pashë, i njoha. Dy herë udhëtuam bashkë me autobus dhe shokët e tu zgërdhiheshin e pëshpërisnin duke parë fustanin tim. Ty të shikonin me një farë mëshire. Ti duhet të më kuptosh, sepse... nuk je si ata. Vetëm zgjuarsia jote të ka shpëtuar nga prangat e konservatorizmit.

— Kush është konservator sipas teje?, — pyeti Demiri.

— Të gjithë minatorët!

— Pse?

— Ata duan që edhe një universitare si unë të mbajë fustanin nën gju siç i mbajnë hanëmet e tyre. Ata shkojnë kundër kohës, kundër rrymës. Kur ia thashë një ditë asaj Shpresës, së shoqes së Zizit, pati paturpësinë të më shiste mend: *Ne kemi kohën tonë*, — më tha. — *Nuk marrim hua si papagalli mënyrat e jetesës së borgjezisë. Bota duhet të imitojë modën tonë, jetën tonë, se ne jemi shumë më përpara se të tjerët!* — Dhe cila më fliste kështu? Një grua minatori. Një grua që merret tërë ditën me hekura!

— Shumë mirë të paska folur Shpresa! Ngrehu të shkojmë!, — i tha Demiri.

— Ja ku po ta them, unë nuk vij. Do të mbyllem në shtëpi. Ti thyej qafën, po deshe!, — dhe përplasi këmbët në dysheme. — Po shkove, do ta pi tërë shishen e flebolit.

Minatorët e festuan për mrekulli atë pasdite dëfrimi. Demiri qëndroi vetëm njëzet minuta në lokalin ku kishin zënë vend shokët e tij.

— Më falni, — u tha shokëve, — shoqen e kam pak pa qejf, — dhe iku.

Pas festimit, Kujtimi dërgoi te Demiri të shoqen, Agrosin dhe dy minatorë. Ekaterina nuk u zgjua. Demiri i priti i hutuar. Vizitorët vunë re mbi tavolinë një shishe verë të përgjysmuar dhe pak kaçkavall.

— Ku e ke amvisën?, — pyeti Zana.

— Në dhomën e gjumit, — u përgjigj Demiri.

— I kaloi?

— Besoj, — u përgjigj Demiri me belbëzim, — një dhembje koke. Do t'i kalojë.

Zana doli në dhomën e gjumit. I erdhi pështirë kur pa Ekaterinën me flokë të shpushpurisur dhe me sy të buhavitur.

— Kati, — i foli ajo me zërin e ëmbël, — ç'ke, moj xhane?, — dhe ia vuri dorën në ballë: — Temperaturë nuk paske. Prit të ta vë termometrin!

— Jo! Vërja atij, ai ka temperaturë.

Zana s'po e kuptonte. Ekaterina u ngrit ndenjtur.

— Zanë, vetëm me ty më hahet muhabeti. Me ata nuk më shkon...

— Cilët janë ata?, — pyeti Zana. Në zërin e saj ndihej zemërimi.

— Ndryshe është burri juaj, — vazhdoi Ekaterina, — ai ka qenë i zgjuar, ka përfituar prej jush, nga edukata juaj, kultura juaj, kurse ky imi...

— Kujtova se kishe dhembje koke, — ia pat Zana, — nuk e dija se ishe sëmurë. Dua të bëj një korrigjim të asaj që the më parë: Kujtimi nuk ka përfituar prej meje, sa kam përfituar unë prej tij.

— Kujtimi është me shkollë, kurse ky imi...

— Të mesmen ka mbaruar im shoq, të mesmen ka Demiri. Ekaterinë, mos e kërko lumturinë në qiell. Ajo gjendet mbi tokë, kërkoje, se do ta gjesh.

— Mbi tokë gjendet, po jo në nëntokë!

— Ti, moj nuse, je mbyllur në guaskë, dil prej saj, futu në botën e madhe të shoqeve dhe shokëve të Demirit. Atje do t'i gjesh të gjitha ato që të mungojnë.

— Intelektuale jemi të dyja, — tha Ekaterina, — por ndryshokemi prej njëra-tjetrës. Unë eci me ritmin e kohës, kështu ecën bota e kulturuar, bota moderne, kurse ti... Nuk e besoja.

— Sa mirë që e ditke! Pandehje se nuk ndryshojmë, por ndryshokemi me gjithë mend.

— Nuk desha të ta them troç, por ma bëre borxh: ndryshimi qëndron këtu, unë e them atë që ndiej dhe mendoj, kurse ju e fshihni!

— Ndjenjat dhe mendimet e tua lypsen parë mirë. Në to dëgjohet gërhamja e së vjetrës!, — tha Zana dhe doli prej dhomës.

Qëndruan edhe ca. Demiri shikonte përdhé.

Agroni këqyri Zanën. Vuri re në qafën e saj një damar që rrihte me nxitim.

— Demir, hajde me ne, dalim!, — i tha Agroni.
— Është vonë, — u përgjigj Demiri.
— Nuk është vonë.
— Jo, jo, do të qëndroj në shtëpi, — tha prerë Demiri.
Zana me tre minatorët dolën. Atje në rrugë i priste Kujtimi. Dy minatorët u ndanë, Kujtimi, Agroni dhe Zana nuk hipën në autobus. Ecën në këmbë.

Kujtimi e pyeti Agronin:

— Si i kishin punët?
— Mbi fytyrën e Demirit sërish duket ajo maska tragjike, — tha Agroni.

— Po Ekaterina?, — pyeti Kujtimi.

— Asaj i kishin hipur kacabunjtë!, — u përgjigj Zana.

— ?...

— Kujtim, — tha Zana, — e kam parë me një farë dyshimi atë martesë.

Agronit diç iu kujtua, shikoi orën dhe kërkoi lejë për t'u larguar. Kujtimi e vështroi në mënyrë pyetëse e i tha:

— Mirë, Agron, do të bisedojmë nesër për Demirin.

Agroni buzëqeshi, sepse e mori vesh që shoku i tij ia dinte hallin, u tha natën e mirë dhe u nda.

— Kujtim, — tha Zana, — për Ekaterinën nuk flasin mirë. Ajo në fillim diti t'i fshihte thonjtë. Sonte kuptova më shumë nga ç'flitet për të.

— Edhe unë kam dëgjuar. Por mendoja se shoqet e shokët tanë do të punojnë me të, pandeha se mund të bënte kthesë.

— Mund të bënte kthesë, sikur ajo të pëlqente ndonjë këngë tjetër, bie fjala «Fshati im i dashur», por asaj nuk i hyn në sy asnjë këngë përveç «Tirana, e bukura Tiranë!» dhe as vë ujën në zjarr të përpunojë vetveten. Pak besoj tek ajo femër.

Prej asaj dite Demiri filloi të pinte sërish.

Minatorët, tek e shikonin të brengosur, thoshin midis tyre:

— Do të jetë grindur me atë!

Ata ndërhyjnë me takt në kolektivin ku punonte Ekaterina. Dërgonin gratë e tyre për ta marrë Ekaterinën. Ajo sillej ftohtë me to. Gratë e minatorëve kishin shfrytëzuar

rastin, i kishin folur asaj për harmoninë e tyre bashkëshortore. Po Ekaterina sa shkante bëhej më kryeneçe. Më sakt ajo po hiqte maskën. Kjo ishte në kundërshtim me edukatën dhelparake, me të cilën e kishte ushqyer e ëma. Ekaterina nuk kishte një karakter të ngulitur. E ëma nuk kishte guxuar t'u fliste hapur të bijave kundër pushtetit popullor, kundër socializmit, sepse frikësohej mos llomotisnin. Gjithmonë në mënyrë të tërthortë, duke u ankuar për padrejtësi gjoja që i kishin punuar persona të veçantë, ajo u kishte mëkuar një urrejtje ndaj punës dhe ndaj çdo gjëje të re. U kishte mësuar vajzave se nuk duhej të ishin të singërta me asnjëri dhe asnjëherë. «Të gjithë njerëzit janë të ligj, — u thoshte ajo, — secili mundohet t'ia hedhë tjetrit». Dhe gjëja më e madhe, me të cilën krenohesh që kishte bërë ajo për vajzat, kishte qenë përpjekja për ta rregulluar punën që të ktheheshin edhe një herë në Tiranë.

Ekaterina nuk përfillte as këshillat e Sermes, e cila nuk mund t'i fliste dhe aq hapur për qëllimin që kishin pasur ata kur kishin luajtur çdo gur për ta sjellë në Tiranë. Ekaterina ishte mbërthyer nga pandehma që shpeshherë e bën njeriun të fluturojë pa pasur flatra. Pasaportizimin e kishte bërë, e kishin emëruar në një shkollë në mes të Tiranës, këto edhe kishin qenë fillimi i ëndrrave të saj. Fundja, sipas saj, edhe Diamanta, edhe Sermja për këtë qëllim i kishin folur.

Kishte harruar ajo se vendosja e saj në Tiranë pa kërkuar asnjë të dhënë për personën e saj ishte bërë vetëm në saje të ndërhyrjes së nëndrejtorit të minierës, i cili u kishte thënë atyre të seksionit fjalët më të mira për Demir Ullishtasin.

Mihoja e kishte ndjekur ecurinë e saj hap pas hapi. I vinte plasje nga ato sjellje, nga ajo mospërfillje e urdhrave të tij që i transmetoheshin asaj nëpërmjet Sermes. Edhe pse me druajtje, bile këtë e quante një farë sakrifice për punën dhe kujdesin e tij, Mihoja e rregulloi nëpërmjet tezes dhe e takoi.

— Kushërirë, — i tha, — nuk duhet të harrosh se rrjedh nga një klasë që quhet e përmbysur. Një gabim yti i vogël shihet në xham zmadhues, ç'ndfishohet, do t'u nxje-

rrësh avaze edhe nënës që të rriti, edhe motrës që nuk jeton keq! Ç'janë këto broçkulla!

— Mos ke gisht edhe ti, — ia kishte përplasur Ekaterina, — në martesën time me atë të ve? Me atë rondokop që është kthyer në hije të minatorëve injorantë! Mëso pra, kusho, se unë dua ta thith deri në palcë jetën. Nuk jam e prirur as për heroizma, as për të lënë ndonjë emër prapa. Në fëmijninë dhe rininë e hershme nuk m'u dha mundësia, tani nuk do të lë kusur.

Mihos i erdhi ta mbërthente për flokësh, ta rrihte mirë, po iu kujtua se asisoji do t'i prisheshin tërë planet e tij të kurdisura me kujdes, mbuloi skërmitjen me buzëqeshje e u detyrua të thoshte:

— E dashur Kati, unë të kuptoj shumë mirë, po të ishte koha dhe mundësitë, unë do të bëja çmos që ta gëzoje jetën ashtu qysh ta do zemra. Po të flas, se ta dua të mirën, se kam frikë për ty. Ia dua të mirën dhe jam përgjegjës për jetën dhe mirëqenien e hallës sime. Po vazhdove kështu, do të të telendisin. Do të ta shohin sherrin edhe Diamanta, edhe Giçi. Ke harruar në ç'botë jeton. Unë që po të flas, nuk jam ndonjë murg, por, siç sillesh ti, veç një i marrë bën.

Ekaterina u buzëqeshi këshillave të djalit të dajës. I tha atij se në të ardhshmen do të ishte më e kujdesshme, se nuk do të mendonte vetëm për veten e saj, por edhe për të ëmën e të motrën.

Mihoja, edhe pse nuk i besoi, nuk e gjeti me vend t'i fliste më gjatë hëpërhë.

Ekaterina i kishte hapur zemrën një shoqeje të saj mësuese, me të cilën njihej prej kohësh.

— Më i ftohtë se akulli më duket ai. E ç'do të kërkosh nga një copë minator!

— E ke me gjithë mend?, — e kishte pyetur shoqja, — Përse u martove me të, kur...

Ekaterina kishte qeshur në një mënyrë misterioze.

— Po më habit, moj Ekaterinë, nuk më besohej se edhe në kohën tonë u gjendkan të tilla!

— Pretendime të tilla kanë edhe vajzat, baballarët e të cilave kanë pozitë të lartë në... E dashur kolege, duhet

të njohësh dialektikën e zhvillimit, rritet mirëqenia, rriten kërkesat. Bota e madhe po përparon, ne duhet të ndjekim hapin e saj.

— Botës i duhet të bëjë atë që bëmë ne më 29 Nëntor 1944, të ngutet shumë për të na zënë ne!...

Ekaterina e kishte ndërprerë.

— Mos më bëj politikë; jemi kolege, një pregatitje kemi.

— Si të duash, — ia pat mësuesja, — por dije mirë, me këto që paske në kokë, dëm askujt nuk mund t'i bësh, vetëm vetes, se ne ua kemi shtypur kokën edhe gjarpërinjve më të mëdhenj, e jo më krimbave.

— Mos i ngatërro gjërat, për politikë s'të fola. Përse më fut në të thella! Të fola për burrin!

— Bëj fëmijë, Ekaterinë! Ndoshta fëmija të bie në vete.

— Uh, ç'këshillë klasike, — ia ktheu Ekaterina, — më dashke të mirën! Tani që jam kaluar, kurrën e kurrës! Po të gjendesha andej në fshatrat e humbura, edhe mund ta bëja një gjë të tillë. Do të sakrifikoja për të ardhur në Tiranë. Tani jam brenda. I them edhe atij të kërkojë një punë për të qenë brenda në Tiranë. Ai, jo vetëm që nuk pranon, por fillon e më mban leksione. Një copë minator t'i mbajë leksione një gruaje me shkollë të lartë! Më vjen plasje!

— Edhe Demiri mund ta mbarojë shkollën e lartë. Edhe ti me korrespondencë e ke mbaruar. Madje, ai mund ta mbarojë ashtu si duhet, duke u mbështetur në forcat e veta. Jo si ti që... Ti e ke të qartë, se të njoh mirë.

— Jam e zonja, më lumtë. Më kënaqin gjërat që fitohen lehtësisht. Kur të bie bretku, s'ka ç'të duhet as fitorja.

— Bëj fëmijë, ndoshta dashuria për fëmijën të sjell edhe një fije mend.

— Më quajnë gruaja e minatorit, po nuk do të lejoj të më quajnë edhe nëna e minatorit. Po ti mos i fut hundët në punët e të tjerëve, ndryshe të mbeten brenda!..., — e kërcënoi Ekaterina.

Pëshpëritej se Ekaterina paskësh qenë e fejuar, madje edhe dy herë e martuar. Po më e keqja ishte se tani ajo nuk rrinte rehat.

— Unë do ta verifikoj, — tha Bajaziti, — ti mos u ngut, po qe ashtu, do t'ia rregullojmë samarin ndryshe Ekaterinës! Prit, e ke parë vetë, apo të kanë thënë?

— Unë e kam marrë vesh i fundit!, — tha Demiri.

— Mirë, mirë, shko në depo. Do të bisedojmë.

Bajaziti filloi të shëtiste nëpër zyrë. Iu afrua dritares. «Po, — tha me vete ai, — për mua do të jetë fjala. Një nëpunës, kështu i kanë thënë këtij torrollakut. Nuk kanë guxuar të përmendin emrin tim! Kush mund ta ketë bërë këtë? Lim Thana më ka përgjuar. Ai më shikon si ndonjë ujk i ndërkryer. As më përshëndet. Ia rregulloj ndryshe atij».

* * *

Bukurien, edhe pse e singertë dhe e ndershme, qëndrimi mospërfillës, gati armiqësor i Limit (ashtu i dukej asaj) e mundonte. Shoqëria me Petritin e bezdiste, ajo nuk kishte si t'ia tregonte udhën se tjetri jo vetëm nuk i kishte thënë asgjë të pahijshme, por vuri re se ai shoqërim i ri Limin e bënte xheloz. Secila femër e ndien se xhelozia nuk lind kot në shpirtin e një djali. Sipas saj Limi vetëm asisoji do të ulte hundën dhe, ose do t'i kërkonte falje për sjelljen prej kapadaiu, ose do të pajtohej pa e zvarisur atë punë.

Shoqërimi i Petritit me Bukurien Limit i shkaktonte një brengë të madhe. I vinte zor t'ua hapte zemrën shokëve, ziente në vetvete. Të gjithë shikonin se si mbi fytyrën e Limit vallëzonin hije nervozizmi. Këto zgjasnin deri në grykën e pusit. Sapo futej brenda e fillonte punën, gjallërohej. Mbërthente blloqet e mëdha të qymyrit, mbushte karelin, gdhendte gojën e kasave, u kënaqej kokrrizave të qymyrit. Sapo zbraznin qymyrin nëpër bunkerë, pastronte frontin, mbërthente matrapikun dhe i kënaqej shpirti nga krismat ritmike të tij.

— Jepi, vëlla, — i thoshte ndihmësit, — jepi, se e kemi vënë punën në vijë. — Pastaj me perferatorin hapte vrimat për mina. Pluhuri që rridhte prej viaskave të ba-

rominave ua nxinte fytyrën, u zbardhnin vetëm dhëmbët kur i qeshnin kënaqësisë që shkaktonte puna.

Kujtim Kreshpës i zgjerohej kraharori prej gëzimit, sa herë i qëllonte të shikonte ish-ndihmësin e vet duke punuar si makinë. Jo vetëm se e kishte nxjerrë prej duarve të veta, porse Limi dhe shokët si Limi e entuziazmonin me dashurinë dhe zotësinë që tregonin për punën, për profesionin, për zellin ndaj shkollës: «Koha troket me forcë në portën e çdo njeriu, — mendonte ai, — pa shkollë s'ka përparime. Tani çdo proces pune kryhet me anën e rrymës elektrike. Lopatat vetëmbushëse, perferatori, martineli, matrapiku, llampat me bateri, transportierët, elektrovozi, e të tjera që do të zbulojë dhe do të vërë në jetë shkenca jonë socialiste. Minatorit do t'i mbetet vetëm të dijë të komandojë me makinën minerare. Ky është një grusht i fortë për hundët e revizionistëve...».

K R E U X I

Përpara stacionit të autobusave prisnin plot minatorë. Heshtja e minatorëve Kujtimit i kujtoi bisedën që kishte bërë me të bijën, Dallëndyshen.

«— Baba, — i kishte thënë e bija, ndërsa e përcillte për në stacion, — përse janë kaq të heshtur minatorët. Ti flet ndryshe për ta.

— Minatorët mund t'i njohësh vetëm në galeri, — i ishte përgjigjur Kujtimi, — këta që të duken të heshtur, edhe pas tetorëshit, pasi i kanë gërryer zemrën shkëmbit, pasi u ka dalë djersa mbi kominoshe, vrapojnë si demat nëpër galeri.

— Domethënë i ruajnë forcat për punë, — pat vërejtur Dallëndyshja.

— Jeta në minierë, moj Dallëndyshja ime, është plot poezi. Atje s'ka si të të shpërndahet vëmendja. Të gjitha mbresat që ka njeriu, atje në thellësi ripërtërihen, krista-

lizohen. Miniera ngjan me një amvisë të mrekullueshme, e cila lan mirë dhe ua nxjerr zhulin rrobeve.

— Baba, mësuesja e letërsisë na ka thënë se një krijues e ka krahasuar shkrimtarin me minatorin.

— Krahasimi do një korrigjim të vogël. Shkrimtari kërkon të pasqyrojë atë anë ku syri i thjeshtë i lexuesit nuk është në gjendje të depërtojë. Kurse minatori, duke zbuluar të fshehtat e nëndheut, aftësohet dhe shkathtësohet për nën tokë e mbi tokë. — Ndërsa minatori po rikujtonte këto copëza bisedash, autobusi ndaloi përpara këmbëve të tij.

Sapo hipën, filluan shakatë.

— Hej, shofer, — thirri Qenani që përherë bënte shaka, — mos harro të ndalesh në stacionin e tretë, për nder do ta pësosh nga Rama.

— Nuk e lë Dilen jo, — tha shoferi dhe i shkeli syrin Ramës.

— Ramë, — pyeti Bukuria, — kur do ta bëjmë dasmën?

— Buke, rri urtë, — foli Rama i skuqur gjer te veshët — se, po fillova unë, do të të djeg pastaj.

— Ramë, — ndërhyri Kujtimi që u frikësua mos Rama i përmendte Limin, — Bukuria bën shaka.

— Nuk ka hije, — tha Rama gati duke pëshpëritur, — po t'i bien në vesh këto shaka Diles, do të nxehet.

— Ajo e ve, ti beqar, — vazhdoi ngacmimin Bukuria që ishte ulur ngjitur me Ramën.

Në stacionin e tretë hipën shumë minatorë, hipi dhe Dilja. Rama u ngrit:

— Shoqja Dile, po deshe, ulu këtu, — i tha ai.

Qenani thirri andej nga mesi i autobusit:

— Shokë, të marrim shembull nga Rama për mirësjellje me shoqet.

Rama shikoi nga Dilja që po i buzëqeshte ëmbël. Zëmëra i refkëtiu si ndonjë djaloshi tetëmbëdhjetëvjeçar.

Diles gjithmonë ia kishte ënda të bisedonte me Ramën. I dukej i çiltër dhe shumë i turpshëm. Ajo skuqje e jashtëzakonshme për moshën ia shtonte respektin ndaj Ramës. Me atë trup të mbushur e me faqe të kuqe Rama i ngjante me ndonjë bari që tërë jetën e ka kaluar ndër male. Nga

ana tjetër ajo tutej mos Rama fyhej prej shakave të minatorëve, meqë ajo i kishte ikur një burri dhe pati vendosur ta ngryste jetën si beqare.

Dilen e kishte shitur xhaxhai i saj xhahil (ajo kishte mbetur jetime që fëmijë). Burri ia kishte sjellë shpirtin në majë të hundës, sa e kishte bërë Dilen e gjorë të urrente gjithë sojin e meshkujve. Por puna dhe jeta në minierë e kishin nxjerrë nga ajo guaskë.

Rama, sa herë ndeshte në shikimin e Diles, harronte betimin për beqarllëk të përjetshëm, megjithëse këtë joshje gudulisëse e quante si ndonjë ëndërr të ëmbël që zgjat vetëm sa dy-tri të goditura të zembrës, pastaj harrohet siç harrohet ëndrra.

Dilja shkelte në të dyzetat, por ishte e shëndetshme, e hijshme, vishej e mbahej mirë. Ndoshta për këtë gjë Ramës i dukej si diçka e paarritshme dhe rregullimin me Dilen e quante ëndërr.

Autobusi u ndal përpara mensës. Minatorët zbrisnin, kurse Rama, si gjithnjë, priste sa të dilte Dilja. Ajo vuri këmbën në shkallë. Duke u mbajtur te Rama, i shtrëngoi pak dorën. «Më gënjen mendja», — mendoi Rama dhe iu kujtua ariu që thoshte se do të bëheshin dardhët, mbasi i haheshin fort.

Kur Dilja hodhi këmbën mbi tokë, ia shtrëngoi edhe një herë dorën Ramës, bile edhe ia lëmoi. Beqarit iu duk se zemra iu kthye në gjuhëz kambane, u kolovit dhe rraptoi tërë kraharorin. Aroma që lëshuan flokët e gruas ia zgjeruan hojëzit. Me atë kënaqësi vajti në garderobë. Në galeri filloi t'i këndonte shpirti. Dilja nga ana tjetër mendonte se nuk ishte e denjë për një njeri aq të mirë. Rama mendonte se do të tallej Dilja, nëse ai do të bënte ndonjë hap të pamatur e t'i propozonte. Beqari i mirë nuk e merrte me mend se ai dhe askush tjetër ishte bërë shkak për gjallërimin dhe ripërtëritjen e ndjenjave të asaj gruaje, të cilën aq mizorisht e kishin shkarravitur zakonet e egra.

Rama deri në atë kohë kishte menduar se dashuria e tij ishte varrosur bashkë me Lemen, atë vajzën e re që e pat dashur aq fort, po që të vëllezërit ia vranë se dashuronte Ramën. Qysh atë kohë Rama kishte vendosur, dhe i

kishte qëndruar besnik një kujtimi të shijuar vetëm pak çaste. Por kënga e shpirtit ishte ruajtur e freskët, ishte paturuar, tingujt e saj ishin plot melodi të ëmbla e dehëse. Ramës i ngjante vetja me një pemë që lulëzon në vjeshtën e vonë. Atë mesnatë në turnin e tretë iu dukën njerëzit më të qeshur se zakonisht, galeritë më të gjera. Bashkë me ndihmësin e vet u nis për në nënkatin e tretë. Përshëndeste me zë të lartë shokët e turnit të dytë që po ktheheshin nga galeritë.

— Ramë, — pyeti një minator i turnit të dytë, — ku është ai që merr në dorëzim turnin në nënkatin e dytë?

— Miho Gjelaci?

— Po.

— Duhet të vijë, ma thuaj mua porosinë.

— Në nënkatin e dytë edhe sonte do të punohet në avancim. Kam bërë nëntë mina. Qymyr do të ketë boll. T'i lyejnë rondelet e dispozitivit me graso. Grasoja gjendet mbi kapelen e portozit pranë oxhakut të rrugëdaljes.

— Flije mendjen, do t'ia them!

— Dalçi faqebardhë!

— Pushim të mbarë!, — uroi Rama dhe eci.

— Ramë, — i foli nga prapa Shkëlqimi, përgjegjësi i turnit, — Miho Gjelaci nuk erdhi sonte, qenka sëmurë, në vend të tij do të punojë Lim Thana, përcillja porosinë e minatorit të turnit paraardhës.

— Pikë për pikë, — ia ktheu Rama, pastaj pyeti: — Ç'e paska gjetur Mihon?

Kujtimi, që dëgjoi zërin e Ramës, ngadalësoi hapin.

— Jepini forca, qymyr ka boll!

— Sa karela do prej meje brigada?, — pyeti Rama.

— Sa më shumë, — iu përgjigj Kujtimi.

— Janë boll dyzet?

— Po i bërë dyzet, je i pari i të parëve.

— Mbaj fjalën!

— Hajt, punë të mbarë!, — tha Kujtimi dhe eci për tek oxhaku numër gjashtë.

Dritat ecnin përpara me shpejtësi. Të gjithë minatorët nguteshin dhe mendonin për zotimin e marrë përpara një jave.

Në mbledhjen e grupit Limi kishte thënë:

«— Grupin tonë ende e quajnë të prapambetur.

— T'u shpallim garë të gjitha grupeve në kompleks!,
— kishte propozuar Rama.

— Jo vetëm grupeve, po të gjitha brigadave dhe tur-
neve në minierë!», — kishin thënë shokët e tjerë.

Kujtimi afroi vagonin tek oxhaku i ri, la dy ndihmësit ta mbushnin me qymyr dhe vetë ngjiti shkallët. Atje sipër provoi arganellën. Tymi akoma nuk ishte pastruar plotësisht, megjithëse tubi i ajrit fishkëllente me forcë. Kuadraturat ishin në rregull. Kjo gjë edhe e gëzoi, edhe e habiti. Turnit paraardhës asnjëherë nuk i krijojeshin avari, kurse këtij jo rrallë i shembeshin kuadraturat, i shkallmoeshin shkallët.

Minat që kishin bërë ata të turnit të dytë kishin hapur mbi një metër e gjysmë lartësi. Lypseshin dhjetë kuadratura.

— Luan, — i thirri Kujtimi ndihmësit nga lart, — lidh në arganellë dymbëdhjetë kasa.

— I ke gati, — u përgjigj ndihmësi nga poshtë.

Kujtimi shtypi butonin e arganellës. Pasi u ngjitën kasat, u dëgjua kërkëllima e matrapikut.

— Luan, — bisedonin ndihmësit e Kujtimit atje poshtë,
— sonte kemi për të bërë nga tri norma.

— Gjersa filluam përnjëherë me arganellën, edhe nga katër mund të bëjmë.

— Ata që kanë dalë prej dorës së Kujtimit, të gjithë janë minatorë pararojë.

— Nga dora e Kujtimit del mjeshtër i mbaruar. Të tjerët thonë se i ka fjalët me para, por unë mburrem kur them: «Jam ndihmësi i Kujtim Kreshpës».

— Luan, — thirri Kujtimi nga lart, — lidhi edhe dhjetë kasa të tjera.

— Lëshoje kavon.

— E kam lëshuar.

— Mirë... Tërhiqi!

Kujtimi tërhoqi. Puthiti me shpejtësi kasat e oxhakut. Sa vendosi kuadraturën e fundit, ngriti kokën, pikat e djer-sës i kullonin nga maja e hundës. Mbi tavanin e oxhakut

shtresat e qymyrit reflektonin dritën e llampës. Kokrrizat shkëlqenin si margaritarë të çuditshëm. Ai përkëdheli me dorën e madhe:

«Të keqen e floririt të zi!». Përbrenda ndjeu ngazëllim. Gjithë ato kristale të çuditshme, mbi të cilat lodron-te drita e llampës, iu kthyen në mijëra flakadanj në fonderitë dhe kaldataj e Republikës. Ndërsa çukiste me majën e kazmës ku do të vendoste barominat, rridhte qymyri. Atij i dukej si metal i lëngëzuar që derdhej nëpër kallëpe. Fishkëllima e ajrit të komprimuar i kthehej në uturimë motorësh që dilnin prej duarve plot kallo të punëtorëve si Kujtimi.

Ndërsa ndihmësit lidhnin poshtë perferatorin në kovën e arganellës dhe Kujtimi shtypi butonin, në tubin e ajrit u dëgjua një trokitje e mbytur. Luani, edhe pse i ri në minierë, e dinte ç'do të thoshin të goditurat në tub, ato kryenin funksione të shumëfishta. Përveç të tjerave ktheheshin edhe në linjë telefonike, prandaj Luani thirri:

— Kujtim, në tubin e ajrit japin shenjën e alarmit, po nuk përcaktoj dot drejtimin.

Kujtimi frengi arganellën, vuri penguesin në dhëmbëzën e ingranazhit dhe zbriti me të shpejtë shkallët.

— Nga cila anë erdhi sinjali i alarmit?

— Nuk e përcaktoj.

— Ah, mor djalosh, — tha Kujtimi dhe mbërtheu me të dyja duart tubin e ajrit, vuri veshin në anën e djathtë, pastaj në anën e majtë. Alarmi u përsërit.

— Luan, merr kazmën! Petrit, lopatën! Pas meje, djema!

Përmes traverbangut dolën në galerinë kryesore duke vrapuar. Në thellësi të galerisë u dha një dritë disa herë me ndërprerje, pastaj lëvizi nga poshtë-lart.

— Djema, në nënkatet e sipërme fatkeqësi! Vraponi pas meje!

Kur iu afruan minatorit që jepte sinjalin me drita, Kujtimi pyeti:

— Ç'ka ngjarë?

— Duhet njoftuar shoqë Kujtim, — tha tjetri.

— Ja ku më ke, foll!

— Përmbytje... Përmbytje!
— Ç'dërdëllit, mor qyq! — Kujtimi, që e urrente panikun, e mbërtheu tjetrin për gjoksi dhe e tundi.

— Kujtim, uji vërshon nga lart si det.
— Luan, shpejto në galeritë e Jugut, ndihmësit të vrapojnë tek ashensori, komunistët dhe minatorët në sulm këtej! Petrit, ngutu në galeritë e dishenterisë së tretë, porosia si për Luanin! Prit! Atje gjendet Shkëlqimi, të njoftojë me telefon sipërfaqen!, — porositi Kujtimi, pastaj u ngjit oxhakut të nënkateve si ketër. I rrëshqisnin duart, i rrëshqisnin këmbët, ai mbërthente gishtat si darë. Në nënkatin e dytë ishte lëshuar kapaku, ishte mbyllur oxhaku i rrugëdaljes. Sa mund të ngrihet pezull shkëmbi, aq lëvizte kapaku i oxhakut. Prapa Kujtimit gjendeshin plot minatorë.

— Shokë, — u foli Kujtimi atyre poshtë, — sipër meje dëgjohen zëra, uji currielon, kapaku nuk hapet.

Përbiruan dy minatorë. Gjashtë duar të fuqishme shtynë kapakun. Sikur u hap një çikë. Një dallgë e fuqishme shpërtheu mbi kokat e minatorëve. Të tre u shtrënguan njëri me tjetrin, duke u mbajtur fort, u ngjitën lart. Uji që ishte mbledhur në nënkatin e dytë vërshoi me furi në oxhakun e hapur.

— Mbylleni kapakun, shokët gjenden brenda në oxhak!

Vorbull e tmerrshme në oxhakun e hapur. Me mundim u mbyll kapaku.

Mbi karelin e nënkatin një llambë e ndezur. Diçka trishtuese, diçka që të rrëqeth mishtë kur shikoje se si nënkati i tërë po mbushej me ujë të pistë e të ftohtë. Kujtimi çau përmes ujit gjer mbi brez, iu afrua karelit, mbi të cilin ndriste llampa, e thirri:

— Ramë! Ramë! Ndhimësi yt ku është? Lim Thana ka mbetur atje lart në nënkatin e tretë!

U afrua edhe një minator tjetër e kapën trupin e Ramës.

— Ta kthejmë kokëposhtë. Ngrije lart! Përkulja gju-njët, se koka i prek në tavan!, — thoshte Kujtimi.

Në ndihmë u erdhi edhe minatori i tretë.

— Mbajeni kështu deri sa t'i dalë uji, — tha Kujtimi, pastaj iu ngjit oxhakut për në nënkatin e tretë. Ishte në

shkallën e pestë kur u hap kapaku i katit të mësipërm. Një rrymë e fuqishme, një trup i rëndë u përplas mbi kokën e Kujtimit, që të dy ranë kutullaç në nënkatën e dytë.

— Shokë, çdo gjë në rregull, — fliste Lim Thana, i cili sapo ra me Kujtimin, brofi në këmbë.

— Lim, gjallë je, Lim!

— Kam hedhur dy karela argjil rreth kapakut të nënkatit të tretë. Kapaku është mbyllur. Të lajmërohen shokët e nënkateve të mëposhtme, të hapet rezervuari i fermës, ndryshe miniera do të përmbytet, do të mbetemi pa minierë!, — tha Limi i mbushur me frymë.

Nga nënkati i tretë shfrynin stërkalat e ujit. Në nënkatin e dytë uji po ulej. OXHAKU kullufiste tërë ujin si ndonjë përbindsh.

— Djema, afrojeni Ramën. Unë po e hap kapakun, këtë ujë po e marr me vete, pastaj zbrisni ju, — u tha shokëve Kujtimi.

— Jo, — thanë tre minatorët, — hape kapakun dhe qëndro lart. Galeria kryesore as që do t'ia dijë prej këtij uji. U hap kapaku. Uji që kishte mbetur kërkëlloi me zhurmë. Minatorët zbritën duke mbyllur kapakun prapa vetes.

— Shpejtoni, shokë, — thërriste Kujtimi, — shpejtoni, se uji ka për të shpërthyer furishëm nga nënkati i tretë.

Ata zbrisnin dhe vetëm nga zëri njihnin njëri-tjetrin. Fytyrat u ishin nxirë, rrobet u ishin qullur, ishin zhyer me llum e baltë të zezë. Çizmet u ishin mbushur dhe bënin shllap-shllup prej lluce.

Në galerinë kryesore lëvizje të stuhishme. Pompistë, minatorë, zjarrmëtarë, vagonistë, shinashtrues, manevrues tërhiqnin tuba plastmasi, tuba prej gome. Pompat thithnin si të pangopura. Kërkëllinte uji, gulçonin pompat.

Kujtimi u vërsul për te telefoni:

— Alo, sipërfaqja, të hapet rezervuari i fermës gjer në fund! Si? Është hapur! Ju lumtë! Kush, drejtori? Sekretari i komitetit? Faleminderit! Asnjë humbje... Duhet shikuar... Ndihmësi i nënkatit të dytë dhe të tretë a janë ngjitur lart? Po? Atëherë gjithçka në rregull. Minatorët e atyre kateve janë me mua... Faleminderit! — Kujtimi vuri receptorin, dhjetëra sy e vështronin, prisnin:

— Shokë, — u tha Kujtimi, — çdo gjë do të marrë fund mirë. Në sipërfaqe janë mobilizuar të gjithë.

Pompat gulçonin. Ujit të ri po i dukej fundi.

— Shokë, — thirri Lim Thana, — se u hap rezervuari, se uji i tij iku përmes kanalit në lumë, u mor vesh. Po kati i tretë, i katërt, i pesti, i gjashti dhe i shtati janë plot me ujë dhe ai ujë ka për të shpërthyer në nënkate! Ka aq ujë sa të përmyten tërë katet e shfrytëzimit. Do të na shkaktojë dëme të mëdha!

Nga ana e ashensorit u dukën plot drita. Vinin plot në vendin e ngjarjes. Në krye sekretari i komitetit të Partisë dhe drejtori.

— Shoku drejtor, kapaku i nënkatit të tretë duhet hapur, të rrjedhë ujë, ndryshe..., — tha Demi.

— Nuk ka mundësi të çohen pompat në nënkatin e tretë dhe të thithet uji që andej?, — pyeti sekretari i komitetit të Partisë.

Minatorët shikuan njëri-tjetrin dhe buzëqeshën, nuk u kishte shkuar në mend ajo zgjidhje.

— Të hapet kapaku, rrezikohet ai ose ata që e hapin, — tha sekretari sërish, — ju qani hallin e prodhimit të disa nënkateve, harruat se me njeriun nuk krahasojmë as mineralin e të gjitha minierave.

— Dem, Dem, ndalu mor harun!, — thirrën minatorët dhe i dolën përpara. Ai s'e kishte dëgjuar propozimin e sekretarit dhe ngulte këmbë të shkonte për të hapur kapakun.

— Shokë, — u foli drejtori minatorëve, — jeni lagur, shkoni tek ashensori. Ngjituni lart, kemi porositur të ndizet zjarr. Punën që ka mbetur ia besoni ndërresës sonë, do ta kryejmë mirë. — Kur pa se asnjëri nuk po lëvizte, ai buzëqeshi.

Brigada e shpëtimit, pompistët dhe të tjerët ngjitën pompat në nënkatin e tretë. Të gjithë u rivunë në lëvizje. Brenda disa orëve u thith tërë uji i nënkateve.

Turni i parë filloi punën si rregullisht.

Që atë mëngjes të hershëm u mbloodh byroja e partisë. Pasi u diskutuan hollësisht rrethanat e shpërthimit të ujit në minierë, të gjithë shokët e byrosë arritën në përfundimin se Lim Thana dhe Ziz Kujunxhiu kishin shkelur normat e sigurimit teknik të rrëmbyer nga zelli i pafre i garave, por asnjëri nuk ishte i sigurtë nëse ishin ata shkaktarë të aksidentit.

Sekretari i komitetit të Partisë, shoku Isa, tha:

— Sekretari i organizatës për turnin «Sulmi», Kujtim Kreshpa, bashkë me komunistët e organizatës të hetojnë çështjen. Le të bëhet mbledhja e kolektivit sipas kërkesës së përgjegjësit të sigurimit teknik. Ndërkohë ne duhet të zbulojmë të vërtetën.

Të gjithë shokët e byrosë miratuan propozimin e sekretarit.

*
* *
*

Përgjegjësi i sigurimit teknik, Latifi, që kishte bërë hetime, ia shtroi çështjen kolektivit të turnit «Sulmi».

Shkëlqim Kuqi dhe Kujtim Kreshpa drejtonin mbledhjen.

Kujtimi vështronte fytyrat e ndezura të minatorëve.

Miho Gjelaci u ngrit sapak, pastaj gërmuqas eci dhe zuri vend në mesin e sallës, prapa nëndrejtor Bajazitit.

— Qenka shëruar Mihoja, — mendoi Shkëlqim Kuqi, përgjegjësi i turnit.

— Shokë, — foli përgjegjësi i sigurimit teknik, — aksidenti i mbrëmshëm njollos me turp emrin e turnit «Sulmi». Fajtorët janë midis nesh. Këta shokë kanë shkelur rëndë rregullat e sigurimit teknik, për të mos thënë kanë bërë punë armiqësore. Janë dy vetë. Ata punuan dy turre bashkë. Të shtunën mbrëma ishin në turnin e dytë,

vazhduan edhe në turnin e tretë. Përfituan nga rasti se turni «Hovi» punoi në galeritë e Jugorit. Më e keqja është se këta shokë e kanë ditur se kati i shtatë gjendet mu nën rezervuarin e fermës. Dy shokë pra kanë lënë frontin e punës dhe hajdutshe janë ngjitur në katin e shtatë, edhe pse e dinin se atë kat vetëm dhjetë metra e ndanin nga shtrati i rezervuarit. Ata kanë bërë edhe mina.

Minatorët ngrinin kokat për të parë se cilët qenkëshin ata dy vetë që paskëshin rrezikuar aq rëndë minierën.

— Cilët janë? Përse nuk na i thua me emra, mor shok!

— Emrat, emrat!, — thirrën shumë minatorë.

— ...Më e keqja është, — vazhdoi Latifi, i cili ishte i prirur për ta bërë me bujë çdo gjë, — më e keqja është se shoku Lim Thana nuk e ndien, as nuk e pranon gabimin. Ndryshe qëndron puna me Ziz Kujunxhiun. Ky e ndien thellë gabimin dhe nuk orvatet të justifikohet me dokrra siç vepron Limi.

Lim Thana kishte ulur kryet, mbi ballin e lartë i ishin ngritur dy damarë.

Kujtimi e njihte mirë Limin. E vështroi me dhembshuri, përzier me një farë dyshimi të turbullt.

«Ah, ariu i galerive, ariu i galerive!, — tha me vete Kujtimi dhe iu kujtua rasti kur ia kishin vënë atë epitet... — Mbetë gjithnjë i rrëmbyer...».

Të gjithë minatorët kishin emra të dytë. Sapo e njihnin mirë punëtorët e nëntokës, sipas vrullit ose ngathtësisë në punë, sipas pamjes së jashtme ose veçorive të karakterit, ata sajonin nofkën. Këto ishin ndër shkaqet që njerëzit i nënshtroheshin ligjit të pashkruar të nëndheut dhe hiqnin dorë nga sedra delikate dhe nga egoja.

Kujtimi shikonte fytyrat e minatorëve dhe sepse mudohej të kujtonte të gjithë emrat e tyre të dytë.

Kishte edhe ndonjë që ruante emrin e parë. Këta numëroheshin me gishta. Ishte për t'u çuditur që atyre askush nuk u sajonte ndonjë emër të dytë. Emri i tyre i parë sikur kthehej në një hendek që i ndante nga minatorët e tjerë. Me këta njerëz pothuaj flisnin me një farë zyrtarizmi, të mos themi në mënyrë burokratike, meqë minatorët thonë se mund të hyjë gjithçka në minierë përveç burokratizmit.

Kujtimi shikonte shokët, të cilët i ishin të afërt dhe aq të dashur, sa i bëhej se përveç biografisë personale, të gjithë përbënin edhe një biografi tjetër kolektive. Ata që ruanin vetëm emrin e parë, atë, me të cilin kishin ardhur në minierë, kishin vetëm një biografi personale, të shkurtyr, ndoshta edhe të errët.

«Cili deshi të përmbyste minierën? Mos është ndonjë i paemër si ëndrrat e atyre personazheve të këqija?!». Ndërsa në kokën e Kujtimit lëvrinin plot pyetje pa përgjigje, Latifi, përgjegjësi i sigurimit teknik, përfundoi:

— Shokë, kaq kisha. Këta të dy janë fajtorë! Rrezikun që kërcënoi minierën e provuat mbi kurrizin tuaj!

— Duam t'i dëgjojmë!, — kërkoi Sherifi.

— Gjithmonë kam qenë zemërapur karshi kolektivit, — foli Zizi gati duke qarë dhe përshkoi shaminë mi hundën picirruke, — ky është një faj. Po, para se të flas, kërktoj prej jush, shokë, të vini dorën në zemër. Ju lutem të kini parasysh që kam pesë kalamanj! Brigada jonë vendosi të punojmë të dielën. Siç e dini, kemi dalë me një zotim veçan të gjithëve për këtë fund viti. Mirëpo atë të shtunë mbrëma ndryshuam mendje dhe vendosëm të punonim dy turne bashkë, pa ndërprerje. Ia fshehëm edhe shokut Kujtim, sepse ai kishte punuar dy turne bashkë, domethënë gjashtëmbëdhjetë orë, në oxhakun gjashtë. Filluam punën në shtresor. Kur mbaroi qymyri u hodhëm në kërkim. Nëpër të gjitha nënkatet ishin bërë minat, qymyr kishte boll. Limi nuk deshi të shfrytëzonim qymyrin që u takonte turneve të tjera. Kështu, duke kërkuar, përfunduam në nënkatin e shtatë. Ramën dhe Qenanin i lamë në shtresor. Ata do të mbushnin dhe do të shtynin vagonat me qymyr që do të hidhnim në nga lart. Më vete morëm edhe perferatorin. Kështu ndodhi...

— Kam një pyetje!, — tha Agron Mala. — Unë sot po vij nga stërvitja ushtarake dhe nuk jam i qartë. Pse inxhinieri i turnit u dha lejë të punonin dy turne bashkë. E kam fjalën thjesht për të treguar kujdes për shëndetin e shokëve nga ana e inxhinierit të turnit. E bëri këtë, pse nuk vajti t'u ndihmonte, të paktën të shikonte ç'po bënin këta njerëz!

Shogun Brahani

Shogun
21/11/87

Inxhinier Ylli, që s'i linte gjërat të ftoheshin, iu përgjigj aty për aty:

— Lim Thana më tha se turni i tyre kishte disa punëtorë në stërvitje ushtarake, dy turnet po u afroheshin e do t'i kalonin. Më tha se nuk donin t'i quanin «brigada e qylave», siç ua kishin vënë nofkën disa nga shokët. Më tha se nuk donin asnjë lek, veç t'i shtonin disa tonelata turnit të tyre. Ndërsa Zizi bëri një ndërhyrje të lezeçme: *Jo, jo, meqë punojmë, të zbatohet parimi, sipas punës paga!*, — tha. Nuk është e vërtetë se s'kam zbritur në minierë. Kam zbritur unë, ka zbritur edhe Vangjushi. Nuk vajtëm atje për t'i kontrolluar, se këta janë minatorë me përvojë. Zbrita për t'i parë se si u shkonte puna, mos kishin nevojë për ndihmë. Poshtë gjeta Ramën dhe Qenanin. Këta më thanë se Limi dhe Zizi kishin hipur për të kërkuar një dispozitiv. Kështu i kishin thënë edhe Vangjushit.

— Limi të flasë! Të flasë Limi!, — thirrën shumë minatorë.

Limi i njihte mirë ata zëra. Ua njihte mirë edhe ashpërsinë. Kur ishte puna për minierën, ata nuk njihnin as shok, as vëlla. U ngrit e tha:

— Gjykomëni, shokë! Nuk kam ç'të flas. Përgjegjësi i sigurimit teknik më quajti armik! Gjithçka mund të jem, po armik kurrë! Latifi le ta futë atë fjalë në xhep. Nuk e dua, s'është për mua!

— Si dëshiroke, zotrote!, — thirri një zjarrmëtar, i cili, edhe pse e kishte dashur shumë Limin, tani që ishte kërcënuar miniera, nuk përmbahej. — Ç'të të quajmë?! Të përmbysësh minierën dhe të të quajmë mik! Jo, more!

— Bëni ç'të doni!, — foli i nxehur Limi dhe dridhej prej zemërimit.

— Shoku Bajazit, shoku Bajazit, — i foli nëndrejtorit Miho Gjelaci, — ky Lim Thana qenka edhe arrogant. Thonë se edhe me Bukurien e gjorë u soll si rrugaç. E shfrytëzoi, pastaj e la..

Bajaziti as nuk e shikoi se cili i foli nga prapa, po u ngrit e thirri:

— Me lejë, kam një pyetje, shoku Lim t'i tregojë kolektivit për sjelljen e shëmtuar me llampisten e turnit.

Limi ktheu kokën me vërtik. Sytë i zunë fytyrën e Mihos që buzëqeshte nën mustaqe.

— Cili e bëri këtë pyetje?, — tha Limi.

— Unë u përgjigj Bajaziti.

— Ka ndonjë lidhje me çështjen?

— Ka shumë lidhje, — u përgjigjën disa punëtorë.

— Përse jemi mbledhur këtu?, — pyeti Limi.

— Që të të kërkojmë llogari, — u përgjigjën shumë punëtorë, — mos u sill kapadai! Fol shkoqur!

— Përmbysësin e minierës mund ta kërkonti gjetkë, — tha Limi!, — Ne i kemi bërë minat në plan horizontal, gjysmë metër thellësi. Pos kësaj kemi bërë katriazh pa lejuar ndonjë boshllëk për shembje.

— Mor, po s'të paskemi njohur, — tha zjarrmëtar Dulla, — paskemi qenë tuhafë! Ti qenke edhe rrenacak! Ku e ke kurrajën e minatorit, mor djalë! Unë mora pjesë në mbylljen e shembjes. Minat nuk janë bërë në plan horizontal, si thua ti, po në plan vertikal, nga poshtë-lart, bile me kompleksin e barominave mbi nëntë metra thellësi. Ti mund të thuash si të duash, po barominat kanë lënë gjurmë. Edhe vërshimi nuk e ka prekur atë anë; sikur ka dashur të na ndihmojë për ta gjetur komplotistin. Shokë, — iu drejtua zjarrmëtari minatorëve, — sa ka faj Limi, kjo duket qartë. Mendoj që faji të ndahet me tërë skuadrën e tij që ka punuar dy turne bashkë. Faj ka edhe inxhinier Ylli që e ka lejuar një gjë të ndaluar.

— Për kokën e kalamanjve, shokë, — foli Zizi, — nuk kemi bërë mina në plan vertikal, siç na ngarkon pa të drejtë shoku Dullë.

— Lëre, se ashtu e ka Dulla, — foli Limi sërish i nxehur, — minat janë bërë parmbremë, duke gdhirë e diel. Nëse do të qenë bërë në plan vertikal, uji do të shpërthente atë kohë dhe jo të priste deri mbrëmë.

— Daleni, shokë!, — u ngrit Rama. — Ah, sa matuf që jam!...

Sinjaliste Dila që kishte zënë vend prapa Ramës, lëshoi një pasthirmë:

— Qyqja, Rama! Ç'ke për të thënë ti? Të shtunë mbrëma, në orën njëmbëdhjetë e gjysmë udhëtove me ne në autobus.

— Jo, — kundërshtoi Rama, — vërtet udhëtova me ju, po u ktheva me autobusin tjetër. — Pastaj iu drejtua të tjerëve: — Unë mbrëmë punova në nënkatin e tretë. Këtë e dinë të gjithë, edhe shoku Shkëlqim, edhe shoku Kujtim. Përpara se të vërshonte uji në oxhakun tonë, kanë plasur mina sipër nesh, se në katin e pestë, të gjashtë apo të shtatë nuk e di. Bile unë dhe ndihmësi im u habitëm, sepse s'kishte asnjë front pune sipër nesh. Desha të hipja në nënkatin e katërt, po më përplasi rryma e ujit si ndonjë kërcu. Të mos qe Lim Thana, unë bashkë me ndihmësin tim nuk do të gjendeshim midis jush, po diku tjetër. Të vdekur do të ishim, shokë!

— O zot, — ofshani Dilja, — i lumtë Limit!

— Oi, ç'na thënka shoqja sinjaliste, i lumtë Limit që deshi të përmbyste minierën!, — tha Miho Gjelaci dhe e mbështolli turirin me shall.

«Ku e kam parë këtë shall të mëndafshtë me vija blu, të bardha, e të kuqe? Ku? Ku? Ku?», — shtrydhte kujtesën Kujtim Kreshpa.

— Ramës i kanë bërë veshët, — foli zjarrmëtar Dulla, — mbrëmë ishin tre zjarrmëtarë, askush prej nesh nuk ka bërë mina mbi katin e tretë. Askush prej nesh nuk i ka dhënë ndokujt eksploziv për të bërë mina në ndonjë front tjetër, përveç se në frontet e parashikuara të prodhimit.

— Kanë plasur mina sipër nesh, — tha ndihmësi i Ramës me zë të lartë, — fill pas plasjes ka shpërthyer uji.

— Lim, — thirri Kujtimi.

— Urdhëro, shoku Kujtim, — u përgjigj Limi pa guxuar ta shikonte tjetrin në sy.

— Zizi tha se gjithë anëtarët e brigadës së tretë vendosën të punonin edhe pas mbarimit të turnit të dytë. Cilët nuk erdhën?

— S'ka rëndësi, — u përgjigj Limi. — E hëngri fjalën ndonjëri, fundja nuk ishin të detyruar. Ne ishim pesë: unë, Zizi, Rama, Qenani. Sherifi iku shpejt, se kishte çunin të sëmurë. Rama dhe Qenani nuk janë ngjitur lart. Unë jam inisiatori. Po dijeni se, përpara se të shkoja në zyrën e sigurimit teknik, vajta në katin e shtatë, në vendin e ngjarjes. Vura re se ishin bërë mina në plan vertikal. U them gjii-

thë shokëve, nëse i kam bërë unë ato mina, atëherë keni të bëni me një armik dhe jo me një mendjelehtë. Shpërthimin vertikal nuk e kam bërë unë.

— Kush propozoi i pari që të punonit edhe në turnin e tretë, pa ndërprerje, ne e kishim lënë të punonim të dielën?, — pyeti Kujtimi.

— Unë, — tha Limi.

— Kush propozoi të bënit mina në katin e shtatë?

— Askush, unë i bëra, — tha Limi.

— Nuk është e vërtetë, — tha Rama, — ka dhjetë ditë që Miho Gjelaci na fliste rreth e rreth: *Turnet e tjera lëvdohen*, — thoshte. — *Na thonë «grupi i qylave»! Më vjen plasje të na e marrin flamurin. Duhet të bëjmë çmos. Ka galeri ku shtresa e qymyrit është e trashë, ku tonelatat bëhen fjet e fjet. Për shembull nënkati i parë në nivelin e dytë dhe kati i shtatë në Veri. Atje mund të nxjerrësh qymyr për një orë sa në të gjithë nënkatet për tetë orë...*

— Ç'dërrdëllit, mor beqar matuf?!, — e kërcënoi Mihoja. — Mos gënje, se unë të marr shpi...

— Edhe Mihoja duhet të punonte me ju duke gdhirë e shtuna?, — pyeti Shkëlqim Kuqi.

— Po, — tha Zizi.

— Përse nuk punoi?

Mihoja futi mjekrën nën shall dhe u kollit rëndë.

«Ku e kam parë këtë shall të mëndafshtë, ku? ku?», — pyeste veten Kujtimi.

— Përse nuk erdhi Mihoja me ndonjë tjetër, le ta thonë vetë, — tha Zizi.

Mihoja mbështolli hundët me shall e u kollit.

«Shalli i mëndafshtë... Njeriu në anën e sipërme të rezervuarit në mëngjesin e së dielës...», — iu kujtua Kujtimit dhe pyeti me zë:

— Miho, të dielën në mëngjes ku ke qenë?

— Kam qenë shumë i sëmurë, shoku Kujtim, — u përgjigj Mihoja me zë të ngjirur.

— Ç'deshe në rezervuarin e fermës përmes atij rrebeshi?

— Kur?

— Të dielën duke aguar.

— Paskeni parë ëndërr. Unë që të shtunën nuk jam

ngritur nga krevati. Këtë e dinë të gjithë shokët e hotelit të beqarëve dhe mund ta vërtetojnë.

— Po, Mihoja ka qenë sëmurë, — thanë dy pompistë, — ne kemi qenë me të. Ka qenë shumë i sëmurë dhe i kemi qëndruar mbi kokë.

— Shoku Kujtim, — tha Bajaziti, — ata shokë që i villnin brigadat dhe turnet e tjera i merrnit ju, rrihnit gjoksin si shpëtimtar i njerëzve me vese e cene. Edhe pse ju është tërhequr vërejtja për këtë gjë, ju pëlqenit mendjen tuaj. Tani përgjigjuni me ta për ta. Ta diskutojmë çështjen. Ndoshta ju dhimbset Limi, s'kemi ç'të bëjmë, disa nuk mund të heqin dorë nga simpatitë personale. Helbete, ndihmës e keni pasur, shoku më i ngushtë juaji. Në mos u barabittë me ju si shpëtimtar i «situatave të koklavitura», jua kalon në kokëfortësi. Ai ka shkelur rrëndë rregullat e sigurimit teknik. Nuk ngutem të them edhe më të madhen... Propozoj që Limi Thanës t'i hiqet patenta e minatorit. Të largohet prej minierës sonë. Bile jam i mendimit të mos punojë as në sektorin e dytë e të tretë. Në asnjë minierë të mos punojë! Edhe sjellja e tij është e pahijshme. Pse, kështu flasin minatorët?!

— Mbështes propozimin e nëndrejtorit, — tha një manevruer, — të mbahet parasysh edhe sjellja e Limit me Bukurie Demën!...

— Sjelljet e Limit janë të shëmtuara, — tha një arganist, — përpara një muaji ai qëlloi një pompist. Vërtet pati hak, se pompisti ia kishte shtruar gjumit dhe pompën e kishte lënë në mëshirën e fatit, por, të godasësh një punëtor, është turp e faqe e zezë.

— Nuk më ka qëlluar, — brofi e tha pompisti, — vetëm më ka kapur prej hunde. Më shau qyrrash dhe më paralajmëroi se do të ma merrte shpirtin nëse e përsërisja edhe një herë gabimin.

— Nuk di si e ka hallin Limi, — tha një zjarrmëtar, — unë po njoh dy Lima: ariun e galerive, krenarinë e turnit, dhe Limin e tanishëm i cili sillet si i ndërkrayer, punon si i teket. Nga punëtor pararojë është kthyer në një punëtor që na turpëron. Të mendojmë se aksidentin nuk e shkaktoi Limi, i falet një minatori të bëjë mina në një vend aq de-

likat? Në një vend të ndaluar? Rrezikshmërinë e atij veprimi e dinë edhe ndihmësminatorët që nuk kanë ngrysur muajin në minierë.

— Masa për heqjen e patentës dhe pezullimin e tij nga puna në minierë nuk është asgjë, — tha një shinashtrues. — Po habitem me shokët, ç'është ky oportunizëm! Limi duhet të futet brenda, që të zërë mend mirë! Atje e ka vendin Limi!

— Se çfarë do të bëjë prokuroria, — sqaroi përgjegjësi i sigurimit teknik, — ajo është punë e saj dhe e ligjit. Ju si e gjykoni. Natyrisht prokuroria do ta marrë parasysh mendimin e kolektivit!

Diskutimet morën zjarr. Mbledhja vazhdoi gjatë.

* * *

Sapo doli nga mbledhja, Kujtimin e thirri centralistja:

— Shoku Kujtim, eja në central, se vajza jote s'po na lë rehat.

— Përse nuk i the se kishim mbledhje?

— Ku bindet ajo! Dallëndyshja do të dëgjojë zërin e babait të vet.

— Shejtania, — t'ha Kujtimi dhe u ngjiti në central. — Alo, Dallëndyshe, je ti? Oh, oh! Ti e di se këto buzëvarje i kam bezdi!

— Sa herë të vonohesh, unë do të të shqetësoj, — foli vajza nga ana tjetër e telit, — ti shaj, nevrikosu, unë...

— Nuk të tha centralistja se isha në një mbledhje.

— Po nuk e dëgjova zërin tënd...

— Dallëndyshe, të mos u besosh të tjerëve...

— E di, do të thuash se mund të jem vetë e pasinqertë. Po mban mend kur kisha ditëlindjen? Kishe lajmëruar se kisha mbledhje. Unë, mamaja, vëllai të pritëm tërë natën. Ti nuk gjendeshe në mbledhje, po në spital. Të kujtohet aksidenti në këmbë? Mos u bëj baba i keq.

— Mirë, mirë, mjaft më, se mua dhe ty na duhet një linjë telefonike më vete, do të vij, mos u bëj merak, — tha Kujtimi.

Meqë autobusi nuk kishte arritur, Kujtimi u fut në bufenë e minierës. Minatorët grupe-grupe pinin, dikush verë, të tjerët birra. Kujtimi zuri vend në një kënd të bufesë.

Kamerierja i solli gjysmë litër verë.

— Një kafe desha, — tha Kujtimi.

— Vera është porositur prej Ramës.

Kujtimi hodhi shikimin, Rama pinte raki dhe kuvendonte me zjarr me një grup minatorësh. «Çudi! Rama asnjëherë nuk pi raki!, — mendoi ai. — Sot e paska harruar gjakun e minatorit, siç e quan ai verën. Ç'ndryshime pësojnë në njerëzit!». Dhe iu kujtua se si falej dikur Rama, se si, kur hynte në minierë, patjetër do të hidhte këmbën e djathtë së pari. Në moshën tridhjetëvjeç i kishte hyrë shkollës dhe e kishte mbaruar me sukses. E tallnin të gjithë kur mbështetej në ca parandjenja edhe për realizimin e normës. Po tani Rama ishte tjetër Ramë. Nuk kishte më atë mëshirën kristiane, si Zizi, që mallëngjehej, ngrihej e mbronte, kërkonte t'i falej gabimi shokut që kritikohej. Sa djersë e mund u desh që Rama të bëhej i tillë siç është.

Megjithatë Rama sot ia paskësh shkelur! Po pinte raki! Kjo e habiti Kujtimin.

— Shoqe, më solle verën, sill edhe dy salçiçe dhe gjysmë franxholle!, — i thirri ai kamerieres.

Bulat e salçiçeve ende shfrynin djersë të kripur dhe çërronin. Minatorit iu kujtua dreka në shtëpi, e bija që e priste dhe mend shtyu pjatën, po ngriti kokën në dritare e, meqë autobusi nuk dukej, kafshoi salçiçen dhe ngriti gotën me verë. «Do të ha prapë me Dallëndyshen», — tha ai me vete.

— More shokë, — fliste Rama me zë të lartë, — kjo zemra ime ma thotë se Limin e kemi dënuar padrejtësisht. Ne jemi minatorë, zbulojmë të fshehtat e nëntokës, shkërmqim shkëmbinj, gërmojmë, zbulojmë. Ai pis, ai maskara që hedh gurin e fsheh dorën nuk duhet t'i shpëtojë syrit tonë. Ju mund të thoni ç'të doni, mund të thoni se Rama qenka kthyer prapë në atë mëshirëmadhin kristian, siç më thoshite më parë Agron Mala. Mund të thotë ndonjëri se Rama është dehur, se hera e tretë është kjo që pi raki (herën e

parë piva kur nuk plotësova planin mujor, të dytën kur mora notë negative në algjebër), por jua them sot, kam për t'jua thënë gjithnjë se Lim Thanën me duart tona e përplasëm nga gjiri i minierës. Do të thoni se e pezulluam nga puna, nuk e fërfëlluam përfare. Një mbjellje e keqe, ka edhe korrje të keqe!

— Ramë, — i foli Demi, — sa e do ti Limin, aq e duam edhe ne, po Limi nuk më duket në rregull!

— Limi është fajtor, — tha Sherifi, — nuk mund të them se e bëri me qëllim për të dëmtuar minierën, se atëherë kishim të bënim me një të çmendur, po...

— Ju betohem, more shokë, — tha Zizi, — i jam lutur: *Aman Lim, të mos punojmë në katin e shtatë! Të shkojmë në ndonjë nënkat tjetër, qymyr paska boll!* Nuk dëgjoji. Ndoshta kishte hallin të fitonim ndonjë lek...

— Ti mos llap! Mbylle atë të shkretë!, — e ndërpreu Rama. — Kur hesht dhe të shikoj fytyrën e muskujt, më ngjan si minator. Po, kur flet, më dukesh si mikroborgjez që kapet pas çikërrimave! Të gjithë i shikon sipas midesë sate! E di ç'ke ti, më lër rehat!

— Ramë, — foli prapë Sherifi, — më vjen keq për Limin. Shok më tepër se vëlla e kishim, e deshëm, po minierën e dua më shumë. Vras mendjen, nuk e gjej dot. Përse e bëri Limi këtë. Për asgjë tjetër, vetëm se mund të jetë hakmarrë!...

— Kundër kujt, kundër vetes?!, — ndërhyne dy minatorë.

— Kundër inxhinierit gjeolog, kundër Petritit, — tha Sherifi.

— Përse, mor Sherif, — pyeti Rama i zemëruar, — e inxhinierit është miniera?!

— Kush tha?, — u përgjigj Sherifi. — Limi me inxhinier Petritin është në hasmëri për punë të Bukuries... Prandaj me siguri ka dashur të hakmerret.

— Ç'lidhje ka inxhinieri gjeolog me aksidentin?, — pyeti një vagonist.

— Inxhinier Petriti ka aprovuar ndërtimin e rezervuarit të fermës mbasi nuk mund t'i sillte asnjë dëm minierës. Limi, duke menduar se faji mund t'i mbetej Petritit,

është përpjekur t'ia punojë me të pabesë, — tha Sherifi.

— Sherif të thonë, — ia ktheu Rama, — Kanun duhej të të thërrisnin! Hala me hakmarrjen ti, or babë! Çfarë stërhollimi! Mirë thotë zjarmëtar Dulla, ti e ke të vësh-tirë të bëhesh minator!

— Unë nuk qenkam minator! Mbjaj gojën, beqar i ma-tufepsur! Se..., — kërcënoi Sherifi.

— Ja ku duket shpirti i hakmarrësit të babaqemos!, — tha Rama. — Të zhburrërova? Hiqe koburen! Me ty duhet të punojnë dhjetë propagandistë!

— Pesho fjalën, Ramë, se gjuha prej tuli është, po koska thyen!, — klithi Sherifi.

Rama me dorën e majtë mbylli gojën, me të djath-tën i bëri shenjë se nuk do të fliste më me të. Në raste të tjera minatorët do t'ia plasnin të qeshurit, do t'i cysnin me romuze, por atë pasdite të vonë ata ishin të brengosur. Nuk ishin të bindur në se kishin marrë vendim të drejtë për sho-kun e tyre. Kjo i brente...

Kujtimi dëgjoi të gjitha dialogjet. Ai e dinte se një diskutim i madh do të fillonte pas mbledhjes. Ishte i bin-dur se minatorët nuk do të pushonin së gërmuari gjer sa të gjendej e vërteta.

«Edhe shokët nuk janë të bindur, — mendoi ai, — nëse vepruan drejt kur një minator si Limi që kishte punuar tetë vjet nën dhe, e pezulluan nga puna. Ky është dëni-mi më i rëndë për një minator. Sa mund të rrojë peshku pa ujë, aq mund të jetojë minatori pa minierën. Po unë? A jam i bindur unë se Limi e meritonte atë dënim?!».

Në shpirtin e Kujtimit filluan të përlësheshin dy zëra. Njëri ishte i shtruar, i avashëm, kurse tjetri i ashpër.

«— Limi, për të fituar garën me turnet dhe brigadat e tjera, bën edhe budallallëqe, — kumbonte zëri i ashpër.

— Kjo është një e metë, — fliste zëri i shtruar, — du-het afruar njeriu që mbart atë të metë, duhet luftuar së-mundja! Ne bashkë me kapelen e pistë, hodhëm tutje edhe kokën!

— Ti gjykon si oportunist, — fliste zëri i ashpër, — faji që ka bërë Limi është i rëndë. Ai duhet ndëshkuar edhe më rëndë! Gjithë minatorët e turnit «Sulmi» mund të vdis-

nin atje brenda. Miniera mund të përmbysej. Tjetër se u morën masa shumë të ngutshme!

— Limi që ai që shpëtoi minierën dhe gjithë minatorët, ai vuri në rrezik veten për shokët, për minierën, — kundërshtonte zëri i shtruar.

— Në këtë rast, — fliste zëri i ashpër, — Limi i ngjan një të dehuri, i cili ia fut zjarrin shtëpisë dhe, kur shikon flakët, i del pija, hidhet në zjarr për ta shuar.

Po sikur të jetë ndonjë i tretë, i cili ka vepruar nën hijen e dy mendjelehtëve.

— Kjo s'ngre peshë, — fliste rëndë-rëndë zëri i ashpër, — askush nuk foli për ndonjë të tretë.

— Po sikur të jetë ndonjë nga ata që kishte pranuar të punonte edhe në turnin e tretë dhe nuk vajti?

— Njëri syresh ishte Miho Gjelaci. Për të folën ata të hotelit të beqarëve. Thanë se Mihoja nuk ishte ngritur prej krevati nga e shtuna.

— Po sikur..., — donte të fliste zëri i shtruar.

— S'ka sikur... edhe sikur të jetë ndonjë i tretë, Limi edhe Zizi u molepsën. Përse nuk e treguan?! Nuk kemi të bëjmë me një gabim dosido, por me diçka shumë të madhe e të rrezikshme!

— Pikërisht kjo më bren mua, — fliste zëri i shtruar, — mos jemi ngutur! —

— Ne nuk e vramë Limin! Ai ka kohë që nuk është në terezi. Nëse ka përfituar ndonjë i tretë nga mugëtira shpirtërore e Limit dhe e ka futur në valle atë, pak e ka dënimin që i dhamë!

— Ka disa muaj që çalon puna në turnin tonë, sidomos në brigadën tonë, fliste i merakosur zëri i shtruar, — njëherë fshihet një matrapik. Në galeritë kryesore thyhen kot së koti kasat parafabrikate. Shkaktohen aksidente. Këto janë imtësira, po kurrë nuk kanë ndodhur në turnin tonë, as në minierën tonë.

Zëri i ashpër heshti, ra në mendime.

— Se ç'më bren dyshimi për atë njohësin e gjuhëve të huaja, — foli duke pëshpëritur zëri i shtruar.

— Ah, ç'më gërryeve zorrët me këto! Të bren dyshimi, gjeje! Ç'pret? Vëzhgo si punon, me kë rri, ç'bisedon. Të

dyshuarit kot është një mani. Marrëzi e dhjetëfishtë është kur dyshon dhe nuk kontrollon!», — e mbylli me solemnitet zëri i ashpër.

— Po, — tha me zë të vogël Kujtimi sikur të ishte zgjuar prej gjumit, — duhet të vërtetohet çdo dyshim.

K R E U XIII

Të gjithë minatorët e turnit «Sulmi» ato mëngjese dhjetori nga turni i tretë ktheheshin nëpër shtëpira të shqetësuar. Aksidenti në minierë, sidomos ato dy vrimat në katin e shtatë të shpuara nga poshtë lart, u kujtonin atyre shumë aksidente të tjera. Në minierë mjafton të ngjasë ndonjë ndodhi sado e vogël u jep shkas kujtimeve. Minatorët kujtonin çdo hollësi, kohën kur kishin filluar avaritë e vogla.

Kujtimi ndryshe nga herët e tjera kthehej vonë në shtëpi. Hante, shkante në dhomën e gjumit. Asnjëherë nuk flinte i qetë. Gjumi sikur ishte lagur në kafe, ishte irrituar, kishte marrë arratinë. Që të mos i jepte rast Dallëndyshes të pyeste për Limin që e kishte dashur aq shumë, edhe pse nuk flinte, e mbulonte kokën me jorgan. Veshët i shungullonin. Sikur i rraptonte diçka midis jastëkut dhe tëmthave, ashtu si krimbi kur bren dërrasat zhurmshëm e me bezdi. Mbi të gjitha zhurmat, ngrinte krye kumbimi i zërit të Lim Thanës:

«... shokë, e meritoj dënimin, po më besoni se unë nuk kam bërë mina në plan vertikal. Këtë jua them që t'i hapni sytë, se dikush tjetër e ka bërë atë shpërthim! Njëqind herë mund të kryeja krim kundër vetvetes, po jo kundër minierës! Miniera është vendi më i shtrenjtë për mua! Njëzetvjeç kam ardhur në minierë, more shokë! Në galeri kam lëshuar shtat!».

— E po kush deshte ta përmbyste minierën!, — foli me zë Kujtimi.

Ëmë e bijë dëgjuan zërin e Kujtimit, Dallëndyshja pyeti nga dhoma tjetër:

— Baba, deshe gjë?

Minatori vuri dorën mbi gojë, nuk u përgjigj.

— Mama, — i foli vajza Zanës në dhomën tjetër, — baba sikur nuk më duket mirë. Mos është gjë sëmurë, se, edhe kur i dhemb ndonjë gjë, nuk tregon.

— Jo, moj Dallëndyshe, — e qetësoi Zana, — punon në turnin e tretë, mbledhje të njëpasnjëshme, lodhet.

Kujtimi përgjoi bisedën. Zëri i Zanës e cyti dhe shpërgjumi kujtimet e fashitura. Lidhja e tij me Zanën zinte fill atje në luginën midis Rashkës dhe Tregut të Ri.

Sadiku duke dhënë shpirt, dokumenti i larë me gjak.

«— Ku të jetë beteja më e vështirë, atje duhet të jenë komunistët, këtë mos e harro!

— Nuk e harroj, baba!».

Këto fjalë i tingëlluan në veshë Kujtimit. Harroi se mund ta dëgjonin Zana dhe Dallëndyshja e prapë foli me zë:

— Këtë porosi e ndjekim të gjithë, baba!

— Po flet në ëndërr, — tha Dallëndyshja matanë.

— Ëndërr, moj bijë, ëndërr, — tha Zana dhe psherëtiu.

Prapë filloi ecejaku i kujtimeve.

— Ku e lamë?, — pyeti ai me zë sikur t'i kishte përpara fytyrat e luftëtarëve.

— Pas çlirimit në aksionet e rinisë, — u përgjigj po vetë.

«— Shoku komandant, — i kishte thënë një ditë komisari i brigadës, — duhet të shkoni në një kurs partie.

Kujtimit i ishin tendosur muskujt në nofullat e fuqishme.

— Çfarë shkolle?, — kishte pyetur ai, sepse në kokë i vlonin problemet e aksionit.

— Në një kurs që të mësosh.

— E dua shkollën, ia di vlerën, s'është se nuk ia di, po kemi shumë punë. Do ta vazhdoj pa shkëputje nga puna. Këtu kreve edhe uniken.

— Duhet të shkoni, shoku Kujtim, është kurs partie.

— Nuk u plaka të shkretën, kam kohë të mbaroj edhe atë.

— Shoku Kujtim, — komisar i dinte se ajo kështjellë mund të merrej vetëm me goditje të përqëndruar, — është

urdhër. Ky duhet zbatuar. Qysh sot duhet të nisesh për Tiranë. Dje atdheu kërkonte luftëtarë dhe ti u tregove i gatshëm, sot socializmi kërkon ngritje ideologjike, politike, shkencore.

— Të them të drejtën, edhe tre-katër muaj nuk kam dëshirë të largohem. Ky aksion mbaron brenda kësaj kohe. Kush ma paska gjetur adresën?

Komisari nuk i kishte folur, po i kishte zgjatur shkresën.

Kujtimi qe përqaftuar me aksionistët. Me ta kishte punuar. Me ta kishte bredhur natën në ndjekje të bandave, me ta kishte ndarë edhe koren e bukës; ishte mësuar me ta, e kishte të vështirë të ndahej prej tyre. Kishte marrë rrugën disi i pezmatuar. I buzëqeshte një fije shprese se mos takonte ish-komisarën, shokun Shaban, në Tiranë dhe t'i lutej që ta kthente në frontin e punës.

Gjatë tërë rrugës ai kishte renditur fjalët, kishte krehur fraza, kishte zgjedhur fakte me qëllim që ta kandiste ish-komisarën e luftës, po nuk i kishte ecur. I kishin thënë se shoku Shaban kishte vajtur me punë në një rreth dhe mund të kthehej pas dy-tre muajve. Kujtimi u qe drejtuar shokëve të luftës, por ata i ditkëshin të gjitha hallet e tij, shpirtin e tij. I kishin thënë se ai duhej t'i kanalizonte energjitë e pashtershme, për këto ishte shkolla, kursi.

Kujtimi u ul në bankën e shkollës. Studimet i shkonin mbarë, por i kruheshin duart për punë.

Gjendej në prag të mbarimit të kursit kur i erdhi një letër. Mbi zarf kishte lloj-lloj shënimesh me dorëshkrime të ndryshme. Letra kishte shëtitur nga aksioni në aksion, e kishin përcjellë me shënimin: «Kujtim Kreshpa gjendet në aksionin e ri, në...». Duke lexuar ato shënime, ai gati kishte harruar të hapte letrën. Ia dërgonte Zana nga një fakultet jashtë vendit.

Me shpresë se kjo letër do të të bjerë në dorë, po të shkruaj se jam mirë. Shpeshherë, nëpër gazetatat që i marrim rregullisht, shikoj portretin tënd. Të mos lexoja emrin nën fotografi, zor se do të të njihja. Ke ndryshuar shumë. Nuk jemi parë që kur u kthyem nga lufta në Tiranë? Mua më

është ngulitur fytyra jote, por atëherë pothuaj ishim fëmijë. Së shpejti mbaroj mjekësinë.

Dëshira ime është të më shkruash një letër.

Përqafoje për mua shokun Shaban.

Shoqja jote që pret t'i shkruash,
Zana Përdrinasi

Kujtimit i kishte qeshur fytyra dhe i ishte dredhur buza nga një kujtim përmallues. Përnjëherë kishte vendosur ti shkruante.

Për çudi, kur njeriu ka shumë mendime dhe kur ato sulmojnë të gjitha njëherësh, është vështirë t'i radhitësh, aq më keq kur shkruan një ose dy fjalë dhe i prish. Shkruan të tjera sërishmi, i prish dhe fillon nga e para gjer sa letra shkarravitet, grisët, fillohet tjetra.

«Po, — fliste me vete Kujtimi, — më mirë t'i shkruaj: *E dashur motër Zanë...* Jo, mor jo. Pse motër? — Këtë fillim nuk ia donte zemra, por shkakun mendohej t'ia fshihte vetes. Ai ende jetonte me shpirt dhe mendje në atmosferën e luftës. Ashtu ishte sjellë edhe në aksion. Ishte i pamëshirshëm ndaj atyre që ngacmonin femrat.

E kishte prishur letrën që kishte shkruar për të dytën herë dhe kishte filluar tjetrën.

«*Shoqe Zanë...*».

«Shumë e thatë, — kishte menduar me vete, — Zana nuk është bashkaksioniste». Më në fund kishte shkruar një letër.

I kishte rënë Zanës në dorë. Ajo i kishte kthyer përgjigjen ku i shkruante se sa gëzim të madh i kishte blatur letra e tij. Fliste me sinqeritetin e një fëmije.

Kujtimi e kishte lexuar, e kishte rilexuar çdo fjalë, edhe vizën më të vogël. Ishte habitur me ato ndjenja të ngrohta që shpreheshin në letër. I vinte plasje me veten. Edhe pse i lëviznin plot mendime, sapo vendoste letrën përpara, mendimet i ngjesheshin si currilat e ndonjë gurre të vrullshme, i përziheshin dhe nuk ishte në gjendje t'i rendiste ashtu si vepronte Zana.

Dy-tri ditë para se të mbaronte kursin, Kujtimi kishte vajtur në BRASH dhe u kishte thënë se ishte gati të kthehej në aksion. Dhe në aksion kishte shkuar. Jo si komandant, por si komisar.

Pas ca kohësh kishte ardhur Zana. Ai e kishte pritur në aerodrom. Disa ditë kishin qëndruar bashkë në Tiranë. Pastaj, Kujtimi ishte kthyer në aksion. Dhjetë ditë më vonë edhe Zana kishte vajtur atje si mjeke e aksionit.

Ishte aksioni i fundit. Komisar Kujtimi kishte marrë udhëzime të reja. Kërkohej fuqi punëtoare. Aksionistët do të shkonin në fronte të tjera, ndër fabrika, në uzinat e para, në kombinatat që do të ngriheshin.

Kujtimi, duke shfletuar shkresat, ishte munduar të zgjidhte frontin ku mund të jepte kontributin e vet. Por ato ishin aq shumë, sa që nuk arrinte të vendoste. Kishte mbledhur brigadat. U kishte folur aksionistëve për kontributin aq të madh që kishin dhënë, pastaj u kishte lexuar thirrjen. Shumë komandantë brigade kishin filluar nga regjistrimi. Kujtimi shkonte sa te një grup në tjetrin. Nëpër miniera ishin shkruar shumë pak. Kjo gjë e kishte shqetësuar.

«Pooo, — kishte folur si me vete Kujtimi, — duhet dhënë shembulli personal. Në minierë do të punojë ajka e klasës punëtoare. Minierat e reja me minatorë të rinj. Ja, dhe fronti i punës për mua u gjet».

— Shokë, kishte thirrur ai dhe kishte pritur gjer sa ishin mbledhur shumë aksionistë rreth tij, — kush i ka listat e fronteve të punës? Më shkruani mua në minierë. Do të bëhem minator! Atje ka nevojë atdheu, atje do të shkoj.

Një zë i kumbueshëm sikur të dilte nga thellësitë e dheut i kishte tingëlluar në veshë: «Ku të jetë beteja më e vështirë, atje duhet të jenë komunistët! Këtë mos e harro!».

Kujtimi kishte ngritur grushtin përpjetë.

Pas tij ishin shkruar komandantët e kompanive e shumë aksionistë.

Ata ishin shpërndarë në të katër anët e Republikës.

Pikërisht ato ditë Kujtimi u martua me Zanën. Për herë të parë u përqaftuan. Për herë të parë u shkëlqyen

sytë nga gazi i jetës që i bën sytë aq të shkëlqyeshëm e aq të bukur.

Pas një jave, të përcjellë nga shokët, kishin hipur në një makinë. Me vete kishin një krevat prej dërrase, një valixhe, tri batanije dhe ca libra.

Disa ditë kishin fjetur në hotel. Pastaj u kishin dhënë një dhomë përdhese. Më vonë ishin ngjitur në pallat. Zana kishte filluar punën si mjeke dhe pedagoge në Fakultetin e ri të Mjekësisë, Kujtimi si minator në minierën «1 Maji».

Kujtimi u përpoq t'u shmangej kujtimeve, u mundua të flinte, por, kur je i lodhur, kur ndonjë mbresë e fortë mbizotëron mbi lodhjen, ta përzë gjumin, po edhe bisedat me të tjerët janë të bezdisshme. Të vetmit shokë që të afrohen, që të qetësojnë dhe shqetësojnë janë kujtimet. Ato ngjajnë me hallka të një zinxhiri të gjatë. Hallka tërheq hallkën. Lëvizja e tyre mund të niset nga më të rejat te më të vjetrat.

Te Kujtimi zinxhiri kishte arritur në hallkat e para-fundit. Atje gjendej hallka që lidhte dy anët.

Kujtimet po i afroreshin vendnisjes kur, papritur, ra zilja e portës.

— Mirë se erdhe, baca Din, — u dëgjua zëri i Dallëndyshes. Në sallon u përzien edhe zëra të tjerë. Kujtimi i njihte mirë këta zëra. Shikoi orën. Njëzet.

«Edhe shokët nuk bëjnë gjumë të mirë», — tha me vete Kujtimi. Hapi dollapin. Vuri pallton krahëve, futi këmbët në pantofla dhe ashtu në pizhame doli në dhomën e pritjes. Ia shtrëngoi dorën xha Dinit, të cilin, edhe pse kishte dalë në pension, nuk e ndante as nata, as dita prej minatorëve. Me xha Dinin kishin ardhur Demi, Agroni, Rama, Qenani, Sherifi, Dilja.

— Aha, — u mundua të qeshte Kujtimi, — brigada e tretë sonte paska për t'ia shtruar gjumit në galeri.

Të tjerët nuk iu përgjigjën shakasë. Vetëm xha Dini, që nuk kishte rrudha në ballë sa kacafytje në betejat e nëndheshme, foli:

— Gazi karbonik ledhaton gjumin, po unë sonte do të qëndroj te ventilatori, do t'ju freskoj tërë natën. Jo t'ju zërë gjumi, jo të djersini, po edhe të mërdhini brenda në galeri.

— Sinjalistja, — Kujtimi tregoi me gisht Dilen, — do të shpëtojë nga veriu i ventilatorit në kabinën e vet ku bubullon zjarri si në kaldajë. Dilja do t'ia shtrojë gjumit, vetëm në e zgjoftë klithma e qymyrit që mezi i pritët të shikojë dritën mbas shekujve në errësi.

— Daktoreshë, — i thirri xha Dini Zanës që sapo hyri në dhomë, — gjashtë kafe të mesme. Për mua një me shumë, kurse për Dilen dy sade, që edhe nesër të mos e zërë gjumi.

— O, qenkan tanët, — tha Zana me gëzim, pastaj iu kthye së bijës: — Përse nuk i fute në kuzhinë! Ky reflektori, siç thotë xha Dini, i ngjan mishit të pjekur matanë vitrinës, tjetrit i lëngëzon goja, po e ndalojnë xhamat. Hajdeni në kuzhinë!

Të gjithë dolën në kuzhinën e madhe, të ngrohtë e të ndritshme.

— Vetëm ti ma di plagën, moj Zanë, — tha xha Dini, — bisedën e ëmbëlson zhurma e flakëve të stufës.

— Kujtim, — nuk iu prit Sherifit, — tek unë ishin zjarrmëtarët.

— Edhe ata s'paskan fjetur?, — pyeti Kujtimi.

— Ata ngulin këmbë se Limi është shkakhtar i aksidentit, dhe ai i ka bërë minat në plan vertikal.

— Nesër, — tha Rama, — do të shkoj të vizitohem te doktori i veshëve.

Dallëndyshja qeshi me Ramën, kurse të tjerët shikuan me habi.

— Po, — vazhdoi Rama, — do të shkoj të vizitoj veshët. Këta thonë se nuk kanë plasur mina në katin e shtatë duke gdhirë e marta. Kurse unë i kam dëgjuar siç po ju dëgjoj ju që po flisni pranë meje.

— Beqar, — ia pat Sherifi, — edhe unë u besova fjalëve të tua në fillim, po ato nuk zënë vend, more burrë i dheut!

— Pse?

— Zjarrmëtarët nuk kanë bërë asnjë shpërthim mbi katin e tretë. Po të besohen fjalët e tua, atëherë del pyetja: jo vetëm kush e bëri shpërthimin, por edhe ku u gjendën minat!

«Ku u gjendën minat?! Vërtet ku u gjendën minat! — Këto fjalë rrahën me forcë në mendjen e Kujtimit. — As që na ka shkuar mendja për këto gjëra! Dreq o punë! Po ngatërrohen fijet, po thellohet labirinti».

— Minat kanë plasur në orën dy, duke gdhirë e marta, fill pas shpërthimit ka vërshuar uji, — tha Rama.

— Ku u gjendën minat? Kush i plasi ato?, — pyeti Agroni.

— Kjo na mundon të gjithë, — tha Demi.

— Po sikur të ketë ardhur ndonjë i jashtëm, — tha Qenani.

— Atëherë duhet varur për këmbësh roja, Qazimi, — tha Dilja.

— I jashtëm, — tha Agroni me atë zërin e trashë, — mund të priste kabllot e korentit, që të mos funksionin ventilatorët, pompat. Por pa ndihmën e një të brendshmi nuk do të dinte se pikërisht kati i shtatë ishte thembra e Akilit, siç thonë shkrimtarët.

— Agroni ka të drejtë, — tha xha Dini.

— Kam edhe më, — vazhdoi Agroni, — bisedova me shokët e fermës, ata më thanë se për çdo kohë të keqe hapin portën e digës që të mos mbushet rezervuari cip mi cip. Kur u dha alarmi, porta e digës ishte shtrënguar deri në fund. Kush e mbylli!

«Ah, ai njeriu me fytyrën e mbështjellë me shall me vija! Cili ishte ai?», — pyeti veten Kujtimi.

— Paçin faqen e zezë Limi dhe Zizi!, — tha Sherifi.

— Të gjitha rrugët të shpien tek ata, — tha Qenani.

— Kur kujton aksidentin, — tha Dilja, — dhe harron të kaluarën e këtyre dy shokëve, të mbushet mendja se ata rrezikuan minierën. Por harrësa, sado e murme, nuk mund të mbulojë punën e palodhshme, djersën e madhe të këtyre dy minatorëve, sidomos të Lim Thanës.

— Ta zëmë se e bëri Limi...

— As që ka mundësi, — e ndërpreu Rama.

— Kurrë nuk më mbushet mendja, — tha Demi.

— Ta zëmë, — tha Agroni, i cili nuk tërhiqej lehtë nga e veta, — se deshi të hakmerrej me të pabesë kundër inxhinierit gjeolog, kjo edhe mund të ndodhë në çaste çmendu-

rie. Po nuk është ky i vetmi rast që tregon se në turnin «Sulmi», sidomos në brigadën tonë, punët nuk venë si duhet. Ne nuk fituam flamurin e muajit të dytë të tremujorit të katërt, edhe pse me prodhimin qëndronim në krye të turneve të tjera. Nuk na e dhanë për shkak të disa aksidenteve. Të vogla, të vogla, po aksidente. Thamë se ishin të rastit. Nëse vazhdojmë të themi ashtu edhe pas këtij aksidenti, duhet të vizitohemi te psikiatri. Pra, të gjitha sa kanë ngjarë nuk janë të rastit. Ta zëmë se Lim Thana, i përfshirë nga flaka e garës, nga sedra e madhe e punës dhe e tejkalimit të planit, i bëri minat, siç e pranon edhe vetë, duke gdhirë e diela; por uji shpërtheu duke gdhirë e marta. Po aksidentet e tre muajve të fundit, Limi i shkaktoi? Më bren dyshimi. Përmbytja na rrëmbeu kohën, në vend që të nxirrnim dyqind vagona, nxorëm dyzet. Por edhe na tundi! Na bëri t'i hapim sytë! Ta njohim mirë njëri-tjetrin.

— E njohim mirë njëri-tjetrin, — tha Rama.

— Jo, Ramë, — tha Agroni, — ka ndonjë që nuk e njohim. Nuk i njohim disa që janë futur nga porta e vogël si peshqesh për festa të panjohura. Ka edhe shokë nga tanët që pinë kohë e pa kohë. Ka ndonjë që gogësin gjatë mbledhjeve...

— Çfarë ka dreqin?, — thirri Kujtimi, i cili ishte kundër shpirtit kritizer të tepruar, megjithëse e dinte që Agroni nuk ishte i tillë.

— Ka anomali, Kujtim, — tha Agroni pa e prishur fare terezinë, — grupit artistik sikur iu çakërdisën telat e violinës. Ju më mirë se askush e dini se me ç'përpjekje e mundime e kemi ngritur. Një njeri në hotelin e beqarëve ka arritur t'u servirë të rinjve fotografi gjysmëlakuriqe. Përse u desh të rrezikohej miniera, që t'i mësonim këto gjëra. Dy djem nga tanët që deri dje mbërthenin për gjoksi ndonjë majmun kalipso jo vetëm në minierë, po edhe në rrugët e qytetit, tani kanë lënë flokët si furçe oxhaku. «Të shkojmë me kohën», — thonë ata. Për këtë duhet t'i jepet një dush i mirë sekretarit të rinisë për turnin, domethënë mua. Lim Thana që ishte propozuar edhe për dekorim një ditë ishte bërë xurxull. Xurxull e tapë bëhet Demir Ullish-

tasi. Dhe cili pa? Demiri, punëtori i depove të eksplozivit. Jo vetëm kaq, po ai bën muhabet qosheve me një njeri që më dhembnin sytë kur e shikoj edhe kur unë, shoku, vëllai i tij, e qortoj, Demiri ma kthen: *Rri, o babaxhan, njerëz të këqij në minierë nuk ka. Ata që janë të këqij, miniera ose i shëron, ose i flak jashtë bashkë me ato që kanë përbrenda!* Kësaj i thonë të bësh gjumë prej indiferenti. Kjo s'i falet askujt, sidomos neve minatorëve!

— Qenke i trashë, — i tha Rama Agronit, — të gjitha fajet ia veshke Limit, ti, or lalë. Një pikë e zezë në sytë e tu nxika male borë.

— Kokrra-kokrra bëhet kilja, kile-kile bëhet kuintali, — tha Agroni. — Biseduam me të gjithë shokët e turnit. Çështja shtrohet kështu: nëse Lim Thana i ka bërë minat në plan vertikal, atëherë kjo nuk është bërë për t'i dhënë turnit më shumë prodhim, por për ta shkatërruar minierën dhe minatorët. Unë them se Limi nuk i ka bërë. Atëherë na dalin këto pyetje që kërkojnë përgjigje të ngutshme: cili mbylli rezervuarin e fermës në kohën kur po binte shi i madh? Kush i bëri minat e dyta atje ku ishin bërë më parë prej Limit dhe Zizit?

Kujtimi e shikonte me vëmendje Agronin, vërente se si i ngriheshin dhe uleshin flegrat e hundës, vështronte vetullat e trasha, nën të cilat shkëlqenin dy sy të mëdhenj e të çiltër. Mendimet e tij puqeshin me të Kujtimit. Ndryshonin në një pikë: ndërsa i pari i mendonte dhe i fliste, të dytit i duhej t'ia nënshtrohte një analize dhe sinteze të thellë.

«Po, Agron, o vëlla, o shok, ti ke të drejtë, — mendonte me vete Kujtimi, — në ty kam besim se, sikur tërë punët e minierës të të bien mbi kokë, ti je i zoti të drejtosh dhe t'ia dalësh ndanë me sukses». Pastaj iu kujtua ai i riu topolak, babaxhan e i padjallëzuar, i cili sa kishte mbaruar gjimnazin, pat ardhur në minierë. Ndihmës e pat pasur Kujtimi. Si Agroni ashtu edhe të tjerët ishin rritur përpara syve të Kujtimit.

Dikur qeshte Kujtimi me fjalët e tyre të padjallëzuara, naive, kurse tani, kur diskutonte me ta, i duhej ti maste mirë ato që nxirrte prej goje.

Në ato çaste Kujtimit iu kujtuan fjalët e së shoqes kur

i fliste një pacienteje: «Më i parrezistueshëm ndaj gripit, qoftë edhe ndaj sëmundjeve të tjera, është njeriu që ka shëndet të dobët, që vuan nga ndonjë sëmundje tjetër. Prandaj lypset kërkuar me kohë ndihma e mjekut. Sëmundjet gjurmojnë organizma që mund t'i pushtojnë më lehtë».

«Vetëm një hap e ndan personin që lypset luftuar nga personat, të cilët mbartin plagë që lypsen shëruar, — mendonte me vete Kujtimi. — Zizi vuan nga lakmia e tepruar për lekë. Ai tjetri e ka nuhatur, e shtyn në ngasje në mënyrë dinake e të stërholluar. Limi vuan prej etheve të garës aq shumë, sa që kjo veti e mirë, duke i kaluar kufijtë, kthehet në të kundërtën e vetvetes, sepse përdor çdo mjet për t'ia arritur qëllimit. Ai tjetri edhe këtë e ka mësuar. Ia turbullon egon duke iu paraqitur si përkrahës, si dashamir, duke menduar që, kur të kryhet veprimi, Limin do ta ketë në dorë. Prapë si «dashamir», por me ato karta të fillojë me të një lojë tjetër.

Pas pak në shtëpinë e Kujtimit erdhën edhe Bukuria me dy seleksioniste. Diskutuan edhe ca. Kujtimi u tha të bënin një sy gjumë, pasi në orën njëzet e tre do të niseshin për minierë. U shpërndanë disa në dhomën e gjumit, disa në të fëmijëve, të tjerët në kuzhinë.

K R E U XIV

Meqë Demir Ullishtasi ua kishte varur punëve kulturore, Kujtimi kërkoi një fisarmonicist në Pallatin e Kulturës. Dërguan një farë Frederiku. Minatorët ia vunë nofkën «Fyçkë», sepse për ato dy orë në ditë që vinte në klubin e minierës, Frederiku më shumë tregonte barceleta, sesa bënte punën, për të cilën ishte ngarkuar. Kështu veproi javën e parë, të dytën nuk u duk.

Kur Kujtimi mori vesh se Frederiku paskësh bredhur nga dasma në dasmë, paskësh ngrënë mish të pjekur dhe paskësh futur dyqindlekëshin në xhep për çdo dasmë, e kërkoi, e gjeti e i foli, po tjetri ia ktheu:

— Or babë, ku luan leku, lëvizin gjishtat në tastierë. Pa lekë... — Fyçka shtoi disa fjalë që as fliten, as shkruhen.

Aty gjendej edhe Sherifi, të cilit i hipi gjaku në kokë dhe në çast e mbërtheu për gjoksi e deshi ta qëllonte, por Kujtimi ia kapi dorën.

— Mos, Sherif!, — i tha. — Të qëllosh bajgën, bie erë dora! — Pastaj e shpuri Fyçkën në Pallatin e Kulturës. Shokët e atjeshëm që pandehnin se Frederiku vazhdonte punën në ndihmë të klubit të minierës u revoltuan shumë dhe mbajtën qëndrim.

Pas kësaj ngjarjeje u mblodh komiteti profesional me kërkesën e anëtarëve të grupit artistik. Demir Ullishtasi duhej të jepte llogari për apati dhe ngathtësi në detyrën si përgjegjës i grupit artistik.

Demiri, në vend që të reflektonte në gabime, foli me nerva të acaruar:

— Nuk më shikoni se jam sëmurë! Zgjidhni ndonjë tjetër përgjegjës grupi!, — dhe doli nga mbledhja!

— Duhet të jetë sëmurë vërtet, — i tha Rrushi Kujtimin, — Demiri është zverdhur. Edhe kur vjen në të rrallë në prova, dremit. Herë-herë nxehet kot së koti. Dridhet, djersët ia mbulojnë fytyrën. Ulet në një vend, dhe, me sy gjysmë të fjetur, shikon në një pikë. Ç'iu desh Demirit të martohej me atë karafilën! Ja ku e shpuri.

Pas kësaj Kujtimin e kapi zjarmëtar Dulla:

— Demir Ullistasi ka për t'u çmendur! I kemi hyrjet përballë njëri-tjetrit. Nga mesnata qan me dënësë. Ndoshta e mundon ndarja me atë, po njeriu nuk bën kështu. I vete, bezdiset. Se nuk është në terezi, duket haptas, por s'ma merr mendja ta ketë tërë këtë sekëlldi vetëm nga ndarja me gruan...

Kujtimi ndjeu brerje në ndërgjegje, pasi prej kohësh nuk i kishte kushtuar Demirit goftë edhe pesë minuta kohë. Ndoshta që nga martesja me Ekaterinën, ndoshta që kishte filluar përsëri të pinte. Ç'është e vërteta ai kishte menduar se kjo sjellje do të ndikonte në një farë mënyre te Demiri, por po bindej se po ndodhte e kundërta dhe u detyrua të ndërronte takt.

Vajti në depon e eksplozivit.

— Ky magazinieri është trullor fare!, — i tha roja. Kujtimi e thirri Demirin dhe i foli ashtu si u flitet njerëzve që gabojnë. Tjetri heshte.

Demiri, sa kishte ikur Kujtimi, kishte zbritur në minierë, kishte vajtur te nëndrejtori.

— Në rast se nuk e ngre punën e atij «mikut» tonë, unë nuk mund të duroj më. Ai është bërë i padurueshëm. Ç'i duhen minat atij!, — i kishte thënë.

Nëndrejtori duket e kishte parë ngushtë dhe, në vend që ta qetësonte, ishte hedhur në sulm.

— Shoku Demir, — i kishte thënë ai, — s'të paskam njo-hur! Të kam mik të vjetër, por nuk mban ujë pilafi. Kush të ka autorizuar t'i japësh mina një tjetri. E di ti se eksplozivi është material luftarak?!

Demiri ishte frikësuar aq tepër përpara atij shantazhi, sa kishte menduar aty për aty ta mohonte:

— Nuk thashë se i kam dhënë njeriu mina, mos ma merrni llafin jangllësh! Më «kërkon» dhe «i dhashë», janë dy gjëra.

— Ashtu thuaj, ndryshe të piu e zeza, edhe pse të kam mik, nuk mund të të ndihmoj.

— Kujtimi më ka thënë t'ia hap zemrën, bile më ka dhënë afat.

— Ku ta ketë pasur fjalën Kujtimi!, — kishte pyetur nëndrejtori me mllef.

— Lodra bie për kë ka veshë, — i ishte përgjigjur Demiri, — Kujtimin nuk i shpëton gjë. Unë mendoj të shkoj atje ku duhet.

— Shumë mirë ke menduar, shko! — Nëndrejtori kishte vënë dorën mbi aparatën e telefonit dhe e kishte shikuar ngultas Demirin. — Po njoftoj unë. Tu them se një punëtor yni ka ardhur për të denoncuar! Si thua? Të njoftoj?!

Demiri ishte zverdhur. Nëndrejtori nuk e hiqte dorën nga aparati telefonik, as shikimin zhbirues Demirit.

Demiri heshte. Nëndrejtori kishte sulmuar.

— Ti e fute në minierë! Fol, ç'do t'u thuash kur të të pyesin? Ç'bën ai, ç'dyshime ke? Këto punë duan fakte, argumente, ndryshe do të të të quajnë shpifës. Për shpifje të dënon ligji!

— Lëre, lëre, e bisedojmë një herë tjetër, — ia kishte kthyer Demiri.

Kujtimi dhe shokët e organizatës së Partisë pyesnin, studjonin punët më me vëmendje, përpikmëri dhe gjakftohësi.

Kujtimi dërgoi Agronin dhe Ramën te ish-vjehrra e Demirit. Ata i ishin paraqitur asaj si shokë të Demirit, të cilët kishin vajtur me shërbim në atë qytet dhe ishin kthyer për të parë vajzën dhe djalin e Demirit. I kishin marrë fëmijët dhe kishin dalë shëtitje.

Vajza e Demirit u kishte thënë:

— Mua edhe vëllanë na merr malli për babin. Njerka nuk na donte, prandaj nuk e bezdisnim, kurse tani babi nuk është në rregull. Edhe kur ishte nëna gjallë, ai se ç'kishte.

— Çfarë kishte?, — e kishin pyetur ata njëzëri. Vajza kishte ngritur supet. Pastaj i ishte kujtuar e ëma dhe tha:

— Mamasë së shkretë i mbeti goja: *Qysh njëditëzaj, kur të mori ai shejtan në telefon, ti dridhesh nga ethet!...*

— Kush e mori në telefon?, — pyeti Agron Mala.

— Një... ku e di unë..., një punonjës i teatrit... Unë them se do të ketë qenë ajo gruaja, me të cilën u martua dhe u nda.

Agroni dhe Rama u kthyen atë të diel mbrëma e vajtën në shtëpinë e Kujtimit.

Pasi i treguan ç'bënë me fëmijët, ngulën këmbë në atë bisedën e mistershme telefonike. Agroni i përmendi Kujtimit edhe një herë dyshimin e tij: «Ku u gjendën minat për shpërthimin në katin e shtatë. Për mua këto të gjitha kanë lidhje midis tyre!».

Kujtim Kreshpa vente në punë, djersitej, kthehej nga puna, po dyshimet e tij dhe të shokëve i nguleshin si thumb.

Një ditë, ndërsa Kujtimi po hynte në mensë bashkë me minatorët e tjerë, Demiri, që ishte mbështetur mbi trungun e një akacjeje, i kishte dalë përpara e me shikimin përdhe i kishte folur:

— Kujtim, dua të bisedoj me ty...

Kujtimi i kishte futur krahun. Atë çast e kishte thirrur drejtori dhe ishte detyruar të largohej. Kur ishte kthyer, e kishte kërkuar në mensë, po nuk e kishte gjetur. I kishte

shkuar në depo, i kishte kërkuar ndjesë që e kishte lënë vetëm.

Demiri kishte qeshur.

— Hiç, hiç, — i kishte thënë ai duke qeshur në një mënyrë të çuditshme, — desha të të qerasja, por ti ike. Tani jam në orarin e punës.

— Nuk kishe gjë tjetër?

— Si të them, — ishte përgjigjur Demiri, — edhe mund të kem, — prapë kishte qeshur siç qeshin të dehurit. — Dikush dëshiron të pijë, se i është helmuar gjaku. Helmi kërkon helm. Dikë e mendojnë kusuret e të tjerëve. Ndonjërin e ndjekin hijet...

— Është bërë tapë, — i kishte pëshpëritur roja i magazinës, po ti mos u shqetëso, jam unë këtu!

Kujtimi e kishte parë rojën e depos me dashamirësi.

— Do të vish me mua në shtëpi!, — i kishte thënë pastaj Demirit.

— Përse?! Përse të vij me ty? Do të më... Nuk dua të vij! Nëse më quajnë Demir Ullishtasi, unë do të di të veproj! I zoti e nxjerr gomarin nga balta. Kjo është aq e vërtetë sa është e vërtetë se Kujtim Kreshpa pandeh se jam i dehur! Unë, mor shok, edhe pa pirë jam i dehur!... — Kaq tha Demir Ullishtasi.

Atë ditë në magazinën e eksplozivit u vu një zjarmëtar veteran.

*

*

*

Të gjithë minatorët ishin dhënë pas hulumtimeve. Kujtim Kreshpa shtrydhte kujtesën, çdo episod, çdo ngjarje të gjashtëmuorit të fundit e kalonte nëpër mend. Iu kujtua rasti kur Ramë Dushku dhe Dem Qesati ishin grindur me Zhagan Dhogën. Ramën e kishte thirrur përgjegjësi i turnit në prani të Kujtimit si sekretar Partie për turnin.

— Ramë, — i kishte thënë, — përse je ngatërruar me Zhaganin?

— Ai Miho Gjelaci nuk më pëlqen. Më duket një tinëzar i ndyrë!, — ishte përgjigjur Rama, — Po të vëresh sytë

e picërruar të Mihos, kupton mirë se ke të bësh me një ugun të keq.

— Mor shoku Ramë, — e kishte ndërprerë Shkëlqimi, — ne të kemi thirrur për zënkën me Zhaganin, askush nuk të pyeti për Mihon.

— Prit, mor tungjatjeta, me kë rri Zhagani? Me Mihon. Ashtu? Zhaganin e mëson Mihoja. Jo se Zhagani është ndonjë mall më i mirë, ka gjetur tenxherja kapakun. Por unë mundohem të bëj një farë ndarje. I keqi nuk mund të bëhet i mirë, kurse dedalli mund të bëhet i keq. Dedalli është shumë afër të keqit. Dedalli do dru që të mos bëhet i keq.

— Ç'është kjo filozofi me dedall, mor Ramë?, — e kishte pyetur Shkëlqimi.

— Dedalli është ai që ka lakra në krye, kurse i keqi është armiku i klasës, jua thashë, meqë i doni arrat të qëruara.

— Ramë...

— Nuk do të zgjatem. Kam vënë re se ky farë Mihoja qysh se ka ardhur në minierë i vardiset Dile Ciparisit.

— Mihoja apo Zhagani?, — kishte pyetur Kujtimi.

— Mihoja nëpërmjet Zhaganit. — Rama prapë po harronte të fliste për zënkën. Atij një fjalë i kujtonte të tjerara dhe harronte kryesoren. — Mund të thotë ndokush se Dilja ka lënë burrin. Mund të thonë se, gjersa ka vepruar ashtu, nuk është femër e ndershme. Po unë mendoj ndryshe, fare, fare ndryshe. Për mua është e ndershme edhe ajo grua që, kur bindet përfundimisht se nuk mund të kalojë me atë që i kanë dhënë për burrë, ndahet. Disa e quajnë të pandershme atë grua, e cila ka pasur kurajën dhe i ka thënë burrit se nuk është lopë, se nuk mund të jetojë me të. Ne meshkujt jemi të zotët të flasim kundër patriarkalizmit. Por e shfaqim fytyrën tonë në veprimet që bëjmë, në kërkesat, në vendimet...

— Mor Ramë, — i foli Shkëlqimi, — të pyeta përse u grinde me Zhaganin? Nuk të thirra të filozofosh. Bjeri shkurt!

— Për atë po ju flas edhe unë. Miho Gjelaci që nuk e di se Dilja ka qenë e martuar, i vardiset. Dihet, nëpërmjet Zhaganit, derisa ky i fundit i ka thënë Diles për një sho-

kun e tij. Meqë Dilja nuk ka pranuar, Zhagani ka kurdisur një kurth. Po Dilja nuk është e tillë, Dilen e njoh mirë. Është femër trimëshë, ka një shpirt të pastër. Dilja më ka treguar vetë se ai xhaxhai lakmitar e ka shitur. Dilen vërtetë e detyroi koha të flinte dy net në një jastëk me një burrë pesë herë më të madh se veten. Por xhaxhai i saj e dërgoi të lidhur te burri duke kullufitur njëqind mijë lekë të vjetër. Po shpirti i Diles, trupi i saj kanë mbetur të pastër, siç mbetet i pastër ari sikur ta hedhësh edhe në pleh. Nuk jam kundër propozimit që i ka bërë Zhagani, por kundër mënyrës së pandershme.

— Cila është kjo mënyrë e pandershme?, — pyeti Kujtimi.

— Zhagani i ka thënë Diles:

— *O do të shkosh me një shokun tim, o do të të punoj qindin. Ka femra që e mbajnë hundën përpjetë, xheç kujtojnë se janë, po befotrofi ruan vulat e turpit të tyre.*

— *Për cilën e ke fjalën, mor maskara?*, — ia kishte pritur Dilja.

— *Nuk është vështirë të shtyhet një fëmijë i befotrofit të thotë se nëna e tij është Dilja. Nëse ti nuk më dëgjon, dije se do të të skuqet fytyra përpara të gjithë minatorëve dhe s'ke për të qenë më Dilja e bukur dhe e ndershme, por një Dile që ka një fëmijë ilegal.*

— *Shpifës, intrigant!*, — e kishte pështyrë Dilja. Zhagani kishte ikur duke belbëzuar:

— *Dile, nuk është hera e parë, as e fundit që mund të flesh me një mashkull. Nuk të kushton gjë. Ndryshe unë mund të ta bëj të keqen dhe kam për të ta bërë... Dilja ishte tmerruar. Ajo nuk ka bërë kurrë fëmijë në jetë. Më tha: «Nuk i duroj dot fjalët, janë shumë të pista!».*

— Ramë, je i bindur për këtë që thua?, — pyeti Kujtimi.

— Më se i bindur. Dilja deshi të vinte te ju, unë nuk e lashë.

— Pse?

— Sepse desha t'ia thyeja turinjtë atij Zhagan Dhogës, pastaj bashkë me Dilen të vinim te ju.

Shikimi i Kujtimit u kryqëzua me atë të Shkëlqimit.

- Ramë, këto që i the këtu, askujt!
- Minatorët nuk llapin, shoku Kujtim.
- Në rregull, por ja që gabova kur e qëllova Zhaganin.
- Kam edhe unë gjynahet e mia, sepse dëshiroj ta ndëshkoj padrejtësinë me dorën time. E kam shpirtin të mbushur me maraz nga njerëz si ata të dy.
- Po Dem Qesati ka qenë me ty?
- Mos e ngatërroni Demin, shoku Shkëlqim... S'kish-te nevojë të më ndihmonte njeri.

Meqë xhelozia nuk mund të lindë kot dhe te kushdo, zënka e Ramës u dha të kuptonin Kujtimit dhe Shkëlqim-it se minatori do t'ia linte lamtumirën beqarisë.

Rama kishte ardhur në minierë kur po hapej pusi i parë. Kushedi sa herë ishin munduar ta bindnin shokët që të martohej. I kishin krijuar edhe raste të njihej me vajza të mira. Por Rama u ishte përgjigjur:

- Iku koha ime.

K R E U X V

Procesi gjyqësor për ndarjen e Demirit me Ekaterinën po vonohej. Demiri, i shtrënguar nga Mihoja, nuk kishte vënë ndonjë argument me peshë për ndarje.

Një plakë u paskësh thënë shoqeve të veta në radhën e qumështit:

- E kapi gruan me tjetrin, pa e ndau!
- Me cilin, moj korbë?, — e kishte pyetur një grua.
- Me atë nga miniera... që vinte tinëz në apartamentin e Demirit!, — kishte thënë plaka.

Fjala kishte marrë dhenë. Arriti në minierë, ra edhe në veshët e nëndrejtor Bajazitit. Ai u inatos, po edhe u frikësua.

Ekaterina, në fillim, e priti me mospërfillje ndarjen e saj me Demirin. Gjithë forcat dhe mjeshtërinë i kishte përqëndruar te një nëpunës, me të cilin, siç kishte dijëni dhe Demiri, kishte relata të fshehta.

«Xhimxhi (kështu e thërriste ajo me përkëdheli) do

të më ndihmojë me mish e shpirt, ai ka një shok të fortë, — thoshte ajo me vete. — Në rast se nuk do të mund ta dëboj Demirin nga shtëpia, Xhimxhi do të ndërhyjë në strehim të më japin hyrje më vete. Pastaj tërheq mananë dhe Giçin që e ndau ai torollaku».

Një mesditë me të tilla mendime në kokë Ekaterina vrapoi bulevardit, kaloi rrugicave dhe u gjend përpara zyrës së Xhimxhit. Priti shumë. Ai doli vonë. Ishte tepër i nevrikosur. Fshinte qafën me shami, djersët i shkonin çurk, edhe pse bënte ftohtë.

— Xhimxhi, — i foli Ekaterina.

Xhimxhi e shikoi me një palë sy të xhamtë. Ktheu kryet prapa:

— Më prit te kthesa, — i tha ai me zë të shuar.

Ekaterina, edhe pse e habitur për atë sjellje të ftohtë si akulli, eci përpara. E prit prapa një dyqani cigaresh.

Xhimxhi edhe një herë shikoi rreth e qark, pastaj e tërhoqi Ekaterinën prapa VC-së.

— Katjushkë, i kemi punët pisk, — i tha ai, — deri tani mbledhje për punën time...

— Çfarë pune?!, — pyeti Ekaterina.

— Për qëndrimin tim moral, pra!, — shfryu Xhimxhi. Ekaterina fërgëlloi.

Në ndonjë rast tjetër Xhimxhit do t'i kishte pëlqyer pa masë, do ta kishte mbuluar me të puthura, por ai dridhej. Në vesh i tingëllonin fjalët e shokëve: «...Shfaqje të theksuara liberale... i dhënë pas hatëreve... i shturur dhe imoral!...».

— Do të mundohem të bëj diçka për ty, — i tha ai Ekaterinës kur ajo i tregoi se ishte ndarë nga burri. E lanë të takoheshin pas tri ditësh në kthesën e Rrugës së Kamzës ku Ekaterina do të shkonte me taksi.

Ekaterina vajti atje, prit gjatë. U nevrikos. Xhimxhi nuk u duk.

Sa nuk i ra pika kur mori vesh se e kishin shpënë për riedukim. Iu prenë të gjitha shpresat.

Vajti te Bajaziti, por ai e prit me këmbët e para.

— Harbon si ndonjë pelë e hazdisur, — i tha ai. — Si ke sy e faqe të vish tek unë! Të njoh si grua të një punë-

tori të ndërmarrjes sime. Tani e tutje të mos ta shikoj bojën. Zhduku dhe mos gabo të trokasësh më në portën time, se të piu e zeza!

Ekaterina vajti te teze Sermja. Edhe ajo ia mbylli derën përpara hundëve duke i thënë:

— Nuk dëgjove këshillat e mia, tani duhet të të shoh kurrizin. Shko i kërko falje Demirit!

Ekaterina vajti te Demiri, u orvat të lëpinte atë që kishte pështyrë më parë. Atë e gjeti të dehur. Shumëkujt iu lut të ndërhynte për t'i pajtuar, po nuk pranonte njeri. Edhe njëri që mori përsipër barrën e rëndë të pajtimit nuk u përfill prej Demirit.

Miho Gjelaci i ndiqte nga larg këto ngjarje dhe i vinte të hante veten me dhëmbë. Me gjithë përpjekjet e tij për ta drejtuar Ekaterinën të vepronte ashtu siç i leverdiste, çdo gjë i rrokullisej në kundërshtim me nevojat dhe dëshirat e tij. Kur u bind se çdo ndërhyrje e tij ishte e kotë, vendosi të kthehej në një sositës të zakonshëm duke rezervuar një shpresë. «Kur të katandiset keq, — thoshte me vete, — do të vijë të më bjerë ndër këmbë. Atëherë do t'ia shtrëngoj vidat mirë. Edhe ky Demir Ullishtasi kohët e fundit po bëhet i pabindur!», — dhe iu kujtua një fjalë e urtë që thotë se topin, sa më shumë ta shtrëngosh, aq më tepër kërcen!

Kur nuk ia doli dot, Ekaterina vendosi t'u bënte elozhe beqarëve të minierës me qëllim që të turbullonte zemrën e Demirit. Kjo gjë i ra në sy Zhagan Dhogës, i cili, pa u këshilluar fare me Mihon, ju vu prapa. Zhagani nuk dinte asgjë për farefisninë e Ekaterinës me Mihon, ashtu si nuk dinte asnjëri përveç Demirit.

Në mos nga pamja e jashtme, nga shpirti Zhagani dhe Ekaterina ngjanin si dy pika uji. Zhagani ishte i pashëm, i gjatë, me një hundë të madhe. Edhe pse ishte llafazan i pashoq, Ekaterinës i pëlqeu.

Që në takimin e parë, Mihoja i pa. Pasi u ndanë, ai kapi Zhaganin e i tha:

— Mos u ngatërro me të, sepse do të të marrin me sy të keq punëtorët e minierës. Ajo është gruaja e një minatori.

— Më ke thënë shumë gjëra, askund nuk ta kam bërë fjalën dy, këtu mos u nakatos, sepse nuk ta përmbush dot këshillën. Ti më njeh...

Mihoja në fillim u skandalizua, por më vonë mendoj qetë-qetë ta shfrytëzonte në dobi të dyfishtë këtë njohje të re midis Zhaganit dhe Ekaterinës.

Zhagani i shpeshoi takimet me Ekaterinën. Ai i fliste asaj: «Kështu e rrafa njërin! Kështu i dhashë një grusht në nofulla një tjetri».

Një ditë Ekaterina vajti në qytezën e minatorëve.

Edhe pse mjeku i minierës me porosinë e Kujtimit i kishte lëshuar raport dhe e kishte porositur Demirin të qëndronte në shtëpi, të pushonte e të qetësohej, ai nuk ndahej nga qyteza e minatorëve. I shikonte shokët nga larg kur hynin në minierë dhe hante veten përbrenda përse nuk ishte si ata.

Këtë gjë e dinte Ekaterina. «Kur të më shikojë me një tjetër, Demir Ullishtasi do të brehet nga xhelozia. Kjo do ta bëjë: ose të pajtohet me mua, ose të rrahë Zhagan Dhogën. Të dyja mundësitë më sjellin fitim. Nëse Demiri do të tërheqë kërkesën për ndarje, do të më nënshtrohet përfundimisht! Do të më japë kohë të peshkoj ndonjë më me pozitë se Xhimxhi. Nëse rrihet me Zhaganin, do ta burgosin. Do të dënohet. Apartamenti më mbetet mua. Ndërkohë martohem. Deri sa të dalë Demiri nga burgu unë me atë tjetrin do të kem fëmijë, s'më lëviz njeri nga Tirana».

Demir Ullishtasit, sa e pa me tjetrin, iu errën sytë.

Kujtim Kreshpa me disa minatorë të tjerë e nuhatën. Ata e dinin sa i ndyrë ishte Zhagan Dhoga, po e kuptuan edhe sa djallëzore ishte ajo femër. Kujtimi e mori me mend se do të pëlçiste grindja, ndaj dërgoi dy shokë që pa të keq iu afruan Demirit, e zunë për krahu dhe bashkë me të u futën në mensë. Buzëqeshja e tij ngjante me ngërdheshje të dehurish, fjalët me belbëzime.

Mu përpara derës së mensës Zhagani bisedonte me Ekaterinën. Qeshte dhe e ngacmonte me dorë, duke shikuar me mburrje nga një grup minatorësh në lulishte.

Kujtimi vuri re fytyrat e egërsuara të minatorëve. Ata

po çapiteshin drejt Zhaganit, sigurisht do ta mbërthenin për zverku dhe do ta përcillnin andej përgjithmonë siç e meritojnë njerëzit e shtthurur. Kujtimi ndau Zhaganin e i tha:

— Ç'e ke atë?

— Një copë të majme për konsum..., — iu përgjigj Zhagani duke u zgërdhirë.

— Mor, po ç'je ti?! Nga ke ardhur te ne?!, — pyeti Kujtimi me një zemërim që mezi e përmbante.

— Shko merr informata në zyrën e gjendjes civile, — ia ktheu Zhagani.

Kujtimit i hipi gjaku në kokë. E kapi për mënge dhe e tërhoqi drejt vetes.

— Hiqe putrën, — u krekos Zhagani.

Kujtimi e mbështeti për muri:

— Kur do të mësosh të flasësh, mor gangster?!

Zhagani këqyri rreth e qark me shpresë se ndonjë do të vinte ta nxirrte prej andej.

— Unë bëra shaka, — tha kur s'pa njeri t'i vinte në ndihmë, — bëra shaka, shoku Kujtim! Më lër, për nder, bëra shaka.

— Zhduku! Kurrë të mos të shikoj këtu me atë lav..., — e hëngri gjuhën, se, edhe po ta thoshte fjalën të plotë, nuk do ta tepronte.

Zhagani nuk e priti autobusin, zbriti kodrës, Ekaterina e ndiqte prapa.

Edhe pas asaj ngjarjeje, Ekaterina vinte e priste Zhaganin atje te akacjet. Demiri i shikonte të gjitha. Ai u kishte dhënë fjalën shokëve se nuk do të fëlliqte duart.

KREU XVI

— Zanë, të më besosh, me trup jam në minierë, kurse mendja më vete gjetkë. Jemi mësuar me dreqin..., — tha Kujtimi. — Ia dinim cenet, duhej të punonim më shumë. I rrëmbyeshëm në çdo veprim.

— E pashë sot.

— Limin? Ku e pe? Patjetër ishte kërleshur si tigër i zemëruar?, — pyeti Kujtimi i interesuar.

— Ecte shpejt bulevardit. Iu afrua portës së komitetit të Partisë. Thithi cigaren, siç e thithin studentët para se të hyjnë në provim dhe e hodhi tutje. Bëri të hynte, po ndërroi mendje. Kur më pa mua, uli kokën e këmbëu rrugë.

— Unë, — tha Kujtimi, — ndiej një zë në thellësi të shpirtit. Limi është i pafajshëm.

— Kush e mbrojti në mbledhje?

— Rama, ndihmësi i Ramës, ndihmësi i Limit, Dilja dhe Bukuria.

— Bukuria?!

— Po, po, Bukuria.

— Po Qenani?

— Edhe Qenani.

— Një kolektiv e ka dënuar, prandaj nuk duhet të të mendojë asgjë.

— Jo, moj Zanë, kolektivi e dënoi për thyerjen e rregullave të sigurimit teknik. Asnjëri nuk e ngarkon me faj për aksidentin.

Ndërsa Kujtimi bisedonte me të shoqen për çështjen e Lim Thanës, Dem Qesati dhe Ramë Dushku pyesnin Bukurie Demën:

— Je bijë mekaniku, — i thoshte Demi, — je anëtare e kolektivit tonë, duhet të thuash të vërtetën! Ke gjë me inxhinier Petritin? Përse u zutë me Lim Thanën?

— Mos na e merr për keq, — ndërhyri Rama, — ato janë punët tuaja, por duhet të sqarojmë një ngatërresë...

Bukuria u skuq. Iu përpëliten ata qerpikët e gjatë. Sytë sapak i lëngëzuan.

— Punë kalamanjsh!..., — tha.

— Nuk e prisja prej teje, — tha Demi, — unë të kam në vend të gocës sime, Gjeraqinës. Nuk po llafosim për punë kalamanjsh, po...

Bukuria e kuptoi se dy fjalët e saj tjetri i keqkuptoi dhe e ndërpreu.:

— Zënka e Limit dhe imja që si grindje fëmijësh. Limi iku në plazh, nuk erdhi të më takonte. U kthye, më mbante mëri. Ndoshta do të shkelja mbi kryelartësinë time, do ta pyesja ç'kishte. Po fjalët që u hapën se ai në plazh... —

Koka iu var mbi gjoks — Më kuptoni, edhe unë u zemërova.
— Dhe për inat të Limit zure një tjetër?, — pyeti Rama.

— E ke fjalën për inxhinier Petritin? Me të nuk kam asgjë, — tha Bukuria.

— Vërtet!, — pyeti Rama edhe i habitur, edhe i gëzuar.

— Petriti nuk është djalë i keq, ndoshta-ndoshta është edhe më i mirë se Limi, por është më i mirë ai që do, si do që të sillet ai...

Demi dhe Rama e ndien veten ngushtë, ndoshta atë çast të dy mendonin njësoj që atë detyrë t'ua kishin ngarkuar shoqeve, meqë vajza skuqej prush ndërsa fliste.

— Domethënë me Petritin nuk ke gjë?, — pyeti Rama duke belbëzuar.

— Si shpjegohet?, — pyeti Demi.

— Do të thuash përse flas me Petritin, — tha Bukuria, — unë mendoj se Petriti asgjë të keqe nuk më ka bërë.

— Limi të do, — tha Rama, — ato që u thanë për të gjatë ditëve që kaloi në kampin e punëtorëve janë thashethe-me.

— Duhet ta kesh parasysh, por të mos ia thuash askujt, — plotësoi Demi, — se grindjen midis jush ka dashur ta shfrytëzojë dikush për qëllimet e veta.

Bukuria picërroi sytë, sikur deshi të depërtonte në ato fjalë që u thanë me një frymë. Po Rama dhe Demi e lanë, ata vajtën te Kujtimi. Atje hëngrën edhe drekë.

Së bashku u nisën për në punë.

*
* *
*

Kujtimi kishte mbaruar punimet në oxhakun numër 6, tani punonte në një oxhak të ri. Gjithë mjeshtëria e minatorit, siç thonë punëtorët, qëndron në hapjen e oxhaqeve. Kujtimi ishte mjeshtri më i mirë i oxhaqeve. Mirëpo uji dhe presioni bënëin kërdrinë. Këso rastesh Kujtimin nuk i shqitej prej mendjes legjenda e kalasë së Rozafës, edhe pse s'u kishte besuar kurrë përrallave as bestytnive.

I fliste ndihmësit, tjetrit i bëhej qejfi, meqë një mjesh-tër si Kujtimi i kërkonte mendim:

— Ke vënë re, Luan, ajo që fitohet me shumë mund e djersë fundin e ka më të gëzueshëm!, — i tha Kujtimi duke mbërthyer perferatorin dhe, si drejtoi llampën mbi kuadraturat, vazhdoi: — Shtresa e qymyrit merr pjerrtas. Shpimi për mina do kujdes. Ndryshe argjili tinëzar do të zvariset si ndonjë gjarpër. Fillojmë!

Vendosën barominat në gojën e perferatorit. Kur Kujtimi shtypi dorezën, filloi kërkëllitja. Baromina rrotullohej, pluhuri i qymyrit rridhte si ndonjë miell i zi. Luani me njëren dorë mbante fundin e perferatorit, me tjetrën priste thërrmiat e qymyrit që rridhnin mbi mëngët e kominosheve të Kujtimit.

Kur po hapnin vrimën e pestë, erdhi zjarmëtari i ngarkuar me mina.

— Dullë, — e pyeti Kujtimi, — si të duket drejtimi i vrimave?

Zjarmëtari rrotulloi kokën, fiksoi dritën atje ku puthiten këmbët e kasave me kapelet e u përgjigj:

— Ia paskeni gjetur zemrën, druaj mos do të ketë ujë.

— Do të shpejtojmë, — tha Luani, — nuk do t'i japim rast të krijohet ndonjë boshllëk për shembje.

— Mre, çuni, — foli Dulla, — ka filluar të bëhet zot i zanatit. Çuno, i ke gati shukat e baltës?

— Ashtu si i do ti, të forta dhe të lëmuara.

Dulla provoi vrimat me shkopin e minave. Vendosi llokumet njëren pas tjetrës, i dyllosi me shukat e baltës, pastaj shtriu telat. Të tre u tërhoqën në kthesën e traverban-gut. Dulla rrotulloi dorezën e aparatit. Një plasje e fuqishme. Rryma e ajrit u vërvit mureve të galerisë.

— Oh, të keqen, shkëmbit iu tundën mushkëritë, — thërriste Luani i entuziazmuar.

— Mre, çuni!, — tha Dulla duke i hedhur dritën në sy Luanit. — Ti në fillim mbyllje veshët! Tani kënaqesh kur përpëlitet shkëmbi. Sa shpejt burrërohen këta çunat tanë!, — i tha ai Kujtimit. — Kur hyjnë për herë të parë në minierë, më duken të qullët. Hiç s'ma mbushin syrin. Sa shpejt bëhen minatorë! E unë i thinjuri i minierës, kur flas

me të, duhet të zgjedh fjalët. — Pastaj vuri çantën mbi kurriz.

— Dullë, — i tha Kujtimi, — pas tri orësh më duhen edhe pesë mbushje.

— Mre, pas tri orësh! Gjysmë ore do të prisni sa të pastrohet tymi.

— Shiko si fishkëllen ajri, — foli Luani, — ia kemi futur tubin mu në gërlan ballit të frontit.

— Po veshjen, po kuadraturat?, — pyeti Dulla.

— Të gjitha i kemi gati.

— Epo mirë ju gjetsha pas tri orësh, — tha Dulla duke ikur.

Te kthesa e traverbangut u duk një llampë minatori. Ishte Miho Gjelaci.

— Po ky, — i pëshpëriti Luani Kujtim, — ç'dashkë këndeje?

Heshtje.

— Puna e mbarë, shoku Kujtim, ç'thotë oxhaku i ri? S'ka ç'të thotë, kur ka të bëjë me një mjeshtër si ju, — tha Mihoja.

«Ky Mihoja s'para më afrohet, — mendoj me vete Kujtimi. — E mundon ndonjë gjë dhe kërkon të flasë me mua, Apo kërkon të provojë ç'qëndrim mbaj unë ndaj tij në raste kur atë e pickon miza nën qeleshe?».

— Shoku Kujtim, — foli Mihoja, — kemi një shembje të vogël në nënkatin e dytë. Dëgjova që bëtë minat, këtë gjysmë ore, sa të pastrohet tymi, po deshët, ejani.

— Luan, — e porositi Kujtimi ndihmësin, — deri sa të vij unë, mos iu afro oxhakut. Nuk do të vonohem, — tha dhe shkoi pas Mihos.

— Shoku Kujtim, — llototiste Mihoja, — më ka rënë të punoj me shumë minatorë, por si ju nuk besoj të ketë në tërë minierat.

Kujtimi nuk i honepste dot lëvdatat, megjithatë heshtte.

— T'ju them të drejtën, — vazhdonte Mihoja, — njeriu mund të mësojë shumë prej jush. Kanë fat të madh ata ndihmës që punojnë me ju.

— Jam minator, si gjithë të tjerët, — tha Kujtimi.

— Ja, pikërisht këtë desha të thosha, jeni aq modest, sa ngjallni respekt te të gjithë. Jo më kot ju duan dhe jua dëgjojnë fjalën të gjithë.

Kur po ngjiteshin për nënkatin e dytë, Kujtimi kapej prej shkallësh për t'u ngjitur sa më shpejt që të mos i jep-te rast tjetrit të fliste.

Në nënkatin e dytë, dy kasa këndeje ballit të frontit, ishte shembur tavani. Duhej bërë katriazh. Kujtimi u buzë-qeshi ëmbël ndihmësve të Mihos, kapi disa copa kasash dhe filloi nga katriazhi. Mihoja dhe ndihmësit e ndihmonin.

Sapo u mbyll shembja, Mihoja filloi të bluante.

— Shoku Kujtim, është fat i madh për ne dhe për minierën që kemi një njeri si ju këtu. Nuk di për të tjerët, mund të ketë edhe mendjemëdhenj, po unë për vete mësoj shumë prej jush. Jeni përsosmëria...

— Miho, — e ndërpreu Kujtimi, — në minierë të gjithë mësojnë prej njëri-tjetrit. Mirë mbetshi, ika!, — tha ai dhe zbriti shkallëve. Kur arriti tek oxhaku, tymi ishte pastruar. Ata filluan nga puna. Veshën oxhakun, hoqën qymyrin që kishte rënë poshtë dhe shpuan vrima të reja. Edhe pse ishin nga fundi i tetorëshit, bënë shpërthimin e dytë dhe pritën sa u pastrua tymi. Veç kësaj bënë edhe veshjen e dytë të oxhakut. Minatorët e turnit tjetër kishin hyrë dhe filluan nga puna.

Kujtimi dhe Luani po i afroreshin oxhakut të rrugëdaljes. Sapo bënë ballë në hyrje të tij, një bllok sa një kataka u lëshua tatëpjetë me zhurmë. Kujtimi e tërhoqi ndihmësin. Blloku ra mbi shkallët e fundit dhe u shkërmoq. Pritën ca. Kur Kujtimi për së dyti vuri këmbën mbi shkallën e oxhakut, prapë u shkapëput një copë argjil e ra mbi këmbën e tij. Dhembja ishte e madhe. Kujtimi eci pak tutje-tëhu dhe mori vesh se nuk kishte pësuar thyerje. Hoqi çizmen, fërkoj këmbën. Ky aksident e përmendi: edhe blloku i hedhur në oxhakun pesë, që kishte plagosur lehtë Ramë Dushkun, nuk duhet të ishte i rastit. Dikush i hidhte këto blloqe! Po kush?

Luani para, Kujtimi prapa u ngjitën në sipërfaqe me ashensor.

Miho Gjelaci sikur ta dinte se Kujtim Kreshpa do të

pyeste se cili kishte dalë i parafundit në sipërfaqe, i larë dhe i veshur kaloi përpara të dyve e shkoi në mensë.

«Mihoja qenka larë, qenka ndërruar, — mendoi Kujtimi, — domethënë paska dalë në sipërfaqe të paktën një orë më parë. Kush t'i ketë hedhur blloqet?!», — mendoi dhe eci drejt banjave duke u munduar të mos çalonte.

Aksidente të tilla në turnin «Sulmi» po shpeshoheshin. Minatorët përgjonin në fshehtësinë më të madhe. Po dyshimet i shpinin në drejtime të pacaktuara. Asnjëherë gjurmët nuk shkonin te Miho Gjelaci.

K R E U XVII

Ca kohë pas hedhjes së dy blloqeve në oxhakun e rrugëdaljes, një pasdite, minatorët komunistë dorëzuan veglat e punës në depot e nëndheshme kaluan përmes kryqëzimit të galerive, buzë pusit numër 2 dhe ndoqën kthesën e rrumbullakët. U zhdukën larg në thellësi. Asnjëri nuk foli me shokun. Ata kishin kërkuar të bëhej me ngut mbledhja e organizatës, Kujtimi kishte njoftuar komitetin e Partisë për minierën për mbledhjen dhe problemet që do të rriheshin.

Kështu minatorët po grumbulloheshin në kthinën që ngjante me një shesh të rrumbullakët me kubetë në formë kurriz peshku.

Kujtimi, pasi përcolli ndihmësin në sipërfaqe, nuk mori rrugën që të shpinte tek ashensori, por u nis nga balli i gjashtës. Vëzhgoi. Bëri një kthesë djathtas, u zhduk në traverbangun e ri. Hodhi dritën në të gjitha anët, përcaktoi vendet ku do të hapeshin oxhaqet e reja.

Në hyrje të atij traverbangu u zgjat një kaush drite. Pas pak pranë Kujtimit u gjend Dem Qesati.

— Kujtim, — i tha ai, — shokët janë mbledhur, ty po të presin.

Tjetri shikoi me habi. Ngriti dorën, ndriçoi orën e tha:
— Do edhe gjysmë ore, bre Dem.

— Sa lamë punën, vendosëm që ta bëjmë mbledhjen në Sheshin e Sulmit.

— Domethënë brenda do ta bëjmë mbledhjen?, — pyeti Kujtimi.

— Në Sheshin e Sulmit pra, — tha Demi dhe u nis.

Kujtimi i vajti prapa. Supet e gjera të Demit tundeshin. Kaushi i dritës së tij derdhej mbi skutat e errëta. Ndriçonte degëzimet e galerive. Sheshin e rrumbullakët që minatorët e quajtën Sheshi i Sulmit malësorët e parë që patën ardhur në minierë e patën quajtur Logu i Burrave, fusharakët Livadhi i Burimit, ndërsa qytetarët Sheshi i Rrumbullakët.

Midis grupit të minatorëve qëndronte Ramë Dushku. Façet i ishin skuqur edhe më tepër se herët e tjera. Kur pa se edhe Kujtimi, sekretari i organizatës-bazë për turnin erdhi, hapi duart, pastaj i bashkoi, sikur përgatitej të raportonte:

— Jemi të gjithë, e fillojmë pra. Në mendjen e secilit rreh një pyetje: «Kush që ai ose ata që deshën të na përmbysnin minierën?», sepse të gjithë kemi gjurmuar, kemi rrahur medime. Unë them se Lim Thana nuk është fajtor për shpërthimin e ujit në katin e shtatë. Ky është mendimi im; flisni edhe ju, shokë.

— Ka bërë gabim Limi, — tha Sherifi, — po jo faj. Ndryshe mendoja më parë, ndaj votova për dënim të rëndë. Tani mendoj ndryshe.

Pas Sherifit u ngritën të tjerë.

Kujtimi dëgjonte. Përfytyrimet e sillnin përpara vetes një koleksion fotografish, jo të fytyrave, por të karaktereve, të bindjeve, të rritjes. Iu bë sikur shfletonte një album dhe në fund të cilësdo fotografi sikur lexonte diçiturën.

— Gjithmonë kam qenë zemërhapur ndaj kolektivit..., — e kishte marrë fjalën Zizi. Kurse Kujtimi lexonte diçiturat:

«Zizi, biri i një dyqanxhiu të vogël. I frikshëm në fillim, tani tejkalon normën. Gëzohet si fëmijë. Kur vinte fundi i pesëmbëdhjetëditëshit, sa më shumë lekë merrte, aq më tepër i shtohet dashuria për punën».

Prapë kishte marrë fjalën Sherifi. Kujtimi e shikoi.

Papritur midis tij dhe Sherifit sikur u ngrit një mjergull, përmes saj dukej një siluetë. Hapa të gjatë që zbrisnin kreshtave teposhtë. Një trastë e dhirtë, gjysmë buke misri brenda. Davariteshin shtresat e mjegullës. Kreshtat zvo-gëloheshin. U kthjellua. Sherifi duke zbritur në galeri. Sherifi duke vënë shuplakën mbi llapën e veshit. Përgjonte mos fliste kush për të, për fisin e tij. Dikush bënte shaka. Sherifi kërlëshej, bërtiste: «Më ke një gjak borxh! S'un e duroj bre, jam shtëpi pushke unë! Oxhaķu im s'e ka njohur korinë denbabaden!».

Shokët. Shumë shokë e këshillonin, e qortonin, e kritikonin. Sherifi skuqej si spec. Dukej sikur grimconte ato që jetonin në qenien e tij.

Autokritika e parë. Sherifi në frontin më të vështirë. Sherifi përqafohet me shokët mbi vagonin e qymyrit. Sherifi në tabelën e nderit.

Kujtimi provonte ndjenja të çuditshme.
«Ç'gëzime provoka njeriu kur ia arrika qëllimit, — tha ai me vete. — S'besoj të ketë detyrë më të shenjtë sesa të punosh me njerëzit. Bëmë mirë kur i morëm në grupin tonë! Shokët punuan me ta dhe me veten dhe ja, ia arritëm. Me këta shokë sot mund t'i përgjigjemi çdo thirrjeje, çdo ndërmarrjeje të vështirë. Ta zbardhin faqen shokët e mirë!».

— Kështu mendoi Kujtimi, pastaj u përqëndrua në fjalët e shokëve që ngriheshin njëri pas tjetrit dhe diskutonin me zjarr.

U ngrit Agroni:

— Mendoj të zgjedhim një grup, — tha ai duke tundur kokën e madhe, — kontrollin punëtor, ashtu siç na mëson Partia. Të kontrollojmë, të shqyrtojmë biografinë e njerëzve pa emër, të disa njerëzve që janë futur në minierë nga dera e vogël.

— Kontrollin punëtor, — thirrën shumë minatorë.

Kujtimi foli i fundit:

— Jam i një mendimi me ju, shokë, — tha ai, — të ngremë një grup të kontrollit punëtor, por jo vetëm prej komunistëve. Jo vetëm nga turni ynë. Në kontrollin punëtor të zgjidhen minatorët më të mirë, më revolucionarët.

Ishte e hënë. Grupi i kontrollit punëtor i përbërë prej pesë vetësh, midis të cilëve edhe Kujtim Kreshpa, hynë në zyrën e kuadrit për sektorin.

— Shoku Liman, — foli përgjegjësi i grupit, Agron Mala, — minatorët e turnit «Sulmi» kërkojnë të mësojnë biografinë e disa personave.

— Çfarë kërkonit të mësoni për këta?, — pyeti nëpunësi i kuadrit.

— Duam të shikojmë dosjet e tyre.

— Ju e dini se dosjet personale nuk shikohen pa një autorizim special.

— Biseduam me kryetarin e degës së kuadrit, i kemi të gjitha.

— Në rregull, — tha Limani.

Anëtarët e kontrollit punëtor i kaluan dorë më dorë dosjet. Asgjë në dosje përveç kërkesave në formë autobiografie, edhe ato të shkurtra.

...Miho Gjelaci... i pamartuar, kam punuar në ndërmarrje të ndryshme. Meqë posedoj kategorinë e pestë të minatorit, kërkoj të punoj në minierë.

...Zhagan Dhoga, rrjedh nga një familje e mesme fshatare. Njëri prej vëllezërve të gruas sime është oficer. Kam punuar në disa ndërmarrje. Duke menduar se në minierë mund të jap më shumë, lutem të merret parasysht kërkesa ime.

Shfletuan edhe disa dosje të tjera që qenë në të njëjtën gjendje.

— Mund të na ndihmoni me ndonjë të dhënë tjetër?, — pyeti Agroni nëpunësin e kuadrit. — Të paktën të dimë në cilat ndërmarrje kanë punuar këta njerëz pa biografi?

— Posi, — u përgjigj Limani dhe filloi të shfletonte një regjistër të trashë.

— Desha të dija edhe një gjë, — tha Kujtimi, — ku e kanë marrë fletën e punës?

Pasi i foli për shumë të tjerë, arriti te Miho Gjelaci. Këtu shokët e kontrollit e përqëndruan më shumë vëmendjen.

— Miho Gjelasin na e ka rekomanduar një shok i drejtorisë sonë, — u përgjigj nëpunësi.

— Cili?, — pyeti Kujtimi.

— Në fillim Demir Ullishtasi, pasi nuk e pranova, erdhi nëndrejtor Bajaziti. Ai më urdhëroi.

— Ta shikojmë urdhrin, — foli një punëtor, anëtar i grupit të kontrollit.

— Ishte urdhër verbal, — tha nëpunësi.

— Nga cila datë ka filluar Mihoja punën te ne!

Nëpunësi i kuadrit u përgjigj. Agroni këqyri Kujtimin me nënkuptim.

— Zhagan Dhogën kush jua rekomandoi?, — pyeti Kujtimi.

— Zhagani erdhi me të shoqen. Të vëllanë e bashkëshortes së tij e kam shok lufte. E shoqja e Zhaganit më paraqiti arsye të rënda. Veçmas Zhaganit m'u lut t'ia pranonim të shoqin në minierë. Ishte pothuaj naive. Tha se nuk e kishte njohur Zhaganin. Ishte mashtruar nga pamja e jashtme. Kishte mbetur shtatzënë: «*Tani, — tha ajo, — e kuptoj cili është Zhagani, por është vonë, presim fëmijë. Ndërmarrja ku punonte jo vetëm që nuk i jep strehim, po edhe e kanë paralajmëruar për largim. Ai ka ikur nga fshati pa lejë nga kooperativa. Zhagani nuk më është ndarë për gjashtë muaj rresht. Më tha se ishte student në Inxhinierinë e Ndërtimit. Megjithëse kurrë nuk ka qenë student. Ai ia arriti. Unë nuk pyeta as prindërit, as vëllezërit. Tani e ndiej mbi shpatulla gabimin do të përdor të gjitha forcat për ta sjellë në rrugë të drejtë tim shoq. Më kanë thënë se miniera është një kudhër e fuqishme ku kaliten njerëzit. Ju lutem ma bëni këtë të mirë. Kështu më tha e shoqja e Zhaganit. — Selmani vazhdoi: — Unë nuk e pranova pa më prurë lejën nga kooperativa. Shokët e kooperativës, duke e ditur se ç'mall ishte dhe duke menduar se në minierë do të kthehej në njeri të vërtetë, nuk kishin ngurruar t'ia jepnin lejën. Bile në vërtetim kishin shënuar se i jepej leja të punonte vetëm në minierë dhe në asnjë qendër pune tjetër.*

— Po ajo puna e studimeve në inxhinieri?, — pyeti një anëtar i grupit të kontrollit punëtor.

— Çfarë studime! Zhagani e kishte gënjyer vajzën për t'ia arritur qëllimit, — u përgjigj Limani.

— Liman, — i tha Kujtimi, — pranimi i të tillëve pa fletë pune nga komiteti ekzekutiv, është arbitrar.

— Ke të drejtë, po ja, kishim nevojë për fuqi punëtore.

— Të gjitha ndërmarrjet kanë nevojë për punëtorë, por duhet respektuar me rigozitetin kodin e punës, — i tha Agroni.

Anëtarët e grupit të kontrollit punëtor dolën të menduar nga zyra, pasi morën emrat e ndërmarrjeve ku kishin punuar më parë Mihoja dhe Zhagani.

Kujtim Kreshpa kërkoi të dhëna për Miho Gjelaçin për kohën kur ai kishte punuar në kantierin e hidrocentralit «Lenin». Megjithëse kishin kaluar shumë vjet nga ajo kohë munda të mësonte shumë. Iu desh të takohej me minatorët dhe ndërtuesit e atëhershëm. Edhe pse ishin shpërndarë në të katër anët e Republikës, ai gjeti shumë prej tyre.

«... E mbaj mend si sot, — i tha një minator veteran. — Kur specialistët e huaj u orvatën të sabotonin dhe i kapëm, Mihoja u tha dy-tre punëtorëve: *S'kanë turp kur ua veshin specialistëve të huaj fajin për të mbuluar injorancën tonë... Isha njëri ndër ata shokë që kërkuam llogari dhe e dëbuam Mihon nga kantieri, ndaj e mbaj mend mirë».*

*
* *

Ato ditë kur Kujtimi ishte i zënë me aq shumë punë në minierë e me kontrollin punëtor nuk e kishte as Zanën në shtëpi të bisedonte për ato që e mundonin. Ajo ishte nisur me një ekip shëndetësor në malësi. Mu pranë kufirit ishin shfaqur shenjat e një epidemie të fëmijët malësorë. Ajo në krye të ekipit të mjekëve hetonte burimin e infeksionit.

Tre fëmijë të sëmurë u izoluan, u morën masa për shërimin e tyre, megjithatë Zana dhe mjekët e tjerë bridhnin nge fshati në fshat, organizonin vizita të përgjithshme, bë-

nin injeksione për parandalimin e sëmundjes, bisedonin me malësorët.

Një natë, ndërsa po ngroheshin pranë zjarrit bubulak në një shtëpi karakteristike të malësisë, i zoti i shtëpisë, njeri shumë mikpritës, u tregoi:

— Gjyshi im ka qenë luftëtar, po e kishte merak edhe gjuetinë. Një ditë shtiu mbi një dhi të egër, plumbi vete e i bie kecit të vogël që qëndronte pranë së ëmës. Gjyshi i afrohet gjahut i pakënaqur. Ç'të shikonte, keci ishte shëndoshë e mirë, plumbi ia kishte thyer bririn e njomë mu në rrëzë dhe e kishte trullusur. Vërritja e dhisë mëmë dëgjohej tutje në bjeshkë. Gjyshi u mallëngjye dhe e lëshoi kecin të ikte me një bri. Kaluan dy-tri vjet, ai kec u bë cjap dhe i shërbente tufës së dhive të egra si përçor. Gjyshi që përgjonte, buzëqeshte dhe fliste me zë: «Ymërgjatë paske qenë, more përçor. Meqë ta shpëtova jetën, pushka ime s'ka për të shtënë kurrë mbi ty». Dhe e mbajti fjalën. Po cjapi i egër ia ngacmoi mizën. Ne gjithnjë kemi qenë në hasmëri me ata përtej. Kur ndërzeheshin dhinë, cjapi me një bri herë dilte matanë kufirit, herë më këtë anë. Gjyshit i ra në sy kjo gjë dhe u zemërua, e quajti cjamin, anipse i egër, tradhtar! Ia bëri benë. Njëditëzaj, cjapi, tek harbonte pas dhive të egra, deshi të kalonte matanë. Gjyshi e mori në shenjë, krisma e pushkës u shoqërua me këto fjalë: «Nuk ta fala jetën të bëheshe tradhtar, mor delenxhi!, — dhe e vrau.

Mjekët qeshën, qeshi edhe Zana. Pas pak ajo pyeti:

— Tufat e dhive të egra kalojnë sa andej-këtej kufirit?

— Po, — u përgjigj malësori plak.

Zanës iu kujtua një revistë e huaj, në të cilën përpara një muaji njoftohej përhapja e epidemisë te fëmijët matanë kufirit.

— A sëmuren shpesh dhinë e egra?, — pyeti sërish.

— Janë të forta dreqkat, — u përgjigj plaku pa kuptuar se ç'e mundonte doktoreshën. Kurse mjekët e tjerë shikuan njëri-tjetrin. Për ta u qartësua prejardhja e sëmundjes. Të nesërmen, ende pa aguar, pasi porositën banorët e atyre fshatrave të mos hanin dhi të egra pa i kontrolluar

me parë veterineri, ekipi mjekësor u nis sërish për rrugë. Fshatra të tjera i prisnin.

Zana i nisi një telegram Kujtimit:

Nuk kthehemi nesër. Do të qëndrojmë edhe disa ditë të tjera.

Përqafime Zana

K R E U XVIII

Lim Thana doli nga komiteti i Partisë i rajonit. Në veshë ende i tingëllonin fjalët e sekretares:

«— Shoku Lim, — i kishte thënë ajo, — mund të gabojë një person, edhe dy-tre mund të gabojnë, por jo një kolektiv i tërë.

— Zemërimi i minatorëve nuk njeh kufi..., — kishte thënë Limi, — megjithatë pjesa më e madhe janë të bindur se unë nuk kam faj për aksidentin.

— Çdo ekstrem kthehet në të kundërtën e vet, — i kishte thënë sekretarja. Organizata ku bën jetë partie ti të hoqi vërejtje për thyerjen e rregullave të sigurimit. Çështja jote do të shqyrtohet. Ti ke ç'të luftosh në vetvete!

— Pa minierën jeta ime nuk ka asnjë kuptim. Më besoni, shoqja sekretare, më vjen të pëlças kur mendoj se shokët përleshën burrërisht me shkëmbin, dhe tamam kur janë marrë zotime të mëdha unë bares si ndonjë luftëtar i paaftë për të luftuar. U bënë dhjetë ditë, më mbeten akoma edhe tetëmbëdhjetë...

— Shko, — kishte përsëritur sekretarja, — lufto në vetvete ato që t'i kanë vënë në dukje shokët. Çdo gjë do të rregullohet sipas meritës dhe së drejtës.

Limi ecte bulevardit dhe buzëqeshte. Fjala «shok» shqiptuar nga sekretarja me një ndjenjë të ngrohtë e të afërt e mbushte me shpresa se çdo gjë do të rregullohej së mbari.

Tek po ecte rrugës, një dorë u zgjat nga autobusi që i kaloi përbri. Limi nuk e njohu cili ishte. Më poshtë autobusi u ndal në stacion. Midis njerëzve që dolën, zbriti edhe

inxhinier Petriti. Ai e priti Limin, të cilit, sa e pa, diçka iu turbullua përbrenda. U ndal. Deshi të kthehej. «Ke ç'të luftosh në vetvete!», — i tingëlluan fjalët e thëna më parë nga sekretarja e rajonit. Tundi kokën. U çapit me hap të ngathët. Petriti eci drejt tij dhe e zuri për krahu. Edhe ai ishte disi i hutuar, futi dorën në xhep të nxirrte paqetën, po nxori shaminë. U skuq e tha:

— Minatorët më vështronin vëngër, nuk dija ç'kishin me mua, po nuk mund t'i thuash tjetrit përse më shikon ashtu ose kështu. Ajo mëri e heshtur që reflektohej në sytë e tyre më brengoste. Nuk dija ç'kishin, gjer sa më kapën, ma thanë troç... Unë u fola atyre çiltër, edhe ty po të be-tohem në nderin tim se nuk kam ditur asgjë fare mbi lidhjet e tua me Bukurie Demën.

Limit, tek dëgjoji të shqiptuar shpengueshëm emrin e vajzës, iu rindez inati, por e përmbajti veten.

— Ne jemi shokë pune, me moshë të përafërt, — vazhdoi inxhinieri, — nuk duhej ta mbysje brengën përbrenda. Sigurisht ke menduar se po ta punoja me të pabesë. Mëso pra: Bukurien e kam komshie. Shpeshherë e kam përcjellë në shtëpi dhe kemi ardhur bashkë në punë. Asgjë nuk kam pasur me të.

Limi fërgëlloi, po nuk i tha inxhinierit as se i besonte, as se nuk i besonte. U nda me të miqësisht dhe vajti në bibliotekë.

K R E U XIX

Disa ditë pas shpërthimit të ujit në minierë Demir Ullishtasi trokiti në derën e zyrës së sekretarit të Partisë për minierën.

— Shoku Isa, — i tha sekretarit të Partisë, — kam diçka për të biseduar. Është me rëndësi, po dëshiroj të jetë këtu edhe sekretari i organizatës-bazë për turnin «Sulmi», meqë atje kam punuar më parë.

Isai dërgoi një shoqe për të thirrur Kujtimin.

Kur u fut në zyrë, Kujtimi vuri re se Demiri ishte sku-

gur në një mënyrë të çuditshme. Sytë nuk i kishte të turbullt, por të skuqur nga pagjumësia.

— U desh të rrezikohej miniera, — foli Demiri kokulur, — që të vija në këtë zyrë, për të nxjerrë atë që kam varrosur në shpirt ditën që varrosa babanë. Jam treguar miop. Miop dhe i ndyrë. Pështirosem prej vetes. Shyqyr që ndodhi aksidenti, se unë do të vazhdoja të zhytesha më thellë e të brehesha përbrenda, të jetoja si qyqë dhe të vdisja si frikacak i përbuzur... Një njeri mban një deklaratë të tim eti... Për këtë babai më pat treguar pak ditë para se të vdiste. Në fillim nuk tregova, se i isha betuar babait. Më vonë nuk e hapa zemrën, se më dukej sikur do të më tregonin me gisht: «Ja, biri i atij që...». Kur u binda se kisha gabuar duke mbajtur të fshehur një gjë të tillë, më pengoi turpi, ndoshta edhe frika nga ndonjë e papritur, jo për veten, por për fëmijët. Tani që mbajtësi i deklaratës po vepron, nuk mund të hesht. Nuk mund të lejoj që një i poshtër, një armik të dëmtojë atë që shokët dhe unë vetë e kemi vënë me djersë e sakrifica. Nuk flitet më për punë turpi, përlyerje emri, apo pasoja të këqija personale, por për minierën tonë, ku me dorën time solla minën e armikut. Unë, Demir Ullishtasi i pasinqertë. Unë, mendjelehti, sedërkalbur! Miho Gjelaci m'u paraqit si njeri që jetonte dekadat e fundit të pleqërisë. Më tha se dëshironte të punonte në minierë vetëm që të merrte pension miniere. Gjoja si pa të keq ma përmendi babanë.

— Me Soli Kimin jam njohur në rrethana të vështira, — më tha. — Më kishte kapur gestapoja. Më akuzonin për ndihmë partizanëve. Tërë natën më torturuan. Në mëngjes më përplasën në një zyrë. Atje gjendej yt atë. Po firmonte deklaratën, të cilën e shkroi dhe shqiptoi me zë gjatë kohës që gjendesha edhe unë në zyrë. Deklaratë për bashkëpunim me nazistët! Më erdhi t'i hidhesha në grykë. Po mora vesh se i kishin kurdisur një grackë. Babanë tënd e liruan. Mua më mbajtën. Vazhduan torturat. Nuk zgjati, partizanët sulmuan gestapon. Oficerët nazistë ia mbathën. Godina e gestapos mori zjarr. U ngjita lart. Mendova të hakmerresha kundër atyre që më kishin masakruar barbarisht. Asnjëri nuk gjeta ndër zyra. Pashë se si digjeshin shumë bankë-

nota. U sula nëpër tym dhe kapa një tufë. Kur dola andej, përveç napolonave, gjeta edhe deklaratën e Soliut. Kë s'kam pyetur për të. Desha të dija fatin e mëtejshëm të plakut. Disa më thanë se Soli Kimi është arratisur. Fare rastësisht mësova se jeni biri i tij. Mua nuk më ka ecur në jetë. Në pleqëri më duhet ndonjë njeri që të kujdeset për mua. Ndonjë shok... Mund të më rregullosh në ndonjë punë në zyrat e minierës...

Prej asaj dite për mua filluan brengat, shqetësimet e mëdha. Nuk ma merrte mendja se Miho Gjelaci erdhi me qëllime të këqija në minierë. Shqetësohesha vetëm se njolla e turpshme doli prej varri. Ajo njollë më ndiqte si hije. Unë duhej të zhdukja personin që mbante vulën e njollës së babait tim të gënjyer. U përfshiva nga ankthi i krimit të mundshëm, të cilin mund ta kryeja në çdo minutë. Kërkesat e mëpastajme të Mihos më bindën se nuk kisha të bëja me një matrapaz deklaratash, po me një armik. Disa herë vendosa ta vras. Prapë ankthi i krimit të mundshëm më shpuri te gota e rakisë. Si i dehur as mund të udhëhiqja grupin. Shtrihesha në krevat, më dukej sikur mijëra kaca-bunj më thumbonin. «Vërtet ka hallin e parave që kërkon të mbledhë të rinjtë rreth vetes, — i bëja pyetje vetes, — apo ky është pretekst? Rinia ka nevojë për zbatimje, për edukim nëpërmjet programeve artistike. Nëse nuk e bëjmë ne këtë, do të mundohet «t'i zbavisë» ai. Mendime shumë të këqija më kaplonin, sidomos natën. Kur vendosa përfundimisht që ta zhdukja, ai më kërkoi disa pako dinamit: Do të shkoj të gjuaj peshk, — më tha, — pleqtë përveç barrës së rëndë të pleqërisë, paskan edhe teka... Duhet të përgjoj, — thashë me vete, — t'ia jap pakot dhe të përgjoj». I dhashë tri pako dinamit. Të dielën e përgjova. Mihoja nuk shkoi për peshk. Kaloi rrëzë kodrës, sipër centralit elektrik. Unë prapa. Iu afrua pusit numër një, atij të braktisurit, dhe u lëshua brenda. Pas një kohe të gjatë doli pa dinamit.

Mendoja se mua më përkiste ta kapja. Por, siç shikoni, ai po shpejton e po shpeshon veprimet. Shpërthimi i rezervuarit është komploti i tij i ndyrë. Këtë e ka kryer përmes Zhagan Dhogës. Harrova t'ju them se i kam dhënë edhe

një herë tjetër dinamit. Tri net përpara se të bëhej ajo që u bë në katin e shtatë, të shtunën pasdite. Mihoja më kërkoi pesë pako dinamit.

— Përse të duhen?, — e pyeta.

— Një mikut tim, — tha, — magazinier eksplozivi, i mungojnë. Kushedi si është ngatërruar kur ka bërë daljet, ka bërë një regjistrim vetjak, i dalin pesë pako mangut. Do të m'i kthejë. Ia dhashë. Ai nuk i shpuri te «miku», por i fshehu në një zgurë në zabelin mbi rezervuarin e fermës. Të shtunë mbrëma vonë, Zhagani erdhi në zabel (atje ruaja unë i fshehur). I mori dhe tinës u lëshua në dishentërinë numër dy. I shkova prapa, po m'u zhduk në galerinë qorre të katit të shtatë. Prita shumë atje. Zhagani u kthye pa dinamit. Që të shtunë mbrëma gjer ditën e martë Miho Gjelaci u shti i sëmurë. Bile ka mbajtur edhe njerëz mbi kokë që ia lagnin ballin me kompresa të ftohta, sigurisht për të provuar alibinë.

— Të jam afruar disa herë, të kam pyetur, — i tha Kujtimi, — përse nuk ma hape zemrën qysh në fillim. Po ta bëje këtë, nuk do të krijohej kjo situatë e rëndë as për ty, as për minierën. Ta zëmë se nuk pate besim tek unë, përse nuk erdhe te shoku Isa, ose atje ku duhet të shkoje?

Demirit iu drodh buza e sipërme. Pas një hezitimi nervoz tha:

— Duhet ta dini se qysh prej kohësh kam pasur miqësi me shokun Bajazit. Vajta tek ai, sa desha t'ia thosha, ai më ndërpreu. Nuk më lejoi të nxirrja asnjë fjalë. Më frikësoi pa masë. *Ik*, — më tha Bajaziti, — *këtë punë do ta rregulloj unë. Ti askujt asnjë fjalë. Të kam mik e më dhimbsesh...*

Kujtimi dhe Isai u shikuan në sy... Ky i fundit tundi këren e mendoj:

«Po Kujtim. Ti edhe shokët kishit të drejtë kur thoshit se pas shfaqjeve liberale, intelektualiste dhe teknokrate te Bajaziti fshihet dicka më e tmerrshme.

Edhe ata shokët e hetuesisë që kanë ardhur disa herë këtu...

Nuk do të lejojmë kurrë të rriten barëra të tilla helmuese në vendin tonë...».

Demir Ullishtasi doli nga zyra.

— Duhet biseduar urgjent me Zhagan Dhogën, — tha Isai.

— Shoku Isa, — iu përgjigj Kujtimi, — fishekët e bindjes janë harxhuar. Zhagani...

— Them të bisedohet edhe një herë.

— Shoku Isa, Zhagan Dhogës puçrrat e qelbëzuara që kishte mbi kokë i janë futur brenda dhe ia kanë qelbëzuar trurin. O kanë punuar shokët me të, o me asnjeri. Ai është për karantinë...

— Ti njëson Zhaganin me Mihon.

— Krimi është kryer, Zhagani duhet të përgjigjet sipas kodit penal.

— Ajo dihet. Po të bisedojmë edhe një herë, lypset të diferencojmë viktimën prej shtytësit.

— Shoku Isa, kanë biseduar minatorët, kam biseduar unë. Qortimeve u kundërve shfajësime naive. Këshillave u zgërdhiet me mospërfillje. Sapo kthen kurrizin, lllomotit: *O po, ç'na mërzhitën këta me politikë, me ideologji! S'jam i politikës, or vëlla! Më teket të mbaj flokët të gjatë, ç'u duhet të tjerëve?! As para për krehër nuk u kërkoj, as paratë e tyre për parfume nuk ua harxhoj. Më teket të eci rrugëve makar lakuriq, ç'u duhet të tjerëve! Këto janë punët e mia, thjesht personale! I ndal dhe u propozoj dhjetëra femrave në ditë. Ashtu dëshiroj, ashtu veproj! Ç'u duhet këtyre?! Mua më teket të shkoj të mbytem në lumë, të tjerëve nuk u hyn, as u del gjë prej xhepit! Ç'kuptim ka të të thonë se u përgjigjka kolektivi për personin! Nuk më pëlqejnë këshillat tuaja, më lini rehat! Ky është Zhagani. Këshillat tona nuk i pëlqejnë, kurse të Mihos po.*

— Duhet biseduar edhe një herë!

— Pas gjithë kësaj pune që kemi bërë, mendoni të bisedojmë edhe një herë me Zhaganin?

— Jo haptas, por me takt. Të shtyhet t'i thotë vetë ato që ka bërë, ta ndiejë fajin e madh. Po u arrit kjo, ai do ta gjykojë vetveten rëndë. Do t'i rikthehet shoqërisë ndryshe, jo si Zhagani i tanishëm. Por kujdes, me kujdes të madh, ndryshe, dëmtoni çështjen, u nxirrni vështirësi organeve të diktaturës. Me shumë takt!

— Në rregull.

Natë. Burri ecte përpara, gruaja prapa. Ravgonin¹⁾ mbi kurrizin e një kanali. Traktori që ishte kthyer në brazdën e dytë ndriçoi arën deri në anët e kanalit. Ata u strukën prapa një shtylle betoni. Pritën sa ra errësira prapa traktorit, pastaj shpejtuan hapin.

— Të ngjitemi te kjo ndërtesa e re, — i tha Zhagani asaj, — nuk besoj të ketë njeri. Kati i tretë është akoma i papërfunduar.

— Jo, kam frikë.

— Atëherë futemi në rrënojat e asaj shtëpisë së shkatërruar.

— Mos ka njeri?

— Është nga ato rrangallat që i shkatërrojnë.

— Kam frikë.

Zhagani e kapi për dore. Përbiruan përmes ca trarëve me të ngrëna mize dhe tërë blozë, u futën në një qoshe, e vetmja skutë që kishte mbetur nga shtëpia e vjetër me qerpiç. Gruaja u lëshua në prehrin e burrit, psherëtiu e foli:

— Ah, Zhagan, sa i afërt je, sa të dua!

— Ekaterina, shpejt, s'kemi kohë për muhabetë!

— Oi, oi, ky!... Ku e ke psonisur këtë parfum? Sa të deh, oi, oi! Oh, gangsteri im i dashur! Gjithmonë kam ëndërruar për një njeri që e njuh, që e adhuron modën, që ecën me kohën! Ç'i do ata qypat që qethen si ushtarakët! Tamam si katundarët! Eh! Ç'kam hequr, i dashur! Ne i ngjajmë njëri-tjetrit, qejfin ushqim, zemrën hambar e kemi. Më thuaj të vërtetën, të zbavit ajo gruaja jote si unë? Oh, ç'pyes! Sa më zbaviste mua ai urithi i nëndheut!

— Sa të bezdisshëm më duken njerëzit që flasin për politikë!, — tha Zhagani.

— Unë të kam psikologjisur qysh me pamjen e parë. Ti je si unë, unë jam si ti. Ne kemi lindur për njëri-tjetrin, thuaj, më do?

1) ecnin në një udhë të rrahur shpesh, të njohur mirë.

— Edhe pse thonë se e kam zemrën autobus dyzetepe-sëvendësh, — tha Zhagani, — ti je një krijesë e veçantë. Ti je ngjalë. Për ty kam rezervuar një vend pranë shoferit, pranë meje.

— Si do të vejë halli ynë?! — Ekaterina papritmas filloi të qante.

— Pse qan, ti je më e bukura.

— E bukura e pafat jam unë. Jam fatkeqe. Atë Demirin e pagdhendur e mora, se dëshiroja të jetoja në Tiranë. E parandieja se këtu do të gjeja një njeri të përshtatshëm. Dhe, kur e gjeta, më përjashtuan nga arsimi. Dhe me çfarë motivacioni: «E papërshtatshme për të edukuar brezin e ri...». Mësues e nxënës. Njerëz të trashë, të patraditë në kulturë, hodhën blozë mbi emrin tim. *Të shkojë për t'u riedukuar*, — thanë në mbledhjen e zgjeruar, — *klasa punëtore duhet ta marrë në dorë riedukimin e saj!* Më ndodhi si dhisë shytë që vajti për të marrë brirët e la edhe veshët...

— Mos u shqetëso, do të zgjidhet edhe puna jote. E bëre letrën që të thashë?

— E shkrova, po s'del gjë prej saj.

— Shkrove se je viktimë e njerëzve që marrin nëpër këmbë të drejtat e femrave?

— Ah, mor Zhagan. Prapë do të pyetet kolektivi. Na mori më qafë kjo vija e masave. Ku dija unë se më paskëshin gjurmuar çdo hap. Çfarë nuk u tha në mbledhje. Jo vetëm kaq, po ata u futën thellë, më gjykuan si klasë që nuk i shërbej së sotmes. Nga letra nuk pres gjë, — tha Ekaterina dhe iu kujtuan urdhrat e prerë që i kishte ngarkuar Mihoja.

Miho Gjelaci, i pajisur me një instinkt dhe nuhatje të përsosur prej armiku, e vinte re se punët nuk shkonin mirë. Tamam atë kohë kishte kërkuar nga Ortaku të arratisë jashtë shtetit, mirëpo qendra agjenturale që i shfrytëzonte spiunët e vet siç shfrytëzojnë njerëzit limonin, që, pasi e shtrydhin, e hedhin në plehra, i dhanë urdhër Mihos të bënte diçka që të krijonte bujë, të dëmtonte ekonominë ose vetë pushtetin popullor «...Ndryshe, — i shkruante Ortaku, — nuk të besojnë. Nuk u jap të drejtë, por ata bazohen në një

logjikë të «fortë», thonë: «Është njeriu ynë, por ka qëndruar gati tri dekada midis atyre atje. Mos po na e rikthejnë minën që të pëlçasë në duart tona...». Prandaj vepro me ngut. Organizoj arratisje në masë. Për çdo person të arratisur do të të rritet vlera dhe do të kenë konsiderata të larta eprorët!...»

Mihoja, që e kishte ndjekur Ekaterinën hap pas hapi, kur ajo u gjend midis katër rrugësh, e kapi dhe në fillim i foli me nëntekst. Si e parapregatiti terrenin dhe vuri re se Ekaterina ishte e gatshme të kryente çdo porosi, e ngarkoi atë ta bindte Zhaganin për t'u arratisur. Mihoja e njihte mirë Zhaganin, ai mund të bënte çdo poshtërsi, por ishte frikacak e pa karakter.

Kështu Ekaterina, e instruktuar deri në hollësitë më të vogla, vajti në takim me Zhaganin. Ndërsa Zhagani e përkëdhelte, ajo vazhdonte bisedën e lënë përgjysmë:

— Ah, Zhagan, ç'më gjeti! Më mirë të kisha qëndruar atje ku isha...

— Kështu thotë edhe ai për vete..., — ia ktheu Zhagani pa përmendur emrin e Mihos, meqë kishte marrë urdhrë të prerë të vepronte ashtu.

— Cili është ai shoku yt?, — pyeti Ekaterina me djallëzi, duke u shtënë sikur nuk e njihte Mihon.

— Një shok për kokën e shokut, që di shumë, që e njeh botën dhe qejfet më mirë se askush tjetër, — u përgjigj Zhagani.

— Edhe ai ka qenë në qytetet provinciale?, — pyeti Ekaterina.

— Jashtë, moj! Ka kullotur jashtë ai.

— Çfarë mrekullie! Sa i kulturuar duhet të jetë! Meqë nuk do të ma thuash cili është, më thuaj të paktën ku punon, — tha Ekaterina.

— Në minierë, i ziu!

— Dhe thua se ka qenë jashtë shtetit, ë?

— Ka edhe pasuri andej, — tha Zhagani.

— Edhe unë e kam xhaxhanë andej. Të peshon me flori, por ç'e do kur ne jemi këndeje..., — tha Ekaterina.

— Se si ma ndez gjakun, — tha Zhagani, — qysh atë ditë

që më the se andej mund të jetonim si pëllumba të dashruar, më gufon gjaku.

— Vetëm kaq?! Ti më the se do të vije edhe në fund të detit, mjafton të ishe me mua!

— Nuk mundem, e dashur. Ndryshe mendoja, por tani nuk më bën zemra. Sikur kjo tokë e mallëkuar më ka lidhur me fije të padukshme, — tha ai dhe u rrëqeth kur e përfytyroi veten të kapur nga forcat e kufirit.

— Po më lë pa mend! E ç'i pëlqen këtij vendi?! Eja me ne, do të gjejmë xhaxhanë tim, edhe dy djemtë e tjerë të dajës i kam jashtë. Do t'i gjejmë edhe ata. Do të na rregullojnë, do të na ndihmojnë. Do të shëtisim me gondola, me limuzina. Do të harrojmë kundërmimin e djersës.

— Unë kam fëmijë. Të isha si më parë..., — mundohej të justifikohesha.

— Shëndoshë koka, kapele gjen kur të duash dhe ku të duash.

— Se si m'i shtie xixat ti!... Do të më mallëkojnë prindërit!

— Ti vetë më ke thënë se ata të kanë hequr prej defterit!

— Më kanë hequr, po nuk mund të them se nuk jam i biri i Lushi Dhogës. Mua më quajnë Mamur Dhoga, ata të minierës ma kanë kthyer në Zhagan. Pra jam Mamur Dhoga, i biri i Lushit.

— Lushi thotë se për të Mamuri ka vdekur. Eja me ne. Ah, sa të dua! Zaten ti qe që ma mbushe mendjen, eja! — Ekaterina e mbuloi me të puthura. Pastaj rrëshqiti në kashlën e mykur...

K R E U XXI

Vetëm dhjetë ditë ndanin dy vjet.

Të gjithë minatorët e minierës «1 Maji» punonin për llogari të tremujorit të dytë të vitit të ardhshëm. Brigada e parë dhe e katërt e turnit «Sulmi» punonin në hapjen e një traverbangu të ri në nivelin e dytë. Kurse brigada e dytë

dhe e tretë hapnin dy oxhaqe të reja. Tubat e ajrit ishin trefishuar. Secili minator punonte në oxhak vetëm një orë. Zbriste njëri, ngjitej tjetri. Me gjithë lutjet dhe këmbënguljen e Kujtimit të punonte të paktën dy orë, si specialist oxhaqesh që ishte, nuk e lejonin. Nuk njiheshin cili ishte minatori, cili drejtori, cili kryeinxhinieri, cili inxhinieri apo tekniku. Të gjithë ishin veshur njësoj, punonin me zell. Metoda zinxhir u jepte dorë. Brenda tetë orëve ngjiteshin në oxhak tetë minatorë. Bëheshin shpërthimet. Tubat e fuqishëm dhe të trefishuar të ajrit e dëbonin tymin brenda tri minutave. Punonin ditë e natë. Minatorit të parë i binte të pushonte shtatë orë. Askush nuk shkonte në shtëpi. Zyrat e inxhinierëve dhe të teknikëve ishin kthyer në bujtina. Mensa punonte natë e ditë pa pushim.

Ramë Dushku grindej me Qenan Qesatin:

— Pistoletë të thonë, — thërriste Rama, — pisqollë na dole. Unë e kam radhën të ngjitem në oxhak.

— Të betohem, e kam radhën unë, — ngulte këmbë Qenani.

— Ptuh, harraqi i dreqit!

— Shan kot!

— Unë merrja turnin prej drejtorit, ti prej meje, — tha Rama dhe u ngjit në oxhak. — Zbrit, drejtor.

— Prit, kam dhe një kuadraturë.

— E vendos vetë, ora jote kaloi.

— Numëro minutat që të ha, se t'i kthej radhën tjetër, — tha drejtori duke puthitur kasat gojë për gojë. Por Rama ia kapi kasën. Drejtori zbriti. Poshtë priste Dilja me shishen e qumështit.

— Pijeni!, — dhe ia zgjati shishen.

— I kam buzët tërë qymyr, prit të lahem.

— Mos thyej rregullat, drejtor! Pije qumështin, nëse do të kthehesh pas shtatë orëve në oxhak!

Në fytyrën e drejtorit të nxirë nga qymyri zbardhnin dhëmbët e bardhë. Ngriti shishen e qumështit në ajër dhe hapi gojën. Qumështi i freskët, tërë kajmak, sikur i shpërndahej damarëve, ia zbuste, e ëmbëlsonte.

— E bardha kundër së zezës, drejtor, — tha Dilja.

— Ku është Kujtimi?, — pyeti drejtori.

— Ka thyer disiplinën, — tha Dilja.

— Përse?

— Nuk ra të flinte në orën e caktuar. Bisedonte dhe me ata të kontrollit punëtor.

— S'ka fjetur fare?, — pyeti drejtori.

— Me një orë vonesë. Ai dhe ata të grupit të kontrollit nuk ta falin as dekikun, kurse për vete... Sa të përfundojmë këto dy oxhaqe, unë do të jem ajo që do t'ua fus të dyja këmbët në një këpucë!

Drejtori buzëqeshi mendueshëm. Pastaj kaloi në oxhakun e tetë. Disa mbushnin vagonat me qymyr, të tjerët transportonin kasat dorë më dorë.

— S'ju punon arganella?, — pyeti drejtori.

— Na vonon, — u përgjigj Demi, — shpikëm një metodë të re.

— Përse nuk na e thatë edhe neve?

— Duhet shumë njerëz. Neve na erdhën në ndihmë shokët e mirëmbajtjes. Zbritën edhe shoqet seleksionuese, po nuk i lejuan, meqë është e ndaluar të punojnë femrat nën dhe. Vetëm Dilja bën përjashtim. Kush i del përpara Diles!

Drejtori u kthye sërish tek oxhaku shtatë. Atje gjeti Isanë me disa nëpunës dhe shumë punëtorë të sipërfaqes.

— Shoku Isa, ty s'guxoka të të qortojë Dilja, kurse mua...

— Drejtor, respekto orarin e pushimit, ndryshe... në një bankë me Kujtim Kreshpën! Disiplina, disiplinë! Sa për shokun Isa, ai punon në galeritë e Jugut, për të nuk përgjigjem unë.

— Dile, vetëm dy fjalë me shokun Isa dhe ika, — tha drejtori duke iu drejtuar sekretarit të Partisë. — Isha te teta. Punonin me metodën zinxhir. Vura re se ajo punë ka rendiment. Ç'bëhet në Jug?

— Dem Qesati e ka huajtur metodën zinxhir nga ata të turnit «Vrulli» dhe turnit «Hovi». Në Jug janë Vangjushi, Ylli, Shpëtimi. Të gjithë kanë zbritur. Pesë orë punë, treqind e pesëdhjetë vagona qymyr, — tha shoku Isa.

— Drejtor!, — thirri Dilja.

Drejtori tundi kokën dhe u nis drejt galerisë kryesore.

Rrugës për tek ashensori takoi Agronin me dy shokë të rinisë.

— Drejtor, jeni vonuar, tani duhej të ishit në dhomën e gjumit. Rregullat që i vendosni si drejtori dhe i aprovon kolektivi duhet t'i respektoni.

— Ika, djema, vetëm disa minuta e kam shkelur, — tha drejtori dhe shpejtoi hapin drejt ashensorit. Në të gjitha galeritë llampat ndrisnin si meteorë. «Në thellësi të nëntokës, — tha me vete drejtori, — vlon puna. Çfarë petritësh!». Pastaj eci pothuaj me vrap.

Kur u ngjit dhe hyri në zyrën bujtinë, dëgjoji pëshpëritjen e tre vetëve nën batanije. Njëri syresh ngriti cepin e batanijes, shikoi drejtorin e qeshi:

— Kujtuam se ishte Dilja ose ata shokët e patrullimit, — tha një minator.

Kujtimi uli batanijen gjer mbi brez:

— Të gjen belaja me ta, — tha ai, — për pak më përçollën në shtëpi.

— Edhe mua më polli me ta, — tha drejtori, — kanë të drejtë, energjitë duhen ripërtërirë, — pastaj u fut nën batanijen ku gjendej Kujtimi me dy minatorë të tjerë.

Pas pak porta u hap lehtë, hyri Agroni, iu afrua drejtorit dhe Kujtimit në majë të gishtave.

— Erdhën...

— Ku janë?, — pyeti Kujtimi.

— U futën te Njëshi, në pusin e braktisur.

— Sa vetë?, — pyeti drejtori.

— Ata të dy.

— Shpejt!, — tha Kujtimi.

— Mos u shqetësoni, — tha Agroni, — grupi i patrullimit u është vënë prapa, edhe shokët e Sigurimit janë me grupet e patrullimit.

*

*

*

Miho Gjelaci tashmë ishte lidhur me grupin. Të gjitha urdhrat dhe këshillat ua kishte transmetuar të tjerëve nëpërmjet hallës së vet, Diamantës. Kishin vendosur të kryenin

sabotime dhe komplete në masë. Pikërisht për atë qëllim ai e kishte lënë pa shfrytëzuar lejën e zakonshme deri në dhjetor. Kishte marrë fletë kampi dhe kishte vajtur në Durrës.

Një mbrëmje vonë priti shumë te plepat. Më në fund një grua zbriti nga autobusi. Ishte halla e tij, Diamanta.

— Hë, grupi i Llaqit me sukses?, — pyeti Mihoja me një frymë.

— Miho, vdiqa nga frika! As Llaqi, as të tjerët nuk u kthyen. Janë zhdukur sikur t'i kishte përpirë dheu! Të gjithë naftësjellësit gjenden në rregull. As u dëgjua ndonjë shpërthim, as flitet për gjë... Nuk e di hallin e tyre. Sa s'më ra pika kur mendova mos i kishin kapur. Vajta pas mesnate te gruaja e atij shokut të Llaqit. Ajo më tregoi se i shoqi i kishte çuar fjalë se bashkë me Llaqin kanë shkuar ndër miq në fshatin Thekërishte. Unë u qetësova disi, por prapë më ha merakun mos janë arratisur pa bërë gjë.

Mihoja ia mbylli gojën hallës me dorë, sigurisht nuk desh të pranonte një dështim të tillë:

— Ma prishe gjakun, moj e uruar, fjala «në fshatin Thekërishte» do të thotë se presin çastin e volitshëm. I kanë punët më se në rregull, janë burra të fortë ata të Llaqi Fikut!, — tha Mihoja i qetësuar.

— Zhduku, nipçe, mos prit! I bëj të fala tim kunati! Na duhen para, shumë para, Miho, këtë mos e harro!

— Prit, moj e uruar, të presim Llaqin...

— Shiko punën tënde!, — ia pat Diamanta. — Llaqi, po bëri gjë, e di rrugën për në kufi! Deti nuk u trazoka me shkop, Miho, ndaj nisu! Ekaterina vjen me ty, do të shpëtojë, po kushedi ç'do të na punojnë neve për shkakun e saj.

— Ti e ke përgatitur opinionin, se e ke mohuar si vajzë. Këtë do ta dëshmojnë dhjetëra njerëz, s'kanë ç'të bëjnë, — i dha zemër Mihoja.

Mihoja mbrëmjen tjetër u kthye në Tiranë. Tërë rrugës mendja i mbeti te grupi i Llaqit. «Kushedi a do t'u shkojë mbarë kryerja e misionit, — mendonte. — Unë duhet të bëj diçka! Fundja të shpejtoj në kohë dhe t'ia mbath! Po prita sa të veprojë Llaqi me të vetët, do të bëhet alarm, asisoji, jo vetëm nuk mund të bëj ndonjë gjë për të qenë, por edhe do ta kem të vështirë të arratisem!».

Drejtori dhe minatorët u ngritën. Ecën rrëzë kodrës për te pusi i braktisur. Atje takuan një shok të Sigurimit.

— Janë marrë të gjitha masat, — u tha ai, — ajo i pret te Lisi i Thatë.

— Ekaterina?, — pyeti Kujtimi si me vete, pastaj shtoi: — Po, po fundërrinat i bashkon era kërmë! Ajo le të presë... po ata të dy kanë gjë me vete?

— Jo, — u përgjigj Agroni, — mbajnë shpresa tek ato që i kanë fshehur në galeritë e braktisura.

— Ku arriti edhe ai Zhagan tyryfyli!, — tha një zjarrmëtar.

— Degjenerimin moral e ndan vetëm një fije floku nga degjenerimi politik, — tha Kujtimi. — I kemi dalë borxhit. Zhagani kërkon të bëjë qejf. Le të bëjë!

— Mos po na bëjnë ndonjë të pabërë, — tha një minator, — gjithë qyteti i minatorëve gjendet poshtë.

Kujtimi i rrahu shpatullat duke i thënë:

— Mos u shqetëso, shok!

K R E U XXII

Kur po ngjiteshin shpatit për te Lisi i Thatë, Mihoja i tha Zhaganit:

— Ec kënde!

— Përse? Nuk po shkojmë te Lisi i Thatë? Kjo rrugica kënde!

— Ec andej nga të thonë!

— Ekaterina na pret te Lisi i Thatë.

— Le të presë, një orë më parë ose një orë më vonë nuk prish punë! Nuk shkojmë në takime dashnorësh!

Zhagan Dhoga u ndal. Në ije e preku një gjë e ftohtë, e akullt, që e rrëqethi. Pështyma iu tha. Diçka e vakët, madje përvëluese iu ngjit në dy anët e zverkut. Mendime të

këqija i kaluan në kokë: «Ky paska edhe revole! Ku më shpie? Nuk e di ky matuf se, po bëri ndonjë vrasje, sikur të kemi edhe krahë, nuk mund të arratisemi?! Kufiri do katër ditë e katër net udhë prej këtej, vetë ma ka thënë!».

— Ç'bluan! Ec... ndryshe!, — tha Mihoja dhe e shtyu me tytën e revolverit.

«Ky zë ndryshoka nga herët e tjera!».

Ishte zëri i vërtetë i Miho Gjelacit.

— Nuk luaj këmbën pa më treguar se ku më shpie!, — tha Zhagani me zë të dridhur. Atij i ishin shpupuritur flokët e gjatë dhe i lëshoheshin gjer në gjoks. Favoritet katër gisht nën veshë i ishin kërleshur.

— Ec dhe mos bëj llafe! Ndryshe do të të vras si qenin! Edhe të vdekur do të të gjykojnë.

— Ç'të kam bërë?!

— Mua asgjë, por atyre që punojnë nën dhe...

— Askujt, asgjë nuk i kam bërë...

— Ec, mor kungull! Nuk ishe ti që hodhe bllokun e argjilit ndërsa Kujtim Kreshpa punonte në oxhak? Nuk ishe ti që shkatërroje për dhjetë minuta çfarë bënte Kujtim Kreshpa për tetë orë në oxhakun gjashtë? Nuk ishe ti që disa herë tentove të vrisje Kujtimin dhe të tjerët? Nuk je ti Zhagan Dhoga që bëre minat në katin e shtatë dhe gjithë uji rrodhi në galeritë? Ata këto nuk i dinë! Nëse ti nuk do të zbatosh urdhrat e mi, do të të vras; do të them se të diktova, të gjurmova, të ndoqa prapa kur po vije në minierë desha të të kapja, nuk u dorëzove, të vrava!...

Zhagan Dhogës filluan t'i dridheshin gjunjët, ndiente fundin e vet. Eci i trullosur e foli nëpër dhëmbë:

— Për të gjithë ç'kam bërë ti më ke ndërsyer...

— Mos fol marrëzira, — ia pat tjetri, — procesverbalet që i ke bërë, i ke firmuar vetë! Atje nuk figuron emri im.

— Ç'gomar paskam qenë! Ti qenke ujk! Nuk je ti që më shtyve të bëja ato procesverbale, duke thënë se, kur të kalonim kufirin, do të na shërbenin si dokumente që vërtetonin se kemi bërë diçka?!

— Lëri ato, mor djalë i mbarë! — Këtë herë i foli me zërin e mefshtë, ashtu siç i fliste më përpara. — Lëri më the e të thashë, procesverbalet e shkruara dhe të firmuara prej

teje gjenden në duart e mia! Ti mos e çmo veten më tepër se unë! Më duhet një ndihmës. Këtë herë të gjitha do t'i bëj unë, ti do të më ndihmosh. Shpejto hapin!

Zhagani ecte dhe i qante hallin vetes me mend:

«Ky njeri mizor kushedi ç'ka ndër mend të bëjë! Edhe sikur të shpëtoj prej këtej, edhe sikur të arrijmë të kalojmë kufirin, kush më garanton se s'ka për të më përdorur gjithandej kështu?! Kush më siguron se edhe njerëzit përtej kufirit nuk janë si ky?! Ky të djeg për hiçgjë! Çfarë mizori qenka ky Miho Gjelaci! Ia vura vetes kapistrën në turi, ky më tërheq! Ku të më çojë, jam i detyruar t'i vete pas! Po sikur të na kapin?».

Zhagan Dhoga as në ëndërr, as në bredhjet e fantazisë nuk kishte parashikuar ndonjë rrezik të mundshëm. Madje as për ndonjë heroizëm, siç mund të ëndërrojë çdo moshatar i tij, nuk i kishte shkuar mendja. Ai gjithnjë i kishte quajtur budallenj njerëzit që kishin rënë për një çështje të madhe. Tani ecte drejt një të panjohure të rrezikshme. I dridhej çdo gjymtyrë e trupit. Një si ngërç ia kishte mbërthyer gjoksin. Diçka e ftohtë e shoqëruar me mornica, në fillim e ngjashme me mpirjen, iu ngjit këmbëve, ia pushtoi barkun, stomakun, krahët, iu ngjit në kokë. Iu duk sikur brenda kafkës i ishte futur një copë e madhe akulli. Ecte kuturu. Kur hynë në shkurret, Mihoja i foli:

— Qëndro me fytyrë nga kodra!

— Ki besim tek unë, — i foli Zhagani me një fije zëri, — u pa puna. Çfarë të bësh ti, do të bëj dhe unë, mos më vra!

— E dija që nuk ishte aq budalla! Po njeriu budallallepset nganjëherë!, — tha dhe iu afrua pusit të braktisur. Futi çelësin në vrimën e drynit të madh e të ndryshkur dhe ngriti kapakun e metaltë. Pusi u hap si ndonjë gojë e errët dhe e thellë. Veshja anësore prej dërrasash ishte shkatërruar. Kishin mbetur vetëm shkallët e hekurta, të cilat rrotulloheshin murit të çimentuar të pusit.

Qetësinë e thellë të asaj errësire të pafund e bënë edhe më ngjethëse currilat e ujit që ktheheshin në një jehonë mbytëse. Miho Gjelaci ndezi baterinë e dorës. Këmbëzat e pantallonave të ngushta, të cilat i kishte qepur ato di-

të, e pengonin Zhaganin në zbritje. Mihoja kishte mbërthyer me dhëmbë elektrikun e dorës e me njëren dorë mbahej në shkallë, në tjetrën shtrëngonte revolverin. Zhagani zbriste para tij. Kur kalonte te kthesa e çdo shkalle, shikonte fytyrën e Mihos dhe habitej. I bëhej sikur për herë të parë e shihte atë njeri. Errësira e thellë, drita e vockël që pëрпиhej nga terri, ia bënë hijen e atij njeriu tamam si vampir. Mihoja, që gjithmonë i kishte folur me sy të fjetur, tani shtrëngonte me ngërç revolen, sytë thuaje se i kishin dalë kokërdhokë! Damarët i kishin kërcyer. Fytyra i ishte sertllisur. Flegrat e hundës i uleshin dhe ngriheshin pa pushim.

Zbritja zgjati më se njëzet minuta. Të dy ishin qullur.
— Djathtas!, — i tha Mihoja. — Atje kam fshehur dinamitin. Do të shkatërrojmë motopompat! Do të hedhim në erë oxhaqet e rrugëdaljes! Edhe me ashensorin do të bëjmë diçka...

Sytë e Zhaganit, mbi të cilët ishte drejtuar bateria e dorës, në fillim u zmadhuan si syri magjik i radios, pastaj u zvogëluan. Flokët që ngjanin me pupla të lagura të ndonjë gale iu kërlëshën. Fytyra iu mbërthye nga një mpirje frike e tmerri.

— Po na kapën, do të na copëtojnë!

— Ata s'kanë për të marrë vesh se si ndodhi, pasi për pak minuta kjo minierë ë mallëkuar që ata aq fort e duan ka për t'i varrosur të gjallë! Janë të llogaritura të gjitha. Një orë të mos punojnë motopompat, miniera përmbytet. Uji ka për t'u ngjitur shatërvan edhe mbi kullën e ashensorit! Neve s'kanë pse të na dhimbsen! Nuk lëmë pas asnjë që ia vlen lotin! Le të hakmerremi për gjithçka! Hakmerru edhe ti kundër atij Kujtimit që të zhburrëroi, kundër Demit, Ramës, Agronit! Është koha më e volitshme për hakmarrje! Këtu askush nuk vjen, janë të braktisura këto galeri, s'ka qymyr, s'ka minatorë, sepse e kanë gërryer derat këtë anë! Ata janë andej, tutje! Zhgarraviten si buaj të zinj nëpër galeri. Janë brenda, të shkujdesur! Le ta tejkalojnë planin përjetësisht! Na ndihmo, o zot, që të hakmerremi për të gjitha! Për të gjitha!

— Do të na kapin si miun në kurth!, — tha Zhagani.

— Kot të paskam folur! Mos u frikëso! Të gjithë urithët e zinj janë përfshirë nga ethet e tejkalimit të planit! Ca nëpër oxhaqe, ca nëpër galeritë e thella! Asnjëri nuk do t'i shkojë ndër mend të ruajë rrugëdaljet! Shpejto të marrim lëndën eksplozive!

Të dy u futën në galerinë e braktisur, e cila ishte shfrytëzuar vite më parë. Ecnin të kërrusur përmes pezhishkave të merimangave. Zhagan Dhogës i shungullonin veshët. Mihoja drejtoi baterinë e dorës midis disa kasave. U kacavar e futi kokën brenda.

«Sikur ta sulmoj! Ta mbërthej! Ti marr revolen! Ta vras përpara se të më vrasin!», — rrahën me forcë mendime të alarmuara në kokën e Zhaganit. Zgjati të dyja duart. Po Mihoja paskësh një intuitë prej dhelpre. Sikur e diktoi. Nxori kokën nga vrima. Zhagani futi duart në xhepa. Tjetri zbriti poshtë dhe ndriçoi vendin rreth e qark me elektrikun e dorës.

— Ku është eksplozivi?! Ku është ai druri që e kam lënë si shenjë?!, — pyeti dhe vrapoi si ndonjë derr i egër. U kacavar në një kapele tjetër. Futi kokën në një mazgallë, po përsëri u zmbraps. Frika sikur iu kthye në një iriq dhe e therte brenda në gjoks Zhaganin. «Mirë më thoshte gruaja, — tha me vete, — unë jam njeri që as të vret, as të fal! Nëse qëndrojmë kështu, minatorët do të na kapin».

Ecën krah njëri-tjetrit në thellësinë e galerisë. Kuterbonte erë e athët. Hundët u digjnin.

— Një dritë!, — thirri Zhagani i lebetitur.

— Mos thirr, mor derr! Ç'do drita në skëterë?!

— Ja!

— Është dru i fosforizuar, mor hajvan!

— Oh, — ofshani Zhagani me dorën në gjoks. Iu bë sikur frika si iriq po i futej në zemër.

— Ja huri, — foli Mihoja.

Zhagani pa një hu të ngulur në argjil. Mihoja u kacavar sipër një armature. Zhagani lëkund i hurin. E nxori prej andej. Sytë iu errësuan. Shtrëngoi hurin.

— Nuk janë as këtu!, — foli Mihoja duke kërcitur dhembët. Nxori kokën andej. Zhagani mbylli sytë e plasi në dënesje:

— Nuk mundem më. Ku të mbytem? Hajde ikim!, — dhe e mbërtheu për këmbë Mihon. E tërhoqi thellë me një forcë të jashtëzakonshme. Koka shogane e Mihos së trullo-sur hiqej osh mbi llucë. Ai hapi mengadalë sytë. Errësirë e thellë. Asgjë nuk dukej. Futi dorën në gji, shtrëngoi revolverin dhe e shkrehu me tahmina. Zhagani, sa dëgjoji krismën, lëshoi këmbën e Mihos dhe iku si i ndërkyer pa ditur se ku shkonte. Hovin nuk mundën t'ia ndalnin as minatorët që përgjonin. Zhagani fluturoi në oxhakun e braktisur duke lëshuar një klithmë të lemerishme.

Mihoja u ngrit me revole në dorë.

Dhjetëra llampa minatorësh u ndezën.

«Më bëjnë sytë! Jam në kllapi! Ç'duan dritat këtu! Ç'duan minatorët këtu!», — thirri Mihoja duke u sjellë rreth vetes si egërsira e rënë në kurth.

Dy duart të fuqishme e mbërthyen.

Miho Gjelaci e mori vesh se nuk shihte ëndërr! E kuptoi se e kishin rrethuar minatorët! Në fillim iu drodh i tërë trupi. Truri sikur i pushoi së punuari. Fare befasisht u dha dy krahëve, me sa forcë kishte e u shkëput. Një grusht i rëndë dhe i fuqishëm u derdh mbi nofullat e Agronit. Goditja qe aq e befasishme, sa që e shtroi përdhe minatorin. Ndërkaq Kujtimi ia mbërtheu Mihos krahun e lirë dhe ia përdrodi. Ai u përpoq të shqitej, po një shqelm u përplas mbi këmbën e djathtë të armikut, trupi i tij u vërvit pingulthi me fytyrë në llucë. Kujtimi i kërceu sipër, e kaploi, ia tërhoqi dhe krahun tjetër. Shoku i Sigurimit i vuri prangat.

Kurrizi i Mihos ulej dhe ngrihej nga turrfatjet historike.

Dhjetëra llampa dolën nga shumë galeri.

Mihoja puliti sytë. Ky është fundi më i tmerrshëm, — mendoj ai me vete, — duhet të përpiqem të shpëtoj!».

Ndërsa po i ngjitnin në sipërfaqe, ai qeshi.

— Përse më lidhët?, — pyeti dhe priti ca, pastaj vazhdoi: — Kur të merret vesh se si qe puna, do të më dekorojnë. — Mori frymë thellë. Heshtja e të tjerëve e tërhoqi. Filloi sërish dërdëllitjet. Thoshte se si Zhagani i paskësh vajtur

në kamp në Durrës dhe i paskësh thënë me mburrje se ato ditë do të hakmerrej kundër Kujtim Kreshpës. Mihoja e paskësh gjurmuar dhe...

Shoku i Sigurimit, që nuk i duronte dot ato llomotitje bajate, i tha:

— Ortaku të bën të fala! Llaqi Likoja ose Fiku, si të duash, me të vetët të presin në një vend të sigurtë!... Po të mësonte për ndërmarrjen..., Ortaku do të të puthte. Por ja, s'ka se si të ta dëgjojë zërin.

Mihoja zgurdulloi sytë. Ndërsa po ngjiteshin shkallëve, ai u anua rrufeshëm për t'u hedhur në pusin e thellë. Po shokët e Sigurimit dhe minatorët e mbajtën mirë. Njëri syresh i tha:

— Miho Gjelaci, nuk vdiset aq lehtë kur ke për të dhënë llogari!

K R E U XXIII

Në sallën e klubit «Minatori» ishin bashkuar tavolinat në tri radhë të gjata. Në gjysmëharkun e dalë kishte zënë vend orkestra e minierës. Minatorët e turnit «Sulmi» kishin zënë vend të gjithë bashkë rreth tavolinave. Në mes të radhës së parë ishin ulur Dilja tërë nur e Rama faqekuq, i cili ishte tepër i ngazëllyer; në të dyzeteshtatin vit të jetës po gëzonte gëzimin e martesës së parë. Atë mbrëmje të gjitha shikimet ishin drejtuar tek ai dhe Dilja. Në të djathtë të Diles kishin zënë vend Zana dhe Kujtimi. Karigia ngjitur me ta ishte bosh. Më tej rrinte Bukuria.

Sa herë ngriheshin gotat e uronin Ramën dhe Dilen, Bukuria shikonte portën e klubit.

— Kujtim, — i foli Zana të shoqit, — shiko si skuqet Rama. Ngjan me një tetëmbëdhjetëvjeçar të turpshëm.

— Të dyve u shkëlqejnë sytë, — tha Kujtimi.

— Kjo më duket dasma më e këndshme.

— Edhe mua, — tha Kujtimi, — shikoj dhe mendoj: për-
tëritja dhe gëzimi nuk njohin moshë. Mjaftojnë kushtet e

mira që lumturia dhe ngazëllimi të shpërthejnë e të lulëzojnë.

— Kujtim, Agroni të kërkon. Ja, atje, me të rinjtë, në radhën e tretë.

Kujtimi ngriti kokën.

Agroni i bëri shenjë me dorë, i tregoi Bukurien. Kujtimi ngriti supet. Agroni u foli diçka në vesh të rinjve, pastaj kaloi përmes tavolinave e iu afrua Kujtimit.

— Pse s'po vjen Lim Thana? Shokët propozojnë të vemi ta marrim, — i tha.

Filloi orkestra.

Drejtori i minierës u ngrit e me gotë në dorë iu afrua Diles dhe Ramës.

— Të trashëgojeni, shokë! — u tha e cakrroi gotat, pastaj u kthye ballë minatorëve e ngriti gotën në ajër: — Gëzuar shokë! Të trashëgohet çifti! Gëzuar Vitin e Ri!

— Gëzuar! Gëzuar! Gëzuar! — Të gjithë ngritën dollitë. Rama dhe Dilja ngritën gotat në ajër, po nuk i vunë në buzë.

Bukuria shikonte gjithnjë nga porta e klubit. Të gjithë shikonin në atë drejtim.

Porta u hap, në të u duk Dallëndyshja. Ajo i ngjante së ëmës, e gjatë e bukur, e thjeshtë. Me hapa të lehtë, pak e skuqur në fytyrë eci përmes tavolinave. Iu afrua të atit:

— Baba, Limi ka turp të futet. Ka një copë herë që i lutemi unë dhe Dardani. Ai ngurron. Ka turp.

— Çfarë tutkuni!, — tha Kujtimi.

— Limi më tha se kishte për të blerë një dhuratë, — tha Zana, — unë i besova.

— Baba, ec më ndihmo ta fusim brenda, — tha Dallëndyshja.

— E rëndon gabimi që ka bërë, nuk mund t'i dalë Bukuries përpara, — tha Kujtimi, u mbështet mbi karrigen bosh dhe i foli Bukuries: — Kjo karrige qan për të zotin...

Bukuria u skuq.

— Limi qëndron pas dere, dil merre.

— Jo, — tha Bukuria, — se si më vjen...

— Bukurie, — iu kërcënua Dilja duke i tundur gishtin tregues.